# ICD-10

# Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin

**Revizioni i 10-të**

**Vëllimi 1**
**Lista tabelare**

**Botimi i pestë**
**2016**

**Logo**

Titulli i librit:
“ICD-10 – Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve-të-lidhura-me-shëndetin”, Revizioni i 10-të,
Vëllimi 1 – Lista tabelare,
Botimi i pestë, OBSH 2016

Nga origjinali anglisht:
”ICD-10 – International statistical classification of diseases and related health problems”, 10th revision, Volume 1 – Tabular list,
Fifth edition, WHO 2016
[ISBN 978 92 4 154916 5 (NML:classification WB 15)]

Korrektimi i përkthimit shqip nga origjinali anglisht:
Prof. Dr. Eduard Kakarriqi

Redaktimi dhe editimi i botimit shqip: Prof. Dr. Eduard Kakarriqi

© Ministria e Shëndetësisë ka të drejtat e ribotimit

Shtëpia botuese:

ISBN

Tiranë 2016

Biblioteka Kataloguese e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) për Publikimin e të Dhënave.

Klasifikimi Statistikor Ndërkombëtar i Sëmundjeve dhe Problemeve-që-lidhen-me–Shëndetin, Revizioni (Rishikimi) i 10-të,

botimi i 5-të, 2016

3 v.(vëllime)

Përmbajtja: v. 1. Lista tabelare – v. 2. Manual i përdorimit – v. 3. Indeksi alfabetik.

1. Sëmundjet – klasifikimi. 2. Klasifikimi. 3. Manualet. I. OBSH. II. ICD-10.

ISBN 978 92 4 154916 5 (Klasifikimi NML: WB 15)

**© Organizata Botërore e Shëndetësisë 2011**
**Rishtypur më 2015**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Publikimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë janë në dispozicion në faqen e internetit të OBSH-së (www.who.int), ose mund të të blihen nga WHO Press, World Health Organization, 20 Avenue Appia , 1211 Geneva 27, Switzerland (tel.: +41 22 791 3264; fax: +41 22 791 4857; e-mail: bookorders@who.int).

Kërkesat për të lejuar riprodhimin apo përkthimin e publikimeve të OBSH-së – si për shitje ashtu dhe për shpërndarje jo-tregtare – duhen adresuar tek WHO Press nëpërmjet faqes së internetit të OBSH-së (http://www.who.int/about/licensing/copyright_form).

Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë opinioni nga ana e Organizatës Botërore të Shëndetësisë në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori, qyteti apo zone apo të autoriteteve të tij, ose në lidhje me caktimin e kufijve të tij. Linjat e ndërprera në harta paraqesin vijat kufitare të përafërta, për të cilat mundet ende të mos jetë arritur marrëveshje e plotë.

Përmendja e kompanive specifike apo prodhuesve të caktuar nuk do të thotë se ata janë miratuar ose të rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në preferencë kundrejt kompanive apo prodhuesve të tjerë të një natyre të ngjashme, që nuk janë përmendur. Gabimet dhe lëshimet e pritshme, emrat e produkteve të pronarit dallohen nga shkronjat fillestare kapitale.

Nga Organizata Botërore e Shëndetësisë janë marrë të gjitha masat e arsyeshme për të verifikuar informacionin e përfshirë në këtë publikim. Megjithatë, materiali i publikuar është duke u shpërndarë pa garanci të çfarëdo lloji, të shprehur apo të nënkuptuar.
Përgjegjësia për interpretimin dhe përdorimin e materialit qëndron me lexuesit. Organizata Botërore e Shëndetësisë nuk do të jetë në asnjë rast përgjegjëse për dëmet që rrjedhin nga përdorimi i tij.

Shtypur në Francë

# PËRMBAJTJA

**Hyrje**

**Falenderime**

**Përditësime**

**Trajnim**

**Qendrat Bashkëpunuese të OBSH-së për Familjen e Klasifikimeve Ndërkombëtare**

**Raporti i Konferencës Ndërkombëtare për Revizionin (Rishikimin) e 10-të të Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve** [*Diseases*]

**Lista e kategorive me tre-karaktere**

**Lista tabelare e përfshirjeve dhe nënkategoritë me katër–karaktere**

| | |
|---|---|
| I | Sëmundjet infektive dhe parazitare të përcaktuara |
| II | Tumoret |
| III | Sëmundjet e gjakut dhe organeve formuese të gjakut dhe disa çrregullime që prekin mekanizmin imunitar |
| IV | Sëmundjet endokrine, të ushqyerjes dhe metabolizmit |
| V | Çrregullimet mendore dhe të sjelljes |
| VI | Sëmundjet e sistemit nervor |
| VII | Sëmundjet e syrit dhe adnekseve (=kapakët e syrit, vetullat, aparati i lotimit) |
| VIII | Sëmundjet e veshit dhe proçesit mastoid |
| IX | Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut |
| X | Sëmundjet e sistemit të frymëmarjes |
| XI | Sëmundjet e sistemit të tretjes |
| XII | Sëmundjet e lëkurës dhe indit që ndodhet nën lëkurë |
| XIII | Sëmundjet e sistemit muskulo-skeletor dhe indit lidhës |
| XIV | Sëmundjet e sistemit uro-gjenital |
| XV | Shtatëzënia, lindja dhe lehonía |
| XVI | Disa gjendje shëndetësore që shfaqen në peridhën perinatale |
| XVII | Keqformimet kongjenitale, deformimet dhe abnormalitetet kromozomike |
| XVIII | Simptomat, shenjat dhe rezultatet jo-normale klinike dhe laboratorike të paklasifikuara diku tjetër |
| XIX | Traumat, helmimet dhe disa pasoja të tjera të shkaqeve të jashtme |
| XX | Shkaqet e jashtme të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë |
| XXI | Faktorët që ndikojnë në gjendjen e shëndetit dhe kontakti me shërbimet shëndetësore |

XXII Kode për qëllime të veçanta

**Morfologjia e Tumoreve (Neoplazmave)**

**Listat speciale tabelare për vdekshmërinë dhe sëmundshmërinë**

**Përkufizime**

**Rregullat që lidhen me nomenklaturën**

# Hyrje

Një klasifikim i sëmundjeve [*diseases*] mund të përkufizohet si një sistem kategorish, të cilit, entitetet nozologjike (=entitetet e sëmundjeve) i bashkëngjiten sipas disa kritereve të caktuara. Ekzistojnë disa mënyra klasifikimi dhe përzgjedhja e asaj që do të përdoret mvaret nga përdorimi statistikor i saj. Një klasifikim statistikor i sëmundjeve duhet të përfshijë të gjithë diapazonin (gjaninë) e gjendjeve morboze (=gjendjeve të të qenurit i/e sëmurë) brënda një numri të administrueshëm kategorish.

Revizioni i 10-të i Klasifikimit Statistikor Ndërkombëtar të Sëmundjeve [*Diseases*] dhe Problemeve Shëndetësore që-Lidhen-me-Shëndetin është i fundit në serinë e vet, i cili pat qenë zyrtarizuar më 1893 si Klasifikimi i Bertillon-it apo Lista Ndërkombëtare e Shkaqeve të Vdekjes. Një vështrim i plotë i historikut të klasifikimit jepet në Vëllimin 2. Ndërkohë që titulli u ndryshua për të bërë më të qartë përmbajtjen dhe qëllimin dhe për të pasyruar shtrirjen (zgjerimin dhe rritjen) progresive të fushës së klasifikimit përtej sëmundjeve dhe traumave, shkurtimi (=akronimi) i mirënjohur "ICD" u ruajt. Në klasifikimin e përditësuar, gjendet morboze u grupuan në një mënyrë të tillë, për t'u ndjerë si më të përshtatëshme për qëllimet e përgjithshme epidemologjike dhe vlerësimit të kujdesit shëndetësor.

Puna për Revizionin e Dhjetë të ICD-së filloi më shtator 1983, pikërisht kur Mbledhja Përgatitore për ICD-10 u zhvillua në Gjenevë. Programi i punës u drejtua, në mbledhjet e rregullta periodike, nga Drejtuesit e Qendrave Bashkëpunuese të OBSH-së për Klasifikimin e Sëmundjeve. Udhëzimi politik u sigurua nga një numër mbledhjesh të veçanta, përfshirë ato të Komitetit të Eksperteve të Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve të ICD-10, mbajtur më 1984 dhe 1987.

Krahas kontributeve teknike të siguruara nga shumë grupe specialistësh dhe ekspertë individualë, një numër i madh komentesh dhe sugjerimesh u morën nga Shtetet Anëtare të OBSH-së dhe Zyrat Rajonale të OBSH-së, si rezultat i një qarkullimi global të projekt-propozimeve për revizionin (rishikimin) më 1984 dhe 1986. Nga komentet e marra, u bë e qartë se shumë përdorues dëshironin që ICD-ja të përfshinte tipe të dhënash të tjera nga "informacioni diagnostik" (në kuptimin më të gjerë të fjalës) që ai kishte trajtuar më parë. Në mënyrë që të përshiheshin nevojat e këtyre përdoruesve, koncepti u ngrit në nivelin e "familjes" së klasifikimeve, përreth ICD-së tradicionale me formën dhe strukturën e saj. Vetë ICD-ja do të plotësonte kështu kërkesat e informacionit diagnostikues për qëllime të përgjithshme, ndërsa njëllojshmëria e klasifikimeve të tjera do të përdorej në lidhje të ngushtë me të dhe do të lidhej me aspekte të tjera (të ndryshme) të të njejtit informacion ose me informacione të ndyshme (kryesisht me proçedurat mjekësore dhe kirurgjikale edhe paaftësinë).

Në vazhdim të sugjerimeve të bëra në kohën e përpunimit të Revizionit (Rishikimit) të Nëntë të klasifikimit se një strukturë bazë e ndryshme do t'i shërbente më mirë nevojave të përdoruesve të shumtë e të ndryshëm, u vlerësuan një sërë modelesh alternative. Ndërkaq, u bë e qartë se skicimi tradicional me akse-variabël-unik të klasifikimit, dhe aspektet e tjera të

strukturës së tij, që përtheksonin gjendjet morboze më të shpeshta, me kosto dhe rëndësi (impakt) në shëndet publik, i rezistoi provës së kohës dhe se shumë përdorues do të ishin të pakënaqur me ndonjë nga modelet që ishin propozuar për zëvendësim.

Për rrjedhojë, siç do ta tregonte studimi i Revizionit (Rishikimit) të10-të, struktura tradicionale e ICD-së u ruajt, por skema e kodimit të mëparshëm numerik u zëvendësua nga një skemë e kodimit alfanumerik. Kjo siguron  një diapazon më të gjerë kodimi dhe lë hapësirë për revizion (rishikim) në të ardhmen pa prishur sistemin e numërimit, siç kishte ndodhur në revizionet (rishikimet) e mëparshme.

Për të arritur një optimum përdorimi të hapësirës së disponueshme, disa çrregullime të mekanizmit të imunitetit janë të përfshira në sëmundjet e gjakut dhe të organeve të formimit të gjakut (Kapitulli III). U krijuan kapituj të rinj për sëmundjet e syrit dhe adnekseve (=kapakët e syrit, vetullat, aparati i lotimit) dhe sëmundjet e veshit dhe proçesit mastoid. Klasifikimi suplementar i mëparshëm i shkaqeve të jashtme dhe i faktorëve që ndikojnë në gjendjen shëndetësore dhe kontakti me shërbimin shëndetësor janë tanimë pjesë e klasifikimit kryesor.

Sistemi dagger dhe asterisk i klasifikimit të dyfishtë për disa gjendje diagnostikuese, i përfshirë në Revizionin e Nëntë, u ruajt dhe madje u zgjerua, me akset asterisk të përfshira në kategoritë homogjene në nivelin me tre-karaktere.

## Përmbajtja e tre vëllimeve të ICD–10

Paraqitja e klasifikimit u ndryshua dhe tani ka 3 vëllime:

**Vëllimi 1. Lista Tabelare.** Ky vëllim përmban Raportin e Konferencës Ndërkombëtare për Revizionin (Rishikimin) e 10-të, klasifikimin me nivelet me tre- dhe katër-karaktere, klasifikimin e morfologjisë së neoplazmave (tumoreve), listat tabelare të posaçme për vdekshmërinë dhe sëmundshmërinë, përkufizimet, dhe nomeklaturën e rregulloreve.

**Vëllimi 2. Manuali i Udhëzimit.** Këtu paraqiten së bashku shënimet mbi çertifikimin dhe klasifikimin, të përfshira më parë në Vëllimin 1, por tanimë me shtesa të dukshme të çështjeve të reja, së bashku me problemet e instruktimit dhe të udhëzimit të përdorura në Vëllimin 1, mbi tabelimet dhe mbi planifikimin e përdorimit të ICD-së, që kishin munguar në botimet e mëparshme. Në këtë vëllim përfshihen gjithashtu materialet historike, që janë paraqitur ne pjesën e hyrjes së Vëllimit 1.

**Vëllimi 3. Indeksi Alfabetik.** Ky vëllim paraqet indeksin së bashku me hyrjen dhe udhëzimet e detajuara të përdorimit.

* * *

Klasifikimi u miratua nga Konferenca Ndërkombëtare për Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë të Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve [*Diseases*] më 1989 dhe u miratua nga Asambleja e 43-të e OBSH-së në rezolutën e mëposhtëme:

Asambleja e 43-të e OBSH-së,

Duke pasur parasysh Raportin e Konferencës Ndërkombëtare për Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë të Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve [*Diseases*];

1. MIRATON sipas Rekomandimeve të Konferencës, si më poshtë:
   (1) listën e detajuar të kategorive me tre-karaktere, dhe, si opsion, nënkategoritë me katër-karaktere, me Listat e Shkurtuara Tabelare për Vdekshmërinë dhe Sëmundshmërinë, që përbën Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë të Klasifikimit Statistikor Ndërkombëtar të Sëmundjeve dhe të Problemeve të-lidhura-me-Shëndetin, që do të hyjnë në fuqi më 1 Janar 1993;
   (2) përkufizimet, standardet dhe kërkesat e raportimit lidhur me vdekshmërinë amësore, fetale, perinatale, neonatale dhe foshnjore;
   (3) rregullat dhe udhëzimet për të nënvizuar kodimin e shkaqeve të vdekshmërisë dhe kushtet kryesore të kodimit të sëmundshmërisë;
2. I KËRKON Drejtorit-të-Përgjithshëm të botojë "Manualin e Klasifikimit Statistikor Ndërkombëtar të Sëmundjeve dhe të Problemeve të-lidhura-me-Shëndetin";
3. MBËSHTET rekomandimet e Konferencës lidhur me:
   (1) konceptin dhe jetësimin (implementimin) e familjes të sëmundjes [disease] dhe klasifikimeve të-lidhura-me-shëndetin, duke përdorur Klasifikimin Statistikor Ndërkombëtar të Sëmundjeve dhe të Problemeve të-Lidhura-me-Shëndetin si klasifikimin bazë, shoqëruar me një numër klasifikimesh suplementare dhe me Nomeklaturën Ndërkombëtare të Sëmundjeve;
   (2) vendosjen e një proçesi përditësimi brënda një cikli revizioni (rishikimi) dhjetë-vjeçar.

# FALENDERIME

Revizioni (rishikimi) periodik i ICD-së, qysh prej Botimit të Gjashtë më 1948, është koordinuar nga OBSH-ja. Me rritjen e përdorimit të klasifikimit, dhe kjo është e kuptueshme, u rrit dëshira midis përdoruesve për të kontribuar në proçesin e revizionit (rishikimit). Revizioni i Dhjetë është produkt i një aktiviteti të gjerë ndërkombëtar, i bashkëpunimit dhe i kompromiseve. OBSH i është mirënjohëse kontributit të grupeve të specialistëve ndërkombëtare dhe lokalë (kombëtarë), si dhe individëve të shumë vendeve.

OBSH falenderon me mirënjohje Qendren e Bashkëpunimit për Familjen e Klasifikimeve Ndërkombëtare që ndodhet pranë Institutit Gjerman për Informacionin dhe Dokumentacionin Mjekësor në Këln, Gjermani, dhe në veçanti Drejtorin e Qendrës Michael Schopen, për përditësimin e teksteve dhe për përgatitjen e dosjeve elektronike që u përdorën për këtë version të ICD-10.

# Përmirësime

Përmirësimet zyrtare të vëllimeve të botuara të ICD-10 janë të gatshme si lista vjetore ndryshimesh në faqen e internetit të OBSH për klasifikimet.

http://www.who.int/classifications

Këto përmirësime janë miratuar çdo vit në mbledhjet e Rrjetit të OBSH-së për Familjen e Klasifikimeve Ndërkombëtare.

Listat tregojne burimet e rekomandimeve dhe datat e zbatimit.

Data e miratimit është treguar për të gjitha ndryshimet, me përjashtim të listës së korrigjimeve të gabimeve.

# Trajnimi

Materialet zyrtare për vetë-trajnimin për ICD-10 dhe nje forum mbështetës online mund të aksesohen tek

http://www.who.int/classifications/icd/implementation/

Nje version për perdorim offline mund të shkarkohet tek

http://apps.who.int/classifications/apps/icd/ClassificationDownload/DLArea/OfflineTraining Package.zip

ose mund të kërkohet si CD-ROM.

# Qendrat Bashkëpunuese të OBSH-së për Familjen e Klasifikimeve Ndërkombëtare

Për të ndihmuar vendet që hasin probleme në zhvillimin dhe përdorimin e klasifikimeve dhe problemeve (ngjarjeve) të-lidhura-me-shëndetin, veçanërisht në përdorimin e ICD-së, OBSH-ja ka ngritur 13 Qendra Bashkëpunuese për Familjen e Klasifikimeve Ndërkombëtare.

Është e rëndësishme që çdo vend të verë në dijeni Qendrën përkatëse për çdo problem të rëndësishëm që mund të hasë gjatë përdorimit të ICD-së, dhe, veçanërisht, në rastet e sëmundjeve të reja, për të cilat ICD-ja nuk siguron një klasifikim të përshtatshëm. Deri tani, d.m.th. në Revizionet (Rishikimet) e mëparshme, pra deri në Revizionin (Rishikimin) e Nëntë, ICD-ja nuk ka qenë përditësuar përgjatë përdorimit të revizionit (rishikimit) të radhës, çka është propozuar të jetësohet (implementohet) përgjatë përdorimit të këtij Revizioni (Rishikimi), pra Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë (ICD-10), në kuptimin që, nëpërmjet Qendrave, të përdoret një mekanizëm për përdorimin e kodeve të përshtatshëm në rastin e sëmundjeve të reja, kur kjo është e arsyeshme.

Krahas Qendrave Bashkëpunuese zyrtare të OBSH-së, ekzistojnë një sërë qendrash kombëtare të referencës, të cilat duhet të konsultohen nga përdoruesit individualë; këta individë mund të kontaktojnë në zyrat kombëtare, në rastet kur ata ndeshen me probleme.

Ekzistojnë 3 Qendra për përdoruesit në gjuhën angleze.

Ju lutem kontrolloni online për listën më të fundit të qendrave të përcaktuara tek:

http://www.who.int/classifications/network/collaborating

Kërkesat duhet t'i drejtohen Kryesisë së Qendrës Bashkëpunuese të OBSH-së për Klasifikimin e Sëmundjeve në:

Australian Institute of Health and Welfare
(Instituti Australian i Shëndetit dhe Mirëqenies)
GPO Box 570
Canberra ACT 2601,
Australia

Health and Social Care Information Centre (HSCIC)
(Qendra e Informimit për Kujdesin Shëndetësor dhe Shoqëror)
Data and Information Service/Information Standards Delivery/Clinical
Classifications Service
Floor 2, Princes Exchange, Princes Square, LS1 4HY
Weat Yorkshire, United Kingdom of Great Britain and Norther Ireland

National Center for Health Statistics
(Qëndra Kombëtare e Statistikave të Shëndetit)

6525 Belcrest Road
Hyattsville, MD 20782
United States of America

Gjashtëmbëdhjetë Qendrat e tjera, secila bazuar në gjuhën individuale apo grup-gjuhësh, gjenden në institucionet në vijim:

School of Public Health of the University of Sao Paulo
Av Dr Arnaldo, 715
01246-904 Sao Paulo, Brasil

Peking Union Medical College (PUMC) Hospital
Chinese Academy of Medical Sciences (CAMS)
No1 Shuaifuyuan Hutong, Dondcheng District, Beijing 100730
People's Republic of China

INSERM-CépiDc
80 Rue du Général Leclerc
94270 Le Kremlin-Bicêtre Cedex, France

German Institute of Medical Dcumentation and Information (DIMDI)
Waisenhausgasse 36-38A, Köln 50676, Germany

Central Bureau of Health Intelligence (CBHI)
Directorate General of Health Services,
Ministry of Health & Family Welfare, New Delhi 110108, India

Direzione centrale salute integrazione sociosanitaria, politiche sociali e famiglia
Regione Autonoma Friuli Venezia Giulia
Via Pozzuolo 330 33100 Udie, Italia

IDC Office
Policy Planning Division
Statistics and Information Department
Minister's Secretariat,
Ministry of Health, Labour and Welfare
1-2-2 Kasumigaseki, Chiyodaku, Tokyo, Japan

Korea Health and Welfare Information Service
Dae-Kyo building 5F, 1107 Ho Gyae-dong
Dongan-gu Anyang-Si, Gyeonggi-Do 431-080
Republic of Korea

Office of Statistics and Medical Records
Health Information and Medical Records
Ministry of Health, Kuwait

Dirección General de Información en Salud
Subsecretaría de Integracíon y Desarrollo del Sector Salud
Secretaría de Salud
Reforma No 450 – 11 vo. Piso
Col Juárez, México DF

National Institute of Public Health and the Environment (RIVM)
PO Box 1, 3720 BA Bilthoven, The Netherlands,

Nordic centre for Classification in Health Care
Norwegian Directorate of Health
PO Box 7000, St Olav's Pass
NO-0130 Oslo, Norway

National Research Institute for Public Health
12 Vorontsovo Pole 12/1, 105064 Moscow, Russian Federation

Informatics and Knowledge Management Directorate
South African Medical Research Council
PO Box 19070, Tygerberg,
South Afrca 7505

Ministry of Public Health
Bureau of Policy and Strategy Office of the Permanent Secretary
Thai Health Standard Coding Center
Tiwanon Road Nonthaburi, 11000 Thailand

Centro Venezolano de Clasificación de Enfermedades
Cetro Coolaborador OPS/OMS para la CIE, en idioma español

Ministerio del Poder Popular para la Salud
Centro Simón Bolívar, Edif Sur, piso 3, Ofic.315
Ubr El Silencio, ZP: 1010, Caracas, DC
República Bolivariana de Venezuela

# Raporti i Konferencës Ndërkombëtare për Revizionin e Dhjetë të Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve

Konferenca Ndërkombëtare për Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë të Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve [*Diseases*] u organizua nga OBSH në Selinë e saj Qendrore në Gjenevë, nga 26 Shtator deri më 2 Tetor 1989. Në të morën pjesë delegatë nga 43 vende (shtete) anëtare:

- Angola
- Australia
- Bahamas
- Belgium
- Brazil
- Bulgaria
- Burundi
- Canada
- China
- Cuba
- Cyprus
- Denmark
- Finland
- France
- German Democratic Republic
- Germany, Federal Republic of
- Hungary
- India
- Indonesia
- Israel
- Japan
- Kuwait
- Luxembourg
- Madagascar
- Mali
- Malta
- Mozambique
- Netherlands
- Niger
- Portugal
- Republic of Korea
- Senegal
- Singapore
- Spain
- Sweden
- Switzerland
- Thailand
- Uganda
- Union of Soviet Socialist Republics
- United Arab Emirates
- United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland
- United States of America
- Venezuela

Kombet e Bashkuara, Organizata Ndërkombëtare e Punës dhe Zyrat Rajonale të OBSH-së dërguan përfaqësuesit e tyre në këtë Konferencë; të njejtën gjë bëri edhe Këshilli i Organizatave Ndërkombëtare të Shkencave Mjekësore, si dhe 12 organizata të tjera jo-qeveritare, si e regjistrit të kancerit, shurdh-memecëve, epidemiologjisë, mjekësisë familjare, gjinekologjisë dhe obstetrikës, hipertensionit, dokumentacioneve të shëndetit, mjekësisë sociale, mjekësisë parandaluese, neurologjisë, psikiatrisë, rehabilitimit, sëmundjeve seksualisht të transmetushme.

Konferenca u hap në emër të Drejtorit të Përgjithshëm, nga Dr J.- P. Jardel, Zv/Drejtor i Përgjithshëm. Dr. Jardeli foli mbi konsultimet e shumta dhe punën përgatitore që çuan në propozimet e revizionit (rishikimit) dhe që kërkuan një interval kohe më të madh se zakonisht midis dy revizioneve (rishikimeve). Ai vuri në dukje se Revizioni (Rishikimi) i Dhjetë do të kishte emërtim të ri, dhe konkretisht "Klasifikimi Statistikor Ndërkombëtar i Sëmundjeve [*Diseases*] dhe Problemeve të-Lidhura-me-Shëndetin", për të nxjerrë në dukje qëllimin e tij statistikor dhe për të pasqyruar zgjerimin e fushës së tij. Ndërkohë që shkurtimi (=akronimi) i përshtatshëm ICD nuk do të ndyshonte, pra do të ruhej. Ai përmendi gjithashtu skemën e re të kodimit alfanumerik, që krijonte mundësi për një balancë më të mirë midis përmbajtjes dhe kapitujve, duke i rezervuar vend shtesave apo ndryshimeve në të ardhmen, si dhe synimit për të përgatitur dhe botuar një manual të ICD-së me kategori tre-karakterëshe me një indeks alfanumerik, i cili do të përdorej në rastet kur versioni më kompleks prej katër-karakteresh do të rezultonte i papërshtatshëm.

Konferenca zgjodhi këta përfaqësues:

Dr R.H.C. Wells, Australi (Kryetar)

Dr H. Bay-Nielsen, Danimarkë (Nën/Kryetar)

Dr R. Braun, Republika Demokratike Gjermane (Nën/Kryetar)

Mr R.A. Israel, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Nën/Kryetar)

Dr R. Laurenti, Brazil (Nën/Kryetar)

Dr P. Maguin, Francë (Raportues)

Ms E. Taylor, Kanada (Raportues)

Sekretariati i Konferencës përbëhej nga:

Dr J.- P. Jardel, Ndihmës Drejtor i Pergjithshëm i OBSH-së ,Gjenevë,Zvicër

Dr H.R. Hapsara, Drejtor i Sektorit të Vrojtimit Epidemiologjik dhe Gjendjes Shëndetësore dhe Vlerësimit të Tendencave, OBSH, Gjenevë, Zvicër

Dr J.- C. Alary, Përgjegjës i Shërbimit Shëndetësor, Zhvillimi i Statistikave Epidemiologjike dhe Shëndetësore , OBSH , Gjenevë, Zvicër

Dr G.R. Brämer, Administrator Shëndetësor, Zhvillimi i Statistikave Epidemiologjike dhe Shëndetësore, OBSH, Gjenevë, Zvicër (Sekretar)

Mr A. L'Hours, Administrator Teknik, Zhvillimi i Statistikave Epidemiologjike dhe Shëndetësore, OBSH, Gjenevë, Zvicër

Professor W. Jänisch, Republika Demokratike Gjermane (Këshilltar i Përkohshëm)

Mr T. Kruse, Danimarkë (Këshilltar i Përkohshëm)

Dr K. Kupka, Francë (Këshilltar i Përkohshëm)

Dr J. Leowski, Poloni (Këshilltar i Përkohshëm)

Ms R.M. Loy, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (Këshilltar i Përkohshëm)

Mr R.H. Seeman, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Këshilltar i Përkohshëm)

Sekretariati i Konferencës përbëhej edhe nga përfaqësues të njësive të tjera teknike të Selisë Qendrore të OBSH-së.

Konferenca miratoi agjendën për përmbajtjen e propozuar të kapitujve të Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë dhe për materialet e përfshira në manualin për publikim; proçesin për paraqiten e tyre; dhe çështje të lidhura me familjen e klasifikimeve.

# 1. Historia dhe zhvillimi i përdorimeve të Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve (ICD)

Në Konferencë u kujtua historia impresionante e klasifikimit statistikor që fillon që në shekullin e 18-të. Ndërsa revizionet (rishikimet) e para të klasifikimit trajtonin vetëm shkaqet e vdekjes, diapazoni i tij u zgjerua në Revizionin (Rishikimin) e 6-të më 1948, ku u përfshinë sëmundjet jo-fatale. Ky zgjerim vijoi përgjatë revizioneve (rishikimeve) të mëpasshme deri në Revizionin (Rishikimin) e 9-të, me disa përmirësime të bëra për t'ju përshtatur nevojave të organizatave me kërkesa të ndryshme. Për më tepër, në Konferencën Ndërkombëtare të Botimit të 9-të (Gjenevë,1975) [1], u bënë dhe u miratuan rekomandime për publikim me qëllime vlerësimi (testimi) të klasifikimeve të proçedurave shtesë në mjekësi dhe në fushat e dëmtimeve, paaftësisve dhe handikapeve.

# 2. Analiza e aktiviteteve për përgatitjen e propozimeve për revizionin e dhjetë të ICD

Propozimet përpara fillimit të Konferencës ishin produkt i një aktiviteti të gjerë të selisë qendrore të OBSH- së, si dhe në të gjithë botën. Programi i punës u udhëhoq nga mbledhje të rregullta të udhëheqjes së Qendrave Bashkëpunuese të OBSH-së për Klasifikimin e Sëmundjeve [*Diseases*]. Politika drejtuese u përcaktua nga një numër mbledhjesh speciale dhe nga Komiteti i Eksperteve për Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve [*Diseases*] (ICD) në Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë, që u mbajt më 1984 [2] dhe 1987 [3], për të vendosur mbi drejtimin e punës dhe propozimet përfundimtare.

Aktiviteti i gjerë përgatitor iu dedikua një rishikimi rrënjësor të përshtatshmërisë së ICD-së, kryesisht lidhur me klasifikimin statistikor të sëmundjeve dhe problemeve të tjera të shëndetit, dhe për t'i shërbyer një numri të madh kërkesash, të dhënave për vdekshmërinë dhe kujdesin shëndetësor. U investiguan rrugët e stabilizimit të sistemit të kodimit për të minimizuar çrregullimet që do të mund të lindin në revizionet (rishikimet) e ardhshme, sikundër u pa edhe mundësia për të siguruar një balancë më të mirë midis përmbajtjes së kapitujve të ndryshëm të ICD-së.

Pavarësisht nga struktura e re, ishte e qartë se një klasifikim nuk do të kënaqte të gjitha kërkesat. Prandaj u zhvillua koncepti i "familjes", duke mbajtur ICD-në trungun kryesor si bazë, që do të mbulonte nevojat kryesore bazë të statistikave të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë tradicionale, ndërkohë që nevojat për klasifikimet më shumë ose më pak të detajuara, ose klasifikime të tjera me çështjet përkatëse, do të trajtoheshin nga anëtarët e tjerë të "familjes".

Nga Qendra Bashkëpunuese u investiguan modele të ndryshme alternative për strukturën e ICD-së, por rezultoi se secila syresh kishte karakteristika të pakënaqshme, dhe asnjëra nuk kishte avantazhe të dukshme ndaj strukturës ekzistuese, për të justifikuar zëvendësimin e saj. Mbledhjet e veçanta për vlerësimin e Revizionit (Rishikimit) të Nëntë të ICD, konfirmuan se, megjithëse disa përdorues potencialë e vlerësonin strukturën e ICD-së si të papërshtatshme, kishte një shumicë përdoruesish të kënaqur, të bindur se kjo strukturë kishte avantazhe të brendshme (natyrale), megjithë mospërputhjet e dukshme, dhe dëshironin që të vazhdohej me formën ekzistuese.

U ekzaminuan skema të ndryshme të informacionit alfanumerik me qëllim krijimin e një platforme kodimi që do t'u siguronte kapitujve një balancë më të mirë dhe do të lejonte një hapësirë të mjaftueshme për shtesat dhe ndryshimet e së ardhmes, pa dëmtuar këto kode.

Vendimet e marra për çështjet e mësipërme shtruan rrugën për përgatitjen e drafteve të kapitujve të propozuar për Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë. Të gjitha këto iu paraqiten dy herë Vendeve (Shteteve) Anëtare për komente, si dhe për rishikim, grupeve të tjera të interesuara, si mbledhjeve të Qendrës së Kryesisë dhe Komitetit të Ekspertëve. Një numër i madh shoqatash të profesionistëve ndërkombëtarë, specialistë individë dhe ekspertë, njësi të tjera të Selisë Qendrore të OBSH-së dhe zyrat rajonale ia paraqitën vërejtjet dhe udhëzimet e tyre njësisë përgjegjëse të OBSH-së për ICD-në si dhe Qendrave Bashkëpunuese të përgatitjes së propozimeve; për rrjedhojë, që materiali shoqërues u paraqit përpara zhvillimit të Konferencës. OBSH-ja u është mirënjohëse për këtë asistencë.

# 3. Karakteristikat e përgjithshme dhe përmbajtja e revizionit të dhjetë të ICD

E reja kryesore në propozimet e Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë ishte përdorimi i skemës koduese alfanumerike me një gërmë (shkronjë) e ndjekur nga tre shifra, pra nivel katër-karakteresh. Efekti ishte më shumë se dyfishimi i skemës së kodimit në krahasim me Revizionin (Rishikimin) e Nëntë, duke iu siguruar shumicës së kapitujve të përcaktoheshin me një gërmë të vetme ose grup gërmash, ku secili mund të garantonte 100 kategori tre-karakterëshe. Nga 26 gërma (shkronja) të vlefshme u përdorën 25 gërma (shkronja). Gërma (shkronja) "U" u la e lirë (vakante) për shtesa apo ndyshime në të ardhmen si dhe për klasifikime të mundshme të përkohshme, për të zgjidhur vështirësitë që mund të shfaqeshin në nivel kombëtar apo ndërkombëtar ndërmjet dy revizioneve (rishikimeve).

Për efekt strategjik, disa kategori tre-karakterëshe u lanë të lira (vakante) për zgjerim dhe revizion (rishikim) në të ardhmen, numri i të cilave varionte sipas kapitujve: për ata me aks primar anatomik u lanë më pak kategori vakante, pasi u gjykua se ndryshimet e së ardhmes në përmbajtjen e tyre do të ishin më të kufizuara, bazuar kjo në natyrën e tyre.

Revizioni (Rishikimi) i Nëntë përmbante 17 kapituj, plus dy klasifikime suplementare: Klasifikimi Suplementar i Shkaqeve të Jashtme të Traumave dhe Helmimeve (Kodi E) dhe Klasifikimi Suplementar i Faktorëve që Ndikojnë (Influencojnë) në Gjendjen Shëndetësore dhe Kontaktin me Shërbimet Shëndetësore (Kodi V). Ashtu siç u rekomandua nga Mbledhja Përgatitore e Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë (Gjenevë 1983) [4] dhe miratua nga mbledhjet vijuese, këta dy kapituj nuk u konsideruan më si suplementarë, por u përfshinë si pjesë përbërëse e klasifikimit bazë.

Renditja e hyrjes së kapitujve në propozimet për Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë, fillimisht ishte i njëjtë me atë të Revizionit (Rishikimit) të Nëntë. Megjithatë, për ta bërë më efektive hapësirën në dispozicion, çrregullimet e mekanizmit imunitar u përfshinë më pas në sëmundjet e gjakut dhe organeve gjak-formuese, ndërkohë që në Revizionin (Rishikimin) e Nëntë ato ishin të përfshira në sëmundjet endokrine, të të ushyerit dhe të metabolizmit. Kapitulli i ri "Sëmundjet e Gjakut dhe Organeve Gjak-formuese dhe disa Çrregullime të lidhura me Mekanizmin e Imunitetit" vijon pas Kapitullit "Neoplazmat (Tumoret)" dhe ndahen nga gërma D.

Gjatë përpunimit të drafteve fillestare të Kapitullit "Sëmundjet e Sistemit Nervor dhe Organeve të Shqisave", u bë shpejt e qartë se do të ishte e pamundur përfshirja e të gjitha detajeve ndën vetëm një gërmë (shkronjë) në 100 kategoritë tre-karakterëshe. Rrjedhimisht u vendos krijimi i 3 kapitujve të veçantë, konkretisht Kapitulli "Sëmundjet e Sistemit Nervor" me gërmën G, dhe 2 Kapitujt "Sëmundjet e Syrit dhe Adnekseve (=kapakët e syrit, vetullat, aparati i lotimit)" dhe "Sëmundjet e Veshit dhe Proçesit Mastoid", të cilët u përfshinë ndën të njëjtën gërmë – gërmën H.

Gjithashtu, Kapitujt "Sëmundjet e Sistemit Uro-Gjenital", "Shtatzënia, Lindja dhe Lehonìa", "Disa Gjendje Morboze të Periudhës Perinatale" dhe "Keqformimet Kongjenitale, Deformimet dhe Çrregullimet (Abnormalitetet) Kromozomike", u morën së bashku si kapituj në përbërje të përmbajtjes së vijueshmërisë ndërmjet Kapitujve nga XIV në XVII.

Me përfshirjen e klasifikimeve suplementare të mëparshme si pjesë e klasifikimit bazë dhe me krijimin e dy kapitujve të rinj, numri total i kapitujve në propozimin për Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë arriti në 21. Titujt e disa kapitujve u ndryshuan për të pasqyruar më mirë përmbajtjen e tyre.

Aty ku pati propozime radikale për ndryshim në ICD, testimi në praktikë tregoi për vlefshmërinë dhe saktësinë e tyre. Ky ishte konkretisht rasti i kapitujve të mëposhtëm:

V. Çrregullimet mendore dhe të sjelljes.

XIX. Dëmtimet, helmimet dhe disa pasoja nga shkaqe të jashtme.

XX. Shkaqe të jashtme të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë.

Kapitulli II, ”Neoplazmat (Tumoret)”, ishte po ashtu subjekt i një testimi në praktikë, rezultati i të cilit diktoi që ndryshimet në përmbajtjen e tij të ishin të një natyre thuajse të papërfillshme.

Disa nga veçoritë e reja të propozimeve të Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë të ICD, ishin si vijon:

- Shënimet përjashtuese në fillim të çdo kapitulli u zgjeruan për të shpjeguar hierarkinë relative të kapitujve, dhe për të qartësuar se kapitujt e “grupeve speciale” kishin përparësi përcaktimi kundrejt kapitujve të sistemit apo të organeve, dhe, se brenda kapitujve të grupeve speciale, ata të “Shtatzënisë, Lindjes dhe Lehonisë” dhe të “Disa Gjendjeve Morboze të Periudhës Perinatale”, kishin përparësi ndaj të tjerëve.

- Gjithashtu, në fillim të çdo kapitulli jepej një vështrim i shkurtër i blloqeve të kategorive tre-karakterëshe, dhe, aty ku ishte e arsyeshme, kategoritë me *asterisk* (=të yllëzuara); duhet theksuar se kjo u bë për të qartësuar strukturën e kapitujve dhe për të lehtësuar përdorimin e kategorive me *asterisk* (=të yllëzuara (*)).

- Shënimet në listën tabelare aplikohen për të gjitha përdorimet e klasifikimit; nëse një shënim ishte i vlefshëm vetëm për sëmundshmërinë ose vetëm për vdekshmërinë, ai u përfshi në shënimet e veçanta që shoqëronin si rregullat e kodimit të sëmundshmërisë ashtu edhe ato të vdekshmërisë.

- Revizioni (Rishikimi) i Nëntë kishte identifikuar një numër të caktuar kushtesh (problemesh) shëndetësore si kushte apo probleme shëndetësore të induktuara (=prejadhura, origjinuara) nga përdorimi i barnave [“*drug-induced health-related conditions*”]. Ky përafrim vijoi edhe në hartimin e propozimeve për Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë, ku shumë kushte të tilla u identifikuan si të veçanta.

Një inovacion i rëndësishëm ishte krijimi në fund të disa kapitujve të veçantë i kategorive për

çrregullimet pas-proçeduriale. Këto identifikonin kushtet e rëndësishme që përbënin një problem të kujdesit shëndetësor në kuptimin e vërtetë të fjalës dhe përfshinin shembuj të tillë si sëmundjet endokrine dhe sëmundjet metabolike me pasojë çrregullimin e një organi dhe kushte të tjera specifike, të tilla si sindroma e heqjes e postgastrektomi-së. Kushtet pas-proçeduriale që nuk ishin specifike për një sistem trupor të veçantë, me pasojë komplikacione të menjëhershme, të tilla si emboliza dhe shoku postoperator, vazhduan të klasifikoheshin në kapitullin "Traumat, helmimet dhe disa pasoja të tjera nga shkaqet e jashtme".

Një ndyshim tjetër ishte se në Revizionin (Rishikimin) e Nëntë, titujt katër-shifrorë shpesh duhet të lexoheshin në kombinim me titujt tre-shifrorë për të siguruar kuptimin e plotë dhe qëllimin e nënkategorisë, ndërkohë që në draftin e paraqitur në Konferencë, titujt ishin thuajse të pandryshuar, të plotë dhe mund të qendronin më vete.

Skema e klasifikimit të dyfishtë të etiologjisë dhe simptomave, e njohur si sistemi dagger (=simboli †) dhe asterisk (=simboli "yll" *), i futur në Revizionin (Rishikimin) e Nëntë, ka qenë subjekt i një kritike të vazhdueshme. Kjo lidhej kryesisht me faktin se klasifikimi shpesh përmbante një kombinim të simptomave me informacione të tjera në nivelet tre- dhe katër-shifror, me të njëjtën etiketë diagnostikimi, që shpesh çfaqej në të dy akset. Për më tepër, shumë e konsideronin atë si mjaft të pakuptueshëm. Për të kapërcyer këto probleme, në draftin e Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë, informacioni i yllëzuar (pra me asterisk), përmbahej në 82 kategori homogjene tre-karakterëshe për përdorim opsional. Kjo (për)qasje mundësonte raportet e diagnozës, të cilat përmbanin informacionin mbi proçesin e sëmundjes bazë dhe një manifestimi klinik apo ndërlikimi (komplikacioni) klinik në një organ të veçantë, që të merrnin dy kode, duke lejuar rekuperimin apo tabelimin në përputhje me akset e tyre.

Këto karakteristika të propozuara për Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë u pranuan nga Konferenca.

Secili kapitull u paraqit në Konferencë me një prezantim të ndyshimeve të adoptuara që nga Revizioni (Rishikimi) i Nëntë, së bashku me disa informacione sqaruese rreth përmirësimeve. Në Konferencë u diskutuan, disa çështje të lidhura me strukturën dhe përmbajtjen e kapitujve, dhe së fundi marrëveshja u arrit në Sekretariat.

# 4. Standardet dhe përkufizimet lidhur me shëndetin e nënës dhe fëmijës

Konferenca konsideroi me interes përcaktimet, standardet dhe kërkesat raportuese të rekomanduara për Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë, lidhur me vdekshmërinë amësore si dhe me vdekshmërinë fetale, perinatale, neonatale dhe foshnjore. Këto rekomandime ishin rezultat i një sërë mbledhjesh speciale dhe konsultimesh dhe patën për qëllim përmirësimin e krahasueshmërisë së të dhënave.

Konferenca vendosi se ishte e dëshirueshme të ruheshin përkufizimet e "lindjes së gjallë" dhe "vdekjes fetale", ashtu siç ishin në Revizionin (Rishikimin) e Nëntë.

Pas disa diskutimesh, Konferenca ngriti një grup pune lidhur me vdekshmërinë amësore (të nënës), dhe mbështetur në rekomandimet e saj, vendosi gjithashtu të ruante përkufizimet e vdekshmërisë amëtare, ashtu siç ishin në Revizionin (Rishikimin) e Nëntë.

Për të përmirësuar cilësinë e të dhënave rreth vdekshmërisë amëtare, dhe për të siguruar metoda alternative për mbledhjen e të dhënave mbi vdekjet gjatë shtatzënisë ose të lidhura me të, si dhe për të inkurajuar regjistrimet e vdekjeve nga shkaqet obsetrikale që ndodhin 42 ditë përpara mbarimit të shtatzënisë, nga grupi i punës u formuluan dy përcaktime shtesë për "vdekshmërinë e lidhur me shtatzëninë".

Konferenca:

> REKOMANDOI që vendet anëtare të merrnin parasysh përfshirjen e çertifikatave të vdekjes të çështjeve që lidhen me shtatzëninë në momentin aktual të kohës dhe shtatzënisë brenda një viti përpara vdekjes në çdo rast konkret.

Konferenca vendosi që, pasi numri i lindjve "të gjalla" ishte shumë më tepër i njohur universalisht se sa numri i "lindjeve totale" (lindjet "e gjalla" plus "vdekjet fetale"), kjo duhej përdorur si emërues i përbashkët në raportet që lidhen me vdekshmërine amësore (të nënës) [siç përmëndet në Vëllimin 2].

Lidhur me vdekshmërinë perinatale, neonatale dhe foshnjore, u rekomandua me forcë që nivelet e publikuara të bazuara në kohortet e lindjeve (=kohort-lindjet) duhej të identifikoheshin dhe të diferencoheshin në këtë mënyrë.

Konferenca konfirmoi praktikën e të shprehurit të moshës në njësi të plota të kohës, duke caktuar ditën e lindjes si ditën zero.

Konferenca

> REKOMANDOI përfshirjen në manualin e Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë të ICD-së, të përkufizimeve, standardeve dhe kërkesave të raportimit që lidhen me vdekshmërinë amësore (të nënës) dhe vdekshmërisë fetale, perinantale, neonatale dhe foshnjore.

# 5. Kodimi, rregullat e përzgjedhjes dhe listat tabelare

## 5.1. Rregullat e kodimit dhe të përzgjedhjes për vdekshmërinë

Konferenca u informua rreth proçesit të rishikimit të rregullave të përzgjedhjes dhe modifikimit për shkaqet bazë të vdekjes dhe të shënimeve shoqëruese, ashtu siç ato ishin në Revizionin (Rishikimin) e Nëntë, çka rezultoi me disa ndryshime të rekomanduara në rregullat dhe me

ndryshime të ndjeshme në shënimet (sqarimet).

Konferenca

> REKOMANDOI që rregullat e përzgjedhjes të shkaqeve të vdekjes për tabelimin e vdekshmërisë kryesore, ashtu siç paraqiteshin në Revizionin (Rishikimin) e Nëntë, të zëvendësoheshin në Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë [me ato që përmbahen në Vëllimin 2].

Konferenca vuri në dijeni disa shënime shtesë për përdorimin në kodimin e shkaqeve bazë dhe në interpretimin e aplikimit të shkaqeve të vdekjes, të cilat u paraqitën si draft dhe u rishikuan. Meqënëse këto shënime kishin për qëllim përmirësimin e stabilitetit në kodim, Konferenca miratoi që ato të përfshiheshin në Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë.

Konferenca vuri në dukje përdorimin e gjerë të kodimit të një shumatore ngjarjesh (konditash/kushtesh) shëndetësore dhe analizës për shkaqet e vdekjes. Ajo shprehu inkurajimin për aktivitete të tilla, por nuk rekomandoi që Revizioni (Rishikimi) i Dhjetë duhej të përmbante rregulla apo metoda të tjera që duheshin ndjekur në analizën e të dhënave.

Duke pasur parasysh Fomularin Ndërkombëtar të Çertifikatës Mjekësore të Vdekjes, Komiteti i

Ekspertëve pranoi se situata e një popullate të moshuar me një proporcion më të madh të vdekjeve nga sëmundjet e shumëfishta dhe efektet e ndërhyrjeve terapeutike përkatëse, tentonte të rriste numrin e gjendjeve të mundshme midis shkakut bazë dhe shkakut të drejtpërdrejtë të vdekjes: kjo do të thoshte se një numër në rritje i kushteve kishin hyrë në Çertifikatat e Vdekjeve të shumë vendeve. Kjo gjë e detyroi Komitetin të rekomandonte përfshirjen e një linje shtesë (d) në Pjesën I të Çertifikatës.

Rrjedhimisht Konferenca:

> REKOMANDOI që, me indentifikimin e një nevoje, vendet anëtare të konsideronin mundësinë e përfshirjes së një linje (rreshti) shtesë (d) në Pjesën I të Çertifikatës mjekësore të Vdekjes.

## 5.2. Kodimi dhe rregullat e përzgjedhjes për sëmundshmërinë

Për herë të parë, Revizioni (Rishikimi) i Nëntë, përmbante udhëzues mbi regjistrimin dhe kodimin e sëmundshmërisë, dhe veçanërisht për përzgjedhjen e një kushti të vetëm për paraqitjen e statistikave të sëmundshmërisë. Eksperienca e fituar në përdorimin e përkufizimeve dhe rregullave të Revizionit (Rishikimit) të Nëntë provoi vlefshmërinë e tyre dhe gjeneroi kërkesa për sqarimin e tyre, për përpunim të mëtejshëm lidhur me regjistrimin e informacionit diagnostikues nga praktikantët e kujdesit shëndetësor, dhe për më shumë orientim në rastet e situatave problematike specifike.

Konferenca miratoi Rekomandimet e Konferencës së Revizionimit të vitit 1975 mbi konditat që duhej të përzgjidheshin për analizat një-konditëshe të episodeve të kujdesit shëndetësor, dhe parashtroi që, aty ku është i praktikueshëm, duhej ndërmarrë kodimi shumë-konditësh dhe analiza e tij për të plotësuar statistikat rutinë. U theksua se Revizioni (Rishikimi) i Dhjetë duhej ta bënte të qartë se shumica e udhëzuesëve ishte e përdorshme vetëm kur tabelimi i "konditës kryesore" për një episod ishte i përshtatshëm dhe kur koncepti i një "episodi" në vetvete ishte i

përputhshëm (relevant) me mënyrën se si mbledhja e të dhënave ishte organizuar.

Rrjedhimisht, Konferenca:

> REKOMANDOI se në Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë duheshin përfshirë udhëzues shtesë mbi regjistrimin dhe kodimin e sëmundshmërisë, dhe se përkufizimet e "konditës kryesore" dhe "konditave të tjera", duhet të inkorporoheshin, së bashku me rregullat e modifikuara për të trajtuar ato që ishin evidentuar qartë në mënyrë jo korrekte si " kondita kryesore". [Këto janë të përfshira në Vëllimin 2.]

Konferenca gjithashtu:

> REKOMANDOI se, aty ku "kondita kryesore" është subjekt i sistemit të klasifikimit të dyfishtë në ICD, duhej të regjistroheshin si kodet "dagger" (me kryq) ashtu edhe ato "asterisk" (me yll), për të lejuar tabelimin alternativ të secilit prej tyre.

Konferenca pranoi se duhej të shtoheshin shënimet e zgjeruara dhe shembujt, për të siguruar asistencë të mëtejshme.

## 5.3. Lista e tabelimeve për vdekshmërinë dhe sëmundshmërinë

Konferenca u informua rreth vështirësive që kishin lindur në përdorimin e Listës së Tabelimit Bazë të Revizionit (Rishikimit) të Nëntë dhe rreth aktiviteteve që ishin ndërmarrë, veçanërisht nga OBSH-ja, për zhvillimin e listave të reja për tabelimin dhe publikimin e të dhënave të vdekshmërisë. Në këtë proçes u bë e qartë se në shumë vende vdekshmëria deri në moshën 5 vjeç ishte një tregues më i fortë se sa vdekshmeria foshnjore, dhe prandaj do të ishte e preferueshme prania e një liste që të përfshinte vdekjet foshnjore dhe vdekjet e fëmijëve deri në moshën 5 vjeç (=vdekjet fëmijënore).

Për t'u konsideruar e pëlqyeshme nga Konferenca, u përgatitën dy versione të listës së vdekshmërisë së përgjithëshme dhe listës së vdekshmërisë foshnjore dhe fëmijënore, ku në versionin e dytë përfshiheshin titujt e kapitujve dhe zërat mbetës për kapitujt.

Meqënëse u shprehën disa shqetësime lidhur me listat e vdekshmërisë, ashtu siç u paraqitën në raport, u krijua një grup i vogël pune për të bërë të mundur përfshirjen e disa zërave shtesë. Raporti i grupit të punës u pranua nga Konferenca dhe pasqyrimi i tij është në listat e vdekshmërisë.

Për çështjen e listave të tabelimit të sëmundshmërisë, Konferenca rishihi si listën e tabelimeve që u propozua, ashtu edhe listën e modelit të publikuar i bazuar në titujt e kapitujve, ku zërat e zgjedhur ishin përfshirë si shembuj nën secilin titull. Një shqetësim i konsiderueshëm u shpreh rreth përdorimit të listave të tilla të sëmundshmërisë në kuptimin më të gjerë të fjalës. U pranua njëzëri që listat që u paraqitën i përshtateshin më mirë sëmundshmërisë, madje u ndje nevoja e

përpjekjeve që duheshin bërë për zhvillimin e listave të përshtatshme edhe për aplikime të tjera të sëmundshmërisë, si dhe që të dyja listat e tabelimit të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë në Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë duhej të shoqëroheshin nga shpjegime dhe instruksione të përshtatëshme përdorimi.

Nën dritën e shqetësimeve që u ngritën në Konferencë dhe konkluzioneve të grupit të punës, Konferenca pranoi se tabelimet dhe listat e publikimeve duhej të përfshiheshin në Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë, ndërkohë që duhej bërë përpjekje për t'i bërë më të qartë shumë tituj përshkrues për këto lista. Gjithashtu, u ra dakord, që për të lehtësuar tabelimin alternativ të kategorive me asterisk, duhej të zhvillohej një version i dytë i tabelimit të sëmundshmërisë, që të përfshinte kategoritë me asterisk.

# 6. Familjet e klasifikimeve

## 6.1 Koncepti i Familjes së Klasifikimeve

Gjatë përgatitjes së Revizionit (Rishikimit) të Nëntë, kishte qenë konstatuar se vetëm ICD-ja nuk do të mund të mbulonte të gjithë informacionin e kërkuar dhe se vetëm një "familje" e sëmundjes dhe klasifikimet përkatëse të shëndetit nuk do të mund të kënaqnin kërkesat e ndyshme të shëndetit publik. Rrjedhimisht, që nga fundi i viteve 1970, kishin qenë parashikuar zgjidhje të ndyshme, njëra prej të cilave kërkonte një klasifikim më rrënjësor të ICD-së, duke parashikuar një sërë modulesh, disa të lidhur në mënyrë hierarkike dhe të tjerët të një natyre suplementare.

Pas studimeve dhe diskutimeve, në bashkëpunim me Qendrat Bashkëpunuese, u përpunua koncepti i familjes së klasifikimeve të familjeve, i cili u rishikua hollësisht nga Komiteti i Ekspertëve më 1987, që rekomandoi skemën "Familja e sëmundjeve [*diseases*] dhe klasifikimi përkates shëndetësor" të paraqitur më poshtë.




Konferenca

REKOMANDOI që koncepti i familjes së sëmundjes dhe klasifikimet përkatëse shëndetësore duhej të ndiqeshin (përpunoheshin) nga OBSH-ja.

Për të ruajtur integritetin e vetë ICD-së dhe të këtij koncepti të familjes, Konferenca:

REKOMANDOI që, në interes të krahasueshmërisë ndërkombëtare, përmbajtja e kategorive tre-karakterëshe dhe nënkategorive katër-karakterëshe të Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë në përgatitje e sipër për përshtatje, nuk do të pësonte ndryshim (siç tregohet nga titujt), veç rasteve kur do të autorizohej nga OBSH-ja. Sekretariati i OBSH-së është përgjegjës për ICD-në dhe vepron si një qendër autorizuese për çdo publikim (me përjashtim të publikimeve statistikore kombëtare) ose përkthim që varen prej tij. OBSH-ja duhet të njoftohet menjëherë mbi qëllimin e prodhimit të përkthimeve apo përshtatjeve ose të klasifikimeve të tjera që lidhen me ICD-në.

Konferenca pa me interes paraqitjen (prezantimin) e përdorimit dhe lidhjes së anëtarëve të ndryshëm të familjes ICD nën prizmin e vlerësimit mjekësor-shoqëror dhe multidimensional të moshës së tretë, jo vetëm lidhur me shëndetin por edhe me aktivitetet e jetës së përditshme, si dhe lidhur me mjedisin shoqëror e fizik. U demonstrua se informacioni efektiv mund të përftohej nga përdorimi i ICD-së dhe i Klasifikimit Ndërkombëtar të Dëmtimeve, Paaftësive dhe Handikapeve

(ICIDH – *International Classification of Impairments, Disabilities, and Handicaps*), dhe veçanërisht nëpërmjet përdorimit të kodeve të propozuara në Kapitullin XXI të Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë.

## 6.2 Përshtatjet sipas subjekteve (apo bazuar-në-specialitete)

Konferenca u informua rreth planeve për zhvillimin e përshtatjeve të Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë në fushën e programit të shëndetit mendor. Udhëzuesi klinik do të shoqëronte versionin e përdorur nga klinicistët që punojnë në fushën e psikiatrisë; kriteret e kërkimit do të propozoheshin për përdorim në hulumtimet e problemeve të shëndetit mendor; dhe, do të zhvilloheshin prezantimet multi-aksiale për përdorim në rastet e çrregullimeve fëmijënore dhe për klasifikimin e problemeve të të rriturve, sikundër edhe një version për përdorim nga praktikantët e përgjithshëm. Përpilimi (ndërtimi) i kodeve ICD të psikiatrisë dhe neurologjisë do të realizohej në përputhje po ashtu me publikimet e mëparshme mbi këtë subjekt.

Konferenca dëgjoi gjithashtu rreth metodave të përdorura për të siguruar që struktura bazë dhe funksioni i ICD-së të ruheshin gjatë zhvillimit fillestar të aplikimit për specialistët stomatologë (ICD-DA), si dhe u njoftua se një botim i ri i ICD-DA, që lidhej me Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë, ishte në fazën finale të përgatitjes.

Një prezantim i veçantë u bë mbi Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve në fushën e Onkologjisë (ICD-O – *International Classification of Diseases for Oncology*), Botimi i Dytë, me klasifikim multi-aksial, përfshirë topografinë dhe morfologjinë e neoplazmave. Kodet e morfologjisë të ICD-O-së, që ishin përpunuar gjatë një periudhe të gjatë kohe, u rishikuan dhe u testuan gjerësisht në praktikë. Kodet topografikë të botimit të dytë do të bazoheshin në kategoritë C00-C80 të Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë, ndërkohë që publikimi do të priste deri sa Asambleja Botërore e Shëndetit të miratonte Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë.

U arrit një marrëveshje mbi vlerën e një adaptimi në fushën e praktikës së përgjithshme mjekësore dhe Konferenca u informua mbi gatishmërinë e grupeve të punës në këtë fushë për të bashkëpunuar me OBSH-në. Lidhur me përshtatjet e tjera sipas subjekteve (apo bazuar-në-specialitete), që dukeshin se po bëheshin gjithnjë e më të shumta, roli autorizues i OBSH-së u konsiderua si shumë i rëndësishëm.

## 6.3 Mbështetja e informacionit ndaj shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor

Në përputhje me rekomandimet e Konferencës së Revizionit (Rishikimit) të vitit 1975, më 1976 në Delhi u ngrit një grup pune për Azinë Jug-Lindore nga Zyra Rajonale e OBSh-së. U hartua një listë e detajuar e bashkësive të simptomave, prej nga ku, rrodhën dy lista të shkurtëra– njëra për shkaqet e vdekjes dhe tjetra për arsyet e kontaktit të shërbimeve shëndetësore. U krye prova në

praktikë për këtë sistem në vendet e rajonit dhe rezultati ishte revizioni (rishikimi) i listës së familje të simptomave dhe të formave të raportimit.Versioni i revizionuar (rishikuar) u botua nga OBSH-ja me 1978 në broshurën "*Raportimi jo-profesional i informacionit shëndetësor*".

Strategjia Globale (Botërore) "Shëndet për të Gjithë në Vitin 2000", e lançuar më 1978, rriti numrin e sfidave për zhvillimin e sistemeve të informacionit tek Vëndet Anëtare. Në Konferencën Ndërkombëtare mbi Statistikat Shëndetësore për Vitin 2000 (Bellagio, Itali, 1982), integrimi i informacionit të "raportit të papërpunuar profesionalisht" me informacione të tjera për t'u përdorur për qëllime administrimi të shëndetit, u identifikua si problemi kryesor që pengonte zbatimin më të gjerë të skemave të raportimit global. Konsultimi i Klasifikimit të Kujdesit Parësor (Gjenevë 1985) theksoi nevojën e një përafrimi, që do të mund të unifikonte suportin e informacionit, administrimin e kujdesit shëndetësor dhe shërbimet ndaj komunitetit nëpërmjet informacionit të bazuar në raportimin jo-profesional në kuptimin më të gjerë.

Konferenca u informua rreth eksperiencës së vendeve në zhvillim dhe në aplikimin e informacionit shëndetësor bazuar në komunitet, që mbulonte problemet dhe nevojat shëndetësore, faktorët e lidhur me riskun dhe burimet përkatëse. Konferenca mbështeti konceptin e zhvillimit të metodave jo-konvencionale në nivel komuniteti, si një metodë që mbushte boshllëkun e informacionit në vende të veçanta, duke forcuar sistemet e tyre të informacionit. U theksua se, si për vendet e zhvilluara ashtu edhe për ato në zhvillim, metoda apo sisteme të tilla duhej të zhvilloheshin bazuar në specifikat lokale, dhe se për shkak të faktorëve të tillë si modelet e sëmundshmërisë si dhe ndryshimet në gjuhë dhe kulturë, nuk duhej tentuar transferimi në zona apo vende të tjera.

## 6.4 Dëmtimet (Traumat), Paaftësitë dhe Handikapet

Klasifikimi Ndërkombëtar i Dëmtimeve (Traumave), Paaftësive dhe Handikapeve (ICIDH – *International Classification of Impairments, Disabilities, and Handicaps*) u botua nga OBSH-ja në anglisht më 1980 për qëllime testimi (prove), në përputhje me rekomandimet e Konferencës së Revizionimeve (Rishikimeve) të vitit 1975 dhe Rezolutës WHA29.35 të Asamablesë Botërore të Shëndetit të vitit 1976. Që prej asaj kohe, kërkimi dhe zhvillimi i klasifikimit ka ndjekur një sërë rrugësh.

Përkufizimet kryesore të tre elementëve – dëmtimi (trauma), paaftësia dhe handikapi kanë qenë pa dyshim instrumenta të rëndësishëm për të ndyshuar qëndrimin ndaj paaftësisë. Përkufizimi i dëmtimit (traumës), një fushë ku ka pasur shumë mbivendosje me termat në ICD, u pranua gjerësisht. Përkufizimi i paaftësisë u përputh gjerësisht me provën në praktikë të grupeve dhe profesionistëve të rehabilitimit, ndonëse u ndie nevoja për t'i kushtuar më shumë vemendje kodit shoqërues të shkallëzimit të rëndesës (ashpërsisë, severitetit), që shpesh ishte si parathënës (diktues) i handikapit. Pati gjithashtu kërkesa në rritje për të rishikuar përkufizimin e handikapit, për të theksuar më shumë bashkëveprimin me ambientin.

Evolucioni i shpejtë i ideve dhe praktikave në administrimin e paaftësisë rezultoi në rishikimin e

ICIDH pikërisht në kohën që do t'i paraqitej Konferencës. U tha se publikimi i një version të ri ishte pak i mundur përpara jetësimit (implementimit) të Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë.

## 6.5 Proçedurat në mjekësi

Klasifikimi Ndërkombëtar i Proçedurave në Mjekësi (ICPM – *International Classification of Procedures in Medicine*) u botua nga OBSH-ja më 1978 për qëllime testimi, në përputhje me rekomandimet e Konferencës së Revizionimeve të vitit 1975 dhe Rezolutës WHA29.35 të vitit 1976. Klasifikimi u adoptua nga pak vende dhe u përdor si bazë për klasifikimin kombëtar të operacioneve kirurgjikale nga një sërë vendesh të tjera.

Kryesitë e Qendrave Bashkëpunuese të OBSH-së për Klasifikimin e Sëmundjeve pranuan se proçesi i draftimit (skicimit) të propozimeve, përftimit të komenteve, ridraftimit (riskicimit) dhe kërkimit të komenteve të mëtejshme ndaj të cilave OBSH-ja duhej të reagonte përpara finalizimit dhe publikimit, ishte i papërshtatshëm në një fushë të tillë që avanconte shumë shpejt, siç ishte ajo e proçedurave. Prandaj Kryesitë e Qendrave Bashkëpunuese të OBSH-së rekomanduan që ICPM-ja nuk do të pësonte asnjë ndryshim në Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë të ICD-së.

Më 1987, Komiteti i Ekspertëve i kërkoi OBSH-së të merrte parasysh përditësimin në Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë, të paktën në përmbledhjen e Kapitullit të 5, "Proçedurat Kirurgjikale", të ICPM në provë (testim). Si përgjigje e kësaj kërkese dhe si nevojë e shprehur nga shumë vende, u bë një përpjekje nga Sekretariati për të përgatitur një listë tabelare për proçedurat.

Kjo listë iu paraqit Kryesive të Qendrave Bashkëpunuese të OBSH-së në mbledhjen e tyre më 1989 dhe u ra dakord se ajo do të mund të shërbente si udhëzues për paraqitje ose botim statistikor kombëtar të proçedurave kirurgjikale dhe se do të lehtësonte krahasimin ndërmjet vendeve të ndyshme. Qëllimi i listës ishte të identifikonte proçedurat dhe grupet e proçedurave dhe t'i përcaktonte ato si bazë për zhvillimin e klasifikimeve kombëtare, duke përmirësuar kështu krahasueshmërinë e klasifikimeve.

Konferenca rezultoi se një listë e tillë ishte me vlerë dhe se puna duhej të vazhdonte me zhvillimin e saj, megjithëse çdo botim duhej të bëhej pas venies në jetë (implementimit) të Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë.

## 6.6 Nomenklatura Ndërkombëtare e Sëmundjeve

Qysh prej vitit 1970, Këshilli i Organizatave Ndërkombëtare të Shkencave Mjekësore (CIOMS – *Council for International Organizations of Medical Sciences*) ka pas qenë përfshirë në përgatitjen e Nomeklaturës Botërore të Sëmundjeve (IND – *International Nomenclature of Diseases*), e cila shërben si një përplotësim i ICD-së.

Qëllimi kryesor i IND-së ishte të siguronte një emër të vetëm të rekomanduar për çdo entitet nozologjik (entitet sëmundje). Kriteri kryesor i zgjedhjes së këtij emri ishte se ai duhej të ishte

specifik, pa shprehje me dy kuptime, vetë-përshkrues dhe sa më i thjeshtë, dhe i bazuar në shkak aty ku ishte e mundur. Çdo sëmundje [*disease*] ose sindromë për të cilën rekomandohej emri, të përkufizohej pa ambiguitet (jo me dykuptimësí) dhe mundësisht sa më shkurt. Përbri çdo përkufizimi vendosej një listë sinonimesh.

Gjatë kohës së Konferencës kishin qenë botuar vëllimet e sëmundjeve të traktit (aparatit) të poshtëm të frymëmarrjes, sëmundjeve infektive (virale, bakteriale, parazitare, mykotike) dhe sëmundjeve kardiake dhe vaskulare (sistemi kardiovaskular), ndërkohë që vazhdonte puna për vëllimet e sistemit tretës, sistemit urogjenital femëror, sistemit urogjenital mashkullor, sëmundjeve të metabolizmit dhe atyre endokrine, organeve të gjakut dhe gjak-formuese, sistemit imunitar, sistemit muskolor-skeletor dhe sistemit nervor. Subjektet e propozuara për vëllimet e ardhshme përfshinin sëmundjet psiqike, si dhe sëmundjet e lëkurës, veshit, hundës, grykës, syrit dhe adnekseve të tij (=kapakët e syrit, qepallat, vetullat, aparati i lotit).

Konferenca pranoi se përditësimi adekuat dhe nomeklatura botërore e sëmundjeve ishin të rëndësishëm në zhvillimin e ICD-së dhe në përmirësimin e krahasueshmërisë së informacionit shëndetësor. Prandaj Konferenca:

> REKOMANDOI që OBSH-ja dhe CIOMS-i të inkurajoheshin për zbulimin e rrugëve më kosto-efektive (më efiçiente) për të arritur kompletimin në kohë të një nomeklature të tillë.

# 7. Zbatimi i revizionit të dhjetë të ICD

Konferenca u njoh me synimin e OBSH-së për të publikuar versionin e detajuar katër-karakterësh të Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë në tre Vëllime: Vëllimi i parë, që përmban Listën Tabelare, Vëllimi i dytë, që përmban të gjitha përkufizimet përkatëse, standardet, rregullat dhe udhëzimet, dhe Vëllimi i tretë, që përmban Indeksin Alfabetik.

Konferenca u informua më tej se versioni tre-karakterësh i Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë do të botohej në një vëllim të vetëm, i cili do të përmbante, në Listën Tabelare, të gjitha shënimet përfshirëse dhe përjashtuese. Ai gjithashtu do të përmbante të gjitha përkufizimet përkatëse, standardet, rregullat dhe udhëzimet, si dhe një Indeks Alfabetik të shkurtuar.

Vendet Anëtare, që kishin ndërmend të botonin versionin e Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë në gjuhët e tyre kombëtare, duhej të njoftonin OBSh-në për këtë veprim. Kopjet e drafteve të ICD-së në nivelet tre- dhe katër-karakterëshe do të bëheshin të disponueshme nga OBSH-ja, si në formë të printuar ashtu edhe elektronike.

Lidhur me paraqitjen fizike të faqeve dhe formatit të shtypjes, si për Listën Tabelare ashtu edhe për Indeksin Alfabetik, Konferenca u sigurua se do të merreshin parasysh rekomandimet e Kryesive të Qendrave Bashkëpunuese të OBSH-së dhe ankesat e koduesve, si dhe çdo përpjekje tjetër që do të bëhej për përmirësimin e këtyre aspekteve, në krahasim me Revizionin (Rishikimin) e Nëntë.

Sikundër edhe në Revizionin (Rishikimin) e Nëntë, u planifikua zhvillimi i materialeve për riorientimin e koduesve të trajnuar, kjo me ndihmën e Qendrave Bashkëpunuese. Kurset e trajnimit do të ishin nën përgjegjësinë e Zyrave Rajonale të OBSH-së dhe të vendeve të veçanta.

Ato do të zhvilloheshin prej fillimit të vitit 1991 deri në fund të vitit 1992, për t'u përfunduar përpara jetësimit (implementimit) të Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë.

Materialet për trajnimin bazë të përdoruesve të rinj do të përgatiteshin nga OBSh-ja; megjithatë, asnjë kurs nuk u planifikua para vitit 1993.

Siç u theksua më sipër, OBSH-ja duhej të përgatitej për të nxjerrë Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë (si Listën Tabelare ashtu dhe Indeksin Alfabetik) në format elektronik. Në të ardhmen, me ndihmën e Qendrave Bashkëpunuese, do të mundësoheshin edhe *softwar*-e të tjera. Përpara implementimit të Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë duhej të ishte i disponueshëm një çelës për konvertim nga Revizioni (Rishikimi) i Nëntë në Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë, dhe anasjelltas.

Meqënëse zhvillimi i aktiviteteve, që u morën përsipër nga Komiteti i Ekspertëve, ishte në përputhje me afatin kohor, Konferenca:

> REKOMANDOI, që Revizioni (Rishikimi) i Dhjetë i Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve [Diseases] duhej të hynte në fuqi më 1 Janar 1993.

# 8. Revizioni i ardhshëm i ICD

Konferenca diskutoi vështirësitë e hasura gjatë periudhës së gjatë të përdorimit të Revizionit (Rishikimit) të Nëntë lidhur me shfaqjen e sëmundjeve të reja dhe mungesën e një mekanizmi përditësues për evidentimin e tyre.

U diskutuan sugjerime të ndryshme për mekanizmat për të kapërcyer vështirësitë dhe për të shmangur probleme të ngjashme në Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë. U ndje qartë se kishte nevojë për shkëmbim informacioni të vazhdueshëm për të standardizuar përdorimin e Revizionit (Rishikimit) të Dhjetë ndërmjet vendeve, por që çdo ndryshim gjatë "jetëgjatësisë" së përdorimit të tij duhej vlerësuar me shumë kujdes lidhur me impaktin e tij në analizat dhe trendet (tendencat). Pati diskutime lidhur me tipin e forumit, ku do të diskutoheshin ndryshime të tilla dhe përdorimi i mundshëm i gërmës vakante "U" në caktimet e reja apo të përkohshme të kodit. U ra dakord se nuk do të ishte praktike të mbaheshin Konferenca për Revizionime (Rishikime) të ICD-së më shpesh se një herë në 10 vjet.

Mbështetur në nevojat e shprehura, dhe fakti se do të ishte e papërshtatëshme të tentohej të vendosej apo përcaktohej proçesi i saktë për përdorim,

Konferenca:

> REKOMANDOI që Konferenca Ndërkombëtare e ardhshme e Revizionit (Rishikimit) të ICD-së do të mbahet pas 10 vjetësh, dhe se OBSH-ja duhet të sanksionojë konceptin e një proçesi përditësues midis Revizionimeve (Rishikimeve) dhe të japë konsideratat e saj se si mund të ngrihet një mekanizëm efektiv përditësimi.

# 9. Adoptimi i revizionit të dhjetë të ICD

Konferenca bëri Rekomandimet e mëposhtëme:

Duke pasur parasysh propozimet e përgatitura nga Organizata, bazuar në rekomandimet e Komitetit të Ekspertëve mbi Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve [*Diseases*] – Revizioni (Rishikimi) i Dhjetë,

Duke njohur nevojën për disa modifikime të mëtejshme të vogla për të pasqyruar komentet mbi pikat e detajeve dorëzuar nga Vendet Anëtare gjatë Konferencës,

> REKOMANDOI që me Kapitujt e propozuar për rishikim, me kategoritë e tyre tre-karakterëshe dhe nënkategoritë katër-karakterëshe dhe Listën e Shkurtër Tabelare për Sëmundshmërinë dhe Vdekshmërinë, të konstituojë Revizionin (Rishikimin) e Dhjetë të Klasifikimit Statistikor Ndërkombëtar të Sëmundjeve [*Diseases*] dhe të Problemeve të-Lidhura-me Shëndetin.

# Referencat


1. Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve, 1975 Rishikim, Vëllimi 1. Gjenevë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1977, ff. xiii-xxiv.
2. Raporti i Komitetit të Ekspertëve për Klasifikmin Ndërkombëtar të Sëmundjeve - Botimi i 10-të: Mbledhja e Parë. Gjenevë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1984 (dokument i pabotuar DES/EC/ICD-10/84.34).
3. Raporti i Komitetit të Ekspertëve për Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve - Botimi i 10-të: Mbledhja e Dytë. Gjenevë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1987 (dokument i pabotuar WHO/DES/EC/ICD-10/87.38).
4. Raport i Mbledhjes Përgatitore të ICD-10. Gjenevë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1983 (dokument i pabotuar DES/ICD-10/83.19).
5. Klasifikimi Ndërkombëtar i Imunitetit, Paaftësisë dhe Handikapeve. Gjenevë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1980.
6. Raport paraprak mbi Informacionin Shëndetësor. Gjenevë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1978.
7. Strategjia Globale për Shëndet për të Gjithë deri në vitin 2000. Gjenevë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1981; (http://whglibdoc.who.int/publications/9241800038.pdf, aksesuar me 22 Maj 2015).
8. Konferenca Ndërkombëtare mbi Statistikat Shëndetësore të Vitit 2000. Budapest, Shtëpia Botuese e Statistikave, 1984.
9. Raport mbi Konsultimin e Klasifikimit të Kujdesit Parësor. Gjenevë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1985 (dokument i pabotuar DES/PHC/85.7).
10. Raporti Zyrtar i OBSH-së, No. 233, 1976, f. 18.
11. Klasifikimi Ndërkombëtar i Proçedurave në Mjekësi. Gjenevë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1978.

# Lista e kategorive me tre-karaktere

# Kapitulli I
# Disa sëmundje infektive e parazitare (A00–B99)

### Sëmundjet infektive të traktit intestinal (të zorrëve) (A00–A09)

A00 Kolera
A01 Tifo e Paratifo (=Ethet tifoide e paratifoide) (=Tifo abdominale e Paratifo)
A02 Infeksione të tjera nga salmonelat
A03 Shigeloza
A04 Infeksione të tjera bakteriale intestinale
A05 Intoksikacione të tjera bakteriale me transmetim nëpërmjet-ushqimeve [*foodborne*]
A06 Amebiaza
A07 Sëmundje të tjera nga protozoarët e zorrëve
A08 Infeksione virale dhe infeksione të tjera të specifikuara të zorrëve
A09 Diarre dhe gastroenterit me origjinë të supozuar infektive

### Tuberkulozi (A15–A19)

A15 Tuberkuloz i aparatit respirator, i konfirmuar bakteriologjikisht dhe histologjikisht
A16 Tuberkuloz i aparatit respirator, i pakonfirmuar bakteriologjikisht dhe histologjikisht
A17† Tuberkuloz i sistemit nervor
A18 Tuberkuloz i organeve të tjera
A19 Tuberkuloz miliar

### Disa zoonoza bakteriale (A20–A28)

A20 Murtaja
A21 Tularemia
A22 Plasja (=Antraksi)
A23 Bruceloza
A24 Morva (=Malleus) dhe Melioidoza
A25 Ethet nga kafshimi i miut
A26 Erisipeloidi
A27 Leptospiroza
A28 Zoonoza të tjera bakteriale, të paklasifikuara diku tjetër

### Sëmundje të tjera bakteriale (A30–A49)

A30 Lebra (sëmundja e Hansen)
A31 Infeksion nga mykobaktere të tjera

A32 Listerioza
A33 Tetanoz i të porsalindurve (=Tetanozi neonator)
A34 Tetanoz obsetrikal
A35 Tetanoze të tjerë
A36 Difteri
A37 Kollë e mirë (=Pertussis)
A38 Skarlatina
A39 Infeksion meningokoksik (=Infeksion nga meningokoku)
A40 Septicemi streptokoksike
A41 Septicemi të tjera
A42 Aktinomykoza
A43 Nokardioza
A44 Bartoneloza
A46 Erizipela
A48 Sëmundje të tjera bakteriale, të paklasifikuara diku tjetër
A49 Infeksion bakterial me lokalizim të papërcaktuar

**Infeksione me mbizotërim të rrugës seksuale të transmetimit (A50–A64)**

A50 Sifilis i trashëguar (=kongjenital)
A51 Sifilis i hershëm
A52 Sifilis i vonshëm
A53 Sifilis tjetër dhe i paspecifikuar
A54 Infeksion gonokoksik
A55 Limfogranulomë nga klamidiat (=Limfogranuloma venereum)
A56 Sëmundje të tjera nga klamidiat (=Klamidiaza të tjera) seksualisht të transmetueshme
A57 Shankroidi
A58 Granuloma inguinale
A59 Trikomoniaza
A60 Infeksion viral herpetik (herpes-virus i thjeshtë) anogjenital
A63 Sëmundje të tjera të transmetuara kryesisht në rrugë seksuale, të paklasifikuara diku tjetër
A64 Sëmundje të paspecifikuara, të transmetueshme në rrugë seksuale

**Sëmundje të tjera nga spiroketat (A65–A69)**

A65 Sifilis jovenerian
A66 Frambezia (=Polipapiloma tropikale)
A67 Pinta (karate)
A68 Ethet rekurrente epidemike

A69 Infeksione të tjera nga spiroketat

**Sëmundje të tjera të shkaktuara nga klamidiat (A70–A74)**

A70 Infeksion nga Chlamydia psittaci

A71 Trakoma

A74 Sëmundje të tjera të shkaktuara nga klamidiat

**Rikeciozat (A75-A79)**

A75 Tifo ekzantematike (=Tifo e morrit)

A77 Ethet butonoze (=Rikecioza me-transmetim-nga-këpushat (rriqnat))

A78 Ethet Q

A79 Rikecioza të tjera

**Infeksione virale të sistemit nervor qendror (A80–A89)**

A80 Poliomieliti akut (=Poliomieliti)

A81 Infeksione të sistemit nervor qendror nga viruse të ngadalshëm

A82 Tërbimi (=Rabies)

A83 Encefalit viral me-transmetim-nga-mushkonjat

A84 Encefalit viral me-transmetim-nga-këpushat (rriqnat)

A85 Encefalit tjetër viral, i paklasifikuar diku tjetër

A86 Encefalit viral i paspecifikuar

A87 Meningit viral

A88 Infeksione të tjera virale të sistemit nervor qendror, të paklasifikuara diku tjetër

A89 Infeksione virale të paspecifikuara të sistemit nervor qendror

**Ethet virale me-transmetim-nga-artropodët dhe ethet virale hemorragjike (A90–A99)**

A92 Ethe të tjera virale me-transmetim-nga-mushkonjat

A93 Ethe të tjera virale me-transmetim-nga-artropodët, të paklasifikuara diku tjetër

A94 Ethe virale me-transmetim-nga-artropodët, e paspecifikuar

A95 Ethet e verdha

A96 Ethe hemorragjike nga arenoviruset

A97 Ethet Dengue (=Dengue)

A98 Ethe të tjera hemorragjike virale, të paklasifikuara diku tjetër

A99 Ethe hemorragjike virale e paspecifikuar

**Infeksione virale të karakterizuara me dëmtime të lëkurës dhe të cipave mukoze (B00–B09)**

B00 Infeksione herpetike virale (=Herpes i thjeshtë)

B01 Variçela (=Lija e dhenve)

B02 Zoster (=Herpes zoster)

B03 Lija

B04 Lija e majmunëve

B05 Fruthi

B06 Rubeola

B07 Kondilomat virale të lëkurës

B08 Infeksione të tjera virale me dëmtime të lëkurës dhe të cipave mukoze, të paklasifikuara diku tjetër

B09 Infeksione virale të paspecifikuara me dëmtime të lëkurës dhe të cipave mukoze

**Hepatiti viral (B15–B19)**

B15 Hepatit viral akut A

B16 Hepatit viral akut B

B17 Hepatit tjetër viral akut

B18 Hepatit viral kronik

B19 Hepatit viral i specifikuar

**HIV = Sëmundja e virusit të imunodefiçiencës humane të fituar [HIV] (B20–B24)**

B20 Sëmundja e virusit të imunodefiçiencës humane të fituar [HIV] që përfundon në sëmundje infektive e parazitare

B21 Sëmundja e virusit të imunodefiçiencës humane të fituar [HIV] që përfundon në tumore malinje

B22 Sëmundja e virusit të imunodefiçiencës humane të fituar [HIV] që përfundon në sëmundje të tjera të specifikuara

B23 Sëmundja e virusit të imunodefiçiencës humane të fituar [HIV] që përfundon në sëmundje apo kushte (kondita) shëndetësore të tjera

B24 Sëmundja e virusit të imunodefiçiencës humane të fituar [HIV] e paspecifikuar

**Sëmundje të tjera virale (B25–B34)**

B25 Sëmundje nga Citomegaloviruset

B26 Parotiti epidemik (=Shytat)

B27 Mononukleoza infeksioze

B30 Konjunktivit viral

B33 Sëmundje tjetër virale, e paklasifikuar diku tjetër

B34 Infeksion viral me lokalizim të paspecifikuar

**Mykozat (B35–B49)**

B35 Dermatofitozë
B36 Mykoza të tjera sipërfaqësore
B37 Kandidiazë
B38 Koksidioidomykozë
B39 Histoplazmozë
B40 Blastomykozë
B41 Parakoksidioidomykozë
B42 Sporotrikozë
B43 Kromomykozë dhe absces feomykotik
B44 Aspergilozë
B45 Kriptokokozë
B46 Zygomykozë
B47 Mycetomë
B48 Mykoza të tjera, të paklasifikuara diku tjetër
B49 Mykozë e paspecifikuar

**Sëmundje nga protozoarët (B50–B64)**

B50 Malarie nga *Plasmodium falciparum*
B51 Malarie nga *Plasmodium vivax*
B52 Malarie nga *Plasmodium malariae*
B53 Malarie tjetër e vërtetuar me analizë parazitologjike
B54 Malarie e paspecifikuar
B55 Leishmaniaza
B56 Tripanozomiaza afrikane
B57 Sëmundje e Chagas
B58 Toksoplasmoza
B59† Pneumocistoza (J17.3*)
B60 Sëmundje të tjera nga protozoarët, të paklasifikuara diku tjetër
B64 Sëmundje të tjera nga protozoarët, të paspecifikuara

**Helmintiazat (B65–B83)**

B65 Scistosomiaza (=Bilharziaza)
B66 Infeksione të tjera nga trematodët
B67 Ekinokokoza
B68 Teniaza
B69 Cisticerkoza

B70 Difilobotriaza dhe sparganoza

B71 Infeksione të tjera nga cestodët

B72 Drakunkuliaza

B73 Onkocerkiaza

B74 Filariaza

B75 Trikineliaza

B76 Sëmundje të shkaktuara nga nematodët

B77 Askaridioza

B78 Strongiloidiaza

B79 Trikiuriaza

B80 Enterobiaza

B81 Helmintoza të tjera të zorrëve, të paklasifikuara diku tjetër

B82 Parazitim i paspecifikuar i zorrëve.

B83 Helmintiaza të tjera

**Pedikuloza (morrat), akariaza (akariet) dhe infestime të tjera (B85–B89)**

B85 Pedikuloza dhe ftiriaza

B86 Zgjebe (=Skabies)

B87 Miaza

B88 Infestime të tjera

B89 Sëmundje parazitare e paspecifikuar

**Pasoja (sekela [*sequelae*]) të sëmundjeve infektive e parazitare (B90–B94)**

B90 Pasoja të Tuberkulozit (TB)

B91 Pasoja të Poliomielitit

B92 Pasoja të Lebrozës

B94 Pasoja të infeksioneve të tjera të paspecifikuara dhe sëmundjeve parazitare të tjera të tjera të paspecifikuara

**Infeksione të tjera bakteriale e virale dhe nga agjentë të tjerë infektivë (infeksiozë) (B95–B97)**

B95 Streptokoku dhe stafilokoku si shkaqe të sëmundjeve të klasifikuara në kapituj të tjerë

B96 Agjentë të tjerë bakterialë si shkaqe të sëmundjeve të klasifikuara në kapituj të tjerë

B97 Agjentë virale si shkaqe të sëmundjeve të klasifikuara në kapituj të tjerë

**Sëmundje të tjera infektive (B99)**

B99 Sëmundje infektive të tjera dhe të paspecifikuara

# Kapitulli II
# Neoplazmat
# (C00–D48)

## Neoplazmat malinje (C00–C97)

*Neoplazmat malinje, të përcaktuara ose të menduara që janë primare, në zona të caktuara, me përjashtim të indeve limfoide, hematopojetike dhe të lidhura me to (C00-C75)*

*Neoplazmat malinje të buzës, hapësirës së gojës dhe faringut (C00–C14)*

C00 Neoplazëm malinje e buzës
C01 Neoplazëm malinje e rrënjës së gjuhës
C02 Neoplazëm malinje e pjesëve të tjera të paspecifikuara të gjuhës
C03 Neoplazëm malinje e gingivave
C04 Neoplazëm malinje e dyshemesë së gojës
C05 Neoplazëm malinje e palatumit të gojës
C06 Neoplazëm malinje e pjesëve të tjera dhe të paspecifikuara të gojës
C07 Neoplazëm malinje e gjendrës parotide
C08 Neoplazëm malinje e **e** gjendrave të tjera dhe të paspecifikuara kryesore të pështymës
C09 Neoplazëm malinje e tonsilës
C10 Neoplazëm malinje e orofaringut
C11 Neoplazëm malinje e nazofaringut
C12 Neoplazëm malinje e sinusit piriform
C13 Neoplazëm malinje e hipofaringut (=faringut të poshtëm)
C14 Neoplazëm malinje e pjesëve të tjera të paspecifikuara të buzës, kavitetit oral dhe faringut

*Neoplazmat malinje të organeve të sistemit digjestiv (C15–C26)*

C15 Neoplazëm malinje e ezofagut
C16 Neoplazëm malinje e stomakut
C17 Neoplazëm malinje e zorrës së hollë
C18 Neoplazëm malinje e zorrës së trashë
C19 Neoplazëm malinje e zonës bashkuese rektosigmoidale
C20 Neoplazëm malinje e rektumit
C21 Neoplazëm malinje e anusit dhe kanalit anal
C22 Neoplazëm malinje e heparit dhe kanaleve biliare intrahepatike
C23 Neoplazëm malinje e vezikës së tëmthit
C24 Neoplazëm malinje e pjesëve të tjera të paspecifikuara të traktit biliar

C25 Neoplazëm malinje e pankreasit

C26 Neoplazëm malinje e organeve të tjera të traktit digjestiv (=tretës), të papërcaktuara mirë

*Neoplazmat malinje të organeve të sistemit respirator dhe të atyre intratorakale (C30–C39)*

C30 Neoplazëm malinje e kavitetit nazal (=hapësirës së hundës) dhe e veshit të mesëm

C31 Neoplazëm malinje e sinuseve ndihmëse

C32 Neoplazëm malinje e laringut

C33 Neoplazëm malinje e trakesë

C34 Neoplazëm malinje e bronkut dhe mushkërisë (=bronkopulmonare)

C37 Neoplazëm malinje e timusit

C38 Neoplazëm malinje e zemrës, mediastinit, dhe pleurës

C39 Neoplazëm malinje e vendeve të tjera të papërcaktuara të organeve të sistemit respirator dhe të atyre intratorakale

*Neoplazmat malinje të kockës dhe kërceve artikulare (C40–C41)*

C40 Neoplazëm malinje e kockës dhe kërceve artikulare të gjymtyrëve

C41 Neoplazëm malinje e kockës dhe kërceve artikulare të vendeve të tjera dhe të papërcaktuara

*Melanoma dhe neoplazma të tjera malinje të lëkurës (C43–C44)*

C43 Melanoma malinje e lëkurës

C44 Neoplazma të tjera malinje të lëkurës

*Neoplazma malinje të indit mezotelial dhe indit të butë (C45–C49)*

C45 Mezotelioma

C46 Sarkoma e Kaposi (=Sarkoma Kaposi)

C47 Neoplazëm malinje e nervave periferikë dhe të sistemit nervor autonom

C48 Neoplazëm malinje e peritoneumit dhe i hapësirës retroperitoneale

C49 Neoplazëm malinje e indit lidhor dhe indit të butë

*Neoplazëm malinje e gjirit (C50)*

C50 Neoplazëm malinje e gjirit

*Neoplazmat malinje të organeve gjenitale femërore (C51–C58)*

C51 Neoplazëm malinje e vulvës

C52 Neoplazëm malinje e vaginës

C53 Neoplazëm malinje e qafës së mitrës (=cervix uteri)

C54 Neoplazëm malinje e trupit të mitrës (=corpus uteri)

C55 Neoplazëm malinje e uterusit (=mitrës), pjesërisht e paspecifikuar

C56 Neoplazëm malinje e ovarit

C57 Neoplazëm malinje e organeve të tjera gjenitale femërore, e paspecifikuar

C58 Neoplazëm malinje e placentës

*Neoplazmat malinje të organeve gjenitale mashkullore (C60–C63)*

C60 Neoplazëm malinje e penisit

C61 Neoplazëm malinje e prostatës

C62 Neoplazëm malinje e testikulit

C63 Neoplazëm malinje e organeve të tjera gjenitale mashkullore, e paspecifikuar

*Neoplazmat malinje të traktit urinar (C64–C68)*

C64 Neoplazëm malinje e veshkës, me përjashtim të pelvisit renal (=legenit të veshkës)

C65 Neoplazëm malinje e pelvisit renal (=legenit të veshkës)

C66 Neoplazëm malinje e ureterit

C67 Neoplazëm malinje e vezikës (fshikëzës) urinare

C68 Neoplazëm malinje e organeve të tjera dhe të paspecifikuara urinare

*Neoplazmat malinje të syrit, trurit dhe pjesëve të tjera të sistemit nervor qendror (C69–C72)*

C69 Neoplazëm malinje e syrit dhe anekseve të tij (=kapakët e syrit, qepallat, kanali i lotëve, vetullat)

C70 Neoplazëm malinje e meningeve

C71 Neoplazëm malinje e trurit

C72 Neoplazëm malinje e palcës kurrizore, nervave të kokës dhe të pjesëve të tjera të sistemit nervor qendror

*Neoplazmat malinje të tiroides dhe gjendrave të tjera endokrine (C73–C75)*

C73 Neoplazëm malinje e gjendrës tiroide

C74 Neoplazëm malinje e gjendrës mbiveshkore (=suprarenale)

C75 Neoplazëm malinje e gjendrave të tjera endokrine dhe strukturave të lidhura me to

*Neoplazmat malinje të lokalizimeve (=zonave/siteve) sekondare dhe të keqpërcaktuara apo të paspecifikuara (C76–C80)*

C76 Neoplazëm malinje me lokalizim tjetër dhe të keqpërcaktuar

C77 Neoplazëm malinje sekondare dhe e paspecifikuar e gjendrave limfatike

C78 Neoplazëm malinje sekondare e organeve të frymëmarjes (=respiratore) dhe atyre tretëse(=digjestive)

C79 Neoplazëm malinje sekondare e lokalizimeve të tjera

C80 Neoplazëm malinje sekondare pa specifikim të lokalizimit

*Neoplazmat malinje të indit limfoid, indit hematopojetik, dhe indeve të lidhura me to (C81–C96)*

C81 Sëmundja e Hoçkin [Hodgkin]

C82 Limfoma folikulare (nodulare) jo-Hoçkin

C83 Limfoma difuze (=e përhapur) jo-Hoçkin

C84 Limfomat me qeliza T periferike dhe të lëkurës (=kutane)

C85 Tipa të tjerë dhe të paspecifikuar të limfomës jo-Hoçkin

C88 Sëmundjet imunoproliferative malinje

C90 Mieloma multiple dhe neoplazmat malinje të qelizave plazmatike

C91 Leuçemi limfoide

C92 Leuçemi mieloide

C93 Leuçemi monocitare

C94 Leuçemi të tjera të llojeve të tjera të qelizave të specifikuara

C95 Leuçemi e qelizave të paspecifikuara

C96 Neoplazma të tjera dhe të paspecifikuara malinje, të indit limfoid, indit hematopojetik, dhe indeve të lidhura me to

*Neoplazmat malinje me lokalizime multiple të pavarura (primare) (C97)*

C97 Neoplazma malinje me lokalizime multiple të pavarura (primare)

**Neoplazmat in situ (D00–D09)**

D00 Karcinoma *in situ* e hapësirës së gojës (=kavitetit oral), ezofagut dhe stomakut

D01 Karcinoma *in situ* e organeve të tjera dhe të paspecifikuara të traktit digjestiv

D02 Karcinoma *in situ* e veshit të mesëm dhe e organeve të sistemit respirator

D03 Melanoma *in situ*

D04 Karcinoma *in situ* e lëkurës

D05 Karcinoma *in situ* e gjirit

D06 Karcinoma *in situ* e qafës së mitrës (=cervix uteri)

D07 Karcinoma *in situ* e organeve të tjera dhe të paspecifikuara gjenitale

D09 Karcinoma *in situ* me lokalizime të tjera dhe të paspecifikuara

**Neoplazmat (tumoret) beninje (D10–D36)**

D10 Tumor beninj i gojës dhe faringut

D11 Tumor beninj i gjendrave të mëdha të pështymës (=salivare)
D12 Tumor beninj i kolonit, rektumit, anusit dhe kanalit anal
D13 Tumor beninj i pjesëve të tjera dhe të papërcaktuara mirë të traktit digjestiv
D14 Tumor beninj i veshit të mesëm dhe i sistemit respirator (=të frymëmarrjes)
D15 Tumor beninj i organeve të tjera dhe të paspecifikuara intratorakale
D16 Tumor beninj i kockës dhe i kërcit artikular (=kartilagos artikulare)
D17 Tumor beninj lipomatoz
D18 Hemangioma dhe limfangioma, e paspecifikuar (=e çdo lokalizimi)
D19 Tumor beninj i indit mezotelial
D20 Tumor beninj i indit të butë retroperitoneal dhe peritoneumit
D21 Tumore të tjera beninje të indit lidhor dhe indit tjetër të butë
D22 Nevuse melanocitare
D23 Tumore të tjera beninje të lëkurës
D24 Tumor beninj i gjirit
D25 Leiomioma e mitrës (=uterusit)
D26. Tumore të tjerë beninje të mitrës (=uterusit)
D27 Tumor beninj i vezores (=ovarit)
D28 Tumor beninj i organeve të tjera dhe të paspecifikuara gjenitale femërore
D29 Tumor beninj i organeve gjenitale mashkullore
D30 Tumor beninj i organeve urinare
D31 Tumor beninj i syrit dhe anekseve (=kapakëve të syrit, qepallave, vetullave, aparatit lakrimal)
D32 Tumor beninj i meningeve
D33 Tumor beninj i trurit dhe pjesëve të tjera të sistemit nervor qendror
D34 Tumor beninj i gjendrës tiroide
D35 Tumor beninj i gjendrave të tjera dhe të paspecifikuara endokrine
D36 Tumor beninj me lokalizime të tjera, të paspecifikuara

**Neoplazma me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur (D37–D48)**

D37 Neoplazëm me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur e hapësirës së gojës dhe organeve të traktit digjestiv
D38 Neoplazëm me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur e veshit të mesëm dhe organeve të sistemit respirator dhe atyre intratorakale
D39 Neoplazëm me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur e organeve gjenitale femërore
D40 Neoplazëm me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur e organeve gjenitale mashkullore sistemit respirator dhe atyre intratorakale
D39 Neoplazëm me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur e organeve gjenitale femërore

D40 Neoplazëm me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur e organeve gjenitale mashkullore

D41 Neoplazëm me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur e organeve urinare

D42 Neoplazëm me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur e meningeve

D43 Neoplazëm me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur e trurit dhe sistemit nervor qendror

D44 Neoplazëm me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur e gjendrave endokrine

D45 Policitemi e vërtetë (=Polycythaemia vera)

D46 Sindromat mielodisplastike

D47 Neoplazma të tjera me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur të indit limfoid, indit hematopojetik, dhe indeve që të lidhura me to

D48 Neoplazëm me sjellje të papërcaktuar ose të panjohur me lokalizime të tjera të paspecifikuara

# Kapitulli III

# Sëmundjet e gjakut dhe të organeve gjak-formuese, dhe çrregullime të caktuara që kanë mekanizëm imunitar (D50–D89)

### Anemitë e ushqyerjes (D50–D53)

D50 Anemi nga pamjaftushmëria e hekurit

D51 Anemi nga pamjaftushmëria e vitaminës B12

D52 Anemi nga pamjaftushmëria e folateve

D53 Anemi të tjera të lidhura me ushqyerjen

### Anemitë hemolitike (D55–D59)

D55 Anemi nga çrregullime të enzimave

D56 Talasemia

D57 Çrregullime drepanocitare (=Anemia drepanocitare) (=Drepanocitoza)

D58 Anemi të tjera hemolitike të trashëguara

D59 Anemia hemolitike e fituar

### Anemitë aplastike dhe anemi të tjera (D60–D64)

D60 Aplazia eritrocitare e fituar (=Eritroblastopenia)

D61 Anemi të tjera aplastike

D62 Anemia akute post-hemorragjike

D63* Anemia nga sëmundje kronike, e klasifikuar diku tjetër

D64 Anemi të tjera

### Defekte të koagulimit, purpura dhe gjendje të tjera hemorragjike (D65–D69)

D65 Koagulim i përhapur intravazal (=Sindromi i defibrinimit)

D66 Pamjaftushmëria e trashëguar e faktorit VIII

D67 Pamjaftushmëria e trashëguar e faktorit IX

D68 Defekte të tjera të koagulimit

D69 Purpura dhe gjendje të tjera hemorragjike

### Sëmundje të tjera të gjakut dhe organeve formuese (=prodhuese) të tij (D70–D77)

D70 Agranulocitoza

D71 Çrregullime funksionale të neutrofileve polimorfonukleare

D72 Çrregullime të tjera leukocitare

D73 Sëmundjet e shpretkës (=lienit)

D74 Metahemoglobinemia

D75 Sëmundje të tjera të gjakut dhe të organeve formuese (=prodhuese) të tij

D76 Disa sëmundje që interesojnë indin limforetikular dhe sistemin retikulohistocitar

D77* Çrregullime të tjera të gjakut dhe të organeve formuese (=prodhuese) të tij nga sëmundjet e klasifikuara diku tjetër

**Çrregullime të tjera që përfshijnë mekanizmin imunitar (D80–D89)**

D80 Imunodefiçenca me mbizotërim të defekteve të antikorpeve

D81 Imunodefiçenca të kombinuara

D82 Imunodefiçenca e shoqëruar me defekte të tjera të rëndësishme

D83 Imunodefiçenca e zakonshme variabël (=CVID – *Common variable immunodeficiency*)

D84 Imunodefiçenca të tjera

D86 Sarkoidoza

D89 Çrregullime të tjera që interesojnë mekanizmin imunitar, të paklasifikuara diku tjetër

# Kapitulli IV

# Sëmundjet endokrine, sëmundjet e të ushqyerit (=nutricionit) dhe sëmundjet metabolike

# (E00–E90)

### Çrregullimet e gjendrës tiroide (E00–E07)

E00 Sindromi i trashëguar (=kongjenital) i pamjaftueshmërisë së jodit

E01 Çrregullime të tiroides të-lidhura-me-pamjaftueshmërinë-e-jodit dhe gjendje të ngjashme

E02 Hipotiroidizëm pa shenja klinike (=subklinik) i pamjaftueshmërisë jodike

E03 Hipotiroidizëm tjetër

E04 Gushë (=Strumë) tjetër jotoksike

E05 Tireotoksikoza (=Hipertiroidizëm)

E06 Tiroidit

E07 Çrregullime të tjera të tiroides

### Diabeti i sheqerit (=Diabeti melitus) (E10–E14)

E10 Diabeti insulino-mvartës i sheqerit (=Diabeti melitus insulino-mvartës)

E11 Diabet jo-insulino-mvartës i sheqerit (=Diabeti melitus jo-insulino-mvartës)

E12 Diabeti i sheqerit i-lidhur-me-kequshqyerjen (=Diabeti melitus i-lidhur-me-kequshqyerjen)

E13 Diabet tjetër i specifikuar i sheqerit (=Diabet melitus tjetër i specifikuar)

E14 Diabet sheqeri i paspecifikuar (=Diabet melitus i paspecifikuar)

### Çrregullime të tjera të rregullimit të glukozës dhe të sekrecionit të brendshëm të pankreasit (E15–E16)

E15 Koma hipoglicemike jodiabetike

E16 Çrregullime të tjera të sekrecionit të brendshëm të pankreasit

### Çrregullime të gjendrave të tjera endokrine (E20–E35)

E20 Hipoparatiroidizëm

E21 Hiperparatiroidizëm dhe çrregullime të tjera të gjendrës paratiroide

E22 Hiperfunksion i gjendrës pituitare

E23 Hipofunksion dhe çregullime të tjera të gjendrës paratiroide

E24 Sindroma e Kushing

E25 Çrregullime adrenogjenitale

E26 Hiperaldosteronizëm

E27 Çrregullime të tjera të gjendrës adrenale (=suprarenale) (=mbiveshkore)

E28 Çrregullim i funksionit të vezores (=Disfunksion ovarial)
E29 Çrregullim i funksionit testikular (=Disfunksion testikular)
E30 Çrregullime të pubertetit, të paspecifikuara diku tjetër
E31 Çrregullim funksional poliglandular (=shumëgjendror)
E32 Sëmundjet e timus-it
E34 Çrregullime endokrine të tjera
E35* Çrregullime të gjendrave endokrine në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

**Malnutricioni (=Kequshqyerja) (E40–E46)**

E40 Kwashiorkor
E41 Marazma e ushqyerjes (=Marazma nutricionale)
E42 Kwashiorkor marazmik
E43 Malnutricion i rëndë nga pamjaftueshmëria proteinike, i paspecifikuar
E44 Malnutricion i moderuar ose i lehtë nga pamjaftueshmeria proteinike
E45 Zhvillim i vonuar nga malnutricioni proteinik
E46 Malnutricion proteinik i paspecifikuar

**Pamjaftueshmëri të tjera të ushqyerjes (E50–E64)**

E50 Pamjaftushmëri e vitaminës A
E51 Pamjaftushmëri e tiaminës
E52 Pamjaftushmëri e niacinës (=Pelagra)
E53 Pamjaftushmëri e vitaminave të tjera të grupit B
E54 Pamjaftushmëri e acidit askorbik
E55 Pamjaftushmëri e vitaminës D
E56 Pamjaftushmëri të tjera vitaminike
E58 Pamjaftushmëri dietetike e kalçiumit
E59 Pamjaftushmëri dietetike e seleniumit
E60 Pamjaftushmëri dietetike e zinkut
E61 Pamjaftushmëri e elementeve të tjerë ushqyes (=nutritivë)
E63 Pamjaftushmëri të tjera të ushqyerjes (=nutritive)
E64 Pasoja të malnutricionit dhe të pamjaftushmërive të tjera të ushqyerjes (=nutritive)

**Obeziteti dhe mbiushqyerje të tjera (E65–E68)**

E65 Adipozitet i lokalizuar
E66 Obezitet
E67 Mbiushqyerje tjetër
E68 Pasoja (=Sekela) të mbiushqyerjes

**Çrregullimet metabolike (E70–E90)**

E70 Çrregullime të metabolizmit të aminoacideve aromatike

E71 Çrregullime të metabolizmit të aminoacideve me zinxhir të degëzuar dhe të metabolizmit të acideve yndyrore

E72 Çrregullime të tjera të metabolizmit të aminoacideve

E73 Intolerancë e laktozës

E74 Çrregullime të tjera të metabolizmit të karbohidrateve

E75 Çrregullime të metabolizmit sfingolipidik dhe çrregullime të tjera të depozitimit të lipideve

E76 Çrregullime të metabolizmit të glukozaminoglukaneve (=mukopolisakarideve)

E77 Çrregullime të metabolizmit të glukoproteinave

E78 Çrregullime të metabolizmit të lipoproteinave dhe lipidemi të tjera

E79 Çrregullime të metabolizmit të purinave dhe të pirimidinave

E80 Çrregullime të metabolizmit të porfirinave dhe të bilirubinës

E83 Çrregullime të metabolizmit të mineraleve

E84 Fibroza cistike

E85 Amiloidoza

E86 Zvogëlim i volumit (=Reduktim i volumit të lëngjeve ekstraqelizore)

E87 Çrregullime të tjera të metabolizmit të lëngjeve, elektroliteve dhe balancës acido-bazike (=ekuilibrit acido-bazik)

E88 Çrregullime të tjera metabolike

E89 Çrregullime endokrine dhe metabolike postproçedurale, të paklasifikuara diku tjetër

E90* Çrregullime metabolike dhe nutricionale në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

# Kapitulli V
# Çrregullimet mendore dhe ato të sjelljes
# (F00–F99)

### Çrregullimet mendore organike, përfshirë ato simptomatike (F00–F09)

F00* Demencia në sëmundjen e Alzheimer (G30.-†)

F01 Demencia vaskulare

F02* Demencia në sëmundje të tjera të klasifikuara diku tjetër

F03 Demencie e paspecifikuar

F04 Sindromi amnezik organik, jo i shkaktuar nga alkooli dhe lëndë të tjera psikoaktive

F05 Delir, jo i shkaktuar nga alkooli dhe lëndë të tjera psikoaktive

F06 Çrregullime të tjera mendore nga dëmtimi dhe disfunksioni i trurit dhe nga sëmundje fizike

F07 Çrregullime të personalitetit dhe të sjelljes nga sëmundje, dëmtime dhe disfunksion i trurit

F09 Çrregullim mendor i paspecifikuar organik ose simptomatik

### Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i substancave psikoaktive (F10–F19)

F10 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i alkoolit

F11 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i opiateve

F12 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i preparateve të kanabis

F13 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i sedativëve ose hipnotikëve

F14 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i kokainës

F15 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga perdorimi i stimulantëve të tjerë, përfshirë kafeinën

F16 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i haluçinogjenëve

F17 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i duhanit

F18 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i solventëve volatilë

F19 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i medikamenteve të shumëllojshme dhe lëndëve të tjera psikoaktive

### Skizofrenia, çrregullimet skizoide (=skizotipale) dhe çrregullimet deluzive (F20–F29)

F20 Skizofreni

F21 Çrregullim skizoid (=skizotipal)

F22 Çrregullime deluzive persistente

F23 Çrregullime psiqike (=psikotike) akute dhe kalimtare

F24 Çrregullim deluziv i induktuar

F25 Çrregullime skizoafektive

F28 Çrregullime të tjera psiqike (=psikotike) jo-organike

F29 Psikozë jo-organike e paspecifikuar

**Çrregullime të humorit (=Çrregullime afektive) (F30–F39)**

F30 Episod maniakal

F31 Çrregullim afektiv bipolar

F32 Episod depresiv

F33 Çrregullim depresiv rekurrent

F34 Çrregullime persistente të humorit (=Çrregullime afektive persistente)

F38 Çrregullime të tjera të humorit (=Çrregullime afektive të tjera)

F39 Çrregullim i paspecifikuar i humorit (=Çrregullim afektiv i paspecifikuar)

**Çrregullimet neurotike, ato të lidhura me stresin dhe ato somatoforme (F40–F48)**

F40 Çrregullimet fobike të ankthit

F41 Çrregullime të tjera të ankthit

F42 Çrregullim obsesiv-kompulsiv

F43 Reaksion ndaj stresit të fortë dhe çrregullime të përshtatjes

F44 Çrregullime disociative (=konversionale)

F45 Çrregullime somatoforme

F48 Çrregullime neurotike të tjera

**Sindroma të sjelljes të lidhura me turbullime fiziologjike dhe me faktorë fizike (F50–F59)**

F50 Çrregullime të ngrënies

F51 Çrregullime jo-organike të gjumit

F52 Disfunksion seksual, i pashkaktuar nga ndonjë çrregullim organik ose sëmundje

F53 Çrregullime mendore dhe të sjelljes, të lidhura me lehoninë, të paklasifikuara diku tjetër

F54 Faktorë psikologjikë dhe të sjelljes të lidhur me çrregullime ose sëmundje të klasifikuara diku tjetër

F55 Abuzim me lëndë që nuk shkaktojnë dipendencë (=vartësi)

F59 Sindromë e paspecifikuar e sjelljes, e shoqëruar me turbullime fiziologjike dhe faktorë fizikë

**Çrregullime të personalitetit dhe të sjelljes së të rriturve (F60–F69)**

F60 Çrregullime specifike të personalitetit

F61 Çrregullime të tjera e të përziera të personalitetit

F62 Ndryshime të qëndrushmërisë të personalitetit, të palidhura me dëmtim dhe/ose sëmundje të trurit

F63 Çrregullime impulsive të sjelljes
F64 Çrregullime të identitetit të gjinisë (=seksit)
F65 Çrregullime të preferencës seksuale
F66 Çrregullime psikologjike dhe të sjelljes të lidhura me zhvillimin dhe orientimin seksual
F68 Çrregullime të tjera të personalitetit dhe të sjelljes së të rriturve
F69 Çrregullim i paspecifikuar i personalitetit dhe sjelljes së të rriturve

**Prapambetje e zhvillimit mendor (F70–F79)**

F70 Prapambetje e lehtë e zhvillimit mendor
F71 Prapambetje e moderuar e zhvillimit mendor
F72 Prapambetje e theksuar e zhvillimit mendor
F73 Prapambetje e thellë e zhvillimit mendor
F78 Prapambetje tjetër e zhvillimit mendor
F79 Prapambetje e zhvillimit mendor, e paspecifikuar

**Çrregullime të zhvillimit psikologjik (F80–F89)**

F80 Çrregullim zhvillimor specifik i të folurit dhe i gjuhës
F81 Çrregullime zhvillimore specifike të aftësive të nxënies (=të mësimmarrjes) (=skolastike)
F82 Çrregullim zhvillimor specifik i funksionit motor
F83 Çrregullime zhvillimore specifike të përziera
F84 Çrregullime zhvillimore difuze
F88 Çrregullime të tjera të zhvillimit psikologjik
F89 Çrregullim i paspecifikuar i zhvillimit psikologjik

**Çrregullime të sjelljes dhe emocionale që shfaqen zakonisht në fëmijëri dhe në adoleshencë (F90–F98)**

F90 Çrregullime hiperkinetike
F91 Çrregullime të sjelljes
F92 Çrregullime të përziera të sjelljes dhe emocionale
F93 Çrregullime emocionale që shfaqen në mënyrë specifike në moshën e fëmijërisë
F94 Çrregullime të funksionimit social që shfaqen në mënyrë specifike në moshën e fëmijërisë dhe atë të adoleshencës
F95 Çrregullime me tike nervore
F98 Çrregullime të tjera të sjelljes dhe emocionale që shfaqen zakonisht në fëmijëri dhe në adoleshencë

**Çrregullim mendor i paspecifikuar (F99)**

F99 Çrregullim mendor, jo i përshkruar ndryshe

# Kapitulli VI
# Sëmundjet e sistemit nervor
# (G00–G99)

**Sëmundjet inflamatore të sistemit nervor (G00–G09)**

G00 Meningit bakterial i paklasifikuar diku tjetër
G01* Meningit në sëmundje të tjera bakteriale të klasifikuara diku tjetër
G02* Meningit në sëmundje të tjera infektive dhe parazitare të klasifikuara diku tjetër
G03 Meningit nga shkaqe të tjera dhe të paspecifikuara
G04 Encefalit, mielit dhe encefalomielit
G05* Encefalit, mielit dhe encefalomielit në sëmundje të klasifikuara diku tjetër
G06 Absces dhe granulomë intrakraniale dhe intraspinale
G07* Absces dhe granulomë intrakraniale dhe intraspinale në sëmundje të klasifikuara diku tjetër
G08 Flebit dhe tromboflebit intrakranial dhe intraspinal
G09 Sekela të sëmundjeve inflamatore të sistemit nervor qendror (SNQ)

**Atrofitë sistemike që prekin më parë sistemin nervor qendror (SNQ) (G10–G13)**

G10 Sëmundja e Huntingtonit
G11 Ataksia hereditare
G12 Atrofi muskulare spinale dhe sindromet përkatëse
G13.* Atrofi sistemike që prekin më parë SNQ, në sëmundje të klasifikuara diku tjetër
G14 Sindroma e Post-Poliomielitit

**Çrregullime ekstrapiramidale të lëvizjeve (G20–G26)**

G20 Sëmundja e Parkinson
G21 Parkinsonizëm sekondar
G22* Parkinsonizëm në sëmundje të klasifikuara diku tjetër
G23 Sëmundje të tjera degjenerative të ganglioneve bazale
G24 Distoni
G25 Çrregullime të tjera ekstrapiramidale të lëvizjeve
G26* Çrregullime ekstrapiramidale të lëvizjeve në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

**Sëmundje të tjera degjenerative të sistemit nervor (SNQ) (G30–G32)**

G30 Sëmundja e Alzheimer
G31 Sëmundje të tjera degjenerative të sistemit nervor, të paklasifikuara diku tjetër
G32* Çrregullime të tjera degjenerative të sistemit nervor në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

**Sëmundjet demielinizuese të sistemit nervor SNQ (G35–G37)**

G35 Skleroza multiple

G36 Tjetër demielinizim i diseminuar akut

G37 Sëmundje të tjera demielinizuese të SNQ

**Çrregullime paroksizmale episodike (G40–G47)**

G40 Epilepsi

G41 Status epileptik

G43 Migrenë

G44 Sidroma të tjera me dhimbje koke

G45 Atake ishemike cerebrale kalimtare dhe sindroma që lidhen me to

G46* Sindroma vaskulare të trurit në sëmundjet cerebrovaskulare (I60–I67†)

G47 Çrregullime të gjumit

**Çrregullime të nervave, të radikseve dhe të pleksuseve (G50–G59)**

G50 Çrregullime të nervit trigeminal

G51 Çrregullime të nervit facial

G52 Çrregullime të nervave të tjerë kranialë

G53* Çrregullime të nervave kranialë në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

G54 Çrregullime të radikseve dhe të pleksuseve nervore

G55* Komprimime të radiksit dhe të pleksusit nervor në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

G56 Mononeuropati të gjymtyrës së sipërme

G57 Mononeuropati të gjymtyrës së poshtme

G58 Mononeuropati të formave të tjera

G59* Mononeuropati në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

**Polineuropatitë dhe çrregullime të tjera të sistemit nervor periferik (G60–G64)**

G60 Neuropati hereditare dhe idiopatike

G61 Polineuropati inflamatore

G62 Polineuropati të tjera

G63* Polineuropati në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

G64 Çrregullime të tjera të sistemit nervor periferik

**Sëmundjet e lidhjeve neuromuskulare dhe të muskujve (G70–G73)**

G70 Miastenia gravis dhe çrregullime të tjera neuromuskulare

G71 Çrregullim muskular primar

G72 Miopati të tjera

G73* Çrregullime të lidhjeve neuromuskulare dhe të muskujve në sëmundje të klasifikuara diku

tjetër

**Paraliza cerebrale dhe sindroma të tjera paralitike (G80–G83)**

G80 Paraliza cerebrale

G81 Hemiplegji

G82 Paraplegji dhe tetraplegji

G83 Sindroma të tjerë paralitikë

**Çrregullime të tjera të sistemit nervor (G90–G99)**

G90 Çrregullime të sistemit nervor autonom (=visceral) (=i pavullnetshëm)

G91 Hidrocefali

G92 Encefalopati toksike

G93 Çrregullime të tjera të trurit

G94* Çrregullime të tjera të trurit në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

G95 Sëmundje të tjera të medulës spinale

G96 Çrregullime të tjera të SNQ

G97 Çrregullime postproçedurale të sistemit nervor, të paklasifikuara diku tjetër

G98 Çrregullime të tjera të sistemit nervor, të paklasifikuara diku tjetër

G99* Çrregullime të tjera të sistemit nervor në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

# Kapitulli VII
# Sëmundjet e syrit dhe anekseve të tij
# (H00–H59)

**Çrregullime të palpebrës (=kapakut të syrit), sistemit lakrimal dhe orbitës (H00–H06)**

H00 Hordeolum dhe kalazion

H01 Inflamacion tjetër i palpebrës

H02 Çrregullime të tjera të palpebrës

H03* Çrregullime të palpebrës në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

H04 Çrregullime të sistemit lakrimal

H05 Çrregullime të orbitës

H06* Çrregullime të orbitës dhe të sistemit lakrimal në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

**Çrregullime të konjunktivës (H10–H13)**

H10 Konjunktivit

H11 Çrregullime të tjera të konjunktivës

H13* Çrregullime të konjunktivës në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

**Çrregullime të sklerës, kornesë, irisit dhe trupit ciliar (H15–H22)**

H15 Çrregullime të sklerës

H16 Keratit

H17 Cikatrice korneale dhe opacitete

H18 Çrregullime të tjera të kornesë

- miokarditi† (I41.8*)
- mioziti† (M63.3*)

Ethja uveoparotide [Heerfordt]

**D86.9 Sarkoidozë e paspecifikuar**

## D89 Çrregullime të tjera që interesojnë mekanizmin imunitar, të paklasifikuara diku tjetër

***Përjashton:*** hiperglobulineminë NOS (R77.1)
gamopatinë monoklonale me rëndësi të papërcaktuar (D47.2)
dështimin ose flakjen e transplantit (T86.-)

**D89.0 Hipergamaglobulinemia poliklonale**

Purpura hipergamaglobuinemike beninje

Gamopatia poliklonale NOS

**D89.1 Krioglobulinemia**

Krioglobulinemia:

- esenciale
- idiopatike
- e përzier
- primare
- sekondare

Krioglobulinemik/e:

- purpura
- vaskuliti

**D89.2 Hipergamaglobulinemi e paspecifikuar**

**D89.3 Sindroma e rikonstitucionit imunitar**

Sindroma inflamatore e rikonstitucionit imunitar

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve (Kapitulli XX), nëse doni, për të identifikuar barnat.

**D89.8 Çrregullime të tjera të specifikuara që interesojnë mekanizmin imun, të paklasifikuara diku tjetër**

**D89.9 Çrregullime që interesojnë mekanizmin imun, të paspecifikuara**

Sëmundjet imunitare NOS

# KAPITULLI IV

# Sëmundjet endokrine, e nutricionit dhe metabolike (E00–E90)

***Shënim:*** Të gjitha neoplazmat, aktive nga ana funksionale ose jo, janë klasifikuar në Kapitullin II. Kodet e duhura në këtë kapitull (p.sh. E05.8, E07.0, E16-E31, E34.-) mund të përdoren nëse dëshirohet, si kode shtesë për të treguar ose aktivitetin funksional të neoplazmes, indit endokrin ektopik, ose hiperfunksionin ose hipofunksionin e gjendrave endokrine të shoqëruara me neoplazmat dhe gjendjet e tjera të klasifikuara gjetkë.

***Përjashton:*** Komplikacionet dhe simptomat e shtatzënisë, lindjes dhe periudhës së pas-lindjes (O00-O99), shenjat dhe gjetjet anormale të gjetjeve laboratorike dhe klinike, të paklasifikuara tjetërkund.

Çrregullime tranzitore endokrine ose metabolike të fetusit ose të të porsalindurit (P70-P74)

**Ky kapitull permban blloqet si vijon:**

| | |
|---|---|
| E00–E07 | Çrregullimet e gjendrës tiroide |
| E10–E14 | Diabeti i sheqerit (=Diabeti melitus) |
| E15–E16 | Çrregullime të tjera të rregullimit të glukozës dhe të sekrecionit të brendshëm të pankreasit |
| E20–E35 | Çrregullime të gjendrave të tjera endokrine |
| E40–E46 | Malnutricioni |
| E50–E64 | Pamjaftueshmëri të tjera të ushqyerjes |
| E65–E68 | Obeziteti dhe mbiushqyerje të tjera |
| E70–E90 | Çrregullimet metabolike |

**Kodet me yll për këtë kapitull janë si vijon:**

| | |
|---|---|
| E90* | Çrregullime metabolike dhe nutricionale në sëmundje të klasifikuara diku tjetër |
| E35* | Çrregullime të gjendrave endokrine në sëmundje të klasifikuara diku tjetër |

# Çrregullimet e gjendrës tiroide (E00–E07)

## E00 Sindromi i kongjenital i pamjaftueshmërisë së jodit

***Përfshin:*** gjendjet endemike të shoqëruara me mungesë ambientale të jodit ose direkt si sipasojë e mungesës së jodit tek nëna. Disa nga gjendjet nuk kanë hipotiroidizëm, por janë si pasojë e prodhimit të pamjaftueshëm të hormonit të tiroides në fetusin në zhvillim. Mund të kenë rol dhe goitrogjenet ambientale.

Përdorni koded shtesë (F70-79), nëse dëshironi, për të identifikuar zhvillimin e prapambetur mendor të lidhur me të.

***Përjashton:*** hipotiroidizmin subklinik nga mungesa e jodit (E02)

### E00.0 Sindrom i trashëguar i pamjaftueshmërisë se jodit, tipi neurologjik

Kretinizmi endemik, tipi neurologjik

### E00.1 Sindrom i trashëguar i pamjaftueshmërisë se jodit, tipi miksedematoz

Kretinizmi endemik:

- hypotiroidit
- miksedematoz

### E00.2 Sindrom i trashëguar i pamjaftueshmërisë së jodit, tipi i përzier

Kretinizmi endemik, i përzier

### E00.9 Sindrom i trashëguar i pamjaftueshmërisë së jodit, i paspecifikuar

Hipotiroidizmi i lindur i pamjaftueshmërisë së jodit NOS

Kretinizmi endemik NOS

## E01 Çrregullime të tiroides të lidhura me pamjaftueshmërinë e jodit dhe gjendje të ngjashme

***Përjashton:*** Hipotiroidizmin e lindur të pamjaftueshmërisë së jodit (E0.-)

Hipotiroidizmin subklinik nga mungesa e jodit (E02)

### E01.0 Gusha (endemike) difuze e lidhur me pamjaftueshmërinë e jodit

### E01.1 Gusha (endemike) multinodulare e lidhur me pamjaftueshmërinë e jodit

Gusha (endemike) nodulare e lidhur me pamjaftueshmërinë e jodit

### E01.2 Gusha (endemike) e lidhur me pamjaftueshmërinë e jodit, e paspecifikuar

Gusha endemike NOS

**E01.8 Çrregullime të tjera të tiroides të lidhura me pamjaftueshmërinë e jodit dhe gjendje të ngjashme**

Hipotiroidizmi i fituar i pamjaftueshmërisë së jodit

## E02 Hipotiroidizëm pa shenja klinike (=subklinik) i pamjaftueshmërisë jodike

## E03 Hipotiroidizëm tjetër

***Përjashton:*** hipotiroidizmin e lidhur me pamjaftueshmërinë e jodit (E00-E02)

Hipotiroidizmin post-proçedurial (E89.0)

**E03.0 Hipotiroidizëm i trashëguar me gushë të përhapur**

Gusha (jotoksike) e lindur:

- NOS
- parenkimatoze

***Përjashton:*** gushën e lindur tranzitore me funksion normal (P72.0)

**E03.1 Hipotiroidizëm i trashëguar, pa gushë**

Aplazia e tiroides (me miksedemë)

Kongjenital/e:

- atrofia e tiroides
- hipotiroidizmi NOS

**E03.2 Hipotiroidizëm nga medikamentet dhe lëndë të tjera të jashtme**

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve (Kapitulli XX), nëse doni, për të identifikuar arsyen.

**E03.3 Hipotiroidizëm postinfeksioz**

**E03.4 Atrofi e tiroides (e fituar)**

***Përjashton:*** atrofinë kongjenitale të të tiroides (E03.1)

**E03.5 Koma miksedematoze**

**E03.8 Hipotiroidizëm tjetër, i specifikuar**

**E03.9 Hipotiroidizëm, i paspecifikuar**

Miksedema NOS

## E04 Gushë (=Strumë) tjetër jotoksike

***Përjashton:*** gushën kongjenitale:

- NOS (E03.3)

- difuze (E03.3)
- parenkimatoze (E03.3)

gushën nga mungesa e jodit (E00-E02)

**E04.0 Gushë jotoksike e përhapur**

Gushë jotoksike:
- difuze (koloidale)
- e thjeshtë

**E04.1 Nodus i vetëm jotoksik i tiroides**

Nodul koloidal (cistik) (tiroid)

Gushë uninodulare jotoksike

Nodul tiroidal (cistik) NOS

**E04.2 Gushë shumënodulare jotoksike**

Gushë cistike NOS

Gushë shumënodulare (cistike) NOS

**E04.8 Gushë tjetër jotoksike, e specifikuar**

**E04.9 Gushë jotoksike, e paspecifikuar**

Gushë jotoksike

Gushë nodulare (jotoksike) NOS

## E05 Tirotoksikoza [hipertiroidizmi]

***Përjashton:*** tiroiditin kronik me tirotoksikozë tranziente (E06.2)
tirotoksikozën neonatale (P72.1)

**E05.0 Tirotoksikozë me gushë të përhapur**

Gushë toksike ose ekzoftalmike NOS

Sëmundja e Graves

Gushë toksike difuze

**E05.1 Tirotoksikozë me një nodus të vetëm toksik**

Tirotoksikozë me gushë me një nodus të vetëm toksik

**E05.2 Tirotoksikozë me gushë shumënodulare toksike**

Gushë nodulare toksike

**E05.3 Tirotoksikozë nga indi tiroidien ektopik (i vendosur diku tjetër)**

**E05.4 Tirotoksikozë nga mbidozimi i medikamenteve**

**E05.5 Kriza ose stuhia e tiroides**

**E05.8 Tirotoksikozë tjetër**

Mbiprodhim i hormonit stimulues të tiroides

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve (Kapitulli XX), nëse doni, për të identifikuar shkakun.

### E05.9 Tirotoksikozë e paspecifikuar

Hipertiroidizëm NOS

Sëmundja tirotoksike e zemrës† (I43.8*)

## E06 Tiroidit

***Përjashton:*** tiroiditin pas lindjes (O90.5)

### E06.0 Tiroidit i akut

Absces i tiroides

Tiroiditi:

- piogjenik
- supurativ

Përdorni kodet shtesë (B95-B98), nëse doni të identifikoni agjentët infeksiozë.

### E06.1 Tiroidit subakut

Tiroiditi:

- de Quervain
- qelizë gjigante
- granulomatoz
- jo-supurativ

***Përjashton:*** tiroiditin autoimun (E06.3)

### E06.2 Tiroidit kronik me tirotoksikozë kalimtare

***Përjashton:*** tiroiditin autoimun (E06.3)

### E06.3 Tiroidit autoimun

Tiroiditi Hashimoto

Hashitoksikoza (tranziente)

Gusha limfadenoide

Tiroiditi limfocitik

Struma limfomatoze

### E06.4 Tiroidit i shkaktuar nga medikamentet

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve (Kapitulli XX), nëse doni, të identifikoni shkakun.

### E06.5 Tiroidit tjetër kronik

Tiroiditi:

- kronik
  - NOS

- fibroz
- linjoz
- Riedel

**E06.9 Tiroidit i paspecifikuar**

## E07 Çrregullime të tjera të tiroides

**E07.0 Superprodhim i kalçitoninës**

Hiperplazia e qelizave C të tiroides

Hipersekretim i tirokalcitoninës

**E07.1 Gusha dis-hormogenetike**

Gusha dis-hormogjenetike familjare

Sindroma Pendred

***Përjashton:*** gushën e lindur tranzitore me funksion normal (P72.0)

**E07.8 Çrregullime të tjera të specifikuara të tiroides**

Anomali e globulinës që lidh tiroksinën

Hemorragji | e/i tiroides
Infarkt

Sindroma e sëmundjes eutiroidike

**E07.9 Çrregullim i tiroides, i paspecifikuar**

# Diabeti melitus
# (E10–E14)

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

Në vijim janë kodet katër-shifrore që mund të përdoren me kategoritë E10-E14:

**.0 me koma**

Diabetike

- koma me ose jo ketoacidozë
- koma hiperosmolare
- koma hipoglicemike

Koma hiperglicemike NOS

**.1 me ketoacidozë**

Diabetike:

- koma me ose jo ketoacidozë

- acidozë
- ketoacidozë

pa përmendje të komës

**.2† me komplikacione renale**

Nefropati diabetike (N08.3*)

Glomerulonefrozë intrakapilare (N08.3*)

Sindroma Kimmelstiel-Wilson (N08.3*)

**.3† me komplikacione oftalmike**

Diabetik/e:

- katarakt (H28.0*)
- retinopati (H36.0*)

**.4† me komplikacione neurologjike**

Diabetike:

- amiotrofi (G73.0*)
- neuropati autonomike (G99.0*)
- mononeuropati (G59.0*)
- polineuropati (G63.2*)
  - autonomike (G99.0*)

**.5† me komplikacione të vazave periferike**

Diabetike:

- gangrena
- angiopati periferike† (I79.2*)
- ulcer

**.6† me komplikacione të tjera**

Artropati diabetike† (M14.2*)

Artropati diabetike neuropatike† (M14.6*)

**.7† me komplikacione të shumta**

**.8† me komplikacione të papërcaktuara**

**.9† pa komplikacione**

## E10 Diabeti melitus i tipit 1

[shih para E10 për nën-ndarjet]

***Përfshin:*** diabetin (melitus)

- delikat
- të moshës së re
- të prirur për ketozë

***Përjashton:*** diabetin (melitus)

- të lidhur me kequshqyerjen (E12.-)

- të të porsalindurit (P70.2)
- të shtatzënisë, lindjes dhe të periudhës së pas lindjes (O24.-)

glikozurinë:

- NOS (R81)
- renale (E74.8)

testin jo-normal të tolerancës së glukozës (R73.0)

hipoinsulineminë post-kirurgjikale (E89.1)

## E11 Diabeti melitus i tipit 2

[shih para E10 për nën-ndarjet]

***Përfshin:*** diabetin (melitus) (jo-obez) (obez)

- të të rriturit
- të moshës së madhe
- jo-ketotik
- stabël

diabetin jo-insulinovartës të të riut

***Përjashton:*** diabetin (melitus)

- të lidhur me kequshqyerjen (E12.-)
- të të porsalindurit (P70.2)
- të shtatzënisë, lindjes dhe të periudhës së pas lindjes (O24.-)

glikozurinë:

- NOS (R81)
- renale (E74.8)

testin jonormal të tolerancës së glukozës (R73.0)

hipoinsulineminë post-kirurgjikale (E89.1)

## E12 Diabeti melitus i lidhur me kequshqyerjen

[shih para E10 për nën-ndarjet]

***Përfshin:*** diabetin melitus i-lidhur-me-kequshqyerjen

- të tipit 1
- të tipit 2

***Përjashton:*** diabetin melitus në shtatzëni, lindje dhe në periudhën e pas lindjes (O24.-)

glikozurinë:

- NOS (R81)
- renale (E74.8)

testin jonormal të tolerancës së glukozës (R73.0)

diabetin melitus të të porsalindurit (P70.2)
hipoinsulineminë post-kirurgjikale (E89.1)

## E13 Diabet melitus tjetër i specifikuar

[shih para E10 për nën-ndarjet]

***Përjashton:*** diabetin melitus:

- të lidhur-me-kequshqyerjen (E12.-)
- të të porsalindurit (P70.2)
- të shtatzënisë, lindjes dhe të periudhës së pas lindjes (O24.-)
- të tipit 1 (E10.-)
- të tipi 2 (E11.-)

glikozurinë:

- NOS (R81)
- renale (E74.8)

testin jonormal të tolerancës së glukozës (R73.0)
hipoinsulineminë post-kirurgjikale (E89.1)

## E14 Diabet melitus i paspecifikuar

[shih para E10 për nën-ndarjet]

***Përfshin:*** diabetin NOS

***Përjashton:*** diabetin melitus:

- të lidhur-me-kequshqyerjen (E12.-)
- të të porsalindurit (P70.2)
- të shtatzënisë, lindjes dhe të periudhës së pas lindjes (O24.-)
- të tipit 1 (E10.-)
- të tipi 2 (E11.-)

glikozurinë:

- NOS (R81)
- renale (E74.8)

testin jonormal të tolerancës së glukozës (R73.0)
hipoinsulineminë post-kirurgjikale (E89.1)

# Çrregullime të tjera të rregullimit të glukozës dhe të sekrecionit të brendshëm të pankreasit

## E15 Koma hipoglicemike jodiabetike

***Përfshin:*** komën insulinike të shkaktuar nga barnat tek jodiabetikët
hiperinsulinizmin me komë hipoglicemike
komën hipoglicemike NOS

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

## E16 Çrregullime të tjera të sekrecionit të brendshëm të pankreasit

### E16.0 Hipoglicemi e shkaktuar nga ilaçet, pa koma

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

### E16.1 Hipoglicemi tjetër

Hipoglicemia johiperinsulinemike funksionale

Hiperinsulinemizmi:

- NOS
- funksional

Hiperplazia e ishujve beta të pankreasit NOS

Koma encefalopatike post-hipoglicemike

### E16.2 Hipoglicemi, e paspecifikuar

### E16.3 Sekretim i rritur i glukagonit

Hiperplazia e qelizave endokrine të pankreasit me tepricë të glukagonit

### E16.3 Sekretim anormal i gastrinës

Hipergastrinemia

Sindroma Zollinger-Ellison

### E16.8 Çrregullime të tjera të specifikuara të sekrecionit të brendshëm pankreatik

Sekretim i rritur i qelizave endokrine të pankreasit nga:

- hormoni nxitës i hormonit të rritjes
- polipeptidet pankreatike
- somatostatina
- polipeptidi intestinal-vazoaktiv

### E16.9 Çrregullime të tjera të sekrecionit pankreatik, të paspecifikuara

Hiperplazia e qelizave ishull NOS

Hiperplazia e qelizave endokrine të pankreasit NOS

# Çrregullime të gjendrave të tjera endokrine (E20–E35)

***Përjashton:*** galaktorrenë (N64.3)
gjinekomastinë (N62)

## E20 Hipoparatiroidizëm

***Përjashton:*** sindromën e DiGeorge (D82.1)
hipoparatiroidizmin mbas-proçedurave IE89.2)
tetaninë NOS (R29.0)
hipoparatiroidizmin neonatal tranzitor (P71.4)

**E20.0 Hipoparatiroidizëm idiopatik**

**E20.1 Pseudohipoparatiroidizëm**

**E20.8 Hipoparatiroidizëm tjetër**

**E20.9 Hipoparatiroidizëm i paspecifikuar**

Tetania paratiroidike

## E21 Hiperparatiroidizëm dhe çrregullime të tjera të gjendrës paratiroide

***Përjashton:*** osteomalacinë:
- adulte (M83.-)
- infantile dhe juvenile (E55.0)

**E21.0 Hiperparatiroidizëm parësor**

Hiperplazia e paratiroides
Osteiti fibroz cistik i gjeneralizuar [Sëmundja von Recklinghausen e kockës]

**E21.1 Hiperparatiroidizëm dytësor**

***Përjashton:*** hiperparatiroidizmin dytësor për shkak të veshkave (N25.8)

**E21.2 Hiperparatiroidizëm tjetër**

Hiperparatiroidizmi terciar

***Përjashton:*** hiperkalceminë hipokalciurike familjare (E83.5)

**E21.3 Hiperparatiroidizëm i paspecifikuar**

**E21.4 Çrregullime të tjera specifike të gjendrës paratiroide**

**E21.5** **Çrregullim i gjendrës paratiroide, i paspecifikuar**

## E22 Hiperfunksion i gjendrës pituitare

***Përjashton:*** sindromën Cushing (E24.-)

sindromën Nelson (E24.1)

mbiprodhimin e:

- ACTH jo të lidhur me sëmundjen Cushing (E27.0)
- ACTH pituitar (E24.0)
- hormonit tiroid-stimulues (E05.8)

**E22.0** **Akromegali dhe gjigantizëm pituitar**

Artropatia e lidhur me akromegalinë† (M14.5*)

Mbiprodhim i hormonit

***Përjashton:*** konstitucional:

- gjigantizmin (E34.4)
- shtatin e lartë (E34.4)

sekretimin e shtuar nga pankreasi endokrin të hormonit-lëshues të hormonit të rritjes (E16.8)

**E22.1** **Hiperprolaktinemi**

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

**E22.2** **Sindrom i prodhimit të papërshtatshëm të hormonit antidiuretik**

**E22.8** **Hiperfunksion tjetër i gjendrës pituitare**

Puberteti i parakohshëm me origjinë qëndrore

**E22.9** **Hiperfunksion i gjendrës pituitare, i paspecifikuar**

## E23 Hipofunksion dhe çregullime të tjera të gjendrës pituitare

***Përfshin:*** gjendjet e listuara pavarësisht nëse gjendja është në hipofizë apo hipotalam

***Përjashton:*** hipopituitarizmin mbas-proçedurave (E89.3)

**E23.0** **Hipopituitarizëm**

Sindroma e eunukut pjellor

Hipogonadizmi hipogonadotropik

Mangësia idiopatike e hormonit të rritjes

Mungesat e izoluara të:

- gonadotropinave

- hormonit të rritjes
- hormonit pituitar

Sindroma Kallman

Shtati i shkurtër i Lorain-Levi

Nekroza pas-lindjes e gjendrës pituitare

Panhipopituitarizmi

Putuitar/e:

- kaheksia
- insufiçienca NOS
- shtati i shkurtër

Sindroma Sheehan

Sëmundja e Simmonds

**E23.1 Hipopituitarizëm i shkaktuar nga medikamentet**

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve të jashtme (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

**E23.2 Diabet insipid**

***Përjashton:*** diabetin insipid nefrogjenik (N25.1)

**E23.3 Çrregullim i funksionit hipotalamik, i paklasifikuar diku tjetër**

***Përjashton:*** sindromën Prader-Willi (Q87.1)

sindromën Russell-Silver (Q87.1)

**E23.6 Çrregullime të tjera të gjendrës pituitare**

Absces i hipofizës

Distrofia adipozogjenitale

**E23.7 Çrregullim i gjendrës pituitare, i paspecifikuar**

## E24 Sindroma Kushing

**E24.0 Sëmundja pituitaro-vartëse Kushing**

Mbiprodhimi i ACTH

Hiperadrenokorticizmi i varur nga hipofiza

**E24.1 Sindroma Nelson**

**E24.2 Sindroma Kushing e shkaktuar nga medikamentet**

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve të jashtme (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

**E24.3 Sindroma ektopike ACTH**

**E24.4 Sindroma pseudo-Kushing e shkaktuar nga alkooli**

**E24.8 Sindromë tjetër Kushing**

**E24.9** **Sindromë Kushing, e paspecifikuar**

## E25 Çrregullime adrenogjenitale

***Përfshin:*** sindromën adrenogenitale, virilizimin ose femininizimin, të fituar ose për shkak të hiperplazisë nga defektet e lindura të sintezës së hormonit

femëror:

- pseudohermafrodizmi
- pseudopuberteti i hershëm heteroseksual

mashkullor/e:

- pseudopuberteti i parakohshëm izoseksual
- makrogenitosomia praecox (=e parakohëshme)
- zhvillim i parakohshëm seksual me virilizim (femrat) nga hiperplazia adrenale

**E25.0** **Çrregullime adrenogjenitale të trashëguara të lidhura me pamjaftushmërinë enzimatike**

Hiperplazia adrenale kongjenitale

Mungesa e 21-hidroksilazës

Hiperplazia adrenale kongjenitale me humbje të kripës

**E25.8** **Çrregullime të tjera adrenogjenitale**

Çrregullimi adrenogjenital idiopatik

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve të jashtme (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

**E25.9** **Çrregullim adrenogjenital i paspecifikuar**

Sindroma adrenogjenitale NOS

## E26 Hiperaldosteronizëm

**E26.0** **Hiperaldosteronizëm parësor**

Sindroma Conn

Aldosteronizmi primar për shkak të hiperplazisë (bilaterale) adrenale

**E26.1** **Hiperaldosteronizëm dytësor**

**E26.8** **Hiperaldosteronizëm tjetër**

Sindroma Bartter

**E26.9** **Hiperaldosteronizëm i paspecifikuar**

## E27 Çrregullime të tjera të gjendrës adrenale

**E27.0** **Hiperaktivitet tjetër adrenokortikal**

Mbiprodhim i ACTH, i pa shoqëruar me sëmundjen e Cushing

Adrenarka e parakohshme

***Përjashton:*** Sindromën Cushing (E24.-)

**E27.1** **Pamjaftushmëri adrenokortikale primare**

Sëmundja e Addison

Adrenaliti autoimun

***Përjashton:*** amiloidozën (E85.-)

sëmundjen Addison tuberkulare (A18.7)

sindromën Water-House-Friderichsen (A39.1)

**E27.2** **Kriza e Addisonit**

Kriza adrenale

Kriza adrenokortikale

**E27.3** **Pamjaftushmëri adrenokortikale e shkaktuar nga medikamentet**

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve të jashtme (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

**E27.4** **Pamjaftushmëri adrenokortikale tjetër dhe e paspecifikuar**

Adrenal/e:

- hemorragji
- infarkt

Insufiçiencë adrenokortikale NOS

Hipoaldosteronizëm

***Përjashton:*** adrenoleukodistrofinë [Addison-Schilder] (E71.3)

Sindromën Water-House-Friderichsen (A39.1)

**E27.5** **Hiperfunksion adrenomedular**

Hiperplazia adrenomedulare

Prodhimi i shtuar i katekolaminave

**E27.8** **Çrregullime të tjera të specifikuara të gjendrës mbiveshkore**

Abnormalitet (=jonormalitet) i globulinës-që-lidh kortizolin

**E27.9** **Çrregullim i gjendrës mbiveshkore, i paspecifikuar**

## E28 Çrregullim i funksionit të ovarit

***Përjashton:*** mungesën e izoluar të gonadotropinave (E23.0)

insufiçiencën e ovareve mbas-proçedurave (E89.4)

**E28.0** **Tepricë estrogjeni**

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve të jashtme (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

**E28.1 Tepricë androgjeni**

Prodhim i shtuar i androgjenëve të ovarit

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve të jashtme (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

**E28.2 Sindrom policistik i vezores**

Sindroma e ovarit sklerocistik

Sindroma Stein-Leventhal

**E28.3 Pamjaftushmëri parësore e vezores**

Estrogjen i pakët

Menopauzë e parakohëshme NOS

Sindroma e ovarit rezistent

***Përjashton:*** gjendjet klimakterike menopauzale dhe femërore (N95.1)
disgjenezën gonadale të pastër (Q99.1)
sindromën Turner (Q96.-)

**E28.8 Çrregullim tjetër i vezores**

Funksion i shtuar ovarian NOS

**E28.9 Çrregullim i vezores, i paspecifikuar**

## E29 Çrregullim i funksionit testikular

***Përjashton:*** sindromën e rezistencës ndaj androgjenëve (E34.5)
azoosperminë ose oligosperminë NOS (N46)
mungesën e izoluar të gonadotropinave (E23.0)
sindromën Kleinfelter (Q98.0-Q98.2, Q98.4)
femininizimin testikular (sindromën) (E34.5)

**E29.0 Hiperfunksion testikular**

Shtim i prodhimit të hormoneve testikulare

**E29.1 Hipofunksion testikular**

Mungesa e 5-alfa-reduktazës (me pseudohermafrodizëm)

Biosintezë defektoze e androgjenëve testikularë NOS

Hipogonadizmi testikular NOS

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve të jashtme (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

**E29.8 Çrregullim tjetër testikular**

**E29.9 Çrregullim testikular, i paspecifikuar**

## E30 Çrregullime të pubertetit, të paspecifikuara diku tjetër

**E30.0 Pubertet i vonuar**

Pubertet i vonuar konstitucional

Zhvillim i vonuar seksual

**E30.1 Pubertet i parakohshëm**

Menstruacione të parakohshme

***Përjashton:*** Sindromën Albright(-McCune)(-Sternberg) (Q78.1)
Pubertetin e parakohshëm me origjinë qëndrore (E22.8)
Hiperplazia adrenale kongjenitale (E25.0)
Pseudopuberteti i parakohshëm heteroseksual femëror (E25.-)
Pseudopuberteti i parakohshëm izoseksual mashkullor (E25.-)

**E30.8 Çrregullime të tjera të pubertetit**

Telarka e parakohshme

**E30.9 Çrregullim i pubertetit, i paspecifikuar**

## E31 Çrregullim funksional poliglandular (=shumëgjendror)

***Përjashton:*** ataksinë telangiektazike [Louis-Bar] (G11.3)
distrofinë miotonike [Steinert] (G71.1)
pseudohipoparatiroidizmin (E20.1)

**E31.0 Pamjaftushmëri shumëgjendrore autoimune**

Sindroma e Schmidt

**E31.1 Hiperfunksion shumëgjendror**

***Përjashton:*** adenomatozën endokrine të shumëfishtë (D44.8)

**E31.8 Çrregullim tjetër funksional shumëgjendror**

**E31.9 Çrregullim shumëgjendror, i paspecifikuar**

## E32 Sëmundjet e timus-it

***Përjashton:*** aplazinë ose hipoplazinë me imunodefiçiencë (D82,1)
miasteninë gravis (G70.0)

**E32.0 Hiperplazia persistente e timusit**

Hipertrofi e timusit

**E32.1 Abscesi i timusit**

**E32.8** **Sëmundje të tjera të timusit**

**E32.9** **Sëmundje të timusit, të paspecifikuara**

## E34 Çrregullime endokrine të tjera

***Përjashton:*** pseudhipoparatiroidizmin (E20.1)

**E34.0** **Sindromi karcinoid**

***Shënim:*** Mund të përdoren kode shtesë për të identifikuar aktivitetin funksional të lidhur me tumorin karcinoid.

**E34.1** **Hipersekrecion tjetër i hormoneve të zorrës**

**E34.2** **Sekrecion hormonal ektopik, i paklasifikuar diku tjetër**

**E34.3** **Nanizëm (shtatshkurtësi) i paklasifikuar diku tjetër**

Shtat i shkurtër:

- NOS
- konstitucional
- i tipit Laron
- psikosocial

***Përjashton:*** progerinë (E34.8)

sindromën Russel-Silver (Q87.1)

staturën me gjymtyrë të shkurtëra me imunodefiçencë (D82.2)

shtat i shkurtër:

- akondropalastik (Q77.4)
- hipokondroplastik (q77.4)
- në sindroma disformike të caktuara – kodoni sindromën – shih indeksin alfabetik
- ushqimor (=nutricional) (E45)
- pituitar (E23.0)
- renal (N25.0)

**E34.4** **Shtatlartësi konstitucionale**

Gjigantizëm konstitucional

**E34.5** **Sindrom androgjen i rezistencës**

Pseudohermafrodizëm mashkullor me rezistencë ndaj endrogjenëve

Çrregullime periferike të receptorit hormonal

Sindroma Reifenstein

Feminizimi testikular (sindroma)

**E34.8** **Çrregullime të tjera të specifikuara të sekrecionit të brendshëm**

Disfunksion i gjendres pineale

Progeria

**E34.9 Çrregullim i sekrecionit të brendshëm, i paspecifikuar**

Çrregullime

- endokrine NOS
- hormonale NOS

## E35* Çrregullime të gjendrave endokrine në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

**E35.0* Çrregullime të gjendrës tiroide të klasifikuara diku tjetër**

Tuberkuloz i gjendrës tiroide (A18.8†)

**E35.1* Çrregullime të gjendrave mbiveshkore në sëmundje të klasifikuara diku tjetër**

Sëmundja tuberkulare Addison (A18.7†)

Sindroma Water-House-Friderichsen (meningeale) (A39.1†)

**E35.8* Çrregullime të gjendrave të tjera me sekrecion të brendshëm në sëmundje të klasifikuara diku tjetër**

# Kequshqyerja
# (E40–E46)

***Shënim:*** Shkalla e kequshqyerjes matet zakonisht në terma të peshës, të shprehur në deviacione standarde nga mesatarja e popullatës në fjalë. Kur një nga matjet e mëparëshme është e mundur të gjehet, mungesa e rritjes tek fëmijët, ose humbja e peshës tek fëmijët dhe të rriturit është zakonisht shenjë e kequshqyerjes. Kur vetëm një matje është e gjetshme, diagnoza bazohet në probabilitete dhe nuk është përfundimtare pa bërë dhe vlerësimet klinike dhe labratorike. Në raste të veçanta, kur nuk ka asnjë matje të gjetshme, duhet të bazohemi mbi gjetjet klinike.

Nëse një peshë e matur del nën mesataren e popullatës në fjalë, probabiliteti është i lartë për kequshqyerje të thellë, kur kjo vlerë e matur është 3 deviacione standard nën mesataren e popullatës; propabilitet i lartë për kequshqyerje të moderuar kur vlera është më pak se 3 dhe më shumë se 2 nën mesataren e popullatës; dhe propabilitet i lartë për kequshqyerje të lehtë kur vlera e matjes është midis 1 dhe 2 deviacione standard nën mesataren e popullatës.

***Përjashton:*** kequshqyerjen intestinale (K90.-)

anemitë nutricionale (D50-D53)

pasojat e kequshqyerjes proteinike-kalorike

sëmundjen e dobësimit (B22.2)

urinë e stërzgjatur (T73.0)

## E40 Kwashiorkor (Distrofia)

Kequshqyerje e thellë me edemë nutricionale dhe dispigmenti të lëkurës dhe flokëve.

***Përjashton:*** kwashiorkorin marazmik (E42)

## E41 Marazma e ushqyerjes (=Marazma nutricionale)

***Përfshin:*** kequshqimin e thellë me marazmë

***Përjashton:*** kwashiorkorin marazmik (E42)

## E42 Kwashiorkor marazmik

***Përfshin:*** kequshqyerjen e thellë proteinike-energjitike [si në E43]:

formën e ndërmjetme

me shenja si të kwashiorkorit ashtu dhe marazmës

## E43 Malnutricion i rëndë nga pamjaftueshmëria proteinike, i paspecifikuar

Humbja e madhe e peshës tek fëmijët dhe të rriturit, ose mos-shtimi në peshë, që çon në një peshë që është të paktën 3 deviacione standard nën mesataren e peshës në popullatë, (ose humbje e ngjashme që shprehet me qasje të tjera statistikore). Kur vetëm një matje është e gjetshme, atëhere ka një probabilitet të lartë për humbje të theksuar në peshë, kur pesha e matur është nën 3 deviacione standard nga mesatarja e peshës në popullatë.

***Përfshin:*** edemën nga uria e tejzgjatur

## E44 Malnutricion i moderuar ose i lehtë nga pamjaftueshmëria proteinike

### E44.0 Malnutricion i moderuar nga pamjaftueshmëria proteinike

Humbja e peshës tek fëmijët dhe të rriturit, ose mos-shtimi në peshë, që çon në një peshë që është të paktën 3 deviacione standard nën mesataren e peshës në popullatë, (ose humbje e ngjashme që shprehet me qasje të tjera statistikore). Kur vetëm një matje është e gjetshme, atëhere ka një probabilitet të lartë për humbje të theksuar në peshë, kur pesha e matur është nën 3 deviacione standard nga mesatarja e peshës në popullatë.

### E44.1 Malnutricion i lehtë nga pamjaftueshmëria proteinike

Humbja e peshës tek fëmijët dhe të rriturit, ose mos-shtimi në peshë, që çon në një peshë që është të paktën 3 deviacione standard nën mesataren e peshës në popullatë, (ose humbje e ngjashme që shprehet me qasje të tjera statistikore). Kur vetem një

matje është e gjetshme, atëhere ka një probabilitet të lartë për humbje të theksuar në peshë, kur pesha e matur është nën 3 deviacione standard nga mesatarja e peshës në popullatë.

### E45 Zhvillimi i vonuar nga malnutricioni proteinik

***Përfshin:*** nutricional/e:

- shtatin e shkurtër
- mos-zgjatjen

zhvillimin e vonuar fizik për shkak të kequshqyerjes

### E46 Malnutricion proteinik i paspecifikuar

***Përfshin:*** kequshqyerjen NOS

disbalancën proteinë-energji NOS

## Pamjaftueshmëri të tjera të ushqyerjes (E50–E64)

***Përjashton:*** anemitë nutricionale (D50-D53)

### E50 Pamjaftushmëri e vitaminës A

***Përjashton:*** pasojat e mungesës së vitaminës A (E64.1)

**E50.0 Pamjaftushmëri e Vitaminës A me tharje (=kserozë) të konjunktivave**

**E50.1 Pamjaftushmëri e Vitaminës A me njollë Bitot dhe tharje të konjuktivave**

Njolla Bitot tek fëmijët e vegjël

**E50.2 Pamjaftushmëri e vitaminës A me tharje të kornesë**

**E50.3 Pamjaftushmëri e vitaminës A me ulçer dhe tharje të kornesë**

**E50.4 Pamjaftushmëri e vitaminës A me keratomalaci**

**E50.5 Pamjaftushmëri e vitaminës A me hemeralopi**

**E50.6 Pamjaftushmëri e vitaminës A me gjurmë kseroftalmie të kornesë**

**E50.7 Manifestime të tjera okulare të pamjaftushmërisë së vitaminës A**

Kseroftalmia NOS

**E50.8 Manifestime të tjera të pamjaftushmërisë së vitaminës A**

Keratoza folikulare | për shkak të mungesës vitaminës A† (L86*)

Kseroderma

**E50.9** **Pamjaftushmëri e vitaminës A, e paspecifikuar**

Hipovitaminoza A NOS

## E51 Pamjaftushmëri e tiaminës

***Përjashton:*** pasojat e mungesës së tiaminës (E64.8)

**E51.1** **Beriberi**

Beriberi:

- e thatë
- e njomë† (I98.8*)

**E51.2** **Encefalopatia e Wernicke**

**E51.8** **Manifestime të tjera të pamjaftushmërisë së tiaminës**

## E52 Pamjaftushmëri e niacinës [Pelagra]

***Përfshin:*** mungesën e:

- niacinës (triptofanit)
- nikotinamidit

pelagrën (alkolike)

***Përjashton:*** pasojat e mungesës së tiaminës (E64.8)

## E53 Pamjaftushmëri e vitaminave të tjera të grupit B

***Përjashton:*** pasojat e mungesës së vitaminës B (E64.8)

aneminë nga mungesa e vitaminë B12 (D51.-)

**E53.0** **Pamjaftushmëri e riboflavinës**

Ariboflavinosë

**E53.1** **Pamjaftushmëri e piridoksinës**

Mungesa e vitaminë B6

***Përjashton:*** aneminë sideroblastike që i përgjigjet piridoksinës (D64.3)

**E53.8** **Pamjaftushmëri e vitaminave të tjera të specifikuara të grupit B**

Mungesat në:

- biotinë
- cianokobolaminë
- folate
- acid folik
- acid pantotenik

- vitaminë B12

**E53.9 Pamjaftushmëri e vitaminës B, e paspecifikuar**

## E54 Pamjaftushmëri e acidit askorbik

***Përfshin:*** mungesën e vitaminës C
skorbutin

***Përjashton:*** aneminë nga skorbuti (D53.2)
pasojat (=sekelat) e mungesës së vitaminës C (E64.2)

## E55 Pamjaftushmëri e vitaminës D

***Përjashton:*** osteomalacinë e të rriturit (M83.-)
osteoporozën (M80-M81)
pasojat (=sekelat) e rakitizmit (E64.3)

**E55.0 Rakitizëm aktiv**

Osteomalacia:
- infantile
- juvenile

***Përjashton:*** rakitizmin:
- celiak (K90.0)
- Crohn (K50.-)
- inaktiv (E64.3)
- renal (N25.0)
- rezistent ndaj vitaminës D (E83.3)

**E55.9 Pamjaftushmëri e vitaminës D, e paspecifikuar**

Avitaminoza D

## E56 Pamjaftushmëri të tjera vitaminike

***Përjashton:*** pasojat e avitaminozave të tjera (E64.8)

**E56.0 Pamjaftushmëri e vitaminës E**

**E56.1 Pamjaftushmëri e vitaminës K**

***Përjashton:*** mungesën e faktoreve të koagulimit nga mungesën e vitaminës K (D68.4)
mungesën e vitaminës K tek të porsalindurit (P53)

**E56.8 Pamjaftushmëri e vitaminave të tjera**

**E56.9** **Pamjaftushmëri vitaminike, e paspecifikuar**

## E58 Pamjaftushmëri dietetike e kalciumit

***Përjashton:*** çrregullimet e metabolizmit të kalciumit (E83.5)

pasojat (=sekelat) e mungesës së kalçiumit (E64.8)

## E59 Pamjaftushmëri diedetike e seleniumit

***Përfshin***: Sëmundjen Keshan

***Përjashton:*** pasojat (=sekelat) e mungesës së seleniumit (E64.8)

## E60 Pamjaftushmëri dietetike e zinkut

## E61 Pamjaftushmëri e elementeve të tjerë ushqyes

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve të jashtme (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat nëse janë shkaktarë.

***Përjashton:*** çrregullimet e metabolizmit të mineraleve (E83.-)

çrregullimet e tiroides të lidhura me mungesën e jodit (E00-E02)

pasojat e mungesave ushqimore dhe kequshqyerjes (E64.-)

**E61.0** **Pamjaftushmëri e bakrit**

**E61.1** **Pamjaftushmëri e hekurit**

***Përjashton:*** aneminë nga mungesa e hekurit (D50.-)

**E61.2** **Pamjaftushmëri e magneziumit**

**E61.3** **Pamjaftushmëri e manganit**

**E61.4** **Pamjaftushmëri e kromit**

**E61.5** **Pamjaftushmëri e molibdenit**

**E61.6** **Pamjaftushmëri e vanadiumit**

**E61.7** **Pamjaftushmëri e shumë elementeve nutritivë**

**E61.8** **Pamjaftushmëri e elementëve të tjerë nutritivë, të specifikuar**

**E61.9** **Pamjaftushmëri e një elementi nutritiv, e paspecifikuar**

## E63 Pamjaftushmëri të tjera nutritive

***Përjashton:*** dehidratimin (E86)

moszhvillimin (R62.8)

problemet e ushqyerjes tek të porsalindurit (P92.-)

pasojat e kequshqyerjes dhe mungesa të tjera të ushqyerjes (E64.-)

**E63.0 Pamjaftushmëri e acideve yndyrore të domosdoshëm**

**E63.1 Çrregullim i balancit të përbërësve të ushqimit të marrur**

**E63.8 Pamjaftushmëri të tjera nutritive, të specifikuara**

**E63.9 Pamjaftushmëri nutritive, e paspecifikuar**

Kardiomiopatia ushqimore NOS† (I43.2*)

## E64 Pasoja (sekela) të malnutricionit dhe të pamjaftushmërive të tjera nutritive

***Shënim:*** Të mos përdoret për kequshqyerjen kronike nga mungesat ushqimore.

Kodoni këto në vendet e mungesave ushqimore ose kequshqimit.

**E64.0 Pasoja të kequshqyerjes të lidhur me energjinë proteinike**

***Përjashton:*** zhvillimin e vonuar nga kequshqyerja proteiniko-energjitike

**E64.1 Pasoja nga pamjaftushmëria e vitaminës A**

**E64.2 Pasoja nga pamjaftushmëria e vitaminës C**

**E64.3 Pasoja të rakitit**

Përdorni kodet shtesë (M40.1, M41.5), nëse dëshirohet, për të identifikuar deformitetet e kollonës.

**E64.8 Pasoja nga pamjaftushmëritë e tjera nutritive**

**E64.9 Pasoja nga pamjaftushmëria nutritive, e paspecifikuar**

# Obeziteti dhe mbiushqyerje të tjera (E65–E68)

## E65 Adipozitet i lokalizuar

***Përfshin***: shtresën dhjamore

## E66 Obezitet

***Përjashton:*** distrofinë adipozogjenitale (E23.6)

lipomatozën

- NOS (E88.2)
- dolorosa [Dercum] (E88.2)

sindromën Prader-Willi (Q87.1)

**E66.0 Obezitet nga teprica e kalorive**

**E66.1 Obezitet i shkaktuar nga medikamentet**

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve të jashtme (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

**E66.2 Obezitet i jashtëzakonshëm me hipoventilacion alveolar**

Sindroma e hipoventilimit nga obeziteti

Sindroma Pickwickian

**E66.8 Obezitet tjetër**

Obeziteti morbid

**E66.9 Obezitet, i paspecifikuar**

Obezitet i thjeshtë NOS

## E67 Mbiushqyerje tjetër

***Përjashton:*** mbiyshqyerjen NOS (R63.2)

pasojat e mbiushqyerjes (E68)

**E67.0 Hipervitaminoza A**

**E67.1 Hiperkarotenemia**

**E67.2 Sindromi i megavitaminës B6**

**E67.3 Hipervitaminoza D**

**E67.8 Mbiushqyerje tjetër, e specifikuar**

## E68 Pasojat (sekelat) e mbiushqyerjes

***Shënim:*** Të mos përdoren për mbiushqyerjen kronike. Kodojini këto në mbiushqyerjen aktuale.

# Çrregullimet metabolike (E70–E90)

***Përjashton:*** sindromën e rezistencës ndaj androgjenëve (E34.5)

hiperplazine adrenale kongjenitale (E25.0)

sindromën Ehlers-Danlos (Q79.6)

aneminë hemolitike nda çrregullimet enzimatike (D55.-)
sindromën Marfan (Q87.4)
mungesën e 5-alfa-reduktazës (E29.1)

## E70 Çrregullime të metabolizmit të aminoacideve aromatike

### E70.0 Fenilketonuria klasike

### E70.1 Hiperfenilalaninemi të tjera

### E70.2 Çrregullim i metabolizmit të tireozinës

Alkaptonuria
Hipertirozinemia
Okronoza
Tirozinemia
Tirozinoza

### E70.3 Albinizëm

Albinizmi:
- okular
- okulokutan

Sindroma:
- Chediak(-Steinbrinck)-Higashi
- Cross
- Hermansky-Pudlak

### E70.8 Çrregullime të tjera të metabolizmit të aminoacideve të tjera aromatike

Çrregullime të:
- metabolizmit të histidinës
- metablizmit të triptofanit

### E70.9 Çrregullim i metabolizmit të aminoacideve aromatike, i paspecifikuar

## E71 Çrregullime të metabolizmit të aminoacideve me zinxhir të degëzuar dhe të metabolizmit të acideve yndyrore

### E71.0 Sëmundje që karakterizohet me urinim me ngjyrën e lëngut të kuq të panjës

### E71.1 Çrregullime të tjera të metabolizmit të aminoacideve me zinxhir të degëzuar

Hiperleucinë-izoleucinemia

Hipervalinemia

Acidemia izovalerike

Acidemia metilmalonike

Acidemia proprionike

**E71.2 Çrregullim i metabolizmit të aminoacideve me zinxhir të degëzuar, i paspecifikuar**

**E71.3 Çrregullim i metabolizmit të acideve yndyrore**

Adrenoleukodistrofia [Addison-Schilder]

Mungesa e karnitinë-palmitil-transferazës në muskul

Mungesa e dehidrogjenazës të vargjeve shumë të gjata të Acil-CoA

***Përjashton:*** sëmundjen e Schilder (G37.0)

## E72 Çrregullime të tjera të metabolizmit të aminoacideve

***Përjashton:*** gjetjet anormale por pa shfaqje të sëmundjes (R70-R89)

çrregullimet e:

- metabolizmit të aminoacideve aromatike (E70.-)
- metabolizmit të aminoacideve të degëzuara (E71.0-E71.2)
- metabolizmit të acideve yndyrorë (E71.2)
- metabolizmit të purinave dhe pirimidinave (E79.-)

gutën (M10)

**E72.0 Çrregullime të transportit të aminoacideve**

Sëmundja e depozitimit të cisteinës† (N29.8*)

Cistinoza

Cistinuria

Sindroma Fanconi(-de Toni)(-Debré)

Sëmundja Hurtnup

Sindroma Lowe

***Përjashton:*** çrregullimet e metabolizmit të triptofanit (E70.8)

**E72.1 Çrregullime të metabolizmit të aminoacideve bartëse të squfurit**

Cistationuria

Homocistonuria

Metioninemia

Mungesa e oksidazës së sulfiteve

***Përjashton:*** mungesën e transkobalaminës II

**E72.2 Çrregullime të metabolizmit të ciklit të uresë**

Argininemia

Aciduria arginino-suksinike

Citrulinemia

Hiperamonemia

***Përjashton:*** çrregullimet e metabolizmit të ornitinës (E72.4)

**E72.3 Çrregullime të metabolizmit të lizinës dhe hidroksilizinës**

Aciduria glutarike

Hidroksilisinemia

Hiperlizinemia

***Përjashton:*** sëmundjen Refsum (G60.1)
sindromën Zellweger (Q87.8)

**E72.4 Çrregullime të metabolizmit të ornitinës**

Ornitinemia (llojet I dhe II)

**E72.5 Çrregullime të metabolizmit të glicinës**

Hiperhidroksiprolinemia

Hiperprolinemia (llojet I dhe II)

Hiperglicemia jo-ketotike

Sarkozinemia

**E72.8 Çrregullime të tjera të metabolizmit të aminoacideve, të specifikuara**

Çrregullime të:

- metabolizmit të beta aminoacideve
- ciklit të gama-glutamilit

**E72.9 Çrregullim i metabolizmit të aminoacideve, i paspecifikuar**

## E73 Intolerancë e laktozës

**E73.0 Pamjaftushmëri kongjenitale e laktozës**

**E73.1 Pamjaftushmëri sekondare e laktozës**

**E73.8 Intolerancë tjetër ndaj laktozës**

**E73.9 Intolerancë ndaj laktozës, e paspecifikuar**

## E74 Çrregullime të tjera të metabolizmit të karbohidrateve

***Përjashton:*** prodhimin e shtuar të glukagonit (E16.3)
diabetin melitus (E10-E14)
hipogliceminë NOS (E16.2)
mukopolisaharidozat (E76.0-E76.3)

**E74.0 Çrregullim i depozitimit të glikogjenit**

Glikogjenoza kardiake

Sëmundjet:

- Andersen
- Cori
- Forbes
- Hers
- McArdle
- Pompe
- Tarui
- Tauri
- von Gierke

Mungesa e fosforilazës në mëlçi

**E74.1 Çrregullime të metabolizmit të fruktozës**

Fruktozuria esenciale

Mungesa e fruktozë-1,6-difosfatazës

**E74.2 Çrregullime të metabolizmit të galaktozës**

Mungesa e galaktokinazës

Galaktozemia

**E74.3 Çrregullime të tjera të absorbimit intestinal të karbohidrateve**

Keqpërthithja e glukozë-galaktozës

Mungesa e sukrozës

***Përjashton:*** intolerancën nga laktoza (E73.-)

**E74.4 Çrregullime të metabolizmit të piruvateve dhe të glukoneogenezës**

Mungesa e:

- fosfoenolpiruvat karboksikinazës
- piruvat:
  - karboksilazës
  - dehidrogjenazës

***Përjashton:*** me anemi (D55.-)

**E74.8 Çrregullime të tjera të specifikuara të metabolizmit të karbohidrateve**

Pentozuria esenciale

Oksaloza

Oksaluria

Glukozuria renale

**E74.9** **Çrregullime të tjera të metabolizmit të karbohidrateve, të paspecifikuara**

## E75 Çrregullime të metabolizmit sfingolipidik dhe çrregullime të tjera të depozitimit të lipideve

***Përjashton:*** mukolipidozat, llojet I-III (E77.0-E77.1)
sëmundjen Refsum (G60.1)

**E75.0** **Gangliosidozë $GM_2$**

Sëmundja:

- Sandhoff
- Tay-Sachs

Gangliosidoza GM2:

- NOS
- adulte
- juvenile

**E75.1** **Gangliosidozë tjetër**

Gangliosidozat:

- NOS
- GM1
- GM3

Mukolipidoza IV

**E75.2** **Sfingolipidozë tjetër**

Sëmundja:

- Fabry(-Anderson)
- Gaucher
- Krabbe
- Niemann-Pick

Sindroma Farber

Leukodistrofia metakromatike

Mungesa e sulfatazës

***Përjashton:*** adrenoleukodistrofinë [Addison-Schilder] (E71.3)

**E75.3** **Sfingolipidozë, e paspecifikuar**

**E75.4** **Lipofuskinozë ceroide e neuroneve**

Sëmundja:

- Batten
- Bielschowsky-Jansky

- Kufs
- Spielmeyer-Vogt

**E75.5 Çrregullime të tjera të depozitimit të lipideve**

Kolesteroza cerebrotendinoze [van Bogaert-Scherer-Epstein]

Sëmundja Wolman

**E75.6 Çrregullim i depozitimit të lipideve, i paspecifikuar**

## E76 Çrregullime të metabolizmit të glukozaminoglukaneve

**E76.0 Mukopolisaharidioza, tipi I**

Sindroma:

- Hurler
- Hurler-Scheie
- Scheie

**E76.1 Mukopolisaharidoza, tipi II**

Sindroma Hunter

**E76.2 Mukopolisaharidozë tjetër**

Mungesa e beta-glukoronilidazës

Mukopolisaharidoza, llojet III, IV, VI, VII

Sindroma:

- Maroteaux-Lamy (e moderuar) (e rëndë)
- Morquio (klasike)
- Sanfilippo (lloji B)(lloji C)(lloji D)

**E76.3 Mukopolisaharidozë, e paspecifikuar**

**E76.8 Çrregullime të tjera të metabolizmit glukozaminoglukanik**

**E76.9 Çrregullim i metabolizmit glukozaminoglukanik, i paspecifikuar**

## E77 Çrregullime të metabolizmit të glukoproteinave

**E77.0 Defekte të modifikimit pas-konvertues të enzimave lizozomale**

Mukolipidoza II [Sëmundja e qelizave I]

Mukolipidoza III [polidistrofia pseudo-Hurler]

**E77.1 Defekte në degradimin e glukoproteinave**

Aspartilglukozaminuria

Fukosidoza

Manosidoza

Sialidoza [Mukolipidoza I]

**E77.8 Çrregullime të tjera të metabolizmit të glukoproteinave**

**E77.9 Çrregullim i metabolizmit të glukoproteinave, i paspecifikuar**

## E78 Çrregullime të metabolizmit të lipoproteinave dhe lipidemi të tjera

***Përjashton:*** sfingolipidozën (E75.0-E75.3)

**E78.0 Hiperkolesterolemi e pastër**

Hiperkolesterolemia familjare

Hiperlipoproteinemia Fredrickson, lloji IIa

Hiperbetalipoproteinemia

Hiperlipidemia, grupi A

Hiperlipoproteinemia me densitet të ulët [LDL]

**E78.1 Hipergliceridemi e pastër**

Hipergliceridemia endogjene

Hiperlipoproteinemia Fredrickson, lloji IV

Hiperlipidemia, grupi B

Hiperprebetalipoproteinemia

Hiperlipoproteinemia me densitet shumë të ulët [VLDL]

**E78.2 Hiperlipidemi e përzier**

Betalipoproteinemia e gjerë ose pluskuese

Hiperlipoproteinemia Fredrickson, lloji IIb ose III

Hiperbetalipoproteinemia me prebetalipoproteinemi

Hiperkolesterolemia me hipergliceridemi endogjene

Hiperlipidemia, grupi C

Ksantoma tubero-eruptive

Ksantoma tuberale

***Përjashton:*** kolesterozën cerebrotendinoze [van Bogaert-Scherer-Epstein] (E75.5)

**E78.3 Hiperkilomikronemi**

Hiperlipoproteinemia Fredrickson, lloji I ose V

Hiperlipidemia, grupi D

Hipergliceridemia e përzier

**E78.4 Hiperlipidemi tjetër**

Hiperlipidemia familjare e kombinuar

**E78.5 Hiperlipidemi, e paspecifikuar**

**E78.6** **Pamjaftushmëri lipoproteinike**

Abetalipoproteinemia

Mungesa e lipoproteinave me densitet të lartë

Hipoalfalipoproteinemia

Hipobetalipoproteinemia (familjare)

Mungesa e lecitin-kolesterol acil-transferazës

Sëmundja Tangier

**E78.8** **Çrregullime të tjera të metabolizmit të lipoproteinave**

**E78.9** **Çrregullim i metabolizmit të lipoproteinave, i paspecifikuar**

## E79 Çrregullime të metabolizmit të purinave dhe të pirimidinave

***Përjashton:*** gurët e veshkës (N20.0)

çrregullimet e kombinuara të imunodefiçiencës (D81.-)

gutën (M10.-)

aneminë orotacidurike (D53.0)

kserodermën pigmentoze (Q82.1)

**E79.0** **Hiperuricemi pa shenja të artritit inflamator dhe të sëmundjes tofaceozë (=tofaceike)**

Hiperuricemi pa shenja

**E79.1** **Sindromi Lesch-Nyhan**

**E79.8** **Çrregullime të tjera të metabolizmit të purinave dhe të pirimidinave**

Ksantinuria e trashëguar

**E79.9** **Çrregullim i metabolizmit të purinave dhe pirimidinave, i paspecifikuar**

## E80 Çrregullime të metabolizmit të porfirinave dhe të bilirubinës

***Përjashton:*** defektet e katalazës dhe peroksidazës

**E80.0** **Porfiria eritropojetike e trashëguar**

Porfiria eritropojetike kongjenitale

Porfiria eritropojetike

**E80.1** **Porfiria e vonëshme e lëkurës**

**E80.2** **Porfiri tjetër**

Koproporfiria e trashëguar

Porfiria:

- NOS
- akute intermitente (hepatike)

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve të jashtme (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni shkakun.

**E80.3 Defekte të katalazës dhe peroksidazës**

Akatalazia [Takahara]

**E80.4 Sindromi i Gilbert**

**E80.5 Sindromi Crigler-Najjar**

**E80.6 Çrregullime të tjera të metabolizmit të bilirubinës**

Sindroma Dubin-Johnson

Sindroma Rotor

**E80.7 Çrregullim i metabolizmit të bilirubinës, i paspecifikuar**

## E83 Çrregullime të metabolizmit të mineraleve

***Përjashton:*** mungesat ushqimore të mineraleve (E58-E61)
çrregullimet e paratiroides (E20-E21)
mungesën e vitaminës D (E55.-)

**E83.0 Çrregullime të metabolizmit të bakrit**

Sëmundja Menkes (flokë të imët)(flokë çeliku)

Sëmundja Wilson

**E83.1 Çrregullime të metabolizmit të hekurit**

Hemokromatoza

***Përjashton:*** aneminë:

- nga mungesa e hekurit
- sideroblastike (D64.0-D64.3)

**E83.2 Çrregullime të metabolizmit të zinkut**

Akrodermatiti enteropatik

**E83.3 Çrregullime të metabolizmit të fosforit**

Mungesa e fosfatazës acide

Hipofosfatemia familjare

Hipofosfatazia

Rezistent/e ndaj vitaminës D:

- osteomalacia
- rakiti

***Përjashton:*** osteomalacinë e adultëve (M83)
osteoporozën (M80-M81)

**E83.4 Çrregullime të metabolizmit të magneziumit**

Hipermagnezemia

Hipomagnezemia

**E83.5 Çrregullime të metabolizmit të kalciumit**

Hiperkalcemia hipokalurike familjare

Hiperkalcuria idiopatike

***Përjashton:*** kondrokalcinozën (M11-M11.2)
hiperparatiroidizmin (E21.0-E21.3)

**E83.8 Çrregullime të tjera të metabolizmit të mineraleve**

**E83.9 Çrregullim i metabolizmit të mineraleve, i paspecifikuar**

## E84 Fibroza cistike

***Përfshin:*** mukoviscidozën

**E84.0 Fibroza cistike me manifestime pulmonare**

**E84.1 Fibroza cistike me manifestime intestinale**

Sindroma e bllokimit distal të zorrëve

Ileus nga mekoniumi në fibrozën cistike † (P75*)

***Përjashton:*** ileusin nga mekoniumi në rastet kur është e ditur që fibroza cistike nuk është prezente (P76.0)

**E84.8 Fibroza cistike me manifestime të tjera**

**E84.9 Fibrozë cistike e paspecifikuar**

## E85 Amiloidoza

***Përjashton:*** sëmundjen e Alzheimer (G30.-)

**E85.0 Amiloidoza familiare hereditare jo-neuropatike**

Ethet mesdhetare familjare

Nefropatia amiloide e trashëguar

**E85.1 Amiloidoza familiare hereditare neuropatike**

Polineuropatia amiloide (portugeze)

**E85.2 Amiloidoza familiare hereditare, e paspecifikuar**

**E85.3 Amiloidoza sistemike sekondare**

Amiloidoza nga hemodializa

**E85.4 Amiloidoza e kufizuar në një organ**

Amiloidoza e kufizuar

**E85.8 Amiloidozë tjetër**

**E85.9 Amiloidozë e paspecifikuar**

## E86 Zvogëlim i volumit

***Përfshin:*** dehidratimin
uljen e volumit të plazmës ose lëngut jashtë-qelizor
hipovoleminë

***Përjashton:*** dehidtratimin e të porsalindurit (P74.1)
shokun hipovolemik:
- NOS (R57.1)
- post-operator (T81.1)
- traumatik (T79.4)

## E87 Çrregullime të tjera të metabolizmit të lëngjeve, elektroliteve dhe ekuilibrit acido-bazik

**E87.0 Hiperosmolaritet dhe hipernatremi**

Tepricë e natriumit [Na]

Mbingarkesë e natriumit [Na]

**E87.1 Hipo-osmolaritet dhe hiponatremi**

Mungesë e natriumit [Na]

***Përjashton:*** sindromën e prodhimit të papërshtatshëm të hormonit antidiuretik (E22.2)

**E87.2 Acidoza**

Acidoza:
- NOS
- laktike
- metabolike
- respiratore

***Përjashton:*** acidozën diabetike (E10-E14 me karakter të katërt të përbashkët .1)

**E87.3 Alkaloza**

Alkaloza
- NOS
- metabolike
- respiratore

**E87.4 Çrregullim i përzier i ekuilibrit acido-bazik**

**E87.5 Hiperkalemi**

Tepricë e Kaliumit [K]

Mbingarkesë e Kaliumit [K]

**E87.6 Hipokalemi**

Mungesë e Kaliumit [K]

**E87.7 Mbingarkesë me lëngje**

***Përjashton:*** edemën (R60.-)

**E87.8 Çrregullime të tjera të metabolizmit të lëngjeve dhe të elektroliteve, të paklasifikuara diku tjetër**

Disbalanca elektrolitike NOS

Hiperkloremia

Hipokloremia

## E88 Çrregullime të tjera metabolike

Përdorni kodet shtesë të shkaqeve të jashtme (Kapitulli XX), nëse doni të identifikoni barnat.

***Përjashton:*** histiocitozën X (kronike) (C96.6)

**E88.0 Çrregullime të metabolizmit të proteinave plazmatike, të paklasifikuara diku tjetër**

Mungesa e alfa-1-antitripsinës

Bisalbulinemia

***Përjashton:*** çrregullimin e metabolizmit të lipoproteinave

gamapatinë monoklonale me sinjifikancë të papërcaktuar (D47.2)

hipergamaglobulineminë poliklonale (D89.0)

makroglobullineminë Waldenström (C88.0)

**E88.1 Lipodistrofi, e paklasifikuar diku tjetër**

Lipodistrofia NOS

***Përjashton:*** sëmundjen e Whipple (K90.8)

**E88.2 Lipomatoza, e paklasifikuar diku tjetër**

Lipomatoza:

- NOS
- dolorosa [Dercum]

**E88.3 Sindroma e shkrirjes së tumorit**

Shkrirja e tumorit (pas marrjes së barnave antineoplastike)(spontane)

**E88.8** **Çrregullime të tjera metabolike, të specifikuara**

Adenolipomatoza Launois-Bensaude

Trimetilaminuria

**E88.9** **Çrregullim metabolik i paspecifikuar**

## E89 Çrregullime endokrine dhe metabolike postprocedurale, të paklasifikuara diku tjetër

**E89.0** **Hipotiroidizëm postprocedural**

Hipotiroidizëm pas rrezatimit

Hipotiroidizëm pas kirurgjisë

**E89.1** **Hipoinsulinemi postprocedurale**

Hiperglicemia pas pankrektomisë

Hipoinsulinemia pas kirurgjisë

**E89.2** **Hipoparatiroidizëm postprocedural**

Tetania paratiroprive

**E89.3** **Hipopituitarizëm postprocedural**

Hipopituitarizëm pas rrezatimit

**E89.4** **Hipofunksion ovarial postprocedural**

**E89.5** **Hipofunksion testikular postprocedural**

**E89.6** **Hipofunksion adrenokortikal (medular) postprocedural**

**E89.8** **Çrregullime të tjera endokrine dhe metabolike postprocedurale**

**E89.9** **Çrregullim endokrin dhe metabolik postprocedural, i paspecifikuar**

## E90* Çrregullime metabolike dhe nutricionale në sëmundje të klasifikuara diku tjetër

# KAPITULLI V

# Çrregullimet mendore dhe ato të sjelljes (F00–F99)

***Përfshin:*** çrregullimet e zhvillimit psikologik

***Përjashton:*** simptomat, shenjat dhe gjetjet anormale klinike dhe laboratorike, të paklasifikuara tjetërkund

**Ky kapitull përmban blloqet si vijon:**

| | |
|---|---|
| F00–F09 | Çrregullimet mendore organike, përfshirë ato simptomatike |
| F10–F19 | Çrregullimet mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i substancave psikoaktive |
| F20–F29 | Skizofrenia, çrregullimet skizoide (=skizotipale) dhe çrregullimet deluzive |
| F30–F39 | Çrregullime të humorit (=Çrregullime afektive) |
| F40–F48 | Çrregullimet neurotike, ato të lidhura me stresin dhe ato somatoforme |
| F50–F59 | Sindroma të sjelljes të lidhura me turbullime fiziologjike dhe me faktorë fizike |
| F60–F69 | Çrregullime të personalitetit dhe të sjelljes së të rriturve |
| F70–F79 | Prapambetje e zhvillimit mendor |
| F80–F89 | Çrregullime të zhvillimit psikologjik |
| F90–F98 | Çrregullime të sjelljes dhe emocionale që shfaqen zakonisht në fëmijëri dhe në adoleshencë |
| F99 | Çrregullim mendor i paspecifikuar |

**Kategoritë me yll për këtë kapitull janë:**

| | |
|---|---|
| F00* | Demencia në sëmundjen e Alzheimer |
| F02* | Demencia në sëmundje të tjera të klasifikuara diku tjetër |

# Çrregullimet mendore organike, përfshirë ato simptomatike (F00–F09)

Ky bllok përmbledh një diapazon çrregullimesh mendore të grupuara së bashku në bazë të demonstrimit të etiologisë së sëmundjes cerebrale, dëmtimit të trurit, ose të insultit që rezulton në disfunksion të trurit. Ky disfunksion mund të jetë primar, si në sëmundje, dëmtime, dhe insulte që e prekin trurin në mënyre direkte dhe selektive; ose sekondar, si në rastin e sëmundjeve sistemike që sulmojnë trurin vetëm si një nga shumë organet e tjera që preken.

Demencia (F00-F03) është nje sindromë e sëmundjes së trurit, zakonisht me progres kronik, e cila ka çrregullime të funksioneve të larta kortikale të shumëfishta, që përfshijnë memorien, të menduarit, orientimin, të kuptuarit, përllogaritjet, aftësinë për të mësuar, gjuhën dhe gjykimin. Ndërgjegja nuk është e prekur. Prekja e funksioneve konjitive shoqërohet shpesh, dhe zakonisht paraprihet, nga përkeqësimi i kontrollit emocional, sjelljes shoqërore dhe motivimit. Kjo sindromë ndodh në sëmundjen e Alzheimer, në sëmundjen cerebrovaskulare, dhe në gjendje të tjera primare ose sekondare që prekin trurin.

Perdorni kodet shtesë, nëse dëshirohet, për të identifikkuar sëmundjet bazë.

## F00* Demencia në sëmundjen e Alzheimer (G30.- †)

Alzheimer është një sëmundje primare degjenerative e trurit me etiologji të panjohur me karakteristika neuropatologjike dhe neurokimike. Çrregullimi është zakonisht i fshehtë në fillim dhe zhvillohet gradualisht përgjate një periudhe disa vjeçare.

### F00.0* Demencia e sëmundjes së Alzheimer, me shfaqje të herëshme (G30.0†)

Demencia në sëmundjen e Alzheimer me fillim para moshës 65 vjeç, me dekurs përkeqësimi relativisht të shpejtë dhe me çrregullime të shumta në funksionet më të larta kortikale.

Sëmundja e Alzheimer, lloji 2

Demencia presenile, e llojit Alzheimer

Demencia degjenerative primare e llojit Azheimer, me fillim presenil

### F00.1* Demencia e sëmundjes së Alzheimer, me shfaqje të vonëshme (G30.1†)

Demencia në sëmundjen e Alzheimer me fillim pas moshës 65 vjeç, zakonisht në fund të të 70-tave, me progres të ngadaltë, dhe me prekje të memories si shenjë kryesore.

Sëmundja e Alzheimer, lloji 1

Demencia degjenerative primare e llojit Azheimer, me fillim senil

Demencia senile, lloji Alzheimer

**F00.2*** **Demencia e sëmundjes së Alzheimer, e formës atipike ose të përzier (G30.8†)**

Demencia atipike, lloji Alzheimer

**F00.9*** **Demencia e sëmundjes së Alzheimer, e paspecifikuar (G30.9†)**

## F01 Demencia vaskulare

Demencia vaskulare është rezultat i infarktit të trurit për shkak të sëmundjes vaskulare, përfshirë sëmundjen e hipertensionit cerebrovaskular. Infarktet janë zakonisht të vegjël por kumulativë në efektin e tyre. Zakonisht fillojnë vonë në jetë.

***Përfshin:*** demencian arteriosklerotike

**F01.0** **Demencia vaskulare me shfaqje akute**

Zakonisht zhvillohet pas një serie goditjesh cerebrale nga tromboza, embolizmi apo hemorragjia. Në raste të veçanta, një infarkt i vetëm i madh mund të jetë shkaktari.

**F01.1** **Demencia nga multi infarktet**

Zakonisht graduale në fillm, pason në numër episodesh ishemike tranziente që prodhojnë akumulimin e infarkteve në parenkimën cerebrale.

Predominante në zonën kortikale.

**F01.2** **Demencia vaskulare subkortikale**

Përfshin rastet me histori hipertensioni dhe vatra shkatërrimesh ishemike në brendësi të pjesës së bardhë të hemisferave të trurit. Korteksi cerebral zakonisht ruhet i paprekur dhe kjo është në kontrast me pamjen klinike, e cila i ngjan shumë asaj të sëmundjes së Alzheimer.

**F01.3** **Demencia vaskulare e përzier kortikale dhe subkortikale**

**F01.8** **Demencia të tjera vaskulare**

**F01.9** **Demencia vaskulare, e paspecifikuar**

## F02* Demencia në sëmundje të tjera të klasifikuara diku tjetër

Rastet e demencias të shkaktuara, ose të menduara që shkaktohen nga shkaqe të tjera nga sëmundja e Alzheimer ose sëmundjet cerebrovaskulare. Mund të fillojë në çdo kohë, megjithëse rrallë në pleqëri.

**F02.0*** **Demencia në sëmundjen e Pick (G31.0†)**

Një demencie progresive, që fillon në mes të jetës, karakterizohet nga një fillim i hershëm me progres të ngadaltë ndryshimesh të karakterit, përkeqësimit shoqëror, të pasuar nga prekje e intelektit, kujtesës dhe funksioneve të gjuhës, me apati, eufori dhe zakonisht me fenomene ekstrapiramidale.

**F02.1*** **Demencia në sëmundjen Creutzfeld-Jakob (A81.0†)**

Një demencie progresive me shenja të shumta neurologjike, nga ndryshimet neuropatologjike specifike që mendohet të jenë si pasojë e agjentit të transmetueshëm.

Fillimi është zakonisht në mes ose në fund të jetës, por mund të ndodhë në çdo kohë gjatë jetës së adultit. Ecuria është subakute, çon në vdekje brenda një ose dy vjetësh.

### F02.2* Demencia në sëmundjen e Huntingtonit (G10†)

Një demencie që ndodh si pjesë e një degjenerimi masiv të trurit. Çrregullimi transmetohet nga një gjen i vetëm dominant autosomal. Simptomat dalin tipikisht në dekadën e tretë ose të katërt. Progresi është i ngadaltë, që çon në vdekje, zakonisht brenda 10-15 vitesh.

Demencia në korean (=chorea) e Huntington.

### F02.3* Demencia në sëmundjen e Parkinsonit (G20†)

Një demencie që zhvillohet në praninë e sëmundjes së Parkinsonit. Nuk ka asnjë veçori dalluese klinike.

Demencia në:

- Paralizën agitans
- Parkinsonizëm

### F02.4* Demencia në sëmundjen HIV (B22.0†)

Demencia zhvillohet përgjatë sëmundjes HIV, në mungesë të një sëmundje tjetër konkuruese (përveç HIV) që të shpjegojë shenjat klinike.

### F02.8* Demencia në sëmundje të tjera të specifikuara, të klasifikuara diku tjetër

Demencia në:

- lipoidozën cerebrale (E75.-†)
- epilepsi (G40.-†)
- degjenerimin hepatolentikular (E83.0†)
- hiperkalcemia (E83.5†)
- hipotiroidizmin, e fituar (E01.- †, E03.-†)
- intoksikimet (T36-T65†)
- trupat e Lewis (sëmundja) (G31.8†)
- sklerozën multiple (G35†)
- neurosifilis (A52.1†)
- mungesën e niacinës (pelagra) (A52†)
- poliarteritin nodoz (M30.0†)
- lupusin sistemik eritematoz (M32.-†)
- tripanosomiazë (B56.- †, B57.-†)
- uremi (N18.5-†)
- mungesën e vitaminës B12 (E53.8†)

## F03 Demencie e paspecifikuar

***Përfshin:*** presenile:

- demencia NOS

- psikoza NOS

demencien degjenerative primare NOS

senile:

- demencia:
  - NOS
  - deprese ose paranoide
- psikoza NOS

***Përjashton:*** demencien senile me delirium ose gjendje konfuzimi akut (F05.1)

senilitetin NOS (R54)

## F04 Sindromi amnezik organik, jo i shkaktuar nga alkooli dhe lëndë të tjera psikoaktive

Një sindromë me prekje të dukshme të memories së hershme dhe të vonshme, me ruajtje të memories së tanishme, me aftësi të reduktuara të të mësuarit e materialeve të reja dhe disorientim në kohë. Konfabulimi mund të jetë një veçori e dukshme, por perceptimi dhe funksionet e tjera konjitive, përfshirë dhe intelektin, janë zakonisht të paprekura. Prognoza varet nga ecuria e lezionit kryesor.

***Përfshin:*** sindromën ose psikozën Korsakov, jo-alkoolike

***Përjashton:*** amnezinë:

- NOS
- anterograde
- disociative
- retrograde

sindromën Korsakov:

- e shkaktuar nga alkooli ose e papërcaktuar.
- e shkaktuar nga substanca psikoaktive (F11-F19 me karakter të katërt të përbashkët .6)

## F05 Delir, jo i shkaktuar nga alkooli dhe lëndë të tjera psikoaktive

Një sindromë organike cerebrale jospecifike me origjinë të panjohur, që karakterizohet nga çrregullime të ndërgjegjes dhe të vëmendjes, perceptimit, të të menduarit, memorjes, sjelljes psikomotore, emocioneve dhe orarit të gjumit-zgjimit. Kohëzgjatja është e ndryshueshme dhe shkalla e dëmtimit varion nga mesatare në shumë të rëndë.

***Përfshin.***: akut/e ose subakut/e:

- sindromën e trurit
- gjendjen të konfuzuara (jo-alkoolike)
- psikozën infektive

- reaksionin organik
- sindromën psiko-organike

***Përjashton:*** deliriumin tremens, të shkaktuar nga alkooli ose të paspecifikuar (F10.4).

### F05.0 Delir jo i mbivendosur mbi demencien, i përshkruar si i tillë

### F05.1 Delir i mbivendosur mbi demencien

Kushtet që plotesojnë kriteret e mësipërme mund të zhvillohen përgjatë ecurisë së demencies (F00-F03).

### F05.8 Delir tjetër

Delirium i përzier

Delirium post-operativ

### F05.9 Delir i paspecifikuar

## F06 Çrregullime të tjera mendore nga dëmtimi i trurit dhe disfunksion nga sëmundjet fizike

Përfshijnë gjendje të ndryshme zakonisht të shkaktuara dhe të lidhura me sëmundje parësore të trurit, nga sëmundje sistemike që prekin më pas trurin, substanca të jashtme, toksina ose hormone, çrregullime endokrine ose sëmundje të tjera.

***Përjashton:*** të lidhura me:

- deliriumin
- demencian e klasifikuar në F00-F03
- nga alkooli ose substanca të tjera psikoaktive (F10-F19)

### F06.0 Haluçinacione organike

Një çrregullim i halucinacioneve të vazhdueshme, zakonisht vizuale ose auditive, që ndodhin me ndërgjegje të qartë dhe që mund ose jo të kuptohen nga subjekti si të tilla. Mund të pasojnë elaborime deluzionale, por ato nuk janë dominante të situatës; aftësia për të kuptuar mund të jetë e ruajtur.

Gjendje halucinante organike (jo-alkoolike)

***Përjashton:*** halucinacionet alkoolike (F10.5)

skizofreninë (F20.-)

### F06.1 Çrregullim katatonik organik

Një çrregullim me aktivitet psikomotor të ulur (stupor) ose të rritur (eksitim) të shoqëruar me simptoma katatonike. Të dy ekstremet e çrregullimeve psikomotorre mund të alternohen.

***Përjashton:*** skizofreninë katatonike (F20.2)

stuporin:

- NOS (R40.1)

- disociativ (F44.2)

### F06.2 Çrregullim organik deluzional (skizoid)

Një çrregullim ku deluzionet persistojnë tablonë klinike. Deluzionet mund të shoqërohen nga haluçinacionet. Disa veçori sugjerojnë skizofreni, si haluçinacionet bizare ose çrregullimet e mendimit, kur janë prezent.

Gjendjet organike paranoide dhe paranoido-halucinante.

Psikoza si në skizofreni, e epilepsisë.

***Përjashton:*** çrregullimet:

- psikotike akute dhe tranziente (F23.-)
- deluzionet persistente (F22.-)
- skizofreninë (F20.-) e shkaktuar nga barnat psikotike (F11-F19 me karakterin e katërt të përbashkët .5)

### F06.3 Çrregullime organike të gjendjes shpirtërore (afektive)

Çrregullime që karakterizohen nga një ndryshim i humorit ose ndjenjës, shoqëruar zakonisht me ndryshime të përgjithshme të aktivitetit, depresive, hypomaniakale, manik ose bipolar (shih F30-F38), por që vijnë si pasojë e një çrregullimi organik.

***Përjashton:*** çrregullimet e humorit, jo-organike ose të paspecifikuara (F30-F39)

### F06.4 Çrregullim anksioz organik

Një çrregullim që karakterizohet nga shenjat e ankthit të gjeneralizuar (F41.1), ose panikut (F41.0) ose një kombinim i të dyjave, por që ka në bazë një çrregullim organik.

***Përjashton:*** çrregullimet e ankthit, jo-organike ose të paspecifikuara (F41.-)

### F06.5 Çrregullim disociativ organik

Një çrregullim që karakterizohet nga humbja e plotë ose e pjesshme e integritetit të kujtesës së hershme, identitetit dhe ndjesive të momentit, dhe kontrollit të lëvizjeve të trupit (shih F44.-), por që janë si pasojë e një çrregullimi organik.

***Përjashton:*** çrregullime disociative, jo-organike dhe të paspecifikuara (F44.-)

### F06.6 Çrregullim emocional labil organik (astenik)

Një çrregullim që karakterizohet nga paqëndrueshmëri emocionale, lodhje dhe ndjesi fizike të pakëndshme, dhimbje, por që kane bazë një çrregullim organik.

***Përjashton:*** çrregullimet somatoforme, jo-organike të paspecifikuara (F45.-)

### F06.7 Çrregullim i lehtë konjitiv

Një çrregullim me humbje të memories, ulje të aftësisë për të mësuar dhe për t'u përqendruar në një detyrë në një kohë të caktuar. Ka ndjesinë e lodhjes mendore, kur synohen të kryhen detyra mendore; veçanërisht ka vështirësi në mësimin e gjërave të reja, edhe kur kjo arrihet me sukses. Asnjë nga keto simptoma nuk është aq i rëndë sa të vihet diagnoza e demencias (F00-F03) ose e deliriumit (F05.-). Kjo diagnozë duhet të vihet vetëm në lidhje me një çrregullim fizik të caktuar dhe jo në praninë e

çrregullimeve mendore ose të sjelljes së përshkruar në F10-F99. Çrregullimi mund të paraprijë, shoqërojë ose pasojë një seri infeksionesh ose crregullimesh fizike, cerebrale ose sistemike, por faktet që tregojnë prekjen e trurit nuk janë gjithnjë të pranishme. Duhet të diferencohet nga sindroma postencefalike (F07.1) dhe sindroma postkontuzionale (F07.2) nga etiologjia e ndryshme, dhe spektri më i ngushtë i simptomave të moderuara dhe në kohë më të shkurtër.

### F06.8 Çrregullime të tjera mendore të specifikuara nga dëmtimi i trurit dhe nga sëmundjet fizike

Psikoza epileptike NOS

### F06.9 Çrregullim i paspecifikuar mendor nga dëmtimi i trurit dhe nga sëmundjet fizike

Organik/e:

- sindroma e trurit NOS
- çrregullimi mendor NOS

## F07 Çrregullime të personalitetit dhe të sjelljes nga sëmundjet e trurit, nga dëmtimet dhe nga disfunksioni

Alterimi i personalitetit dhe sjelljes mund të jetë si pasojë e një sëmundje, dëmtimi ose disfunksioni të trurit.

### F07.0 Çrregullim organik i personalitetit

Një çrregullim me ndryshim të madh të zakoneve të sjelljes, që shfaqen nga subjekti para sëmundjes, që prek shprehjen e emocioneve, nevojave dhe impulseve. Prekja e funksioneve konjitive dhe të mendimit ose ndryshimit të seksualitetit janë gjithashtu pjesë e tablosë klinike.

Organik:

- personalitet pseudopsikopatik
- personalitet pseudoretard

sindroma:

- e lobit frontal
- e personalitetit limbik të epilepsisë
- e lobotomisë
- epostleukotomisë

***Përjashton:*** ndryshime të qendrueshme të personalitetit mbas:

- eksperiencave katastrofike (F62.0)
- sëmundjeve psikiatrike (F62.1)

sindromën postkontuzionale (F07.2)

sindromën postencefalit (F07.1)

çrregullimin e personalitetit (F60.-)

### F07.1 Sindrom postencefalitik

Ndryshim rezidual jospecifik i sjelljes pas një encefaliti viral ose bakterial. Dallimi kryesor me çrregullimet organike të personalitetit është së ky është i rikthyeshem.

***Përjashton:*** çrregullimet organike të personalitetit (F07.0)

**F07.2 Sindrom postkontuzional**

Sindromë që ndodh pas traumave të kokës (që mund të lënë me humbje të ndërgjegjes) dhe që ka një numër simptomash si dhimbje koke, marrje mendsh, lodhje, irritueshmëri, vështirësi në përqendrim dhe kryerjen e detyrave mendore, prekje të memories, pagjumësi dhe tolerancë të ulët ndaj stresit, eksitimit emocional dhe alkoolit.

Sindroma postkontuzionale (encefalopati)

Sindroma post-traumatike, jo-psikotike

***Përjashton:*** kontuzionin aktual, trurin (S06.0)

**F07.8 Çrregullime të tjera organike të personalitetit dhe të sjelljes nga sëmundje të trurit, nga dëmtimi dhe nga disfunksioni**

Çrregullim organik afektiv i hemisferës së djathtë.

**F07.9 Çrregullim i paspecifikuar organik i personalitetit dhe i sjelljes nga sëmundje e trurit, nga dëmtimi dhe nga disfunksioni**

Psikosindroma organike

**F09 Çrregullim mendor i paspecifikuar, organik ose simptomatik**

***Përfshin:*** psikozën:

- organike NOS
- simptomatike NOS

***Përjashton:*** psikozën NOS (F29)

# Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i substancave psikoaktive (F10–F19)

Ky bllok përmban shumë çrregullime, që ndryshojne në rëndësi dhe formë klinike, por që shkaktohen nga përdorimi i substancave psikoaktive, të lëshuara me recetë ose jo. Karakteri i tretë i kodit përcakton substancën në fjalë, ndersa kodi i katërt percakton gjendjen klinike. Kodet duhen përdorur siç kërkohet për çdo substance të përdorur, por duhet pasur parasysh se jo të gjitha kodet 4-shifrore janë të përdorshme për të gjitha substancat.

Identifikimi i substancave psikoaktive duhet bazuar në një numër sa më të madh që të jetë e mundur të burimeve të informacionit. Këtu përfshihen të dhënat e vetëraportuara, analizat e

gjakut dhe lëngjeve trupore, karakteristikat fizike dhe simptomat psikologjike, shenjat klinike dhe të sjelljes, si dhe të dhena lidhur me drogat që mund të merren nga palë të treta. Shumë përdorues drogash përdorin më shumë së një lloj droge. Diagnoza kryesore duhet, sa herë të jetë e mundur, të klasifikohet sipas substancës ose llojit të substancës që ka shkaktuar sindromën klinike. Diagnoza të tjera duhen koduar, kur substanca të tjera janë marrë në doza intoksikimi (me karakter të përbashkët të katërt .0), ose që mund të shkaktojnë dëmtim (karakteri i katërt .1), varësi (karakteri i katërt .2) ose çrregullime të tjera (karakteri i katërt .3-.9).

Vetëm në rastet kur zakonet e marrjes së substancave janë kaotike dhe jo të rregullta, ose kur ka fakte që efektet e substancave të ndryshme janë përzier, atëhere mund të përdoren diagnozat për gjendjet që vijnë nga përdorimi i shumë substancave njëkohësisht (F19.-)

***Përjashton:*** abuzimin e substancave që nuk shkaktojnë varësi (F55).

Në vijim janë nën-ndarjet e katër karaktereve të përdorur në kategoritë F10-F19.

**.0 Intoksikacion akut**

Një gjendje që pason administrimin e një substance psikoaktive, që çon në çrregullime të ndërgjegjes, njohjes, perceptimit, ndjesisë ose sjelljes, ose përgjigjeve apo funksioneve psiko-psikologjike. Çrregullimet janë direkt të lidhura me efektet farmakologjike akute të substancës dhe përmirësohen me kalimin e kohës, me shërim të plotë, përveç rasteve kur ka dëmtim të indeve ose komplikacione të tjera. Komplikacionet përfshijnë trauma, inhalim të të vjellave, delirium, koma, konvulsione, dhe komplikacione të tjera. Natyra e këtyre komplikacioneve varet nga klasa farmakologjike e substancës dhe mënyrës së administrimit.

Dehja akute (alkoolike)

'udhëtime të këqija' (drogat)

Dehja NOS

Intoksikacioni patologjik

Gjendje transi dhe posedimi nga intoksikimi i substancave psikoaktive (T36-T50)

***Përjashton:*** intoksikimet që synojne helmimin (T36-T50)

**.1 Përdorimi i dëmshëm**

Një seri substancash psikoaktive që mund të dëmtojnë shëndetin. Dëmtimi mund të jetë fizik (si në rastin e hepatitit nga injektimi i substancave psikoaktive), ose mendor (episodet depresive nga konsumimi i tepërt i alkolit).

Abuzim me substancat psikoaktive

**.2 Sindroma e vartësisë**

Një grup fenomenesh të sjelljes, njohjes dhe fiziologjisë që zhvillohet pas marrjes së përsëritur të substancave dhe që në mënyrë tipike përfshin dëshirën për të marrë drogën, vështirësi në kontrollin e përdorimit të saj, përdorim të vazhduar pavarësisht pasojave negative, dhënia prioritet marrjes së përsëritur të drogës sesa veprimeve dhe detyrimeve të tjera, tolerancë e rritur, si dhe ndonjëherë gjendje abstinence.

Sindroma e varësisë mund të jetë prezent për një sërë substanash të caktuara (duhani, alkooli, diazepami), ose për klasa substancash (psh drogat opioide), ose për një sërë substancash psikoaktive farmakologjike.

Alkoolizmi kronik

Dipsomania

Varësia nga drogat

### .3 Gjendja e abstinencës

Një grup simptomash që ndryshojnë grupim dhe rëndësi, që ndodhin në një abstinencë absolute ose relative ndaj një substance psikoaktive dhe që persistojnë pas saj. Fillimi i abstinencës ndryshon dhe zgjat në varësi të llojit të substancës dhe dozës së saj. Është një gjendje që mund të komplikohet me konvulsione.

### .4 Gjendja e abstinencës me delirium

Një gjendje, ku abstinenca përcaktohet me karakterin e katërt .3, komplikuar me delirium siç përcaktohet në F05.-. Mund të ndodhin gjithashtu konvulsione. Kur mendohet që faktorë organikë luajnë një rol në etiologji, gjendja duhet të klasifikohet si F05.8.

Delirium tremens (për shkak të alkoolit)

### .5 Çrregullimet psikotike

Një grup fenomenesh psikotike që ndodh gjatë ose pas përdorimit të substancave psikoaktive, por që nuk shpjegohet në bazë të intoksikimit akut dhe nuk është pjesë e gjendjes së abstinencës. Çrregullimi karakterizohet nga halucinacione (tipike auditive, por shpesh dhe me më shumë së një sens i përfshirë), shtrembërime të perceptimit, deluzione (shpesh të natyrës persekutive ose paranoike), çrregullime psikomotore (eksitim ose stupor) dhe një ndjenjë anormale, që varion nga frikë intensive deri në ekstazë. Sensoriumi është deri diku i qartë, por mund të jenë prezent disa shkallë të turbullimit të ndërgjegjes, veçse jo konfuzion i rëndë,.

Alkooli:

- halucinacione
- xhelozi
- paranojë
- psikozë NOS

***Përjashton:*** çrregullimet psikotike me fillim të vonë, të shkaktuara nga alkooli ose substancat psikoaktive (F10-19 me karakterin e katërt .7)

### .6 Sindroma amnezike

Një sindromë e shoqëruar me keqësim të dukshëm kronik të memories së hershme dhe të vonë. Kujtesa e momentit është shpesh e ruajtur dhe memoria e vonët preket më shumë së ajo e hershme. Çrregullimet e orientimit në kohë dhe të sekuences së ngjarjeve janë të dukshme, ashtu si dhe vështirësia për të mësuar materiale të reja. Konfabulimi është i dukshëm, por jo gjithnjë prezent. Funksionet e tjera konjitive janë të ruajtura relativisht mirë dhe defektet amnezike janë në shpërpjestim me çrregullimet e tjera.

Çrregullimi amnezik, nga akooli ose drogat

Sindroma ose psikoza e Korsakov, nga alkooli ose substanca psikoaktive

Përdorni kodet shtesë (E53.8†), nëse dëshironi, kur shoqërohet me sindromën ose sëmundjen Korsakov.

***Përjashton:*** sindromën ose psikozën Korsakov jo-alkoolike (F04)

**.7 Çrregullimi psikotik i vonshëm dhe rezidual**

Një çrregullim, në të cilin alkooli ose substancat psikoaktive ndryshojnë njohjen, ndjenjën, personalitetin, ose sjelljen, përtej një periudhe kohe, kur mendohet që do zgjaste efekti i alkoolit ose substancës. Fillimi i çrregullimit është i lidhur me momentin e fillimit të substancës psikoaktive. Rastet kur fillimi i çrregullimit është më vonë së fillimi i substancës duhen koduar këtu vetëm kur ka fakte të forta që ja atribuojnë çrregullimin substancës psikoaktive. Kujtimet mund të dallohen nga gjendja psikotike pjesërisht nga natyra e tyre episodike, me kohëzgjatje të shkurtër dhe nga mbivendosja e tyre me eksperienca të mëparshme me alkoolin dhe substancat psikoaktive.

Demencia e alkolit NOS

Sindroma e trurit alkoolik kronik

Demencia dhe forma me të buta të prekjes së funksioneve konjitive

Kujtime

Çrregullim psikotik me fillim të vonët nga substancat psikoaktive

Çrregullim i perceptimit post-haluçinogjenik

Rezidual:

- çrregullim afektiv
- çrregullim i personalitetit dhe sjelljes

***Përjashton:*** të shkaktuara nga alkooli ose substancat psikoaktive:

- sindroma Korsakov (F10-F19 me shifër të katërt .6)
- gjendje psikotike (F10-F19 me shifër të katërt .5)

**.8 Çrregullime të tjera mendore dhe të sjelljes**

**.9 Çrregullime mendore dhe të sjelljes, të paspecifikuara**

## F10 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i alkoolit

[shih para F10 për nën-ndarjet]

## F11 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i opiateve

[shih para F10 për nën-ndarjet]

## F12 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i preparateve të kanabis

[shih para F10 për nën-ndarjet]

## F13 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i sedativëve ose i hipnotikëve

[shih para F10 për nën-ndarjet]

## F14 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i kokainës

[shih para F10 për nën-ndarjet]

## F15 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga perdorimi i stimulantëve, përfshi kafeinën

[shih para F10 për nën-ndarjet]

## F16 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i haluçinogjenëve

[shih para F10 për nën-ndarjet]

## F17 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i duhanit

[shih para F10 për nën-ndarjet]

## F18 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i solventëve volatilë

[shih para F10 për nën-ndarjet]

## F19 Çrregullime mendore dhe të sjelljes nga përdorimi i medikamenteve të shumëllojshme dhe i lëndëve të tjera psikoaktive

[shih para F10 për nën-ndarjet]

Kjo kategori duhet përdorur kur dy ose më shumë substanca psikoaktive janë të të përfshira, por kur nuk dihet cila nga substancat kontribuon më shumë në çrregullim. Duhet përdorur gjithashtu edhe kur nuk dihet me saktësi identiteti i substancave të përdorura, pasi edhe vetë përdoruesit e drogave nuk i dijnë detajet e të gjithë drogave që përdorin.

***Përfshin:*** keqpërdorimin e drogave NOS

# Skizofrenia, çrregullimet skizotipike dhe çrregullimet deluzive (F20–F29)

Ky bllok bën bashkë skizofreninë, si anëtari me i rëndësishëm i grupit, crregullimin skizotipik, çrregullimet deluzionale persistente, dhe një grup më të madh të çrregullimeve psikotike tranziente. Çrregullimet skizoafektive janë mbajtur këtu pavarësisht natyrës së tyre kontroversiale.

## F20 Skizofreni

Çrregullimet skizofrenike karakterizohen në përgjithësi nga shtrembërime karakteristike themelore të të menduarit dhe të percepsionit, me ndjenja që janë të papërshtatshme ose të mpira. Kapaciteti intelektual dhe ndërgjegja ruhen zakonisht të qartë, megjithëse disa aspekte konjitive mund të preken me kalimin e kohës. Fenomeni më i rëndësishëm psikopatologjik është eko-ja e mendimit; futja e mendimeve ose tërheqja; transmetimi i mendimeve; perceptimet delusive dhe deluzionet e kontrollit; influencë ose pasivitet; zëra haluçinantë që komentojnë ose diskutojnë jetën e personit në vetë të tretë; çrregullime të mendimit; dhe simptoma negative.

Çrregullimet mund të kenë ecuri të vazhduar, ose episodike, me defiçit progresiv ose stabël, ose mund të ketë disa episode me shërim të plotë ose të pjesshëm. Diagnoza e skizofrenisë nuk duhet vënë në prani të simptomave depresive ose manike të mëdha, perveçse në rastet kur është e qarte së skizofrenia ka qene e pranishme më parë se simptomat në fjalë. Skizofrenia nuk duhet të diagnostikohet as në praninë e sëmundjeve të fshehta të trurit, ose gjatë periudhave të intoksikacionit ose të abstinencës. Çrregullime të ngjashme që ndodhin në prani të epilepsisë ose të sëmundjeve të tjera të trurit duhen klasifikuar në F10-F19 me karakterin e katërt të përbashkët .5.

***Përjashton:*** Skizofreninë:

- akute (të pa diferencuar) (F23.2)
- ciklike (F25.2)

Reaksionin skizofreni (F23.2.)

Çrregullimin skizotipik (F21)

### F20.0 Skizofreni paranoide

Një formë skizofrenie, ku ndryshimet afektive jane të dukshme, deluzionet dhe haluçinacionet janë fragmentare, sjellja është e papërgjegjshme dhe e paparashikueshme, dhe manierizmat janë të pranishme. Humori është i cekët dhe i papërshtatshëm, mendimi është i crregulluar, zakonisht i shoqëruar me haluçinacione auditive dhe çrregullime të perceptimit. Çrregullimet prekin edhe ndjenjën, dëshirën dhe ligjërimin, dhe simptomat katatonike mungojnë ose janë pothuaj të padukshme.

Skizofreni parafrenike

***Përjashton:*** Gjendjen paranoide të pavullnetshme (F22.8)

Paranojën (F22.0)

### F20.1 Skizofreni hebefrenike

Një formë skizofrenie, ku ndryshimet afektive jane të dukshme, deluzionet dhe haluçinacionet janë fragmentare, sjellja është e papërgjegjshme dhe e paparashikueshme, dhe manierizmat janë të pranishme. Ka tendencë për izolim. Prognoza është e keqe për shkak të zhvillimit të menjëhershëm të simptomave negative, veçanërisht sheshimi i ndenjave dhe humbja e dëshirës. Mund të diagnostikohet kryesisht në të rinjtë dhe adoleshentët.

Skizofrenia e çorganizuar

Hebefrenia

## F20.2 Skizofreni katatonike

Skizofrenia katonike dominohet nga çrregullime psikomotore të dukshme, që mund të alternohen midis ekstremeve, si hiperkineza dhe stupor, një bindje automatike dhe negativizëm. Qëndrimet dhe posturat e shtrënguara mund të mbahen për një kohë të gjatë. Episode të eksitimit të dhunshëm mund të jenë veçori e dukshme e çrregullimit. Fenomeni katatonik mund të kombinohet me një gjendje si në ëndërr (oneroid) dhe që shoqërohet me haluçinacione skenike të gjalla.

Stupor katatonik

Skizofrenik/e:

- katalepsinë
- katatoninë
- flexibilitas cerea

## F20.3 Skizofreni e padiferencuar

Është një episod depresiv që i plotëson të gjitha kushtet për diagnozen e skizofrenisë, por jo ato të nën-tipeve të saj (F20.F20.2), ose që ka shumë shfaqje të nën-tipeve të saj, por kur asnjë nga to nuk është dominante.

***Përjashton:*** Çrregullimin psikot akut të ngjashëm me skizofreninë (F23.2)

Skizofreninë kronike të padiferencuar (F20.5)

Depresionin post-skizofrenik (F20.4)

## F20.4 Depresion postskizofrenik

Një episod depresiv, që mund të zgjatet, që del pas një sëmundje skizofrenike. Disa simptoma skizofrenike, 'pozitive' ose 'negative', duhet të jenë prezent, por jo që të dominojnë tablonë klinike. Këto gjendje depresive shoqërohen me rrezik të lartë për vetëvrasje. Nëse pacienti nuk ka më simptoma skizofrenike, atëherë duhet diagnostikuar për episod depresiv (F32.-). Nëse simptomat skizofrenike janë ende floride dhe prominente, dignoza duhet të mbetet ajo e nën-llojit të duhur skizofrenik (F20.0-F20.3).

## F20.5 Skizofreni reziduale

Një fazë kronike e zhvillimit të sëmundjes skizofrenike, në të cilën ka një progres të qartë nga një fazë e hershme në atë të vonshme, shpesh me kohëzgjatje të madhe, por jo domosdoshmërisht të kthyeshme, me simptoma 'negative', p.sh. ngadalësim psikomotorr, ulje të aktivitetit, mpirje të ndjenjave, pasivitet dhe mungesë iniciative, sasi dhe cilësi të ulët të shprehisë, komunikime të varfra verbale dhe me gjeste të fytyrës, kontaktit me sytë, ndryshimeve të zërit dhe qëndrimit, mungesë kujdesi personal dhe sjelljes shoqërore.

Skizofrenia kronike e padiferencuar

Restzustand (skizofrenike)

Gjendje reziduale skizofrenike

### F20.6 Skizofreni e thjeshtë

Një çrregullim, në të cilin ka një progres të fshehtë por të sigurtë të çrregullimeve të sjelljes, paaftesisë për të përmbushur detyrimet shoqërore, dhe përkeqësim të ecurisë në përgjithësi. Veçoritë negative të skizofrenisë reziduale (mpirja e ndjenjave dhe humbja e dëshirës) zhvillohen pa u paraprirë nga simptoma psikotike të dukshme.

### F20.8 Skizofreni tjetër

Skizofrenia cenestopatike

Skizofreniforme:

- çrregullime NOS
- psikozë NOS

***Përjashton:*** çrregullime të shkurtëra skizofreniforme (F23.2)

### F20.9 Skizofreni e paspecifikuar

## F21 Çrregullim skizotipik

Një çrregullim, që karakterizohet nga sjellje ekscentrike dhe anomali të të menduarit dhe ndjenjës që ngjajne me skizofreninë, megjithëse anomali skizofrenike të përcaktuara mund të ndodhin në çdo fazë. Simptomat përfshijnë një ndjenjë të ftohtë ose të papërshtatshme; anhedoni; sjellje ekscentrike dhe të çuditshme, një tendence për tërheqje nga shoqëria, ide të çuditshme ose që nuk arrijnë në deluzione; çrregullime të mendimit dhe shqetësime të përhershme; gjendje tranziente me episode pothuaj-psikotike me iluzione të forta, haluçinacione dhe ide pothuaj si deluzione, që zakonisht ndodhin pa provokim të jashtëm. Nuk ka një fillim të qartë dhe ecuria dhe zhvillimi janë ato të një çrregullimi personaliteti.

***Përfshin:*** reaksionin skizofrenik latent

skizofreninë:

- kufitare
- latente
- prepsikotike
- prodromale
- pseudoneurotike
- pseudopsikopatike

çrregullim persoaliteti skizoid

***Përjashton:*** sindromën Asperger (F84.5)

## F22 Çrregullime deluzive persistente

Përfshin një seri çrregullimesh, që kanë si karakteristikë të vetme deluzionet e qendrueshme, të cilat nuk mund të klasifikohen si organike, skizofrenike ose afektive. Çrregullimet deluzionale, që kanë zgjatur për me pak së disa muaj, duhen klasifikuar, të pakten përkohësisht, tek F23.-.

### F22.0 Çrregullim deluziv

Një çrregullim karakterizohet nga një deluzion i vetëm ose nga një seri deluzionesh që zgjatin tërë jetën. Përmbajtja e tyre është e ndryshueshme. Haluçinacionet e qarta auditive, simptoma skizofrenike si deluzione të kontrollit dhe të mpirjes së ndjenjave, apo tregues të sëmundjes së trurit janë të papërputhshëm me këtë diagnozë. Megjithatë, prania e haluçinacioneve të përkohshme auditive, veçanërisht në pacientë të moshës së thyer, nuk e përjashton këtë diagnozë, me kusht që ato të jenë jo-skizofrenike dhe të mos dominojnë tablonë klinike.

Paranoja

Paranoide:

- psikoza
- gjendja

Parafrenia

Sensitiver beziehungswahn

***Përjashton:*** paranoid/e:

- çrregullimet e personalitetit (F60.0)
- psikozat psikogjenike (F23.3)
- reaksionin (F23.3)
- skizofreninë (F20.0)

### F22.8 Çrregullim tjetër deluziv persistent

Çrregullime, në të cilat deluzionet shoqërohen nga haluçinacione zanore ose simptoma skizofrenie, që nuk justifikojnë diagnozën e skizofrenisë (F20.-).

Dismorfofobia deluzionale

Gjendje paranoide involucionale

Paranoia querulans

### F22.9 Çrregullim deluziv persistent i paspecifikuar

## F23 Çrregullime psikotike akute dhe kalimtare

Një grup heterogjen crregullimesh, që karakterzohen nga shfaqja akute e simptomave skizofrenike si deluzione, haluçinacione dhe çrregullime të perceptimit, dhe nga ndërprerja e funksionimit normal. Fillimi akut përkufizohet si zhvillim në ngjitje e tablosë anormale klinike në dy ose më pak javë. Për këto çrregullime nuk ka fakte të shkaqeve organike. Konfuzioni dhe çudia janë shpesh të pranishëm, por çorientimi në lidhje me kohën, vendin dhe personat nuk është i qendrueshëm dhe i mjaftueshëm për të justifikuar diagnozën e një deliriumi me bazë organike.

### F23.0 Çrregullim psikotik polimorf akut, pa simptoma të skizofrenisë

Një çrregullim akut psikotik, në të cilin haluçinacionet, deluzionet ose çrregullimet e perceptimit janë gjerësisht të ndryshme, që ndryshojnë nga dita në ditë, madje dhe nga ora në orë. Stuhitë emocionale me ndjesi të paqendrueshme lumturie ose ekstaze, ose

ankthi dhe irritimi, janë shpesh të pranishme. Polimorfizmi dhe paqendrueshmeria janë karakteristikë e një tabloje klinike dhe veçoritë psikotike nuk justifikojnë diagnozën e skizofrenisë (F20.-). Këto çrregullime kanë shpesh një fillim të shpejtë, zhvillohen me shpejtësi për disa ditë, dhe kanë një rezolucion të shpejtë dhe nuk përsëriten. Nëse simptomat persistojnë, diagnoza duhet ndryshuar në çrregullim deluzional (F22.-).

Bouffée délirante pa simptoma skizofrenie ose e paspecifikuar

Psikozë cikloide pa simptoma skizofrenie ose e paspecifikuar

### F23.1 Çrregullim psikotik polimorf akut, me simptoma të skizofrenisë

Një çrregullim psikotik akut shumë-formësh dhe me tablo klinike të paqendrueshme, siç është prezantuar në F23.0; megjithatë, pavarësisht kësaj paqendrueshmërie, disa simptoma tipike të skizofrenisë janë prezente gjatë shumicës së kohës. Nëse simptomat e skizofrenisë persistojnë, diagnoza duhet ndryshuar në skizofreni (F20.-).

Bouffée délirante me simptoma skizofrenie

Psikozë cikloide me simptoma skizofrenie

### F23.2 Çrregullim psikotik skizoid akut

Çrregullim psikotik akut, ku simptomat psikotike janë relativisht më të qendrueshme dhe justifikojnë diagnozën e skizofrenisë, por që kanë zgjatur me pak së një muaj; veçoritë polimorfike të paqendrueshme, siç paraqitet në F23.0, mungojnë. Nëse simptomat skizofrenike persistojnë, diagnoza mund të ndryshohet në skizofreni (F20.-).

Skizofreni akute (e padiferencuar)

I/E shkurtër dhe skizofreniform/e:

- çrregullim
- psikozë

Oneirofreni

Reaksion skizofrenik

***Përjashton:*** çrregullimet deluzionale organike [si skizofrenike] (F06.2)
çrregullimet skizofreniforme NOS (F20.8)

### F23.3 Çrregullime të tjera psikotike, kryesisht iluzive

Çrregullime psikotike akute, në të cilat deluzionet dhe halucinacionet e qendrueshme janë veçoria kryesore, por që nuk justifikojnë diagnozën e skizofrenisë (F20.-). Nëse deluzioni persiston, diagnoza duhet ndryshuar në çrregullim deluzional (F22.-).

Reaksion paranoid

Psikozë psikogjenike paranoide

### F23.8 Çrregullim tjetër psikotik akut e kalimtar

Çdo çrregullim tjetër akut psikotik, për të cilin nuk ka fakte të shkakësisë organike dhe që nuk justifikon klasifikimin në F23.0-F23.3.

### F23.9 Çrregullim tjetër psikotik akut e kalimtar, i paspecifikuar

Psikoza reaktive e shkurtër NOS

Psikoza reaktive

## F24 Çrregullim deluziv i induktuar

Një çrregullim deluzional, që ndahet nga dy ose më shumë njerëz me lidhje të ngushtë emocionale. Një nga njerezit vuan një çrregullim psikotik të mirëfilltë; deluzionet induktohen tek tjetri dhe zakonisht zhduken, kur njerëzit ndahen nga njeri tjetri.

***Përfshin:*** Folie à deux

I induktuar:

- çrregullim paranoid
- çrregullim psikotik

## F25 Çrregullime skizoafektive

Çrregullime episodike, në të cilat si simptomat afektive ashtu dhe ato skizofrenike janë të dukshme, por që nuk justifikojnë as diagnozën e skizofrenisë, as atë të episodeve depresivo-maniakale. Gjendje të tjera, në të cilat simptomat afektive u mbivendosen sëmundjeve ekzistuese skizofrenike ose bashkëjetojnë me çrregullimet deluzionale të çdo lloji, klasifikohen në F20-F29. Simptoma psikotike të fokusuara tek humori në çrregullimet afektive nuk justifikojne një diagnozë çrregullimesh skizoafektive.

### F25.0 Çrregullim skizoafektiv, tip maniakal

Një çrregullim, në të cilin edhe simptomat skizofrenike dhe ato maniakale janë prominente, por që episodet e sëmundjes nuk e justifikojnë diagnozën as të skizofrenisë e as të episodit maniakal. Kjo kategori duhet të përdoret si për një episod të vetëm, ashtu dhe për çrregullime të përsëritura, në të cilat shumica e episodeve janë skizoafektive të llojit maniakal.

Psikozë skizoafektive, e llojit maniakal

Psikozë skizofreniforme, e llojit maniakal

### F25.1 Çrregullim skizoafektiv, tip depresiv

Një çrregullim, në të cilin edhe simptomat skizofrenike dhe ato maniakale janë prominente, por që episodet e sëmundjes nuk e justifikojnë diagnozën as të skizofrenisë e as të episodit depresiv. Kjo kategori duhet të përdoret si për një episod të vetëm, ashtu dhe për çrregullime të përsëritura, në të cilat shumica e episodeve janë skizoafektive të llojit depresiv.

Psikozë skizoafektive, e llojit depresiv

Psikozë skizofreniforme, e llojit depresiv

### F25.2 Çrregullim skizoafektiv, tip i përzier

Skizofreni ciklike

Psikozë afektive dhe skizofrenike e përzier

### F25.8 Çrregullime të tjera psikoafektive

### F25.9 Çrregullim skizoafektiv i paspecifikuar

Psikozë skizoafektive NOS

## F28 Çrregullime të tjera psikotike jo-organike

Çrregullime deluzionale ose haluçinante që nuk justifikojne diagnozën e skizofrenisë (F20.-), çrregullime deluzionale persistente (F22.-), çrregullime psikotike akute dhe tranziente (F23.-), lloje psikotike të episodeve maniakale (F30.2) ose episode depresive të rënda (F32.3).

***Përfshin:*** psikozën halucinante kronike

## F29 Psikozë jo-organike e paspecifikuar

***Përfshin:*** psikozën NOS (F99)

***Përjashton:*** çrregullimet mendore NOS (F99)

psikozën organike ose simptomatike NOS (F99)

# Çrregullime të humorit [afektive] (F30–F39)

Ky bllok përmban çrregullime, në të cilat çrregullimi themelor është ndryshimi i humorit, në depresion (me ose pa ankth shoqërues) ose në ngjitje. Ndryshimi i humorit është shpesh i shoqëruar me ndryshim në nivelin e përgjithshëm të aktivitetit; shumica e simptomave të tjera janë sekondare, ose kuptohen lehtësisht në kontekstin e ndryshimit të humorit dhe aktivitetit. Shumica e këtyre çrregullimeve kanë tendencën të jenë të përsëritshme dhe fillimi i episodeve individuale mund të jetë relativisht i lidhur me situata ose ngjarje stresante.

## F30 Episod manjakal

Çdo çrregullim i kësaj kategorie duhet të përdoret vetëm për një episod të vetëm. Episodet hipomanike ose maniake në individë që kanë pasur një ose më shumë episode afektive (depresive, hipomaniakale, maniakale ose të përziera) duhet të kodohen si çrregullim afektiv bipolar (F31.-).

***Përfshin:*** çrregullimin bipolar, episod maniakal i vetëm

### F30.0 Hipomani

Një çrregullim, që karakterizohet me një ngritje të vogël të qendrueshme të humorit, energjisë dhe aktivitetit, dhe me ndjesi të mira të qenies dhe të efiçiencës mendore dhe fizike. Ka një rritje të shoqërueshmërisë, të të folurit, mbi-familjaritetit, energjisë seksuale dhe ulje të nevojës për gjumë, por jo aq sa të çojë në ndërprerje të rëndë të punës apo përjashtim shoqëror. Irritimi, mendjemadhësia dhe arroganca mund të zëvendësojnë shoqërueshmërinë zakonisht euforike. Çrregullimet e sjelljes dhe të humorit nuk shoqërohen me haluçinacone dhe deluzione.

### F30.1 Mani pa simptoma psikotike

Humori është ngritur dhe pa lidhje me situatat e pacientit, dhe mund të luhatet nga jeta e çliret pa shpërfillje deri në eksitim të pakontrolluar. Ngritja shoqërohet me energji të rritur, që jep aktivitet të rritur, fjalime të zgjatura dhe ulje të nevojës për gjumë. Vemendja nuk mund të ruhet, dhe shpërqendrimi është i rritur. Ka rritje të vetëvleresimit, me ide të mëdha dhe mbikonfidence. Humbja e frenimeve të zakonshme shoqërore mund të çojë në sjellje të rrezikshme, të papërgjegjshme dhe jashtë karakterit.

### F30.2 Mani me simptoma psikotike

Përveç tablosë klinike të përshkruar në F30.1, deluzionet (zakonisht të madhësisë) ose haluçinacionet (zëra që i flasin direkt pacientit) janë shpesh prezente, ose eksitimi, shtimi i aktivitetit motorik, apo idetë fluturuese janë aq ekstreme, sa subjekti është i pakuptueshëm dhe i paarritshëm në komunikim.

Mani me:

- simptoma psikotike në përputhje me humorin
- simptoma psikotike jo në përputhje me humorin

Stupor maniakal

### F30.8 Episode të tjera maniakale

### F30.9 Episod maniakal i paspecifikuar

Mania NOS

## F31 Çrregullim afektiv bipolar

Një çrregullim i karakterizuar nga dy ose me shumë episode, në të cilat humori i pacientit dhe nivelet e aktivitetit janë të prekura dukshëm dhe ky çrregullim koincidon me raste të ngritjes së humorit dhe të nivelit të energjisë dhe aktivitetit (hipomani ose mani) apo përkundrazi me raste të rënies së humorit, energjisë dhe aktivitetit (depresion). Episodet e përsëritura të hipomanise dhe të manise klasifikohen vetëm si bipolare.

***Përfshin:*** depresionin maniakal

maniakalo-depresiv/e:

- sëmundje
- psikozë
- reaksion

***Përjashton:*** çrregullimet bipolare, episodet e vetme maniakale (F30.-)

ciklotiminë (F34.0)

### F31.0 Çrregullim afektiv bipolar, episod hipomaniakal i tanishëm (aktual)

Pacienti është për momentin hipomaniakal dhe ka pasur të paktën një episod tjetër afektiv (hipomaniakal, maniakal, depresiv ose të përzier) në të kaluarën.

### F31.1 Çrregullim afektiv bipolar, episod hipomaniakal i tanishëm (aktual) pa simptoma psikotike

Pacienti është për momentin maniakal, pa simptoma psikotike (si në F30.1) dhe ka pasur të paktën një episod tjetër afektiv (hipomaniakal, maniakal, depresiv ose të përzier) në të kaluarën.

### F31.2 Çrregullim afektiv bipolar, episod hipomaniakal i tanishëm (aktual) me simptoma psikotike

Pacienti është për momentin maniakal, me simptoma psikotike (si në F30.2) dhe ka pasur të paktën një episod tjetër afektiv (hipomaniakal, maniakal, depresiv ose të përzier) në të kaluarën.

### F31.3 Çrregullim afektiv bipolar, episod i tanishëm (aktual) i lehtë ose i moderuar i depresionit

Pacienti është për momentin depresiv, si në një episod depresiv të lehte ose mesatar (F32.0 ose F32.1), dhe ka pasur të paktën një episod të provuar të hipomanisë, manisë, ose afektiv të përzier në të kaluarën.

### F31.4 Çrregullim afektiv bipolar me episod depresiv të rëndë, i tanishëm (aktual), pa simptoma psikotike

Pacienti është për momentin depresiv, si në një episod depresiv të rëndë pa simptoma psikotike (F32.2), dhe ka pasur të paktën një episod të provuar të hipomanisë, manisë, ose afektiv të përzier në të kaluarën.

### F31.5 Çrregullim afektiv bipolar me episod depresiv të rëndë, i tanishëm (aktual), me simptoma psikotike

Pacienti është për momentin depresiv, si në një episod depresiv të rëndë me simptoma psikotike (F32.3), dhe ka pasur të paktën një episod të provuar të hipomanisë, manisë, ose afektiv të përzier në të kaluarën.

### F31.6 Çrregullim afektiv bipolar, episod i tanishëm (aktual) i përzier

Pacienti ka pasur të paktën një episod të provuar të hipomanisë, manisë, ose afektiv të përzier në të kaluarën, dhe për momentin tregon simptoma të përziera ose të ndryshueshme të manisë ose depresionit.

***Përjashton:*** episodin afektiv të vetëm të përzier (F38.0)

### F31.7 Çrregullim afektiv bipolar, aktalisht në remision

Pacienti ka pasur të paktën një episod të provuar të hipomanisë, manisë, ose afektiv të përzier në të kaluarën, ose të paktën një episod tjetër afektiv (të hipomanisë, manisë, ose afektiv të përzier), por që për momentin nuk vuan nga çrregullime të humorit, të paktën për disa muaj. Periudhat e përmirësimit gjatë trajtimit profilaktit duhen koduar këtu.

### F31.8 Çrregullime të tjera afektive bipolare

Çrregullimi bipolar II

Episode maniakale të përsëritshme NOS

### F31.9 Çrregullim afektiv bipolar i paspecifikuar

Depresion maniakal NOS

## F32 Episod depresiv

Në episodet tipike të lehta, mesatare ose të rënda, pacienti vuan nga ulje e humorit, energjisë dhe aktivitetit. Ulet gjithashtu aftësia për t'u kënaqur, interesi dhe

përqendrimi, ka lodhje të theksuar edhe pas sforcimeve minimale. Gjumi zakonisht çrregullohet dhe oreksi ulet. Vetëvleresimi dhe vetëbesimi ulen gjithnjë edhe në format e lehta dhe ka gjithnjë një ndjenjë faji dhe të ndierit i pavlerë. Humori i ulur ndryshon pak nga dita në ditë, pacienti nuk u përgjigjet rrethanave dhe mund të shoqërohet nga simptomat e ashtuquajtura 'somatike', si humbja e interesit dhe ndjesive pozitive, zgjim në mëngjes disa orë më parë së koha e zakonshme, depresion më të rëndë në mëngjes, ngadalësim psikomotor, agjitim, humbje oreksi, humbje në peshë, dhe rënie të libidos. Në varësi të numrit dhe rëndësisë së simptomave, një episod depresiv mund të klasifikohet si i lehtë, mesatar dhe i rëndë.

***Përfshin***: episode të vetme të:

- reaksionit depresiv
- depresionit psikogjenik
- depresionit reaktiv

***Përjashton:*** çrregullimet e përshtatjes (F43.2)

çrregullimin depresiv të përsëritshëm (F33.-)

kur shoqërohet me çrregullime të sjelljes në F91.- (F92.0)

### F32.0 Episod depresiv i lehtë

Dy ose tre nga simptomat e mësipërme janë zakonisht të pranishme. Pacienti është zakonisht i stresuar, por që vazhdon me aktivitetet normale.

### F32.1 Episod depresiv i moderuar

Katër ose më shumë nga simptomat e mësipërme janë zakonisht të pranishme dhe pacienti ka vështirësi të madhe në kryerjen e aktiviteteve normale.

### F32.2 Episod depresiv i rëndë, pa simptoma psikotike

Një episod depresioni, në të cilin disa nga simptomat e mësipërme janë të theksuara dhe stresante, veçanërisht humbja e vetëvlerësimit dhe ndjesia e të qenit i pavlerë ose fajtor. Mendimet vetëvrasëse janë të zakonshme dhe një numër simptomash 'somatike' janë zakonisht të pranishme.

| | |
|---|---|
| Depresion i agjituar | një episod i vetëm pa simptoma |
| Depresion madhor | psikotike |
| Depresion jetësor | |

### F32.3 Episod depresiv i rëndë, me simptoma psikotike

Një episod depresioni i përshkruar si në F32.2, por me praninë e haluçinacioneve, deluzioneve, ngadalësimit psikomotor ose stupor, aq të thella, sa aktiviteti social i zakonshëm është i pamundur; ka rrezik për vetëvrasje, dehidratim ose uri të tejzgjatur. Haluçinacionet dhe deluzionet mund ose jo të jenë në përputhje më humorin.

Episode të vetme të:

- Depresionit madhor me simptoma psikotike
- Psikozë depresive psikogjenike
- Depresion psikotik
- Psikozë depresive reaktive

### F32.8 Episode të tjera depresive

Depresion atipik

Episod i vetëm i depresionit të ‘maskuar’ NOS

**F32.9 Episod depresiv i paspecifikuar**

Depresion NOS

Çrregullim depresiv NOS

## F33 Çrregullim depresiv rekurrent

Një çrregullim i karakterizuar nga episode të përsëritura depresioni siç përshkruhet në episodet depresive në (F32.-), pa histori episodesh të vetme të rritjes së humorit të energjisë (maniakale). Por mund të ketë episode të shkurtër të ngritjes së vogël të humorit dhe të aktivitetit (hipomani) menjëherë pas një gjendje depresive, zakonisht pas marrjes së antidepresantëve. Format më të rënda të çrregullimit depresiv të përsëritur (F33.2 dhe F33.3) kanë më shumë të përbashkët me koncepte të mëparshme si depresioni maniako-depresiv, melankolia, depresioni jetësor, dhe depresioni endogjen. Episodi i parë mund të ndodhë në çdo moshë nga fëmijëria në moshë të thyer, fillimi mund të jetë akut ose i fshehtë, dhe kohëzgjatja varion nga javë deri në muaj. Rreziku që një pacient me çrregullime depresive të përsëritura do të ketë një episod manie nuk zhduket kurrë, ndonëse shumë episode depresive kanë ndodhur. Nëse një episod i tillë ndodh, diagnoza duhet ndërruar në çrregullim afektiv bipoar (F31.-).

***Përfshin:*** episode të përsëritur të:

- reaksionit depresiv
- depresionit psikogjenik
- depresionit reaktiv

çrregullimin depresiv sezonal

***Përjashton:*** episode depresive të shkurtëra të përsëritura (F38.1)

**F33.0 Çrregullim depresiv rekurrent, me episod të lehtë të tanishëm (aktual)**

Një çrregullim i karakterizuar nga episode të përsëritura depresioni, episodi aktual është i lehtë, si në F32.0, dhe pa histori manie.

**F33.1 Çrregullim depresiv rekurrent, me episod të moderuar të tanishëm (aktual)**

Një çrregullim i karakterizuar nga episode të përsëritura depresioni, episodi aktual është mesatar, si në F32.1, dhe pa histori manie.

**F33.2 Çrregullim depresiv rekurrent, me episod të rënde të tanishëm (aktual), pa simptoma psikotike**

Një çrregullim i karakterizuar nga episode të përsëritura depresioni, episodi aktual është i rëndë, si në F32.2, dhe pa histori manie.

Depresion endogjen pa simptoma psikotike

Depresion madhor, pa simptoma psikotike të përsëritura

Psikozë maniako-depresive, e llojit depresiv, pa simptoma psikotike

Depresion jetësor, pa simptoma psikotike të përsëritura

### F33.3 Çrregullim depresiv rekurrent, me episod të rëndë të tanishëm (aktual), me simptoma psikotike

Një çrregullim që karakterizohet nga episode të përsëritura depresioni, ku episodi aktual është me simptoma të rënda psikotike, si në F32.3, dhe pa episode të mëparshme manie.

Depresion endogjen me simptoma psikotike

Psikozë depresive psikogjenike

Episode të rënda të përsëritura të:

- depresionit psikotik
- psikozës depresive psikogjenike
- depresionit psikotik
- psikozës depresive reaktive

### F33.4 Çrregullim depresiv rekurrent, aktualisht në remision

Pacienti ka pasur dy ose më shumë episode depresive si tek F33.0-F33.3 në të kaluarën, por nuk ka pasur më simptoma depresive prej disa muajsh.

### F33.8 Çrregullime të tjera depresive rekurrente

### F33.9 Çrregullim depresiv rekurrent i paspecifikuar

Depresioni monopolar NOS

## F34 Çrregullime persistente të humorit [afektive]

Çrregullime të përsëritura dhe të ndryshueshme të humorit, në të cilat shumica e episodeve individuale nuk janë mjaftueshëm të rënda për t'u përshkruar si episode hipomanike ose depresive të lehta. Duke qenë që zgjasin për vite të tërë, dhe ndonjëherë për pjesen më të madhe të jetës së njeriut, ato shkaktojnë stres dhe paaftësi të madhe. Në disa raste mund të mbivendoset dhe një episod i vetëm maniakal ose depresiv mbi çrregullimin afektiv të përsëritur.

### F34.0 Ciklotimia

Një paqendrueshmëri e (instabilitet i) gjatë i humorit, që përfshin shumë episode depresive dhe ngritje të vogla, asnjë prej të cilave nuk është mjaftueshmërisht i rëndë ose i gjatë për të justifikuar diagnozën e çrregullimit afektiv bipolar (F31.-) ose çrregullimit depresiv të përsëritur (F33.-). Ky çrregullim haset zakonisht tek të afërmit e pacientëve me çrregullim afektiv bipolar. Disa pacientë me ciklotimi mund të zhvillojnë çrregullim afektiv bipolar.

Çrregullim afektiv i personalitetit

Personalitet cikloid

Personalitet ciklotimik

### F34.1 Distimia

Një gjendje depresive kronike, që zgjat disa vjet, jo mjaftueshmërisht e rëndë, ku episodet individuale nuk janë të zgjatur mjaftueshëm për të justifikuar një diagnozë

çrregullimi të rëndë, mesatar ose të lehtë të çrregullimit depresiv të përsëritur si tek (F33.-).

Depresiv/e:

- neuroza
- çrregullimi i personalitetit

Depresioni neurotik

Depresioni me ankth të vazhdueshëm

***Përjashton:*** ankthin e depresionit (të lehtë ose jo të përsëritur) (F41.2)

**F34.8 Çrregullime të tjera persistente të gjendjes shpirtërore (afektive)**

**F34.9 Çrregullim persistent i gjendjes shpirtërore (afektive), i paspecifikuar**

## F38 Çrregullime të tjera të humorit [afektive]

Çdo çrregullim tjetër humori që nuk justifikon klasifikimin në F30-F34, sepse nuk kanë kohëzgjatje ose rëndësi të mjaftueshme.

**F38.0 Çrregullime të tjera të vetme të gjendjes shpirtërore (afektive)**

Episode afektive të përziera

**F38.1 Çrregullime të tjera rekurente të gjendjes shpirtërore (afektive)**

Episode depresive të shkurtëra të përsëritura

**F38.8 Çrregullime të tjera të specifikuara të gjendjes shpirtërore (afektive)**

## F39 Çrregullim i paspecifikuar i humorit [afektiv]

***Përfshin:*** psikozën afektive NOS

# Çrregullimet neurotike, ato të lidhura me stresin dhe ato somatoforme (F40–F48)

***Përjashton:*** kur shoqërohen me çrregullime të sjelljes F91.-(F92.8)

## F40 Çrregullimet fobike të ankthit

Një grup çrregullimesh, në të cilat ankthi del në pah në situata të mirëpërcaktuara, që zakonisht nuk janë të rrezikshme. Si rezultat, këto situata evitohen ose përjetohen me tmerr. Shqetësimi i pacientit mund të fokusohet në simptomat individuale si palpitacionet ose ndjesitë e të fiktit dhe ndjesi të tjera të frikës nga vdekja, humbjes së kontrollit, ose e të çmendurit. Thjesht mendimi i afrimit të situatës së fobisë shkakton zakonisht ankth anticipator. Ankthi i fobisë dhe i depresionit shpesh bashkëjetojnë. Nëse nevojiten të dy diagnozat – ankthi i fobisë dhe episodi depresiv, ose vetëm njera,

kjo përcaktohet nga kohëzgjatja e dy gjendjeve dhe vleresimet terapeutike në kohën e konsultës.

### F40.0 Agorafobia

Një grup fobish të mirëpërcaktuara, që përmbledh frikën e daljes nga shtëpia, hyrjes në dyqane, turma dhe vende publike, udhëtimi vetëm në tren, autobus ose avion. Çrregullimi i panikut është me natyrë të shpeshtë dhe me episode të vjetra dhe të reja. Simptomat e depresionit dhe të obsesionit, fobisë shoqërore janë shpesh të pranishme si veçori që kalojnë. Shmangia nga situatat e fobisë është e dukshme, dhe disa agorafobë kanë dhe pak ankth sepse janë në gjendje t'u shmangen situatave të tyre të fobisë.

Agorafobi pa histori çrregullimi të panikut

Çrregullim paniku me agorafobi

### F40.1 Fobia sociale

Frika e vlerësimit nga të tjerët çon në shmangie të situatave shoqërore. Fobitë shoqërore më pervazive shoqërohen zakonisht me ulje të vetëvlerësimit dhe frikë nga kritika. Kjo mund të shoqërohet me skuqje në fytyrë, dridhje të duarve, të përziera ose ndjesi urinimi, dhe shpesh pacienti bindet së këto simptoma janë problemi kryesor. Simptomat mund të avancojnë në atake të panikut.

Antrofobia

Neuroza shoqërore

### F40.2 Fobi specifike (e izoluar)

Fobi të kufizuara në situata shumë shpecifike si afërsia me kafshët, lartësitë, gjëmimet, errësira, vendet e mbyllura, urinimi ose defekimi në tualete publike, ngrënia e disa ushqimeve, dentisti ose pamjet e gjakut apo dëmtimeve. Megjithëse shkaku është i përcaktuar, kontakti me të mund të nxisë panikun si në agorafobinë ose fobitë shoqërore.

Akrofobia

Fobitë ndaj kafsheve

Klaustrofobia

Fobia e thjeshtë

***Përjashton:*** dismorfofobinë (jo-deluzionale) (F45.2)

nozofobinë (F45.2)

### F40.8 Çrregullime të tjera anksioze fobike

### F40.9 Çrregullim anksioz fobik i paspecifikuar

Fobia NOS

Gjendjet e fobisë NOS

## F41 Çrregullime të tjera të ankthit

Çrregullime, në të cilat manifestimi i ankthit është simptoma kryesore dhe jo e kufizuar në ndonjë situatë të caktuar ambientale. Simptomat depresive dhe

obsesionale, dhe madje dhe disa elemente të ankthit të fobisë, mund të jenë prezent, nëse ato janë qartësisht sekondare dhe më pak të rënda.

### F41.0 Çrregullimi i panikut [ankth episodik paroksizmal]

Veçoria themelore janë sulmet e përsëritura të ankthit të rëndë (panikut), që nuk kufizohen në ndonjë situatë të caktuar dhe që janë kështu të paparashikueshëm. Edhe si në rastin e çrregullimeve të ankthit, simptoma dominante përfshin fillimin e menjëhershëm të palpitacioneve, dhimbjes së gjoksit, ndjesisë së mbytjes, marrjen mendsh dhe ndjesinë e mungesës së realitetit (depersonalizim ose derealizim). Ka shpesh një frikë sekondare nga vdekja, humbja e kontrollit ose të bëhesh i çmendur. Çrregullimet e panikut nuk mund të vihen si shkaqet kryesore të diagnozës, nëse pacienti e ka një çrregullim depresiv në kohën kur fillojnë sulmet; në këto kushte, sulmet e panikut janë sekondare nga depresioni.

Paniku:

- sulme
- gjendje

***Përjashton:*** çrregullime paniku me agorafobi (F40.0)

### F41.1 Çrregullim anksioz i gjeneralizuar

Ankth që është i gjeneralizuar dhe persistent, por që nuk kufizohet me, apo madje mbizotëron fuqishëm, në ndonjë rrethanë të caktuar (d.m.th. që është "pluskim i lirë"). Simptomat dominante janë të ndryshme, por përfshijnë ankesa të një gjendje nervoziteti të vazhduar, dridhje, tension muskular, djersitje, marrje mendsh, palpitacione, dhe parehati epigastrike. Shprehet shpesh frika së mos pacienti ose një i afërm do të sëmuret ose pësoje aksident.

Ankthi:

- neurozë
- reaksion
- gjendje

***Përjashton:*** neuroasteninë (F48.0)

### F41.2 Çrregullim i përzier anksioz dhe depresiv

Kjo kategori duhet përdorur kur simptomat e ankthit dhe depresionit janë të dyja të pranishme, por asnjëra nuk është qartësisht dominante, ose në atë mase sa të justifikojë diagnozat veç e veç. Kur të dyja simptomat e ankthit dhe depresionit janë të pranishme dhe serioze, mjaftueshmërisht për të justifikuar secilën nga diagnozat, të dyja diagnozat duhen shënuar dhe kjo kategori nuk duhet përdorur.

Depresion anksioz (i lehtë ose jo i vazhduar)

### F41.3 Çrregullime të tjera anksioze të përziera

Simptomat e ankthit të përzier me veçori të çrregullimeve të tjera si në F42-F48. Asnjë lloj simptome nuk është serioze aq sa të justifikojë diagnozën nëse vlerësohet veçmas.

### F41.8 Çrregullime të tjera anksioze të specifikuara

Histeria e ankthit

### F41.9 Çrregullim anksioz i paspecifikuar

Ankthi NOS

## F42 Çrregullim obsesiv–kompulsiv

Veçoria themelore janë mendimet e vazhduara obsesive ose veprimet kompulsive. Mendimet obsesive janë ide, imazhe ose impulse që i hyjnë pacientit në mendje sërish dhe sërish në një forme stereotipike. Janë pothuaj gjithnjë me natyrë stresante dhe shpesh pacienti përpiqet pa rezultat t'u rezistojë. Megjithatë, ato njihen si mendime të tij/saj, edhe pse janë të pavullnetshme dhe shpesh të pështira. Veprimet kompulsive ose ritualet janë sjellje stereotipike që përsëriten sërish dhe sërish. Nuk janë të pëlqyeshme dhe as nuk çojnë në përfundimin e detyrave të dobishme. Funksioni i tyre është që të parandalojë pacientin të kryeje akte të dëmshme, që ai/ajo ka frikë se mund të ndodhin. Zakonisht kjo sjellje njihet nga pacientët si e pavlerë dhe joefektive dhe përpjekje të vazhdueshme bëhen për t'i ndaluar. Ankthi është pothuaj gjithnjë i pranishëm. Nëse u rezistohet akteve kompulsive, ankthi bëhet më i rëndë.

***Përfshin:*** neurozën anankastike

neurozën obsesive-kompulsive

***Përjashton:*** (çrregullimin) e personalitetit obsesivo-kompulsiv (F60.5)

### F42.0 Mendime kryesisht obsesionale ose zhytje në mendime

Këto mund të marrin formën e ideve, imazheve mendore ose impulseve për të vepruar, që gjithnjë janë stresante për subjektin. Shpesh idetë janë të pavendosura, vlerësim i pafund i alternativave, shoqëruar me paaftësi për të marrë vendime të vogla por të rëndësishme për jetën e përditshme. Marrëdhënia midis zhytjes në mendime dhe depresionit është shumë e ngushtë dhe diagnoza e një çrregullimi obsesiv-kompulsiv duhet të preferohet vetëm nëse ato janë në mungesë të episodit depresiv.

### F42.1 Veprime kryesisht kompulsive (rituale obsesionale)

Shumica e veprimeve kompulsive kanë të bëjnë me pastrimin (veçanërisht larjen e duarve), kontrollin e herëpashershëm që një situatë e rrezikshme nuk lejohet të ndodhë, pastërtinë dhe rregullin. Nën këtë sjellje të dukshme qendron frika, kryesisht për diçka që mund t'i ndodhë ose të shkaktoje pacienti, dhe rituali i veprimeve është një përpjekje simbolike për të shmangur këtë rrezik.

### F42.2 Veprime dhe mendime të përziera obsesionale

### F42.8 Çrregullime të tjera obsesive–kompulsive

### F42.9 Çrregullim obsesiv–kompulsiv i paspecifikuar

## F43 Reaksion ndaj stresit të fortë dhe çrregullime të përshtatjes

Kjo kategori ndryshon nga të tjerat, në atë që përfshin çrregullime të identifikueshme në bazë jo vetëm të simptomave por dhe të një ose dy influencave shkakësore: një ngjarje veçanërisht stresante në jetë që prodhon një reaksion stresant, ose një ndryshim i rëndësishëm i jetës që sjell pasoja të papëlqyeshme që kanë si pasojë një çrregullim përshtatjeje. Megjithëse stresi psikosocial jo shumë i rëndë ('ngjarjet e jetës') mund të precipitojnë fillimin ose të kontribuojnë në një prezantim me një gamë të gjerë crregullimesh të klasifikuara gjetkë në këtë kapitull, rëndësia etiologjike nuk është shpesh e qartë dhe çdo rast varet nga individi, shpesh idiosinkratik, nga vulnerabiliteti, p.sh. ngjarjet e jetës as të nevojshme por as të mjaftueshme për të shpjeguar ngjarjen

dhe formën e çrregullimit. Në kontrast me këtë, çrregullimet e grupuara këtu mendohet që vijnë gjithnjë si një pasojë direkte e një stresi akut të rëndë ose një traume të vazhduar. Ngjarjet stresante ose pasojat e vazhdueshme të pakëndshme janë faktori kryesor që shkakton çcrregullimin, i cili nuk do të kishte ndodhur pa impaktin e faktorit. Çrregullimet në këtë seksion mund të konsiderohen si përgjigje e keqadaptimit ndaj një stresi të rëndë ose të vazhduar dhe ndaj çon në probleme me funksionimin shoqëror.

## F43.0 Reaksion stresant akut

Një çrregullim i përkohshëm, që zhvillohet në një individ pa ndonjë çrregullim tjetër mendor, si përgjigje e një stresi mendor dhe fizik, që në përgjithësi zhduket brenda pak ditësh ose orësh. Vulnerabiliteti individual dhe aftësia për ta menaxhuar atë luajnë një rol në shfaqjen dhe seriozitetin e reaksionit stresant akut. Simptomat flasin për një tablo zakonisht në ndryshim, mikste, që përfshin një faze fillestare 'hutimi', me disa kufizime në fushën e ndërgjegjes dhe ngushtimit të vëmendjes, paaftësi për të kuptuar stimujt, dhe disorientim. Kjo gjendje mund të pasohet nga ose tërheqje nga situata rrethuese (deri në stupor asociativ – F44.2), ose me agjitim dhe rritje të activitetit (reaksion ikjeje ose fuge). Shenjat autonome të ankthit të panikut (takikardi, djersitje, zjarrmi) janë gjithnjë të pranishme. Simptomat zakonisht shfaqen brenda pak minutash pas stimulit ose ngjarjes stresante dhe zhduken brenda dy ose tre ditësh (shpesh brenda pak orësh). Amnezi e pjesshme ose e plotë (F44.0) mbi episodin mund të jetë gjithnjë e pranishme. Nëse simptomat persistojnë, duhet konsideruar (bërë) një ndryshim në diagnozë.

Akute:

- reaksion i krizës
- reaksion ndaj stresit

Lodhje nga luftimi (përleshja)

Gjendje krize

Shok psikik

## F43.1 Çrregullim stresant post-traumatik

Vjen si një përgjigje e vonuar ose e tërhequr ndaj një ngjarje ose situate stresante (të shkurtër ose të gjatë), e një natyre jashtëzakonisht kërcënuese ose katastrofike, e cila ka gjasa që të shkaktojë distres pervaziv tek thuajse çdokush. Faktorë predispozues, si vecoritë e personalitetit (psh, kompulsiv, astenik), ose histori sëmundjesh neurotike, mund ta ulin pragun për ndodhjen e kësaj sindrome ose ta përkeqësojnë ecurinë e saj, por ato nuk janë as të nevojshme por as të mjaftueshme për të shpjeguar shfaqjen e saj. Shenja tipike janë episode të rijetimit të traumave si kujtime intrusive, ëndrra ose makthe që ndodhin në sfondin e një ndjesie mpirjeje emocionale, largim nga njerëzit, mospërgjigje ndaj ambientit, anhedoni, si dhe shmangie nga aktivitetet dhe situatat që u kujtojnë traumat. Ka zakonisht një gjendje autonomike hipervigjilente, me reaksion të lartë trembjeje dhe pagjumësi. Ankthi dhe depresioni janë gjithë të shoqëruar me shenjat dhe simptomat e mësipërme dhe ideja e vetëvrasjes nuk është e rrallë. Fillimi i sëmundjes pason traumën pas një periudhe latente prej pak javësh ose muajsh. Ecuria është me luhatje, por shërimi vjen në shumicen e rasteve. Në një numër të vogël të tyre, gjendja mund të vijoje një ecuri kronike për disa vite, me përfundim zakonisht në një ndryshim të qendrueshëm personaliteti (F62.0).

Neurozë traumatike

### F43.2 Çrregullime të përshtatjes

Gjendje distresi subjektiv dhe çrregullimi emocional, që zakonisht interferon me funksionimin shoqëror dhe performancën, që lind në një periudhë adaptimi me një ndryshim të rëndësishëm në jetë ose një ngjarje stresante. Stresori mund të ketë prekur integritetin e rrjetit shoqëror të individit (periudhë zije, ndarjet, etj), ose sistemin më të gjerë të vlerave dhe mbështetjes shoqërore (migrimin, statusin e refugjatit), ose të përfaqësojë një krizë ose tranzicion zhvillimor (vajtja në shkollë, bërja prind, dështim në arritjen e një qëllimi personal, dalja në pension). Predispozicioni ose ndjeshmëria e individit luajnë një rol në rrezikun e shfaqjes dhe formës së manifestimeve të çrregullimit, por gjithsesi mendohet që gjendja nuk do ishte shfaqur pa një stresor. Manifestimet variojnë dhe përfshijnë një gjendje të depresuar, ankth ose shqetësim (ose një përzierje e të dyjave) si dhe ndjenjën e pamundësisë për të përballuar, planifikuar në avancë ose vazhduar në situatën aktuale, si dhe me disa gradë paaftësie në kryerjen e aktiviteteve të përditshme. Çrregullimet e sjelljes mund të jenë një veçori shoqëruese, veçanërisht tek adoleshentet. Veçoria mbizotëruese mund të jetë një reaksion depresiv i shkurtër ose i gjatë, ose një shqetësim i emocioneve të tjera ose sjelljes.

Shok kulturor

Reaksion i zisë

Hospitalizimi i fëmijëve

***Përjashton:*** ankthin e ndarjes në fëmijëri (F93.0)

### F43.8 Reaksione të tjera ndaj stresit të fortë

### F43.9 Reaksion ndaj stresit të fortë, i paspecifikuar

## F44 Çrregullime disociative [konversionale]

Temat kryesore që janë të përbashkëta midis çrregullimet disociative dhe të konversionit janë ato të humbjes së plotë ose të pjesshme të integrimit të kujtesës së hershme me atë të re, ndërgjegjshmëria për identitetin dhe ndjesitë imediate, dhe kontrollin e lëvizjeve të trupit. Të gjitha llojet e çrregullimeve disociative tentojne të zhduken pas pak javësh ose muajsh, veçanërisht nëse fillimi i tyre ishte i lidhur me një ngjarje traumatike në jetë. Shumë çrregullime kronike, veçanërisht paralizat dhe anestezitë, mund të zhvillohen nëse fillimi ishte i shoqëruar me probleme pa zgjidhje dhe vështirësi ndërpersonale. Këto çrregullime janë klasifikuar me parë si lloje të ndryshe të 'histerisë së konversionit'. Mendohet të jenë me origjinë psikogjenike, që shoqërohen ngushtësisht në kohë me ngjarje traumatike, probleme pa zgjidhje ose marrëdhënie problematike. Simptomat shpesh përfaqësojnë konceptin e pacientit se si do të manifestohej sëmundja fizike. Vizitat mjekësore nuk gjejnë praninë e ndonjë çrregullimi neurologjik të njohur fizik. Për më tepër, ka fakte që humbja e funksionit është një shprehje e konfliktit emocional ose të nevojave. Simptomat mund të zhvillohen në marrëdhënie të ngushtë me stresin psikologjik dhe shpesh ndodhin papritur. Vetëm çrregullimet e funksioneve fizike zakonisht nën kontroll të vullnetshëm dhe humbja e ndjeshmërisë, përfshihen këtu. Çrregullimet që përfshijnë dhimbjen dhe ndjesi të tjera komplekse fizike, të përcjella nga sistemi nervor autonom, klasifikohen si çrregullime të somatizimit (F45.0). Mundësia e shfaqjes së fundmi e çrregullimeve serioze fizike ose psikiatrike duhet të kihet gjithnjë parasysh.

***Përfshin:*** e konversionit:

- histerinë
- reaksionin

histerinë

psikozën histerike

***Përjashton:*** malingeringun [simulimin e vetëdijshëm] (Z76.5)

## F44.0 Amnezi disociative

Veçoria kryesore është humbja e kujtesës, zakonisht për ngjarje të fundme të rëndësishme, që nuk shkaktohen nga çrregullime mendore organike, dhe që është shumë e madhe për tu shpjeguar me harresë të zakonshme ose lodhje. Amnezia është e përqendruar në ngjarje traumatike, si aksidentet ose mbajtja e një zie të pazakontë, dhe është zakonisht e pjeshme dhe selektive. Amnezia e përgjithshme dhe e plotë është e pazakontë, dhe është zakonisht pjesë e fugës (F44.1). Nëse kjo është e tillë, çrregullimi kodohet si i tillë. Diagnoza nuk duhet të vihet në praninë e çrregullimeve organike të trurit, intoksikimit ose lodhjes së tejskajshme.

***Përjashton:*** amnezinë nga alkooli ose substancat psikoaktive (F10-F119 me karakter të katërt .6)

amnezinë:

- NOS (R41.2)
- anterograde (R41.1)
- retrograde (R41.2)

sindromën amnezike organike jo-alkoolike (F04)

amnezinë pas iktusit në epilepsi (G40.-)

## F44.1 Fuga disociative

Fuga disociative ka të gjitha veçoritë e amnezisë disociative, si dhe udhëtim të qëllimshëm përtej diapazonit të përditshëm. Megjithëse ka amnezi për periudhën e fugës, sjellja e pacientit gjatë kësaj kohe mund të duket komplet normale prej vëzhguesve të jashtëm.

***Përjashton:*** fugën post-iktale në epilepsi (G40.-)

## F44.2 Stupor disociativ

Stupori disociativ diagnostikohet në bazë të një zvogëlimi të madh ose mungese të lëvizjeve të vullnetshme dhe përgjigjes normale ndaj stimujve të jashtëm si drita, zhurma dhe prekja, por ekzaminimi dhe hetimi nuk tregojnë ndonjë fakt të një shkaku fizik. Për më tepër, ka një tregues pozitiv për një shkak psikogjenik në formën e një ngjarjeje të vonë stresante ose problemi.

***Përjashton:*** çrregullimin katatonik organik (F06.1)

stupor:

- NOS (R40.1)
- katatonik (F20.2)
- depresiv (F31-F33)
- manik (F30,2)

### F44.3 Ekstaza dhe çregullimet posesive

Çrregullim, në të cilin ka një humbje të përkohshme të sensit të identitetit personal dhe ndërgjegjshmërisë së plotë të ambientit. Përfshini këtu vetëm gjendjet në trans, që janë të pavullnetshme dhe të dëshiruara, që ndodhin jashtë situatave të pranueshme kulturale ose fetare.

***Përjashton:*** gjendjet e shoqëruara me:

- çrregullime psikotike akute dhe të përkohshme (F23.-)
- çrregullime organike të personalitetit (F07.0)
- sindromën postkontuzionale (F07.2)
- intoksikim me substanca psikoaktive (F10-F19 me karakter të katërt .0)
- skizofreninë (F22.-)

### F44.4 Çrregullime motore disociative

Në llojet me të zakonshme ka një humbje të aftësisë për të lëvizur një ose disa gjymtyrë në mënyrë të pjesshme ose të plotë. Mund të ketë ngjashmëri të madhe me çdo lloj ataksie, apraksie, akinezie, afonie, disatrie, diskinezie, shkarkese në tru ose paralize.

Psikogjenike:

- afoni
- disfoni

### F44.5 Konvulsione disociative

Konvulsionet disociative mund të kopjojnë shkarkesat në tru nga epilepsia në lidhje me lëvizjen, kafshimin e gjuhës, gërvishtjen nga rënia, inkontinencën urinare, dhe më rrallë ndërgjegja zëvendësohet me një gjendje stupor ose transi.

### F44.6 Anestezia disociative dhe humbja e ndjeshmërisë

Zonat anestetike të lëkurës shpesh kanë kufinj që e tregojnë qartë që janë të shoqëruar me idenë e pacientit për funksionet trupore, sesa nga njohuria mjekësore. Mund të ketë një humbje diferenciale midis modaliteteve sensoriale që nuk mund të jenë për shkak lezioneve neurologjike. Humbja sensoriale mund të shoqërohet me ankesa të parestezisë. Humbja e shikimit ose dëgjimit janë rrallë të plota në çrregullimet disociative.

Shurdhëria psikogjenike

### F44.7 Çrregullime të përziera disociative [konversionale]

Çrregullimet e kombinuara të specifikuara në F44.0-F44.6

### F44.8 Çrregullime të tjera disociative [konversionale]

Sindroma Ganser

Personalitet i shumëfishtë

Psikogjenike

- konfuzion
- gjendje mugëtire

### F44.9 Çrregullim disociativ (konversional), i paspecifikuar

## F45 Çrregullime somatoforme

Veçoria kryesore është prezantimi i përsëritur i simptomave fizike, së bashku me kërkesat e vazhduara për kontrolle mjekësore, pavarësisht nga gjetjet negative dhe sigurimit nga mjekët se simptomat nuk kanë një bazë fizike. Nëse ndonjë çrregullim fizik është i pranishëm, ai nuk shpjegon natyrën dhe shtrirjen e simptomave ose stresin dhe preokupimin e pacientit.

***Përjashton:*** çrregullimet disociative (F44.-)

shkuljen e leshrave (F98.4)

të qenit thuthuq (F80.8)

kafshimin e thonjve (98.8)

faktorët psikologjike ose të sjelljes që janë të shoqëruar me çrregullime të klasifikuara tjetërkund (F54)

disfunksionin seksual, të pashkaktuar nga sëmundje organike (F52.-)

thithjen e gishtit (F98.8)

çrregullimet e tikut (në fëmijëri dhe në adoleshencë) (F95.-)

sindromën Tourette (F95.2)

trikotilomaninë (F63.3)

### F45.0 Çrregullim i somatizimit

Veçori kryesore janë simptoma fizike të shumta, të përsëritura dhe shpesh të ndryshueshme për të paktën dy vjet. Shumica e pacientëve kanë një histori të gjatë kontaktesh me shërbimet mjekësore si parësore dhe të specializuara, gjatë të cilave janë kryer shumë kontrolle ose vizita eksplorative. Simptomat mund të referohen në çdo pjesë të trupit. Ecuria e sëmundjes është kronike dhe me luhatje, dhe shpesh shoqërohet me ndërprerje të sjelljes shoqërore, familjare dhe ndërpersonale. Simptomat e shkurtëra (më pak se dy vjet) dhe disa lloje simptomash duhet të klasifikohen nën çrregullimet somatoforme të padiferencuara (F45.1).

Çrregullimi Briquet

Çrregullimi psikomatik i shumëfishtë

***Përjashton:*** malingering [simulimin e ndërgjegjshëm] (Z76.5)

### F45.1 Çrregullim somatoform i padiferencuar

Kur ankesat somatoforme janë të shumëfishta, të ndryshueshme dhe persistente, por që tabloja tipike dhe e plotë e somatizimit nuk përmbushet, duhet të konsiderohet (të merret për bazë) diagnoza e çrregullimit somatoform të padiferencuar.

Çrregullimi psikomatik i padiferencuar

### F45.2 Çrregullim hipokondriakal

Veçoria kryesore është preokupimi i vazhduar me mundësinë e pasjes së një ose me shumë çrregullimesh fizike progresive. Pacienti manifeston me ankesa somatike persistente dhe me shqetësim të vazhduar për paraqitjen e tyre fizike. Ndjesitë e zakonshme dhe paraqitja normale shpesh interpretohen nga pacienti si anormale dhe

stresante, dhe vëmendja zakonisht fokusohet mbi një ose dy organe/sisteme të trupit. Depresioni dhe ankthi i shtuar janë prezent, dhe mund të justifikojnë diagnoza shtesë.

Çrregullimi dismorfik i trupit

Dismorfofobia (jodeluzionale)

Neuroza hipokondrike

Hipokondriaza

Nosofobia

***Përjashton:*** dismorfofobinë deluzionale (F22.8)

deluzionet fikse për format ose funksionet e trupit (F22.-)

## F45.3 Disfunksion somatoform automatik

Simptomat paraqiten nga pacienti si të ishin për shkak të një çrregullimi fizik i një sistemi ose organi që është me së shumti ose plotësisht nën inervimin dhe kontrollin e sistemit nervor autonom, p.sh., sistemin kardiovaskular, gastrointestinal, respirator dhe urogjenital. Simptomat janë zakonisht dy llojëshe, asnjë prej të cilave nuk flet për një çrregullim fizik ose prekje të një organi ose sistemi. Së pari, ka ankesa bazuar mbi shenja objektive të zgjimit autonomik, si palpitacione, djersitje, zjarrmi të brendshme, dridhje dhe shprehje frikë dhe stresi mbi mundësinë e pasjes së një sëmundjeje. Së dyti, ka ankesa subjektive të një natyre jospecifike dhe të ndryshueshme, si dhimbje të përkohshme, ndjesi djegieje, rendim i përgjithshëm, shtrëngesë ose ndjesi të të qenit i fryrë, të cilat referohen nga pacienti në një organ ose sistem specifik.

Neurozë kardiake

Sindroma Da Costa

Neurozë gastrike

Asteni neurocirkulatore

Format psikogjenike të:

- aerofagisë
- kollës
- diarresë
- dispepsisë
- dizurisë
- flatulencës
- lemzës
- hiperventilimit
- rritjes së shpeshtësisë të urinimit
- sindromës të zorrës së irrituar
- spazmës së pilorit

***Përjashton:*** faktorët psikologjikë dhe të sjelljes të lidhur me çrregullime ose sëmundje të klasifikuara tjetërkund (F54)

## F45.4 Dhimbje somatoforme persistente

Ankesa kryesore është një dhimbje e fortë persistente dhe stresante, që nuk mund të shpjegohet plotësisht nga një proces fiziologjik ose një çrregullim fizik dhe që ndodh në bashkëpunim me një konflikt emocional ose psikosocial, që janë të mjaftueshëm për të dalë në konkluzionin se ata janë shkaktarët kryesorë. Rezultati është zakonisht një mbështetje dhe vëmendje e rritur, qoftë personale, qoftë mjekësore. Dhembja e menduar psikogjenike në origjinë, që ndodh gjatë ecurisë së çrregullimeve depresive ose skizofrenisë, nuk duhet përfshirë këtu.

Psikalgjia

Psikogjenike:

- dhembja e shpinës
- dhembja e kokës

Çrregullimi somatoform i dhimbjes

***Përjashton:*** dhimbjen e shpinës (M54.9)

dhimbjen:

- NOS (R52.9)
- akute (R52.0)
- kronike (R52.2)
- të padurueshme (R52.1)

dhimbjen e kokës nga tensioni (G44.2)

### F45.8 Çrregullim tjetër somatoform

Çdo çrregullim tjetër i ndjesive, funksionit ose sjelljes, që nuk është për shkak të çrregullimeve fizike, që nuk janë të transmetuara me anë të sistemit nervor autonom, që janë të kufizuara në pjesë ose sisteme specifike dhe që janë të shoqëruara ngushtësisht në kohë me probleme ose ngjarje stresante.

Psikogjenik/e:

- dismenorrea
- disfagia, që përfshin 'globus histericus'
- pruritus
- torticollis

Kërcitja e dhëmbëve

### F45.9. Çrregullim somatoform, i paspecifikuar

Çrregullimet psikomatike NOS

## F48 Çrregullime neurotike të tjera

### F48.0 Neurasteni

Variacione kulturore të konsiderueshme ndodhin në prani të këtij çrregullimi, dhe janë dy tipa kryesorë që ndodhin, me një mbivendoje të konsiderueshme. Në njërin lloj, veçoria kryesore është një ankesë për një lodhje të madhe pas një sforcimi mendor, shpesh e shoqëruar me një ulje të performancës profesionale ose përballimit me

eficiencë të detyrave të përditshme. Lodhja mendore shpjegohet në mënyrë tipike si një ndërhyrje e papëlqyeshme e asociacioneve hutuese ose kujtesave, vështiresisë në përqendrim, dhe në përgjithësi të menduar jo efiçient. Në llojin tjetër, theksi është tek ndjesia e një dobësie trupore ose fizike, lodhje pas një pune me përpjekje minimale, të shoqëruar me ndjesinë e dhimbjeve muskulare dhe të pamundësisë për t'u relaksuar. Në të dyja llojet, është e shprehur një lloj ndjesie e një pakënaqësie fizike, si dhe marrje mendsh, dhimbje koke nga tensioni dhe ndjesi e një paqendrueshmërie të përgjithshme. Shqetësimi për përkeqësim mendor dhe fizik, irritabilitet, anhedoni dhe në shkallë të vogël edhe depresion dhe ankth, janë të pranishëm. Gjumi është i shqetësuar në fazën e fillimit dhe të mesme, por hipersomnia mund të jetë gjithashtu e pranishme.

Sindroma e lodhjes

Përdorni kod shtesë, nëse dëshironi, për të identifikuar sëmundjet e mëparshme.

***Përjashton:*** astenine NOS (R53)

rraskapitje (Z73.0)

të ndjerit keq dhe lodhjen (R53)

sindromën e lodhjes postvirale (G93.3)

psikasteninë (F48.8)

### F48.1 Sindrom i depersonalizim-derealizimit

Një çrregullim i rrallë, në të cilin pacienti ankohet në mënyrë spontane që aktiviteti mendor i tij/saj, trupi dhe ambienti kanë ndryshuar në cilësinë e tyre, duke u bërë jo-realë, të largët dhe të automatizuar. Ndërmjet fenomeneve të ndryshëm të këtij sindromi, pacientët ankohen me së shumti për humbje të emocioneve dhe ndjesisë së prishjes dhe largimit nga të menduarit e tyre, trupit të tyre ose botës reale. Pavarësisht nga natyra dramatike e kësaj eksperience, pacienti është i ndërgjegjshëm ndaj të qenit jo-real të këtij ndryshimi. Sensoriumi është normal dhe kapacieteti për shprehje emocionale është i paprekur. Simptomat e depersonalizimit-derealizimit mund të ndodhin si pjesë e çrregullimeve të një skizofrenie të diagnostikueshme, depresive, fobike ose obsesivo-kompulsive. Në këto kushte, diagnoza duhet të jetë ajo e çrregullimit kryesor.

### F48.8 Çrregullime të tjera nervore, të specifikuara

Sindroma Dhat

Neuroza okupacionale, që përfshin ngërçin e shkrimtarit

Psikastenia

Neuroza psikastenike

Sinkopi psikogjenik

### F48.9 Çrregullim nervor, i paspecifikuar

Neuroza NOS

# Sindroma të sjelljes të lidhura me turbullime fiziologjike dhe me faktorë fizikë

# (F50–F59)

## F50 Çrregullime të ngrënies

***Përjashton:*** anoreksinë NOS (R63.0)

të ushqyerit:

- vështirësitë dhe keqmenaxhimi
- çrregullimet në foshnjëri apo fëmijëri (F98.2)

polifaginë (R63.2)

### F50.0 Anoreksi nervore

Një çrregullim, që karakterizohet me humbje të qëllimshme në peshë, e shkaktuar ose e mbajtur me qëllim nga pacienti. Ndodh më së shumti tek vajzat adoleshente dhe tek gratë e reja, por mund të preken dhe djemtë adoleshentë dhe burrat e rinj, si dhe fëmijë në afërsi të pubertetit dhe gra më të moshuara deri në menopauzë. Çrregullimi shoqërohet me një psikopatologji, ku tmerri i dhjamosjes së trupit është një ide e mbivlerësuar intrusive që persiston, dhe pacienti më pas i nënshtrohet një pragu të ri me të ulët të peshës së tij. Zakonisht ka kequshqyerje me shkallë të ndryshme rëndësie, me ndryshime dytësore endokrine dhe metabolike, dhe me çrregullime të funksioneve të trupit. Simptomat përfshijnë kufizimin e ushqimit me anë të dietës, stërvitje të tepruar, provokim të vjellash dhe nxjerrje ushqimi, si dhe përdorimin e frenuesve të oreksit dhe diuretikëve.

***Përjashton:*** humbjen e oreksit (R63.0)

humbjen e oreksit

- psikogjenik (F50.8)

### F50.1 Anoreksi nervore atipike

Çrregullim, që përmbush disa nga cilësitë e anoreksisë nervore, por në të cilin tabloja e përgjithshme klinike nuk e justifikon diagnozën. Për shembull, një nga simptomat kryesore, si amenorrea ose tmerri i të qenit i/e shëndoshë, mund të mungojë, në prani të humbjes së madhe në peshë dhe sjelljes që synon rënien në peshë. Diagnoza nuk duhet të bëhet në prani të një çrregullimi fizik të njohur të shoqëruar me humbje peshe.

### F50.2 Bulimi nervore

Një sindromë, që karakterizohet nga shpërthime të përsëritura të tejngrënies dhe një preokupim i tepërt për kontrollin e peshës së trupit, që çon në një shabllon të tejngrënies dhe me pas të të vjellit ose nxjerrjes së ushqimit. Ky çrregullim ka shumë veçori psikologjike të përbashkëta me anoreksinë nervore, përfshirë dhe një shqetësim me formën e trupit dhe peshën. Të vjellat e përsëritura çojnë në rritje të çrregullimeve të elektroliteve dhe të komplikacioneve fizike. Shpesh ka, por jo gjithnjë, një histori të një episodi të mëparshëm të anoreksisë nervore, me një interval që varion nga disa muaj deri në disa vite.

Bulimia NOS

Hiperoksia nervosa

### F50.3 Bulimi nervore atipike

Çrregullime, që përmbushin disa nga veçoritë e bulimisë nervore, por në të cilat tabloja e përgjithshme klinike nuk e justifikon diagnozën. Për shembull, mund të ketë disa shpërthime të tejngrënies dhe mbipërdorimit të purgativëve pa ndonjë ndryshim të madh në peshë, ose mbishqetësimi tipik për formën e trupit dhe peshën mund të mungojë.

### F50.4 Mbingrënie e lidhur me turbullime të tjera fiziologjike

Mbingrënie për shkak të ngjarjeve stresante, si zija, aksidentet, lindjet, etj

Mbingrënie psikogjenike

***Përjashton:*** obezitetin (E66.-)

### F50.5 Të vjella të lidhura me turbullime të tjera fiziologjike

Vjellje të përsëritura, që ndodhin në çrregullime disociative (F44.-) dhe hipokondriale (F45.2), dhe që nuk janë vetëm për shkak të gjendjeve të klasifikuara jashtë këtij kapitulli. Kjo nënkategori mund të përdoret gjithashtu si shtesë e O21.- (të vjellat e shtuara gjatë shtatzënisë), kur faktorët emocionalë janë predominantë në shkaktimin e të përzierave dhe të vjellave të herëpashershme gjatë shtatzënisë.

E vjella psikogjenike

***Përjashton:*** të perzierat (R11)

të vjellat NOS (R11)

### F50.8 Çrregullime të tjera të ngrënies

Ngrënia e gjithçkaje tek të rriturit

Humbja psikogjenike e urisë

***Përjashton:*** ngrënien e gjithçkaje në foshnjëri dhe fëmijëri (F98.3)

### F50.9 Çrregullim i ngrënies, i paspecifikuar

## F51 Çrregullime jo-organike të gjumit

Në shumë raste, një çrregullim i gjumit është një simptomë e një çrregullimi tjetër, mendor ose fizik. Nëse çrregullimi tjetër në një pacient të caktuar është një gjendje e pavarur ose thjesht një nga veçoritë e një çrregullimi tjetër të klasifikuar tjetërkund, ose në këtë kapitull ose diku tjetër, atëherë kjo duhet të përcaktohet në bazë të paraqitjes dhe ecurisë klinike, si dhe të vlerësimeve terapeutike dhe prioriteve në kohën e konsultës. Në përgjithësi, nëse çrregullimi i gjumit është një nga ankesat kryesore dhe perceptohet si një gjendje në vetvete, kodi aktual duhet të përdoret së bashku me diagnozat e tjera që përshkruajnë psikopatologjinë dhe patofiziologjinë e përfshirë në një rast të caktuar. Kjo kategori përfshin vetëm ato çrregullime të gjumit në të cilat shkaqet emocionale konsiderohet të jenë një faktor primar, dhe që nuk janë për shkak të çrregullimeve fizike të identifikuara të klasifikuara tjetërkund.

***Përjashton:*** çrregullimet e gjumit (organike) (G47.-)

### F51.0 Insomni jo-organike

Një gjendje e një sasie ose cilësie të pakënaqshme të gjumit, që persiston për një periudhë të kosiderueshme kohe, përfshirë vështirësinë për të rënë në gjumë, atë të të qenit në gjumë, ose zgjimin e parakohshëm. Pagjumësia është një simptomë e përbashkët e shumë çrregullimeve fizike dhe mendore, dhe duhet të klasifikohet këtu si shtesë e çrregullimit bazë vetëm nëse e dominon tablonë klinike.

***Përjashton:*** pagjumësinë (organike) (G47.0)

## F51.1 Hipersomni jo-organike

Hipersomnia përcaktohet si një çrregullim ose i fjetjes shumë gjatë ditës dhe sulme gjumi (të papërllogaritura dhe me një sasi të pamjaftueshme gjumi), ose me një tranzicion të zgjatur deri në zgjimin e plotë. Në mungesë të një faktori organik për hasjen e hipersomnisë, kjo gjendje zakonisht shoqërohet me çrregullime mendore.

***Përjashton:*** hipersomninë (organike) (G47.1)

narkolepsinë (G47.4)

## F51.2 Çrregullim jo-organik i regjimit të gjumit

Një mungesë sinkronizimi midis orarit zgjuar-fjetur dhe orarit të dëshiruar zgjuar-fjetur për ambientin e individit që çon në një ankesë ose të pagjumesisë ose të hipersomnisë.

Invertimi psikogjenik:

- cirkadian
- niktohemeral
- i gjumit

} ritmi

***Përjashton:*** çrregullimet e orarit zgjuar-fjetur (organike) (G47.2)

## F51.3 Somnambulizëm

Një gjendje e ndërgjegjes së alteruar, në të cilën kombinohen fenomene të gjumit dhe të qenit zgjuar. Gjatë një episodi të ecjes në gjumë, individi ngrihet nga krevati, zakonisht gjatë një të tretës së parë të gjumit të natës, dhe ecën kuturu, duke shfaqur nivele të ulët ndërgjegjeje, reaktiviteti dhe aftësish motore. Sapo zgjohet, individi zakonisht nuk mban mend asgjë nga çka ka ndodhur.

## F51.4 Terror i gjumit (terror i natës)

Episode gjatë natës me terror ekstrem dhe panik, që shoqërohet me vokalizime intense, lëvizshmëri dhe nivele të larta shkarkesash autonomike. Individi zgjohet/ngrihet, zakonisht gjatë një të tretës së parë të natës, me ulërima paniku. Shumë shpesh, ai/ajo shkon me vrap tek dera në përpjekje për të shpëtuar, megjithëse shumë rrallë del nga dhoma. Mbajtja mend e episodit ndodh rrallë (zakonisht një ose dy fragmente imazhesh mendore).

## F51.4 Ankthi i natës

Eksperienca ëndrrash të mbushura me ankth dhe frikë. Ka një kujtesë të ruajtur në detaje të përmbajtjes së ëndrrës. Eksperienca e ëndrrës është shumë e gjallë dhe zakonisht përfshin tema që kanë të bëjnë me kërcënime ndaj jetës, sigurisë ose vetëvlerësimit. Shumë shpesh, ka një përsëritje të së njëjtës temë makthi frikësues ose të ngjashëm. Gjatë një episodi tipik, ka një shkallë shkarkimi autonom, por nuk ka vokalizim ose lëvizje trupi të dukshme. Në zgjim, individi bëhet me shpejtësi alert dhe i orientuar.

Çrregullim ankthi i ëndrrës

### F51.8 Çrregullime të tjera jo-organike të gjumit

### F51.9 Çrregullim jo-organik i gjumit, i paspecifikuar

Çrregullime emocionale të gjumit NOS

## F52 Disfunksion seksual, i pashkaktuar nga ndonjë çrregullim organik ose sëmundje

Disfunksion seksual, që përfshin momentet e ndryshme në të cilat një individ është i paaftë për të marrë pjesë në një marrëdhënie seksuale siç do të dëshironte. Përgjigja seksuale është një proces psikosomatik dhe të dy proceset somatike dhe psikologjike janë të përfshira si shkaktarë të disfunksionit seksual.

***Përjashton:*** sindromën Dhat (F48.8)

### F52.0 Ulje ose humbje e dëshirës seksuale

Humbja e dëshirës seksuale është problemi kryesor dhe jo sekondar nga çrregullime të tjera seksuale, si insufiçienca erektile apo dispareunia.

Frigjiditeti

Çrregullimi i dëshirës seksuale hipoaktive

### F52.1 Neveri seksuale dhe mungesë e kënaqësisë seksuale

Ose mundësia e kryerjes së aktit seksual që shkakton frikë dhe ankth, që çon në evitim të aktivitetit seksual (aversion seksual), ose përgjigjet seksuale ndodhin normalisht dhe orgazma arrihet, por ka një mungesë kënaqesie të përshtatshme (mungesë e kënaqësisë seksuale).

Anhedoni (seksuale)

### F52.2 Pamjaftushmëri e përgjigjes seksuale

Problemi kryesor tek burrat është disfunksioni erektil (vështirësi në pasjen ose mbajtjen e një ereksioni të përshtatshëm për marrëdhënien seksuale). Tek femrat problemi është mungesa e lubrifikimit ose e thatësisë së vaginës.

Çrregullim i eksitimit seksual femëror

Çrregullim erektil mashkullor

Impotencë psikogjenike

***Përjashton:*** impotencën me origjinë organike (N48.4)

### F52.3 Disfunksion i orgazmës

Orgazma ose nuk ndodh ose vonohet në mënyrë të ndjeshme.

Orgazëm e penguar (mashkullore) (femërore)

Anorgazmia psikogjenike

### F52.4 Ejakulacion i parakohshëm

Paaftësia për të kontrolluar në mënyrë të mjaftueshme ejakulimin, në mënyrë që të dy partnerët të shijojnë bashkëveprimin seksual.

### F52.5 Vaginizëm jo-organik

Spazëm e muskujve të dyshemesë së pelvisit që rrethonjnë vaginën, duke shkaktuar një bllokim të hapjes së vaginës. Hyrja e penisit është e pamundur ose shumë e dhimbshme.

Vaginizmi psikogjenik

***Përjashton:*** vaginizmin (organik) (N94.2)

**F52.6 Dispareunia jo-organike**

Dispareunia (ose dhimbje gjatë marrëdhënies seksuale) ndodh si në femrat ashtu dhe në meshkujt. Mund t'i atribuohet patologjive lokale dhe duhet të karaterizohet saktë nën gjendjen patologjike. Kjo kategori duhet përdorur vetëm nëse nuk ka një disfunksion seksual jo-organik parësor (p.sh vaginizëm ose tharje të vaginës).

Dispareunia psikogjenike

***Përjashton:*** dispareuninë (organike) (N94.1)

**F52.7 Nxitje seksuale e tepruar**

Nimfomania

Satiriaza

**F52.8 Disfunksion tjetër seksual, jo i shkaktuar nga dëmtime organike ose sëmundje**

**F52.9 Disfunksion seksual i paspecifikuar, jo i shkaktuar nga dëmtime organike ose sëmundje**

## F53 Çrregullime mendore dhe të sjelljes, të lidhura me lehoninë (=puerperiumin), të paklasifikuara diku tjetër

Kjo kategori përfshin jo vetëm çrregullimet mendore të lidhura me periudhën pas lindjes (që fillojnë brenda 6 javëve pas lindjes), që nuk plotësojnë kriteret për çrregullimet e klasifikuara tjetërkund në këtë kapitull, ose sepse nuk ka informacion të mjaftueshëm, ose sepse konsiderohet si një veçori klinike shtesë që shfaqet dhe e bën të papërshtatshëm klasifikimin tjetërkund të tyre.

**F53.0 Çrregullime të lehta mendore e të sjelljes, të lidhura me lehoninë, të paklasifikuara diku tjetër**

Depresioni:

- postnatal NOS
- postpartum NOS

**F53.1 Çrregullime të rënda mendore e të sjelljes, të lidhura me lehoninë, të paklasifikuara diku tjetër**

Psikoza puerperale (=e paslindjes) NOS

**F53.8 Çrregullime të tjera mendore e të sjelljes, të lidhura me lehoninë, të paklasifikuara diku tjetër**

**F53.9 Çrregullim mendor puerperal, i paspecifikuar**

## F54 Faktorë psikologjikë dhe të sjelljes të lidhur me çrregullime ose sëmundje të klasifikuara diku tjetër

Kjo kategori duhet të përdoret për të regjistruar praninë e influencave psikologjike dhe të sjelljes, që mendohet se kanë luajtur një rol të madh në etiologjinë e çrregullimeve fizike që mund të klasifikohen në kapituj të tjerë. Çdo çrregullim mendor që pason është zakonisht i lehtë dhe shpesh i zgjatur (si shqetësim, konflikt emocional, dhe frikë për ndodhíra të kota), dhe nuk e justifikon përdorimin e kategorive në këtë kapitull.

***Përfshin:*** faktorët psikologjike që prekin gjendjen fizike

shembuj të përdorimit të kësaj kategorie janë:

- astma F54 dhe J45.-
- dermatiti F 54 dhe L23-l25
- ulcera gastrike F54 dhe K25.-
- sindroma e zorres së irritueshme F54 dhe K58.-
- koliti ulçeroz F54 dhe K51.-
- urtikaria F54 dhe L50.-

Përdorni kode shtesë, nëse dëshirohet, për të identifikuar çrregullimet fizike shoqëruese.

***Përjashton:*** dhimbjen e kokës nga tensioni (G44.2)

## F55 Abuzim me lëndë që nuk shkaktojnë vartësi

Mund të përfshihen një gamë e gjerë medikamentesh dhe mjekimesh popullore, por grupet me të rëndësishme janë: (a) barnat psikotrope që nuk shkaktojnë vartësi, si antidepresantët, (b) laksativët, dhe (c) analgjezikët që mund të blihen pa recetë, si aspirina dhe paracetamoli.

Përdorimi i vazhdueshëm i këtyre substancave shpesh përfshin kontakte të padëshiruara me staf mjekësor profesional ose mbështetës, dhe shpesh mund të shoqërohet me efekte fizike të dëmshme të substancës. Përpjekje për të ndaluar ose ndërprerë me forcë këto substanca, has në kundërshti; për laksativët dhe analgjezikët kjo mund të ndodhë edhe pas kështillimit ndaj (ose shfaqjes së) dëmtimit fizik, si humbja e funksionit renal ose çrregullime elektrolitesh. Megjithatë, është e qartë që edhe pse pacienti ka një motivim të fortë për të marrë substancën, simptomat e vartësisë ose abstinencës nuk zhvillohen si në rastin e substancave psikoaktive të specifikuara në F10-F19.

***Përfshin:*** abuzimin me:

- antacide
- mjekime popullore ose me bazë bimore
- steroide dhe hormone
- vitamina

laksativët

***Përjashton:*** abuzimin me substancat psikoaktive (F10-F19)

## F59 Sindroma të paspecifikuar të sjelljes të shoqëruar me turbullime fiziologjike dhe faktorë fizikë

***Përfshin:*** Disfunksionin fiziologjik psikogjenik NOS

# Çrregullime të personalitetit dhe të sjelljes së të rriturve (F60–F69)

Ky bllok përfshin një gamë gjendjesh dhe sjelljesh me rëndësi klinike, që kanë tendencën për të qenë të vazhduara dhe që duket të jenë shprehje e veçorive individuale të stilit të jetesës dhe mënyrës së reagimit ndaj vetes dhe të tjerëve. Disa nga këto gjendje dhe mënyra të sjelluri dalin herët në proçesin e zhvillimit individual, si rezultat i faktorëve konstitucionalë dhe eksperiencës shoqërore, ndërsa të tjerë fitohen më vonë në jetë. Çrregullime të caktuara të personalitetit (F60.-), të përziera ose të tjera (F61.) dhe të qendrueshme (F62.-) janë të gdhendura thellë në mënyrat e sjelljes që manifestojnë si një pergjigje jofleksibël ndaj një game të gjerë situatash shoqërore dhe personale. Ato përfaqësojnë një devijim ekstrem ose të rëndësishëm nga mënyra se si një individ i zakonshëm në një kulturë të caktuar percepton, mendon, ndien dhe, sidomos, sillet me të tjerët. Tendenca të tilla sjelljeje janë të qendrueshme dhe përfshijnë shumë domene të funksionimit psikologjik dhe të sjelljes. Ato janë në mënyrë të shpeshtë, por jo gjithnjë, të shoqëruara me shkallë të ndryshme stresi dhe problemesh në performancën shoqërore.

## F60 Çrregullime specifike të personalitetit

Janë disa çrregullime në personalitetin dhe tendencat e sjelljes së individit; të rezultuara jo drejtpërdrejt për shkak të sëmundjeve, dëmtimeve ose insultit të trurit, apo nga çrregullim tjetër psikiatrike; përfshijnë zakonisht disa zona të personalitetit; pothuaj të tëra të shoqëruara me një stres personal të konsiderueshëm dhe shkëputje shoqërore; dhe zakonisht manifestohen që në femijëri ose adoleshencë dhe vazhdojnë në moshë të rritur.

### F60.0 Çrregullim paranojak i personalitetit

Çrregullime të personalitetit të karakterizuara me ndjeshmeri të rritur ndaj kujtimeve; mosfalje e poshtërimeve; dyshueshmëri e madhe dhe një tendence për të shtrembëruar veprimet neutrale dhe miqësore të të tjerëve, si veprime armiqësore dhe të qëllimshme; dyshime të vazhduara, pa justifikim, lidhur me besnikerinë seksuale të partnerit/es seksual/e ose bashkëshortit/es; dhe një natyrë luftarake dhe këmbëngulëse për të drejtat personale. Mund të ketë një vetëvlerësim të madh dhe shpesh mbështetje e rritur tek forcat e veta.

Personalitet (çrregullim):

- paranoid ekspansiv
- fanatik
- lehtësisht i prekshëm

- paranojak
- paranojak i ndjeshëm

***Përjashton:*** paranojën (F22.0)

paranojën e prekshme lehtë (F22.8)

paranoide:

- psikozën (F22.0)
- skizofrenine (F22.0)
- gjendjen (F22.0)

### F60.1 Çrregullim skizoid i personalitetit

Një çrregullim personaliteti i karakterizuar nga tërheqja nga kontaktet e ndjeshme, shoqërore e të tjera, me preferencë për fantazi, aktivitete të vetmuara dhe introspeksion. Ka një aftësi të kufizuar për të shprehur ndjenjat dhe përjetuar kënaqësi.

***Përjashton:*** sindromën Asperger (F84.5)

çrregullimin deluzional (F22.0)

çrregullimin skizoid të fëmijërisë (F84.5)

skizofreninë (F20.-)

çrregullimet skizotipike (F21)

### F60.2 Çrregullim dissocial i personalitetit

Çrregullime të personalitetit, që karakterizohen nga mospërfillje ndaj detyrimeve shoqërore dhe pandjeshmeri për ndjenjat e të tjereve. Ka një mospërputhje të madhe midis sjelljes dhe normave shoqërore. Sjellja nuk është lehtesisht e modifikueshme me eksperienca të ndryshme, përfshirë dhe ndëshkimin. Ka një tolerancë të ulur ndaj frustrimit dhe shkarkimit të agresionit, përfshirë dhunën; ka një tendencë për të fajësuar të tjerët, ose për të afruar racionalizime të pranueshme për sjelljen, që e shpien pacientin në përplasje me shoqërinë.

Personalitet (çrregullim):

- amoral
- antisocial
- asocial
- psikopatik
- sociopatik

***Përjashton:*** çrregullimet e sjelles (F91.-)

çrregulimet e personalitetit emocional të paqendrueshëm (F60.3)

### F60.3 Çrregullim i personalitetit emocionalisht i paqendrueshëm

Çrregullim i personalitetit, i karakterizuar nga një tendencë e përhershme për të vepruar në mënyrë impulsive dhe pa menduar për pasojat; humori është i paparashikueshëm dhe kapriçioz. Ka shpërthime emocionale dhe paaftësi për të kontrolluar shpërthimet emocionale. Ka një tendencë për sjellje të sherrshme dhe konfliktuale me të tjerët, sidomos kur aktet impulsive shmangen ose censurohen. Dy lloje mund të dallohen: lloji impulsiv, që ka kryesisht instabilitet emocional dhe

mungesë të kontrollit të impulseve, dhe lloji kufitar, që karakterizohet nga çrregullime të imazhit për veten, të qëllimeve dhe preferencave të brendshme, dhe një tendence për sjellje vetëshkatërruese që përfshin vetëvrasjen dhe tentativat e saj.

Personalitet (çrregullim):

- agresiv
- kufitar
- eksploziv

***Përjashton:*** çrregullimin dissocial të personalitetit (F60.2)

### F60.4 Çrregullim teatral (=histrionik) i personalitetit

Çrregullim i personalitetit, që karakterizohet nga ndjenja të cekëta dhe të paqendrueshme, vetëdramatizim, teatrikalitet, ekzagjerim i shprehjes së emocioneve, sugjestionim, egocentricitet, vetëkënaqësi, mungesë e konsideratës për të tjerët, prekje e lehtë, dhe kërkim i vazhduar i vlerësimit, eksitimit dhe vëmendjes.

Personalitet (çrregullim):

- histerik
- psikoinfantil

### F60.5 Çrregullim anankastik i personalitetit

Çrregullim i personalitetit, që karakterizohet nga ndjesia e dyshimit, perfeksionizmit, ndërgjegjshmërisë të tepruar, kontrollit dhe preokupimit për detajet, kokëfortësi, kujdes dhe ngrirje. Mund të ketë mendime këmbëngulëse dhe të pamirëpritura ose impulse që nuk arrijnë lartësinë e çrregullimeve obsesive-kompulsive.

Personalitet (çrregullim):

- kompulsiv
- obsesiv
- obsesiv-kompulsiv

***Përjashton:*** çrregullimet obsesive-kompulsive (F42.-)

### F60.6 Çrregullim anksioz (shmangës) i personalitetit

Çrregullim i personalitetit, që karakterizohet nga ndjesia e tensionit dhe ajo se diçka e keqe do ndodhë, pasiguri dhe inferioritet. Ka një dëshirë të vazhduar për të qenë i pëlqyer dhe i pranuar, një mbindjeshmëri ndaj mospranimit dhe kriticizmit, me kufizim të tërheqjeve personale, dhe një tendencë për të shmangur disa aktiviteteve të caktuara, me ekzagjerim të madh të rreziqeve potenciale ose dëmtimeve në situatat e përditshme.

### F60.7 Çrregullim dipendent i personalitetit

Çrregullim i personalitetit, që karakterizohet nga një vartësi pasive e vazhduar ndaj njerëzve të tjerë për të marrë vendime të mëdha ose të vogla; frikë e madhe ndaj braktisjes, ndjesi e paaftësisë dhe pafuqisë, përputhje pasive me dëshirat e me të mëdhenjve dhe të tjerëve, dhe një përgjigje e dobët ndaj kërkesave të jetës së përditshme. Mungesë fuqie mund të tregohet në çdo sferë intelektuale apo emocionale; ka një tendencë për të transferuar përgjegjësinë tek të tjerët.

Personalitet (çrregullim):

- astenik

- i papërshtatshëm
- pasiv
- vetësabotues

**F60.8 Të tjera çrregullime specifike të personalitetit**

Personalitet (çrregullim):

- ekscentrik
- i llojit 'haltlose'
- i papjekur
- narcistik'
- pasiv-agresiv
- psikoneurotik

**F60.9 Çrregullim personaliteti, i paspecifikuar**

Neurozë e karakterit NOS

Personalitet patologjik NOS

## F61 Çrregullime të tjera e të përziera të personalitetit

Kjo kategori është e planifikuar për çrregullimet e personalitetit që janë shpesh shqetesuese, por nuk shfaqin mënyrën specifike të çrregullimeve të përmendura në F60.-. Si rezultat, ato janë më shumë të vështira për t'u diagnostikuar se ato në F60.-.

Shembuj ilustrues:

- Çrregullime të personalitetit, të përziera me veçori të disa prej çrregullimeve në F60.-, por pa dominimin e grupit të simptomave që do të lejonin një diagnozë më specifike.
- Ndryshime problematike të personalitetit, të paklasifikuara në F60.- ose F62.-, dhe që vlerësohen si dytësore pas një diagnoze kryesore ose një çrregullimi ankthi ose afektivi ekzistues.

***Përjashton:*** personalitetin me natyrë të theksuar (Z73.1)

## F62 Ndryshime të qendrushmërisë së personalitetit, të palidhura me dëmtim dhe/ose sëmundje të trurit

Çrregullime të personalitetit të të rriturit dhe sjelljes, që janë zhvilluar në persona që nuk kanë çrregullime personaliteti të mëparshëm, që pasojnë ekspozim ndaj një stresi të madh të zgjatur ose katastrofi, ose që pasojnë një sëmundje psikiatrike të rëndë. Këto diagnoza duhet të vihen vetëm kur ka fakte të një ndryshimi përfundimtar dhe të qendrueshëm në një person, në mënyrën se si perceptohet ambienti dhe vetëvetja. Ndryshimi i personalitetit duhet të jetë sinjifikant dhe i shoqëruar me sjellje joflexibël dhe të keqpërshtatur, por jo më parë së eksperienca patogjenike. Ndryshimi nuk duhet të jetë një manifestim direkt i një çrregullimi tjetër mendor ose një simptomë reziduale e një çrregullimi mendor paraprirës.

***Përjashton:*** çrregullimet e personalitetit dhe sjelljes për shkak të sëmundjes, dëmtimit ose disfunksionit të trurit (F07.-)

### F62.0 Ndryshime të qendrushmërisë së personalitetit, pas një katastrofe

Një ndryshim i qendrueshëm personaliteti, i pranishëm për të paktën dy vjet, që pason ekspozimin ndaj një stresi katastrofik. Stresi duhet të jetë aq shumë ekstrem, sa të mos jetë i nevojshëm të konsiderohet vulnerabiliteti personal që të shpjegohet efekti i madh në personalitet. Çrregullimi karakterizohet nga një qendrim armiqësor dhe mosbesues ndaj botës, tërheqje shoqërore, ndjesi boshllëku dhe paaftësie, një ndjesi kronike e 'të qenit në teh' si të ishte i kërcënuar në mënyrë konstante, dhe jomiqësore në shoqëri. Çrregullimi i stresit post-traumatik (F43.1) mund ta paraprijë këtë lloj ndryshimi të personalitetit.

Ndryshim i personalitetit pas:

- eksperiencave në kampet e përqëndrimit
- katastrofave natyrore
- të tejzgjatura:
  - heqje lirie me një mundësi të menjëhershme për t'u vrarë
  - ekspozim ndaj situatave kërcënuese për jetën, si p.sh. viktimë e një akti terrorist
  - torturë

***Përjashton:*** çrregullimin e stresit post-traumatik (F43.1)

### F62.1 Ndryshime të qëndrushmërisë së personalitetit pas një sëmundje psiqike

Ndryshim personaliteti, që zgjat të paktën 2 vjet, që i atribuohet një eksperience traumatike të vuajtjes nga një sëmundje psikiatrike e rëndë. Ndryshimi nuk mund të shpjegohet nga një çrregullim i personalitetit të mëparshëm dhe duhet të dallohet nga skizofrenia reziduale dhe gjendje të tjera të mos-shërimit të plotë nga një çrregullim mendor i mëparshëm. Ky çrregullim karakterizohet nga një vartësi e shtuar dhe kerkesa maksimale ndaj të tjerëve; bindja se sëmundja e ka ndryshuar ose stigmatizuar, që çon në një paaftësi për të formuar dhe mbajtur marrëdhënie të besueshme dhe të afërta dhe në izolim shoqëror; pasivitet, interesa të ulura, dhe përfshirje të ulur në aktivitete që sjellin kënaqësi; ankesa permanente të të qenit 'sëmurë', që mund të shoqërohen me ankesa hipokondriake dhe sjellje të sëmurë, me disfori ose humor të luhatshëm, por jo për shkak të pranisë së çrregullimit mendor aktual ose çrregullimit mendor pararendës me simptoma afektive reziduale; si dhe probleme të pazgjidhura në funksionimin shoqëror dhe profesional.

### F62.8 Ndryshime të tjera të qëndrushmërisë së personalitetit

Sindroma e personalitetit me dhimbje kronike

### F62.9 Ndryshim i qendrushmërisë së personalitetit, i paspecifikuar

## F63 Çrregullime impulsive të sjelljes

Kjo kategori përfshin disa çrregullime të sjelljes që nuk janë të klasifikueshme nën kategoritë e tjera. Ato karakterizohen nga akte të përsëritura, që nuk kanë një motiv real të qartë, që nuk mund të kontrollohen, dhe që në përgjithësi dëmtojnë interesat e vetë pacientit dhe të personave të tjerë. Pacienti raporton që sjellja është e lidhur me impulset për të vepruar. Shkaku i këtyre çrregullimeve nuk kuptohet mirë dhe ato

grupohen së bashku për shkak të ngjashmerive përshkuese të përgjithshme, por jo sepse ato ndajnë veçori kryesore të njëjta.

***Përjashton:*** përdorimin e tepruar i alkoolit ose substancave psikoaktive (F10-F19)

çrregullime të sjelljes dhe impulse që prekin sjelljen seksuale (F65.-)

### F63.0 Dëshirë patologjike për të rrezikuar në kumar (bixhoz)

Çrregullimi përbëhet nga episode të përsëritura të shpeshta të angazhimit në kumar, që dominojnë jetën e pacientit dhe çojnë në përkeqësim të vlerave dhe angazhimeve shoqërore, profesionale, materiale dhe familjare.

Angazhimi kompulsiv në kumar

***Përjashton:*** bixhozin e tepruar nga pacientë maniakë (F30.-)

bixhozin dhe bastet NOS (Z72.6)

bixhozin në çrregullimin e personalitetit dissocial (F60.2)

### F63.1 Piromani (dëshirë patologjike për zjarrvënie)

Ky çrregullim karakterizohet nga akte të shumta, përpjekje, për t'i vënë zjarrin pronës ose objekteve të tjera, pa një motiv të dukshëm, dhe nga një preokupim i vazhduar me subjekte të lidhura me zjarrin dhe djegien. Kjo sjellje shpesh shoqërohet me ndjenja të rritjes së tensionit para aktit, dhe me eksitim intens menjëherë pas tij.

***Përjashton:*** Zjarrvënia (nga)(në)

- të rritur me çrregullim personaliteti dissocial (F62.0)
- intoksikimi me alkool dhe substanca psikoaktive (F10F19, me karakter të përbashkët të katërt .0)
- si një arsye për observimin e çrregullimit mendor të dyshuar (Z03.2)
- çrregullimet e sjelljes (F91.-)
- çrregullimet mendore organike (F00-F09)
- skizofrenia (F20.-)

### F63.2 Kleptomani (vjedhje patologjike)

Çrregullim, që karakterizohet nga dështim i përsëritur për t'i rezistuar impulseve për të vjedhur objekte që nuk  përbëjnë një perfitim personal ose monetar. Këto objekte mund të përdoren më pas për t'u hedhur, falur ose grumbulluar. Kjo sjellje shoqërohet zakonisht me një tension para, dhe një ndjesi kënaqjeje gjatë dhe menjëherë pas aktit.

***Përjashton:*** çrregullimet depresive me vjedhje (F31-F33)

çrregullimet mendore organike (F00-F09)

vjedhjet në dyqane si një arsye për observimin e çrregullimit mendor të dyshuar (Z03.2)

### F63.3 Trichotillomania (=Trikotilomani)

Një çrregullim i karakterizuar nga humbje leshrash për shkak të dështimit për t'i rezistuar impulsit të shkuljes së leshrave. Shkulja e leshrave zakonisht paraprihet nga

një tension i rritur dhe pasohet nga një sens çlirimi ose kënaqësie. Diagnoza nuk duhet të vihet nëse ka një inflamacion ekzistues të lëkurës, ose nëse shkulja e leshrave është si përgjigje ndaj deluzioneve ose haluçinacioneve.

***Përjashton:*** çrregullimin e levizes stereotipike me shkulje leshrash (F98.4)

### F63.8 Çrregullime të tjera impulsive të zakoneve

Të tjera sjellje keqpërshtatjeje të përsëritura dhe të vazhdueshme, që nuk janë si pasojë e një sindrome psikiatrike të njohur dhe në të cilën duket që pacienti në mënyrë të përsëritur po dështon t'u rezistojë impulseve për të kryer sjelljen. Ka një periudhë prodromale tensioni, me një ndjesi çlirimi në kohën e kryerjes së aktit.

Çrregullime eksplozive të herëpashershme

### F63.9 Çrregullim impulsiv i zakoneve, i paspecifikuar

## F64 Çrregullime të identitetit të gjinisë

### F64.0 Transseksualizëm

Një dëshirë për të jetuar dhe qenë i pranuar si anëtar i seksit të kundërt, zakonisht i shoqëruar nga një ndjesi parehatie, ose papërshtatshmërie me seksin e vet, dhe një dëshirë për të bërë një kirurgji dhe trajtim hormonal që ta bëjë trupin e vet të pajtueshëm me seksin e vet të preferuar.

### F64.1 Transvestizëm me rol të dyzuar

Veshja e rrobave të seksit të kundërt për një kohë të ekzistences së individit, me qëllim për të shijuar, si një eksperiencë e përkohshme, anëtarësinë tek seksi tjetër, por pa dëshirë për ndryshim përfundimtar të seksit ose kirurgji për përcaktimin e seksit, dhe pa eksitimin seksual në veshjen e rrobave të seksit të kundërt.

Çrregullime të identitetit të gjinisë të adoleshences ose të të rriturit, lloji jotransseksual

***Përjashton:*** transvestizmin fetishist (F65.1)

### F64.2 Çrregullim i identitetit të seksit i fëmijërisë

Një çrregullim, që zakonisht del në fillim në fëmijërinë e hershme (gjithnjë para pubertetit), që karakterizohet nga një stres i vazhduar dhe intens lidhur me seksin që ka, së bashku me dëshirën për të qenë (ose insistimin që është) i seksit tjetër. Ka një preokupim të vazhduar me veshjen dhe aktivitetet e seksit tjetër dhe mospëlqimin e seksit të vet. Diagnoza kërkon një çrregullim të thellë të identitetit të gjinisë normale; thjesht sjelljet prej djali tek vajzat e reja dhe sjelljet si vajzë tek djemtë e rinj nuk janë të mjaftueshme. Çrregullimet e identitetit të gjinisë në individë që e kanë arritur ose kanë hyrë në pubertet nuk duhet të klasifikohen këtu, por në F66.-.

***Përjashton:*** orientimin seksual egodistonik (F66.1)

çrregullimin e maturimit seksual (F66.0)

### F64.8 Çrregullime të tjera të identitetit të seksit

### F64.9 Çrregullim i identitetit të seksit, i paspecifikuar

Çrregullim i rolit të gjinise NOS

## F65 Çrregullime të preferencës seksuale

***Përfshin:*** parafilitë

### F65.0 Fetishizëm

Varësia mbi një objekt jo të gjallë si një stimul për eksitim dhe kënaqesi seksuale. Shumë fetishizma janë si zgjatje e trupit të njeriut, si veshje ose mbathje. Shembuj të tjerë janë ata që kanë një përbërje të caktuar si gomë, plastikë ose lekurë. Objektet e fetishit ndyshojnë në rëndësinë që kanë për individin. Në disa raste, ato thjesht shërbejnë për të rritur kënaqësitë seksuale në mënyra të ndryshme (p.sh. kur partneri vishet me një veshje të caktuar).

### F65.1 Transvestizëm i fetishizuar

Veshja e rrobave të seksit të kundert kryesisht për të shkaktuar eksitim seksual dhe për të krijuar pamjen e një personi të seksit të kundërt. Transvestizmi i fetishizuar dallohet nga transvestizmi transseksual nga lidhja e tij e qartë me eksitimin seksual dhe dëshirën për të hequr rrobat pas arritjes së orgazmës dhe uljes së eksitimit seksual. Gjithashtu mund të ndodhë në një fazë me të hershme të zhvillimit të transseksualizmit.

Fetishizmi transvestik

### F65.2 Ekzibicionizëm

Një tendencë e përsëritur dhe e vazhduar për t'ua treguar organet gjenitale personave të panjohur (zakonisht të seksit të kundërt) ose njerëzve në vende publike, pa i ftuar ose dëshiruar kontakt më të afërt. Ka zakonisht, por jo në mënyrë të pandryshuar, eksitim seksual në kohën e ekspozimit dhe akti pasohet me masturbim.

### F65.3 Voyeurizëm

Një tendencë e përsëritur dhe e vazhdueshme për të parë njerëzit që angazhohen në akte seksuale ose intime (si zhveshja). Kur kjo ndodh, njerëzit që vëzhgohen nuk janë të ndërgjegjshëm për këtë, dhe zakonisht çon në eksitim seksual dhe masturbim.

### F65.4 Pedofili

Një preference seksuale për fëmijë, djem dhe vajza ose të dy, zakonisht të moshës prepubertale ose pubertale të hershme.

### F65.5 Sadomazokizëm

Një preference për aktivitet seksual, që përfshin shkaktimin e dhimbjes dhe poshtërimit. Nëse subjekti preferon të jetë pritës i një stimuli të tillë quhet mazokizëm; nëse është shkaktues quhet sadizëm. Shpesh individi merr eksitim seksual si nga sadizmi ashtu dhe mazokizmi.

Mazokizëm

Sadizëm

### F65.6 Çrregullime multiple të preferencës seksuale

Një seri sjelljesh me preferencë dhe aktivitet seksual në një person ku asnjë nga ato nuk është e para. Kombinimi me i shpeshtë është fetishizmi, transvestizmi dhe sadomazokizmi.

### F65.8 Çrregullime të tjera të preferencës seksuale

Një seri aktivitetesh dhe preferencash seksuale, që përfshijnë bërje e telefonave me fjalë të pista, fërkimi ndaj njerëzve për të arritur stimulim seksual në vende publike dhe të mbipopulluara, aktivitet seksual me kafshë, dhe përdorimi i mbytjes me duar në fytin e partnerit/es seksual/e apo anoksisë për rritjen e eksitimit seksual.

Frotteurism

Nekrofilia

### F65.9 Çrregullim i preferencës seksuale, i paspecifikuar

Deviacion seksual NOS

## F66 Çrregullime psikologjike dhe të sjelljes të lidhura me zhvillimin dhe orientimin seksual

***Shënim:*** Orientimi seksual në vetvete nuk mund të konsiderohet si çrregullim.

### F66.0 Çrregullim i pjekurisë seksuale

Pacienti vuan nga një pasiguri lidhur me gjininë e vet ose orientimin seksual, gjë që shkakton ankth dhe depresion. Me së shumti kjo ndodh tek adoleshentët që nuk janë të qartë nëse janë homoseksualë, heteroseksualë ose biseksualë (shpesh në një marrëdhënie të gjatë), të cilët vënë re që orientimi i tyre seksual po ndryshon.

### F66.1 Orientim seksual egodistonik

Identiteti i gjinisë ose preferenca seksuale (heteroseksual, homoseksual, biseksual ose prepubertal) nuk është në dyshim, por individi dëshiron të ishte ndryshe për shkak të çrregullimeve të sjelljes dhe psikologjike, dhe mund të kërkojë ndihmë për ta ndryshuar atë.

### F66.2 Çrregullim i marrëdhënieve seksuale

Identiteti i gjinisë ose preferenca seksuale (heteroseksual, homoseksual, biseksual) është përgjegjës për vështirësitë në formimin dhe mbajtjen e një marrëdhënie me partnerin seksual.

### F66.8 Çrregullime të tjera të zhvillimit psikosocial

### F66.9 Çrregullim i zhvillimit psikosocial, i paspecifikuar

## F68 Çrregullime të tjera të personalitetit dhe të sjelljes së të rriturve

### F68.0 Përpunimi i simptomave fizike për motive psikologjike

Simptomat fizike të përputhshme me dhe origjinalisht nga një çrregullim fizik të konfirmuar, sëmundje ose paaftësi, bëhen të ekzagjeruara dhe të tejzgjatura, për shkak të gjendjes psikologjike të pacientit. Pacienti është i stresuar nga dhembja ose nga paaftësia, dhe është i preokupuar me shqetësime, të cilat mund të jenë të justifikuara, mbi mundësinë e tejzgjatjes së dhimbjes ose paaftësisë progresive.

Neuroza e kompensimit

**F68.1** **Prodhim i qëllimshëm ose simulim i simptomave ose i pamundësive fizike apo psikologjike [çrregullim artificial]**

Pacienti i simulon simptomat në mënyrë të përsëritur për asnjë arsye reale dhe mund edhe të vetëdëmtohet me qëllim që të prodhoje shenja ose simptoma. Motivimi është i paqartë dhe mendohet i brendshëm me qëllimin e luajtjes së rolit të të sëmurit. Çrregullimi kombinohet shpesh me çrregullime të mëdha të personalitetit dhe marrëdhënieve.

Sindroma e vizituesit të spitaleve

Sindroma Münchausen

Pacienti peregrinues

***Përjashton:*** dermatitin fakticial (L98.1)

personat që shtiren si të sëmurë (me motivim të qartë) (Z76.5)

**F68.8** **Çrregullim tjetër i personalitetit dhe i sjelljes së moshës madhore**

Çrregullimet e karakterit NOS

Çrregullimet e marrëdhënies NOS

**F69** **Çrregullim i paspecifikuar i personalitetit dhe sjelljes së të rriturve**

# Prapambetje e zhvillimit mendor (F70–F79)

Një gjendje e zhvillimit të paplotë ose të ndaluar të mendjes, që karakterizohet në mënyrë të veçantë nga perkeqësimi i aftësive të manifestuara gjatë periudhës së zhvillimit, aftësi të cilat kontribuojnë në nivelin e përgjithshëm të inteligjencës, psh. aftësive konjitive, të gjuhës, motore dhe shoqërore. Prapambetja mund të ndodhë me ose pa gjendje fizike ose mendore të tjera.

Shkallët e prapambetjes mendore vlerësohen me testet e standardizuara të inteligjencës. Këto mund të shtohen me shkallë që masin adoptimin shoqëror në një mjedis të caktuar. Këto masa sigurojnë një përafrim tek shkalla e prapambetjes mendore. Diagnoza do të varet nga vlerësimi i përgjithshëm i funksionimit intelektual nga një diagnostikues i aftë.

Aftësitë intelektuale dhe përshtatja shoqërore mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, dhe, megjithëse të varfëra, mund të përmirësohen si rezultat i trajnimit ose rehabilitimit. Diagnoza duhet të bazohet në nivelet aktuale të funksionimit.

Përdorni kodet shtesë, nëse dëshironi, për të identifikuar gjendje si autizmi, ose çrregullime të zhvillimit, epilepsinë ose handikapet fizikë të rënduar.

Në vijim janë nën-ndarjet e karakterit të katërt, që përdoren në kategoritë F70-F79 për të identifikuar shtrirjen e dëmtimit të sjelljes:

**.0** **me përcaktimin e asnjë çrregullimi, ose çrregullim minimal të sjelljes**

**.1** **çrregullim i konsiderueshëm i sjelljes që kërkon vëmendje dhe trajtim**

**.8 çrregullime të tjera të sjelljes**

**.9 pa përmendur çrregullim të sjelljes**

## F70 Prapambetje e lehtë e zhvillimit mendor

[shih para F70 për nën-ndarjet]

Intervali i Koeficientit të Inteligjencës (KI) është 50-69 (tek të rriturit, mosha mendore (=mentale) nga 9 deri nën 12 vjeç). Ka gjasa që të kenë vështirësi në shkollë. Shumë të rritur mund të punojnë dhe të ruajnë një marrëdhënie të mirë shoqërore dhe të kontribuojnë në shoqëri.

***Përfshin:*** mendje-dobëtit

nën-normalitet mendor i lehtë

## F71 Prapambetje e moderuar e zhvillimit mendor

[shih para F70 për nën-ndarjet]

Intervali i Koeficientit të Inteligjencës është 35-49 (tek të rriturit, mosha mendore (=mentale) nga 6 deri nën 9 vjeç). Ka gjasa që të kenë vonesa të mëdha në fëmijëri, por shumica arrijnë të mësojnë të zhvillojnë një farë pavarësie në kujdesin për veten dhe aftësi të mira komunikimi dhe akademie. Të rriturve do t'u nevojitet një ndihmë për të jetuar dhe punuar në shoqëri.

***Përfshin:*** nën-normalitet mendor të moderuar

## F72 Prapambetje e theksuar e zhvillimit mendor

[shih para F70 për nën-ndarjet]

Intervali i Koeficientit të Inteligjences është 20-34 (tek të rriturit, mosha mendore (=mentale) nga 3 deri nën 6 vjeç). Ka gjasa të kërkojnë një mbështetje të vazhdueshme.

***Përfshin:*** nën-normalitet mendor të rëndë

## F73 Prapambetje e thellë e zhvillimit mendor

[shih para F70 për nën-ndarjet]

Intervali i Koeficientit të Inteligjences është nën 20 (tek të rriturit, mosha mendore (=mentale) nën 3vjeç). Rezulton në kufizime të rënda në kujdesin për veten, nevojat, komunikimin dhe lëvizshmërinë.

***Përfshin:*** nën-normalitet mendor të thellë

## F78 Prapambetje tjetër e zhvillimit mendor

[shih para F70 për nën-ndarjet]

## F79 Prapambetje e zhvillimit mendor, e paspecifikuar

[shih para F70 për nën-ndarjet]

***Përfshin:*** mendor/e:

- defiçiencën NOS
- nën-normalitetin

# Çrregullime të zhvillimit psikologjik (F80–F89)

Këto çrregullime, të perfshira në këtë bllok, kanë të përbashkët: (a) fillimin gjithnjë tek fëmijëria e hershme; (b) çrregullim ose vonesë të zhvillimit të funksioneve që janë të lidhura me maturimin biologjik të sistemit nervor qendror; dhe (c) një ecuri e qendrueshme pa përmirësime dhe përsëritje. Në shumicën e rasteve, funksionet e prekura përfshijnë gjuhën, aftësitë vizive dhe spaciale dhe koordinimin motor. Zakonisht, vonesa ose çrregullimi ka qenë i pranishëm që nga kur të mund të kapej dhe do të zvogëlohet me kalimin e kohës dhe me rritjen e fëmijës, ndonëse defiçite më të buta shpesh ngelen dhe në moshë madhore.

## F80 Çrregullim zhvillimor specifik i të folurit dhe i gjuhës

Çrregullime, në të cilat modelet normale të zotërimit të gjuhës janë të çrregulluara që në fazat e hershme të zhvillimit. Gjendjet nuk i atribuohen direkt anormaliteteve neurologjike ose mekanizmit të ligjëratës, çrregullimeve të shqisave, prapambetjes mendore apo faktorëve ambientale. Çrregullime specifike të zhvillimit të ligjëratës dhe gjuhes ndiqen shpesh nga probleme të lidhura me to, si vështirësi në lexim dhe gërmëzim, anomali në marrëdhëniet personale, emocionale dhe të sjelljes.

### F80.0 Çrregullim specifik i artikulimit të të folurit

Një çrregullim specifik i zhvillimit, në të cilin përdorimi nga fëmija i tingujve të ligjëratës është nën nivelin e duhur për moshën mendore, por që ruhet një nivel normal i gjuhës.

Zhvillimore:

- çrregullime fonetike
- çrregullime të artikulimit të ligjëratës

Dislali

Çrregullim i artikulimit të ligjërates funksionale

Lalling-u (=Lalimi)

***Përjashton:*** çrregullimet e artikulimit të ligjëratës (për shkak të):

- afazisë NOS (R47.0)
- apraksisë (R48.2)
- humbjes së dëgjimit (H90-H91)
- me çrregullim të zhvillimi të gjuhës:
  - ekspresiv (F80.1)

- receptiv (F80.2)

## F80.1 Çrregullim gjuhësor ekspresiv

Një çrregullim zhvillimor, në të cilin aftësia e fëmijës për të përdorur gjuhë të folur shprehëse është shumë nën nivelin e duhur për moshën mendore, por në të cilin kuptimi i gjuhës është brenda kufinjve normalë. Mund të ketë ose jo anomali në artikulim.

Disfazi ose afazi zhvillimore, lloji ekspresiv

***Përjashton:*** afazinë e fituar me epilepsi [Laundau-Kleffner] (F80.3)

disfazinë ose afazinë:

- NOS (R47.0)
- zhvillimore, lloji receptiv (F80.2)

mutizmin elektiv (F94.0)

prapambetjen mendore (F70-F79)

çrregullimet zhvillimore pervazive (F84.-)

## F80.2 Çrregullim gjuhësor receptiv

Një çrregullim zhvillimor specifik, në të cilin kuptimi i gjuhës së fëmijës është nën nivelin e duhur për moshën mendore. Pothuaj në të gjitha rastet, gjuha ekspresive do të jetë e prekur dhe anomalitë në shqiptimin e tingujve-fjalëve janë të pranishme.

Mosperceptimi auditor i lindur

Zhvillimor:

- disfazi ose afazi, lloji receptiv
- afazia Wernicke

Shurdhëri e fjalës

***Përjashton:*** afazinë e fituar me epilepsi

autizmin (F84.0-F84.1)

disfazinë dhe afazinë:

- NOS (R47.0)
- zhvillimore, lloji ekspresiv (F80.1)

mutizmin elektiv (F94.0)

vonesën e gjuhës për shkak të shurdhërisë (H90-H91)

prapambetjen mendore (F70-F79)

## F80.3 Afazi e fituar me epilepsi (Landau-Kleffner)

Një çrregullim, në të cilin fëmija, që ka pasur me parë një progres normal të zhvillimit të gjuhës, humbet si aftësitë receptive ashtu dhe ato ekspresive, por mban inteligjencën e përgjithshme; fillimi shoqërohet me anormalitete paroksizmale në EEG, dhe në shumicën e rasteve edhe nga kriza epileptike. Zakonisht fillimi i çrregullimit është midis 3 dhe 7 vjeç, me aftësitë që humben brenda pak ditësh ose javësh. Lidhja e përkohshme midis fillimit të krizave dhe humbjes së gjuhës është e ndryshueshme, me njerën që i paraprin tjetrës me nga pak muaj deri në 2 vjet. Një proces encefaliti inflamator është sugjeruar si një shkak i mundshëm i këtij deficiti. Rreth dy të tretat (2/3) e pacientëve mbeten me një deficit receptiv të gjuhës pak a shumë të rëndë.

***Përjashton:*** afazinë (nga):

- NOS (R47.0)
- autizmi (F84.0-F84.1)
- çrregullimet disintegrative të fëmijërisë (F84.2-F84.3)

### F80.8 Çrregullim tjetër zhvillimor i të folurit e i gjuhës

Thuthuqët

### F80.9 Çrregullim zhvillimor i të folurit e i gjuhës, i paspecifikuar

Çrregullimet e gjuhës NOS

## F81 Çrregullime zhvillimore specifike të aftësive skolastike

Çrregullime, të cilat modelet normale të marrjes së aftësive janë të çrregulluara që në fazat e hershme të zhvillimit. Kjo nuk është thjesht si një pasojë e mungesës së mundësisë për të mësuar, nuk është vetëm një rezultat i prapambetjes mendore, dhe nuk është për shkak të asnjë forme traume ose sëmundje të trurit.

### F81.0 Çrregullim specifik i të lexuarit

Veçoria kryesore është një çrregullim i dukshëm në zhvillimin e aftësive të leximit, që nuk është vetëm i dukshëm në krahasim me moshën mendore, probleme të mprehtësisë së shikimit ose shkollimin. Aftësitë e kuptimit të leximit, njohja e fjalës së lexuar, aftësitë e leximit oral dhe kryerjes së detyrave që kërkojnë lexim janë të gjitha të prekura. Vështirësitë në gërmëzim shoqërohen me vështirësi në të lexuar dhe këto mbeten deri në adoleshencë, edhe pas një farë progresi në lexim. Çrregullime specifike të zhvillimit të leximit shpesh paraprihen prej një çrregullimi të zhvillimit të ligjëratës ose të gjuhës. Çrregullime shtesë emocionale ose të sjelljes janë të zakonshme në periudhën e moshës shkollore.

'Leximi mbrapsht'

Disleksia zhvillimore

Prapambetja specifike e leximit

***Përjashton:*** aleksinë NOS (R48.0)

disleksinë (R48.0)

probleme në lexim si pasojë e çrregullimeve emocionale (F93.-)

### F81.1 Çrregullim specifik i shqiptimit të tingujve

Veçoria kryesore është çrregullimi i dukshëm dhe specifik në zhvillimin e aftësive të gërmëzimit, në mungesë të një historie të çrregullimeve specifike të leximit, i cili nuk shpjegohet vetëm nga mosha e ulët mendore, por dhe nga probleme me mprehtësinë e shikimit dhe probleme në shkolle. Aftësitë për të gërmëzuar me gojë dhe shkrimi korrekt i fjalëve janë të dyja të prekura.

Prapambetja specifike e gërmëzimit (R48.8)

***Përjashton:*** agrafinë NOS (48.8)

vështirësi në gërmëzim:

- të lidhura me çrregullime të leximit (F81.0)
- të lidhura me mësim-dhënien jo të duhur (Z55.8)

### F81.2 Çrregullim specifik i aftësive aritmetike

Përfshin një çrregullim specifik të aftësive aritmetikore, që nuk shpjegohet vetëm me prapambetjen mendore të përgjithshme ose me problemet në shkollë. Defiçiti ka të bëjë më shumë me zotërimin e aftësive bazë të përllogaritjes – mbledhjen, zbritjen, shumëzimin, pjestimin, sesa me ndonjë nga aftësitë më abstrakte në algjebër, trigonometri, gjeometri ose kalkulus.

Zhvillimor/e:

- akalkulia
- çrregullim aritmetikor
- sindroma Gerstmann

***Përjashton:*** akalkulinë NOS (R48.8)

vështirësi në aritmetikë:

- të shoqëruara me çrregullime leximi ose gërmëzimi (F81.3)
- për shkak të mësim-dhënies jo të duhur (Z55.8)

### F81.3 Çrregullim i përzier i aftësive skolastike

Një kategori reziduale e keqpërcaktuar, në të cilën si aftësitë e leximit ashtu dhe ato të aritmetikës ose të gërmëzimit janë të prekura shumë, por ku çrregullimi nuk është i shpjegueshëm vetëm nga prapambetja e madhe mendore e përgjithshme ose nga problemet në shkollë. Duhet përdorur për çrregullimet që plotësojne kriteret si të F81.2 dhe të F81.0 ose të F81.1.

***Përjashton:*** specifik/e:

- çrregullimet e aftësive aritmetike (F81.2)
- çrregullimet e leximit (F81.0)
- çrregullimet e gërmëzimit (F81.1)

### F81.8 Çrregullime të tjera zhvillimore të aftësive skolastike

Çrregullime të shkrimit ekspresiv zhvillimor

### F81.9 Çrregullim zhvillimor i aftësive skolastike, i paspecifikuar

Paaftësi për marrjen e njohurive NOS

I/E të mësuarit:

- paaftësia NOS
- çrregullimi NOS

## F82 Çrregullim zhvillimor specifik i funksionit motor

Një çrregullim, në të cilin veçoria kryesore është një prekje e zhvillimit të koordinimit motor, që nuk shpjegohet vetëm me prapambetjen e përgjithshme intelektuale ose ndonjë çrregullimi neurologjik të fituar apo të lindur. Megjithatë, në shumicën e rasteve, një ekzaminim klinik i kujdesshëm tregon papjekuri neurozhvillimore, si lëvizje koreiforme të gjymtyrëve të pambështetura dhe veçori të tjera motore, si dhe shenja të prekjes së koordinimit motor të madh dhe atij fin.

***Përfshin:*** sindromën e fëmijës së ngathët zhvillimor/e:

- çrregullimin e koordinimit
- dispraksinë

***Përjashton:*** anomalitë e ecjes dhe lëvizshmërisë (R26.-)

mungesën e koordinimit (R27.-)

mungesën e koordinimit

- sekondare, për shkak të prapambetjes mendore (F70-F79)

## F83 Çrregullime zhvillimore specifike të përziera

Një kategori reziduale, në të cilën ka një përzierje të çrregullimeve specifike zhvillimore të gjuhës, aftësive skolastike, dhe funksioneve motore, por ku asnjë prej tyre nuk është dominante mjaftueshëm që të jetë diagnoza e parë. Kjo kategori mikste duhet të përdoret vetëm kur të ketë një mbivendosje të madhe midis secilës prej këtyre çrregullimeve. Çrregullimet janë zakonisht, por jo gjithnjë, të shoqëruara me disa prekje të funksioneve konjitive. Kështu, kjo kategori duhet të përdoret vetëm kur ka çrregullime që prekin dy ose me shumë nga F80.-, F81.- dhe F82.

## F84 Çrregullime zhvillimore difuze

Një grup çrregullimesh, që karakterizohen nga anomali në ndërveprimet reciproke shoqërore dhe në modelet e komunikimit, dhe nga një repertor i kufizuar, stereotipik, interesash dhe aktivitetesh. Këto anomali cilësore janë një veçori e përhapur në funksionimin individual në të gjitha situatat.

Përdorni kodin shtesë, nëse dëshirohet, për të identifikuar ndonjë gjendje mjekësore të lidhur me të dhe prapambetjen mendore.

### F84.0 Autizëm i fëmijërisë

Një çrregullim zhvillimor i vazhduar, që percaktohet nga: (a) prania e një zhvillimi të vonuar që manifestohet para moshës 3 vjeç, dhe (b) një karakteristikë funksionimi anormal në të tre zonat e psikopatologjisë: ndërveprimi shoqëror reciprok, komunikimi dhe një sjellje e kufizuar stereotipike e përsëritur. Si shtesë e këtyre veçorive diagnostike, janë të pranishme një sërë problemesh të tjera jospecifike, si fobitë, çrregullime të ngrënies dhe të fjetjes, shpërthime temperamentale dhe agresion (i drejtuar nga vetja).

Çrregullim autistik

Infantil:

- autizem
- psikozë

Sindroma Kanner

***Përjashton:*** psikopatinë autistike (F84.5)

### F84.1 Autizëm atipik

Një lloj çrregullimi zhvillimor i vazhduar, që ndryshon nga autizmi i fëmijërisë ose nga mosha e shfaqjes ose në dështimin për të përmbushur të tre kriteret diagnostike. Kjo nën-kategori duhet të përdoret kur ka një zhvillim anormal, që është i pranishëm pas moshës 3 vjeçare, dhe ka një anomali që nuk demonstrohet mjaftueshëm në një ose dy zonat e psikopatologjisë që kerkohen për diagnozën e autizmit (d.m.th. ndërveprimi shoqëror reciprok, komunikimi, dhe një sjellje e kufizuar stereotipike e përsëritur) pavarësisht karakteristikave anormale në zonat e tjera. Autizmi atipik ngrihet më së shumti në individët e prapambetur, individët me një çrregullim zhvillimor specifik të rëndë dhe individë me çrregullim zhvillimor specifik të gjuhës receptive.

Psikoza atipike e fëmijërisë

Prapambetje mendore me veçori autistike

Përdorni kodet shtesë (F70-F79), nëse dëshirohet, për të treguar prapambetjen mendore.

### F84.2 Sindromi i Rett

Një gjendje, deri tani e hasur tek vajzat, në të cilën një zhvillim i hershëm, në dukje normal, pasohet nga humbje e plotë ose e pjeshme e të folurit dhe aftësive lokomotore dhe përdorim të duarve, së bashku me ndalim të rritjes së kokës, me fillimin zakonisht në moshën nga 7 deri 24 muaj. Ka një humbje të lëvizjeve të qëllimta të duarve, lëvizje stereotipike të tyre, dhe hiperventilim. Zhvillimi shoqëror dhe loja janë të ndaluara, por interesi shoqëror duket i ruajtur. Ataksia dhe apraksia e trungut fillon të zhvillohet rreth moshës 4 vjeç dhe lëvizjet koreoathetoide pasojnë shumë shpejt. Prapambetja e thellë mendore është një rezultat i pashmangshëm.

### F84.3 Çrregullim tjetër dezintegrues i fëmijërisë

Një çrregullim zhvillimor i qendrueshëm, që përcaktohet nga një periudhë zhvillimi tërësisht normal para fillimit të çrregullimit, pasuar me një humbje të zhvillimit të bërë në disa fusha zhvillimore në harkun e pak muajve. Kjo shoqërohet me një humbje të përgjithshme interesi ndaj ambientit, me manierizma motore të përsëritura stereotipike, dhe nga anomali autistike në ndërveprimin shoqëror dhe komunikim. Në disa raste, çrregullimi mund të tregohet se vjen për shkak të ndonjë encefalopatie shoqëruese, por diagnoza duhet të vihet mbi veçoritë e sjelljes.

Demencia infantile

Psikozë disintegrative

Sindroma Heller

Psikoza simbiotike

Përdorni kode shtesë, nëse dëshirohet, për të identifikuar gjendjen neurologjike shoqëruese.

***Përjashton:*** sindromën Rett (F84.2)

### F84.4 Çrregullim me superaktivitet, i shoqëruar me prapambetje të zhvillimit mendor dhe lëvizje stereotipike

Një çrregullim i keqpërcaktuar, me një vlefshmëri nozologjike të paqartë. Kategoria është menduar për një grup fëmijësh me prapambetje të rëndë mendore (KI nën 35), që shfaqin probleme të mëdha në hiperaktivitet dhe në vëmendje, si dhe sjellje stereotipike. Ata duket se nuk përfitojnë nga barnat stimuluese (si përkundër ata me KI normal) dhe mund të shfaqin një reaksion disforik të rëndë (disa herë me prapambetje psikomotore) kur u jepen stimulantë. Në adoleshencë, rritja e aktivitetit

zëvendësohet me një ulje të tij (një model që nuk është i zakontë në fëmijë hiperkinetikë me inteligjencë normale). Ky sindrom shpesh shoqërohet me një sërë vonesash në zhvillim, qoftë specifike qoftë globale. Gjania e shtrirjes, se deri ku ky model sjelljeje është një funksion i KI të ulët ose i një dëmtimi organik të trurit, nuk është e njohur.

### F84.5 Sindroma Asperger

Një çrregullim me vlefshmëri nozologjike të paqartë, që karakterizohet nga anomali cilësore të të njëjtit tip, si ndërveprimi shoqëror reciprok i autizmit, së bashku me një repertor të kufizuar dhe përsërites interesash dhe aktivitetesh. Ndryshon nga autizmi primar nga fakti që nuk ka vonesë të përgjithshme ose prapambetje në gjuhë apo zhvillim konjitiv. Ky çrregullim shoqërohet shpesh me ngathtësi të dukshme. Ka një tendencë të fortë që anomalitë të vazhdojnë deri në adoleshencë ose moshë të rritur. Episodet psikotike zakonisht ndodhin në fillim të moshës së rritur.

Psikopatia autistike

Çrregullimi skizoid i fëmijerisë

### F84.8 Çrregullime të tjera zhvillimore pervasive

### F84.9 Çrregullim zhvillimor pervasiv, i paspecifikuar

## F88 Çrregullime të tjera të zhvillimit psikologjik

***Përfshin:*** agnozinë zhvillimore

## F89 Çrregullim i paspecifikuar i zhvillimit psikologjik

***Përfshin:*** çrregullime zhvillimore NOS

# Çrregullime të sjelljes dhe emocionale që shfaqen zakonisht në fëmijëri dhe në adoleshencë (F90–F98)

## F90 Çrregullime hiperkinetike

Një grup çrregullimesh, që karakterizohen nga një fillim i hershëm (zakonisht në 5 vitet e para të jetës), mungesë të vazhdueshmërisë në aktivitete që kërkojnë përfshirje konjitive, dhe një tendencë për të lëvizur nga një aktivitet në një tjetër, pa i mbaruar ato me parë, së bashku me një aktivitet të çorganizuar, të keqrregulluar dhe të tepërt. Shumë anomali të tjera janë shoqëruese. Fëmijët hiperaktive janë shpesh të pakujdesshem, impulsivë ose të prirur për aksidente, dhe shpesh bien pre e problemeve të disiplinës për shkak të shkeljes së pamenduar të rregullave sesa të shkeljes së tyre të qëllimtë. Marrëdhënia e tyre me të rriturit është e shpenguar, me një mungesë kujdesi dhe rezerve. Ata janë jopopullorë me fëmijët e tjerë dhe mund të bëhen të izoluar. Prekja e funksioneve konjitive nuk është e shpeshtë; vonesat në zhvillimin motor dhe të gjuhës janë të shpeshta në mënyrë joproporcionale.

Komplikacionet sekondare përfshijnë ato të sjelljes dissociale dhe të vetvlerësimit të ulur.

***Përjashton:*** çrregullimet e ankthit (F41.-)

çrregullimet e humorit [afektive] (F30-F39)

çrregullimet zhvillimore të vazhduara (F84.-)

skizofreninë (F20.-)

### F90.0 Çrregullim i aktivitetit dhe i vëmendjes

Defiçite të vëmendjes:

- çrregullim me hiperaktivitet
- çrregullim hiperaktiviteti
- sindroma me hiperaktivitet

***Përjashton:*** çrregullimin hiperkinetik të shoqëruar me çrregullime të sjelljes (F90.1)

### F90.1 Çrregullim hiperkinetik i sjelljes

Çrregullim hiperkinetik i shoqëruar me çrregullime të sjelljes

### F90.8 Çrregullim tjetër hiperkinetik

### F90.9 Çrregullim hiperkinetik, i paspecifikuar

Reaksioni hiperkinetik i fëmijërisë ose adoleshencës NOS

Sindroma hiper-reaktive NOS

## F91 Çrregullime të sjelljes

Çrregullime që karakterizohen nga modele të përsëritura dhe persistente dissociale, agresive ose sfiduese. Këto sjellje duhet të arrijnë deri tek shkeljet e pritshmërive shoqërore të përshtatshme për moshën; duhet pra të jenë me të rënda se gabimet fëmijënore ose rebelimi i adoleshences dhe duhet të flasin për një model të qendrueshëm sjelljeje (6 muaj ose me tepër). Veçoritë e çrregullimit të sjelljes mund të jenë shenja të sëmundjeve (konditave) të tjera, ku duhet përcaktuar diagnoza e sëmundjes bazë.

Shembuj të sjelljeve, në të cilat bazohet diagnoza, përfshijnë nivele të rritura luftimi ose ngacmimi, dhunë ndaj njerëzve ose kafshëve, dëmtime të rënda ndaj pronës, zjarrvënie, vjedhje, mungesa në shkollë, largim nga shtëpia, zakonisht shpërthime të pakontrolluara dhe mosbindje. Çdonjë nga këto sjellje, nëse janë të dukshme, është e mjaftueshme për diagnozën, por jo veprimet dissociale të izoluara.

***Përjashton:*** humorin [afektiv] (F30-F39)

çrregullimet zhvillimore të vazhduara (F84.-)

skizofreninë (F20.-)

kur shoqërohet me:

- çrregullime emocionale (F92.-)
- çrregullime hiperkinetike (F90.1)

### F91.0 Çrregullim i sjelljes i mbyllur në kontekstin familjar

Çrregullime të sjelljes, që përfshijnë sjellje dissociale ose agresive (dhe jo thjesht kundërshtuese, sfiduese ose ndërprerëse), në të cilat sjellja anormale është tërësisht e lokalizuar në shtëpi dhe me ndërveprimet e anëtarëve të familjes së afërt ose brenda banesës. Çrregullimi kërkon që kriteret e përgjithshme të F91.- të plotësohen; edhe marrëdhëniet prind-fëmijë të prekura rëndë nuk janë të mjaftueshme për vënien e diagnozës.

### F91.1 Çrregullim i pasocializuar i sjelljes

Çrregullim i karakterizuar nga kombinimi i vazhduar i sjelljeve agresive dhe dissociale (që plotëson kriteret e përgjithshme të F91.- dhe jo thjesht sjelljet kundërshtuese, sfiduese ose ndërprerëse) me anomali të rëndësishme të vazhduara në marrëdhënien e individit me fëmijë të tjerë.

Çrregullim i sjelljes, lloji solitar agresiv

Çrregullim agresiv jo i shoqërueshëm

### F91.2 Çrregullim i socializuar i sjelljes

Çrregullimi përfshin sjellje dissociale ose agresive (që ploteson kriteret e përgjithshme të F91.- dhe jo vetëm sjelljet kundërshtuese, sfiduese ose ndërprerëse) që ndodhin në individë që janë përgjithësisht të integruar mirë në grupin e tyre shoqëror.

Çrregullim i sjelljes, lloji i grupit

Keqbërje në grup

Cënime në kontekstin e anëtarësisë në një bandë

Vjedhje në bashkëpunim me të tjerë

Braktisje e shkollës

### F91.3 Çrregullim opozitar provokues

Çrregullim i sjelljes, që zakonisht haset tek fëmijët e vegjël, që karakterizohet së pari nga një sjellje dukshëm sfiduese, e pabindur dhe ndërprerëse që nuk ka qëllim keqbërës, ose format ektreme të çrregullimeve të sjelljes dissociale dhe agresive. Çrregullimi kërkon përmbushjen e kritereve të përgjithshme të F91.-; edhe vetë sjelljet e rënda çapkëne ose të këqija nuk janë të mjaftueshme për të vënë diagnozën. Kujdes duhet bërë para se të përdoret kjo kategori, veçanërisht me fëmijë pak të rritur, sepse çrregullimet e dukshme të sjelljes shoqërohen shpesh me sjellje agresive ose dissociale që shkon përtej sfidimit, mosbindjes apo ndërprerjes.

### F91.8 Çrregullime të tjera të sjelljes

### F91.9 Çrregullim i sjelljes, i paspecifikuar

Të fëmijërisë:

- çrregullim i sjelljes NOS
- çrregullim i qendrimit NOS

## F92 Çrregullime të përziera të sjelljes dhe emocionale

Një grup çrregullimesh, që karakterizohen nga kombinimi i sjelljeve dissociale ose të mosbindjes, agresive dhe të vazhduara, me simptoma të dukshme të depresionit,

ankthit ose shqetësimeve të tjera emocionale. Duhet plotësuar kriteri për të dy çrregullimet e sjelljes së fëmijërisë (F91.-) dhe çrregullimeve emocionale të fëmijërisë (F93.-), ose diagnoza neurotike e të rriturit (F40-F48), ose e çrregullimit të humorit (F30-F39).

### F92.0 Çrregullim depresiv i sjelljes

Kjo kategori kërkon kombinimin e çrregullimeve të sjelljes (F91.-) me humor dukshëm të depresuar (F32.-) në mënyrë të vazhduar, sikurse demonstrohet nga simptomat si gjendje e dëshpëruar, humbje e interesit dhe kënaqësisë në aktivitetet e zakonshme, vetëfajësimi dhe mungesa e shpresës; çrregullimet e gjumit ose të oreksit mund të jenë po ashtu të pranishme.

Çrregullime të sjelljes në F91.- të shoqëruara me çrregullime depresive në F32.-

### F92.8 Të tjera çrregullime të përziera të sjelljes dhe emocionale

Kjo kategori kërkon kombinimin e çrregullimeve të sjelljes (F91.-) me simptoma emocionale të dukshme, si ankth, obsesion dhe kompulsion, depersonalizim ose derealizim, fobi ose hipokondriazë.

Çrregullime të sjelljes në F91.- të shoqëruara me:

- çrregullime emocionale në F93.-
- çrregullime neurotike në F40-F48

### F92.9 Çrregullime të përziera të sjelljes emocionale, të paspecifikuara

## F93 Çrregullime emocionale që shfaqen në mënyrë specifike në moshën e fëmijërisë

Kryesisht ekzagjerime në tendencat normale të zhvillimit sesa fenomene që janë cilësisht anormale në vetvete. Përshtatshmëria zhvillimore është përdorur si një veçori kryesore diagnostike në përcaktimin e dallimeve midis çrregullimeve emocionale, që fillojnë në fëmijëri, me çrregullime neurotike (F40-F48).

***Përjashton:*** kur shoqërohen me çrregullime të sjelljes (F92.-)

### F93.0 Çrregullim anksioz i ndarjes (veçimit) i moshës së fëmijërisë

Duhet vënë si diagnozë kur frika e ndarjes përbën fokusin e ankthit dhe kur një diagnozë e tillë ngrihet gjatë viteve të hershme të fëmijërisë. Dallon nga forma normale e ankthit nga ndarja, kur është e një shkalle (rëndese, severiteti) statistikisht të pazakontë (që përfshin një zgjatje jonormale përtej periudhes së zakonshme moshore) dhe kur është e shoqëruar me probleme të rëndësishme në funksionimin shoqëror.

***Përjashton:*** çrregullimet e humorit [afektive] (F30-F39)
çrregullimet neurotike (F40-F48)
çrregullimin e ankthit fobik të fëmijërisë (F93.1)
çrregullimin e ankthit shoqëror të fëmijërisë (F93.2)

### F93.1 Çrregullim anksioz fobik i moshës së fëmijërisë

Frikërat në fëmijëri, që tregojnë një specificitet për fazën e zhvillimit dhe rritje (deri diku) në shumicën e fëmijëve, por që deri diku janë anormale. Frikëra të tjera që dalin në fëmijëri, por që nuk janë pjesë normale e zhvillimit psikosocial (p.sh. agorafobia), duhet të kodohen nën kategorinë e duhur tek F40-F48.

***Përjashton:*** çrregullimin e ankthit të gjeneralizuar (F41.1)

### F93.2 Çrregullim anksioz social i moshës së fëmijërisë

Në këtë çrregullim ka një lodhje me të huajt dhe frikë sociale ose ankth kur takohen situata të reja, të çudishme ose kërcënuese. Kjo kategori duhet të përdoret vetëm kur frikëra të tilla shfaqen qysh në vitet e hershme dhe janë të pazakonta si në shkallë ashtu dhe në problemet e funksionimit shoqëror.

Çrregullim i shmangies në fëmijëri ose adoleshencë

### F93.3 Çrregullime rivaliteti me të afërmit

Disa gradë të çrregullimit emocional, që pasojnë lindjen e një të afërmi më të ri që tregohet nga shumica e fëmijëve të vegjël. Rivaliteti mes të afërmve duhet të diagnostikohet vetëm nëse ka një vazhdueshmëri të çrregullimit, që është statistikisht i pazakontë dhe shoqërohet me anomali të ndërveprimit shoqëror.

Xhelozia e të afërmve

### F93.8 Të tjera çrregullime emocionale të moshës së fëmijërisë

Çrregullime të identitetit

Çrregullime të ankthit me të lartë

***Përjashton:*** çrregullim të identitetit gjinor të fëmijërisë (F64.2)

### F93.9 Çrregullim emocional i moshës së fëmijërisë, i paspecifikuar

## F94 Çrregullime të funksionimit social që shfaqen në mënyrë specifike në moshën e fëmijërisë dhe atë të adoleshencës

Një grup deri diku heterogjen sëmundjesh, që kanë të përbashkët anomali në funksionimin shoqëror, që fillojnë në periudhën e zhvillimit, por që (në dallim nga çrregullimet zhvillimore të qendrueshme) nuk karakterizohen më së pari nga një paaftësi shoqërore konstitucionale e dukshme apo një defiçit që mbizotëron të gjitha fushat e funksionimit. Në shumë raste, shtrembërimet ose privacionet ambientale të rënda luajnë një rol të rëndësishëm në etiologji.

### F94.0 Mutizëm elektiv

Karakterizohet nga një selektivitet i përcaktuar në të folur, i tillë që fëmija demonstron një kompetencë gjuhe në disa situata, por dështon të flasë në situata të tjera. Çrregullimi është zakonisht i shoqëruar me veçori të dukshme personaliteti, që përfshijnë ankth, tërheqje, sensitivitet ose rezistencë.

Mutizëm selektiv

***Përjashton:*** çrregullime zhvillimore të vazhduara (F84.-)

skizofreninë (F20.-)

çrregullime zhvillimore specifike të të ligjëratës dhe gjuhës (F80.-)

mutizmin e përkohshëm si pjesë e ankthit të ndarjes tek fëmijët e vegjël (F93.0)

### F94.1 Çrregullim reaktiv i dashurisë (lidhjes) i moshës së fëmijërisë

Fillon në 5 vitet e para të jetës dhe karakterizohet nga anomali të qendrueshme në modelin e marrëdhënieve shoqërore të fëmijës që shoqërohen me çrregullime shoqërore dhe që janë reaktive ndaj ndryshimeve në rrethanat ambientale (p.sh. frikë dhe hipervigjilencë, ndërveprim shoqëror i varfër me shokët, agresion ndaj vetes dhe të tjerëve, dëshpërim, dhe mungesë rritje në shumë raste). Sindroma ndodh si një rezultat direkt i një negligjence prindërore, abuzimi ose keqkujdesje të rëndë.

Përdorni kodet shtesë, nëse dëshironi për të identifikuar dështimin e rritjes ose zhvillimit.

***Përjashton:*** sindromën Asperger (F84.5)

çrregullimin e të bashkangjiturit të pafrenuar në fëmijëri (F94.2)

sindromat e keqtrajtimit (T74.-)

variacionet normale në modelet e bashkangjitjes selektive

abuzimin seksual ose fizik në fëmijëri, që shpie në probleme psikosociale (Z61.4-Z61.6)

### F94.2 Çrregullim i papërmbajtur i dashurisë (lidhjes) i moshës së fëmijërisë

Një model i funksionimit shoqëror anormal, që shfaqet në 5 vitet e para të jetës dhe, që ka tendencë të vazhdojë, pavarësisht ndryshimeve të dukshme në rrethanat ambientale, p.sh. sjellje joselektive të bashkangjitjes së fokusuar, sjellje që kërkon vemendje dhe është shumë miqësore pa dallim, ndërveprim i keqrregulluar me shokët, dhe në vartësi të rrethanave mund të ketë çrregullime shoqëruese të emocioneve ose sjelljes.

Psikopatia me mungesë ndjenjash

Sindroma institucionale

***Përjashton:*** sindromën Asperger (F84.5)

hospitalizimin e fëmijëve (F43.2)

çrregullimet hiperkinetike (F90.-)

çrregullimin e bashkangjitjes reaktive tek fëmijët (F94.1)

### F94.8 Të tjera çrregullime të funksionimit social të moshës së fëmijërisë

### F94.9 Çrregullim i funksionimit social i moshës së fëmijërisë, i paspecifikuar

## F95 Çrregullime me tike nervore

Sindroma, në të cilat manifestimi kryesor është tiku. Një tik është një lëvizje motore e pavullnetshme, e shpejtë, e përsëritur, jo ritmike (që zakonisht përfshin një grup muskujsh të përcaktuar) ose vokalizime që janë të papritura dhe pas asnjë qëllim të caktuar. Tiket manifestohen si të parezistueshëm, por zakonisht mund të supresohen për periudha të caktuara kohe, keqsohen nga stresi dhe zhduken gjatë gjumit. Tiket motore më të përhapur janë rrahja e qepallave, lëvizjet e qafës, lëvizjet e shpatullave dhe shtrembërimet e fytyrës. Tike vokale të thjeshta përfshijnë pastrimin e grykës,

lehjen, marrjen erë dhe fishkëllimin. Tiket e zakonshme komplekse përfshijnë goditjen e vetes, kërcimin, kërcimin pupthi. Tiket vokale komplekse përfshijnë përsëritjen e fjalëve të caktuara dhe disa herë përdorimin e përsëritur të fjalëve të veçanta, dhe shpeshherë të papranueshme shoqërisht (fjalë të pista) (koprolali) ose përsëritjen e fjalëve të veta apo tingujve të vet (palilali).

### F95.0 Tik kalimtar

Përmbush kriteret e përgjithshme të çrregullimit të tikut, por nuk zgjat me shumë së 12 muaj. Tiku është në formën e rrahjes së qepallave, shenjave me fytyrë ose lëvizjeve të kokës.

### F95.1 Tik motor ose vokal kronik

Përmbush kriteret e përgjithshme të çrregullimit të tikut, në të cilin ka tike motore ose vokale (por jo në të njëjtën kohë), që mund të jenë të vetëm ose të shumtë (por më tepër të shumtë) dhe që zgjasin më shumë së 12 muaj.

### F95.2 Tik i kombinuar vokal dhe motorik multipël (de la Tourette)

Një formë çrregullimi tiku, në të cilin ka pasur një ose shumë tike motore ose vokale, të cilët nuk kanë ndodhur në të njëjtën kohë. Çrregullimi zakonisht përkeqsohet gjatë adoleshencës dhe vazhdon deri në moshë të rritur. Tiket vokale janë të shumtë, me shpërthime vokale të përsëritura, pastrim të grykës ose hungërima, dhe mund të ketë përmendje të fjalëve ose shprehjeve të pista. Disa herë ka një ekopraksi të gjesteve, e cila mund të jetë e natyrës së fjalëve të pista (kopropraksi).

***Përjashton:*** shurdh-memecërinë NEC (H91.3)

shurdhërinë NOS (H91.9)

humbje dëgjimi:

- NOS (H91.9)
- nga zhurmat (H83.3)
- ototoksike (H91.0)
- e menjëhershme (idiopatike) (H91.2)

**H90.0 Humbja konduktive e dëgjimit, e dyanëshme (bilaterale)**

**H90.1 Humbja konduktive e dëgjimit, unilaterale me dëgjim të paprekur në anën tjetër**

**H90.2 Humbja konduktive e dëgjimit, e paspecifikuar**

Shurdhëri konduktive NOS

**H90.3 Humbja neurosensoriale e dëgjimit, bilaterale**

**H90.4 Humbja neurosensoriale e dëgjimit, unilaterale me dëgjim të paprekur në anën tjetër**

**H90.5 Humbja neurosensoriale e dëgjimit, e paspecifikuar**

Shurdhëri kongjenitale NOS

Humbje dëgjimi:

- qendrore
- neurale
- perceptive
- sensoriale

NOS

Shurdhëri sensoneurale

**H90.6** **Humbja e përzier konduktive dhe neurosensoriale e dëgjimit, bilaterale**

**H90.7** **Humbja e përzier konduktive dhe neurosensoriale e dëgjimit, unilaterale me dëgjim të paprekur në anën tjetër**

**H90.8** **Humbje e përzier konduktive dhe neurosensoriale e dëgjimit, e paspecifikuar**

## H91 Humbje të tjera të dëgjimit

***Përjashton:*** perceptim auditiv anormal (H93.2)
humbje dëgjimi e klasifikuar në H90.-
cerumen i prekur (H61.2)
humbje dëgjimi nga zhurmat (H83.3)
shurdhëri psikogjenike (F44.6)
shurdhëri ishemike tranziente (H93.0)

**H91.0** **Humbje ototoksike e dëgjimit**

Përdorni kodet shtesë për shkaqet e jashtme (Kapitulli XX), nëse dëshironi, për të identifikuar agjentin toksik.

**H91.1** **Presbycusis (=Presbikuzia)**

Presbiakuzia

**H91.2** **Humbja e menjëhershme idiopatike e dëgjimit**

Humbje e papritur e dëgjimit NOS

**H91.3** **Shurdhmemecëria, e paklasifikuar tjetërkund**

**H91.8** **Humbje të tjera të specifikuara të dëgjimit**

**H91.9** **Humbje e dëgjimit, e paspecifikuar**

Shurdhëri:

- NOS
- frekuencë e lartë
- frekuencë e ulët

## H92 Otalgjia dhe efuzioni i veshit

**H92.0** **Otalgjia**

**H92.1** **Rjedhje nga veshi (Otorrhea)**

***Përjashton:*** rrjedhjen nga veshi të lëngut truno-shpinor (G96.0)

**H92.2** **Otorragjia**

***Përjashton:*** otorragjinë traumatike – kodoni sipas llojit të dëmtimit

## H93 Çrregullime të tjera të veshit të paklasifikuara tjetërkund

**H93.0 Çrregullime degjenerative dhe vaskulare të veshit**

Shurdhëri ishemike tranziente

***Përjashton:*** presbikusinë (H91.1)

**H93.1 Tinnitusi**

**H93.2 Perceptime anormale të tjera dëgjimore**

Rekrutimi auditor

Diplakusia

Hiperakusia

Ndryshim i përkohshëm i pragut akustik

***Përjashton:*** haluçinacione auditore (R44.0)

**H93.3 Çrregullime të nervit akustik**

Çrregullime të nervit të 8-të kranial

**H93.8 Çrregullime të tjera specifike të veshit**

**H93.9 Çrregullime të veshit, të paspecifikuara**

## H94* Çrregullime të tjera të veshit në sëmundje të klasifikuara tjetërkund

**H94.0* Neuriti akustik në sëmundjet infektive dhe parazitare të klasifikuara tjetërkund**

Neuriti akustik në sifilis (A52.1†)

**H94.8* Çrregullime të tjera specifike të veshit në sëmundje të klasifikuara tjetërkund**

## H95 Çrregullime postproçedurale të veshit dhe procesit mastoid të paklasifikuara tjetërkund

**H95.0 Kolesteatoma rekurrente e kavitetit postmastoidektomik**

**H95.1 Çrregullime të tjera që pasojnë mastoidektominë**

Inflamacion kronik
Granulim
Cist mukozal
} i kavitetit postmastoidektomik

**H95.8** **Çrregullime të tjera postproçedurale të veshit dhe proçesit mastoid**

**H95.9** **Çrregullime postproçedurale të veshit dhe proçesit mastiod, të paspecifikuara**

# KAPITULLI IX

# Sëmundjet e sistemit cirkulator (I00–I99)

***Përjashton:*** gjendje të caktuara që rrjedhin prej periudhës perinatale (P00-P96)
gjendje të caktuara infektive dhe parazitare (A00-B99)
komplikacione të shtatzënisë, lindjes dhe pas lindjes (O00-O99)
keqformimet kongjenitale, deformimet dhe anomalitë kromozomale (Q00-Q99)
sëmundjet endokrine, nutricionale dhe metabolike (E00-E90)
dëmtime, helmime dhe pasoja të caktuara nga shkaqe të jashtme (S00-T98)
neoplazmat (C00-D48)
simptoma, shenja dhe gjetje anormale klinike dhe laboratorike, të paklasifikuara tjetërkund (R00-R99)
çrregullime sistemike të indit lidhor (M30-M36)
sulme ishemike tranziente dhe sindromat e lidhura me to (G45.-)

**Ky kapitull përmban blloqet e mëposhtëme:**

| | |
|---|---|
| I00–I02 | Ethja reumatizmale akute |
| I05–I09 | Sëmundjet reumatizmale kronike të zemrës |
| I10–I15 | Sëmundjet hipertensive |
| I20–I25 | Sëmundjet iskemike të zemrës |
| I26–I28 | Sëmundja pulmonare e zemrës dhe sëmundjet e qarkullimit pulmonar |
| I30–I52 | Forma të tjera të sëmundjeve të zemrës |
| I60–I69 | Sëmundjet cerebrovaskulare |
| I70–I79 | Sëmundjet e arterieve, arteriolave dhe kapilarëve |
| I80–I89 | Sëmundje të venave, vazave limfatike dhe limfonodulave, të paklasifikuara tjetërkund |
| I95–I99 | Çrregullime të tjera të paspecifikuara të sistemit cirkulator |

**Kategoritë me yll për këtë kapitull jepen si me poshtë:**

| | |
|---|---|
| I32* | Perikarditi në sëmundjet e klasifikuara tjetërkund |
| I39* | Endokarditi dhe çrregullimet e valvulave të zemrës në sëmundje të klasifikuara tjetërkund |

| | |
|---|---|
| I41* | Miokarditi në sëmundje të klasifikuara tjetërkund |
| I43* | Kardiomiopatia në sëmundje të klasifikuara tjetërkund |
| I52* | Çrregullime të tjera të zemrës në sëmundje të klasifikuara tjetërkund |
| I68* | Çrregullime cerebrovaskulare në sëmundje të klasifikuara tjetërkund |
| I79* | Çrregullime të arterieve, arteriolave dhe kapilarëve në sëmundje të klasifikuara tjetërkund. |
| I98* | Çrregullime të tjera të sistemit cirkulator |

# Ethja reumatizmale akute
# (I00–I02)

## I00 Ethja reumatizmale pa prekje të zemrës

***Përfshin:*** artritin, reumatizmal, akut ose subakut

## I01 Ethja reumatizmale me prekje të zemrës

***Përfshin:*** sëmundjet kronike me origjinë reumatike (I05-I09) përveçse kur ethja reumatizmale është gjithashtu e pranishme ose ka fakte për riaktivizim të proçesit reumatik. Për rastet kur ka mëdyshje për aktivitet reumatik në kohën e vdekjes, referojuni udhëzimeve dhe rregullave të kodimit në Vëllimin 2.

### I01.0 Perikarditi reumatizmal akut

Çdo gjendje në I00 me perikardit

Perikarditi reumatizmal (akut)

***Përjashton:*** kur nuk specifikohet si reumatizmal (I30.-)

### I01.1 Endokarditi reumatizmal akut

Çdo gjendje në I00 me endokardit ose valvulit

Valvuliti reumatizmal akut

### I01.2 Miokarditi reumatizmal akut

Çdo gjendje në I00 me miokardit

### I01.8 Të tjera sëmundje akute reumatizmale të zemrës

Çdo gjendje në I00 me prekje tjetër (një ose të shumëfishtë) të zemrës

Pankarditi reumatizmal akut

### I01.9 Sëmundja reumatizmale akute e zemrës, e paspecifikuar

Çdo gjendje në I00 me prekje të paspecifikuar të zemrës

Reumatizmale:

- karditi, akut
- sëmundje e zemrës, aktive ose akute

## I02 Korea reumatizmale

***Përfshin:*** korean Sydenham

***Përjashton:*** korean:

- NOS (G25.5)

- Huntington (G10)

**I02.0** **Korea reumatizmale me prekje të zemrës**

Korea NOS me prekje të zemrës

Korea reumatizmale me prekje të zemrës të çdo tipi nën I01.-

**I02.9** **Korea reumatizmale pa prekje të zemrës**

Korea reumatizmale NOS

# Sëmundjet reumatizmale kronike të zemrës (I05–I09)

## I05 Sëmundjet reumatizmale të valvulës mitrale

***Përfshin:*** gjendjet e klasifikuara në (I05.0) dhe (I05.2-I05.9), pavarësisht nëse janë të specifikuara si reumatizmale apo jo

***Përjashton:*** kur janë të specifikuara si jo-reumatizmale (I34.-)

**I05.0** **Stenoza mitrale**

Bllokim (reumatizmal) i valvulës mitrale

**I05.1** **Insufiçienca mitrale reumatizmale**

Mitrale reumatizmale:

- inkompetencë
- regurgitacion

**I05.2** **Stenoza mitrale me insufiçiencë**

Stenozë mitrale me insufiçiencë ose regurgitacion

**I05.8** **Sëmundje të tjera të valvulës mitrale**

Dështim i valvulës mitrale

**I05.9** **Sëmundje e valvulës mitrale, e paspecifikuar**

Çrregullim i valvulës mitrale (kronik) NOS

## I06 Sëmundjet reumatizmale të valvulës aortale (aortike)

***Përjashton:*** kur nuk janë të specifikuara si reumatizmale (I35.-)

**I06.0** **Stenoza aortale reumatizmale**

Bllokim reumatizmal i valvulës aortale

**I06.1** **Insufiçienca aortale reumatizmale**

Aortale reumatizmale:

- inkompetencë
- regurgitacion

**I06.2 Stenozë aortale reumatizmale me insufiçiencë**

Stenozë aortale reumatizmale me inkompetencë ose regurgitacion

**I06.8 Sëmundje të tjera reumatizmale të valvulës aortale**

**I06.9 Sëmundja reumatizmale e valvulës aortale, e paspecifikuar**

Sëmundja reumatizmale e valvulës aortale NOS

## I07 Sëmundjet reumatizmale të valvulës trikuspidale

***Përfshin:*** pavarësisht nëse janë të specifikuara si reumatizmale apo të panjohura

***Përjashton:*** kur janë të specifikuara si jo-reumatizmale (I36.-)

**I07.0 Stenoza trikuspidale**

Bllokim (reumatizmal) i valvulës trikuspidale

**I07.1 Insufiçienca trikuspidale**

Insufiçienca (reumatizmale) e valvulës trikuspidale

**I07.2 Stenoza trikuspidale me insufiçiencë**

**I07.8 Sëmundjet e tjera të valvulës trikuspidale**

Çrregullime të valvulës trikuspidale NOS

## I08 Sëmundjet multiple të valvulave

***Përfshin:*** pavarësisht nëse janë të specifikuara si reumatizmale apo të panjohura

***Përjashton:*** endokarditin, valvula e paspecifikuar (I38.-)

sëmundje multivalvulare me origjinë joreumatizmale të zemrës; përdorni kodet e duhura në (I34-I38, Q22-Q23, Q24.8)

sëmundjet reumatizmale të endokardiumit, valvula e paspecifikuar (I09.1)

**I08.0 Çrregullime të valvulës mitrale dhe aortale së bashku**

Përfshirje të të dy valvulave mitrale dhe aortale të specifikuara si reumatizmale ose me origjinë të paspecifikuarjo

**I08.1 Çrregullime të valvulës mitrale dhe trikuspidale së bashku**

**I08.2 Çrregullime të valvulës aortale dhe trikuspidale së bashku**

**I08.3 Çrregullime të kombinuara të valvulës mitrale, aortale dhe trikuspidale**

**I08.8** **Sëmundje të tjera multiple të valvulave**

**I08.9** **Sëmundja multiple e valvulës, e paspecifikuar**

## I09 Sëmundje të tjera reumatizmale të zemrës

**I09.0** **Miokarditi reumatizmal**

***Përjashton:*** miokarditin të specifikuar si jo-reumatizmal (I51.4)

**I09.1** **Sëmundja reumatizmale e endokardiumit, valvula e paspecifikuar**

Reumatizmal:

- endokardit (kronik)
- valvulit (kronik)

***Përjashton:*** endokarditin, valvula e specifikuar (I38)

**I09.2** **Perikarditi kronik reumatizmal**

Perikardit adherent, reumatizmal

Reumatizmal kronik:

- mediastinoperikardit
- mioperikardit

***Përjashton:*** kur nuk specifikohet si reumatizmal (I31.-)

**I09.8** **Sëmundjet e tjera të specifikuara reumatizmale të zemrës**

Sëmundje reumatizmale të valvulës pulmonare

**I09.9** **Sëmundja reumatizmale e zemrës, e paspecifikuar**

Reumatizmale:

- karditi
- insufiçiencë kardiake

***Përjashton:*** karditin reumatizmal (M05.3)

# Sëmundjet hipertensive (I10–I15)

***Përjashton:*** që komplikon shtatzëninë, lindjen dhe pas lindjen (O10-O11, O13-O16)
që përfshin vazat koronare (I20-I25)
hipertensionin neonatal (P29.2)
hipertensionin pulmonar (I27.0)

## I10 Hipertensioni esencial (primar)

***Përfshin:*** presionin e lartë të gjakut

hipertensionin

(arterial)(beninj)(esencial)(malinj)(primar)(sistemik)

***Përjashton:*** që prek vazat e:

- trurit (I60-I69)
- syrit (H35.0)
-

## I11 Sëmundja hipertensive e zemrës

***Përfshin:*** çdo gjendje në I50.-, I51.4-I51.9 për shkak të hipertensionit

### I11.0 Sëmundja hipertensive e zemrës me insufiçiencë kardiake kongjestive

Insufiçienca kardiake hipertensive

### I11.9 Sëmundja hipertensive e zemrës pa insufiçiencë kardiake kongjestive

Sëmundja hipertensive e zemrës NOS

## I12 Sëmundja hipertensive renale

***Përfshin:*** çdo gjendje në N00-N07, N18.-, N19 ose N26 për shkak të hipertensionit

arteriosklerozën e veshkës

nefritin arteriosklerotik (kronik)(intersticial)

nefropatinë hipertensive

nefrosklerozën

***Përjashton:*** hipertensionin sekondar (I15.-)

### I12.0 Sëmundja hipertensive renale me insufiçiencë renale

Insufiçienca renale hipertensive

### I12.9 Sëmundja hipertensive renale pa insufiçiencë renale

Sëmundja hipertensive renale NOS

## I13 Zemra hipertensive dhe sëmundja renale

***Përfshin:*** çdo gjendje në I11.- me çdo gjendje në I12.-

sëmundje:

- kardiorenale
- renale kardiovaskulare

**I13.0** **Zemra hipertensive dhe sëmundja renale me insufiçiencë kardiake kongjestive**

**I13.1** **Zemra hipertensive dhe sëmundja renale me insufiçiencë renale**

**I13.2** **Zemra hipertensive dhe sëmundja renale me insufiçiencë kardiake kongjestive dhe insufiçiencë renale**

**I13.9** **Zemra hipertensive dhe sëmundja renale, e paspecifikuar**

## I15 Hipertensioni sekondar

***Përjashton:*** që përfshin vazat e:

- trurit (I60-I69)
- syrit (H35.0)

**I15.0** **Hipertensioni renovaskular**

**I15.1** **Hipertensioni sekondar nga çrregullime të tjera renale**

**I15.2** **Hipertensioni sekondar nga çrregullime endokrine**

**I15.8** **Hipertension tjetër sekondar**

**I15.9** **Hipertension sekondar, i paspecifikuar**

# Sëmundjet iskemike të zemrës (I20–I25)

***Shënim:*** Për sëmundshmërinë, kohëzgjatja siç përdoret në kategoritë I21, I22, I24 dhe I25, i referohet intervalit midis fillimit të episodit ishemik dhe marrjes së kujdesit mjekësor. Për vdekshmërinë, kohëzgjatja i referohet intervalit nga fillimi deri në vdekje.

***Përfshin:*** me përmendje të hipertensionit (I10-I15).

Përdorni kodet shtesë, nëse dëshironi, për të identifikuar praninë e hipertensionit.

## I20 Angina pectoris

**I20.0** **Angina e paqendrueshme**

Angina:

- kreshente
- de novo, nga përpjekja
- përkeqësuese, nga përpjekja

Sindroma koronare e menjëhershme

Sindroma pre-infarkt

### I20.1 Angina pectoris me spazëm të dokumentuar

Angina:

- angiospastike
- Prinzmetal
- e shkaktuar nga spazma
- e ndryshueshme

### I20.8 Forma të tjera të angina pectoris

Angina e lodhjes

Sindroma e rrjedhjes së ulët koronare

Angina stabël

Stenokardia

### I20.9 Angina pectoris, e paspecifikuar

Angina:

- NOS
- kardiake

Sindroma e anginës

Dhimbje gjoksi ishemike

## I21 Infarkti akut i miokardit

***Përfshin:*** infarktin e miokardit të përcaktuar si akut dhe me kohëzgjatje nga 4 javë (28 ditë) ose më pak që nga fillimi

***Përjashton:*** disa komplikacione që pasojnë infarktin akut të miokardit (I23.-)

infarktin e miokardit:

- të vjetër (I25.2)
- të specifikuar si kronik ose me kohëzgjatje më shumë së 4 javë (më shumë së 29 ditë) nga fillimi (I25.8)
- pasues (I22.-)

sindromën e pas infarktit të miokardit (I24.1)

### I21.0 Infarkti akut miokardial transmural i murit anterior

Infarkt (akut) transmural (i):

- (murit) anterior NOS
- anteroapikal
- anterolateral

- anteroseptal

**I21.1 Infarkti akut miokardial transmural i murit inferior**

Infarkt (akut) transmural (i):

- murit diafragmatik
- (murit) inferior NOS
- inferolateral
- inferoposterior

**I21.2 Infarkti akut miokardial transmural në vende të tjera**

Infarkt (akut) transmural (i):

- apikalo-lateral
- bazalo-lateral
- lateral i lartë
- (murit) lateral NOS
- posterior (i vërtetë)
- postero-bazal
- postero-lateral
- postero-septal
- septal NOS

**I21.3 Infarkti akut miokardial transmural në vende të paspecifikuara**

Infarkt transmural i miokardit

**I21.4 Infarkti akut miokardial subendokardial**

Infarkt i miokardit pa ngritje në-ST

Infarkt transmural i miokardit NOS

**I21.9 Infarkti akut i miokardit, i paspecifikuar**

Infarkt (akut) i miokardit NOS

## I22 Infarkti i miokardit i përsëritur

***Shënim:*** Për kodimin e sëmundshmërisë, kjo kategori duhet përdorur për infarktin e çdo zone të miokardit.

***Përfshin:*** infarktin e miokardit:

- të gjerë
- të shpeshtë
- ri-infarktin

***Përjashton:*** specifikuar si kronik ose me kohëzgjatje në më shumë së 4 javë (28 ditë) nga fillimi (I25.8)

**I22.0 Infarkti miokardial i përsëritur i murit anterior**

Infarkti miokardial i përsëritur (akut)(i):

- (murit) anterior NOS
- anteroapikal
- anterolateral
- anteroseptal

**I22.1 Infarkti miokardial i përsëritur i murit inferior**

Infarkti miokardial i përsëritur (akut)(i):

- murit diafragmatik
- (murit) inferior NOS
- inferolateral
- inferoposterior

**I22.8 Infarkti miokardial i përsëritur në vende të tjera**

Infarkti miokardial i përsëritur (akut)(i):

- apikalo-lateral
- bazalo-lateral
- lateral i larte
- (murit) lateral NOS
- posterior (i vërtetë)
- postero-bazal
- postero-lateral
- postero-septal
- septal NOS

**I22.9 Infarkti miokardial i përsëritur në vende të paspecifikuara**

## I23 Komplikacione të hershme që pasojnë infarktin akut të miokardit

***Përjashton:*** Gjendjet e listuara si me poshtë, kur:

- Janë të njëkohëshme me infarktin akut të miokardit (I21-I22)
- Nuk specifikohen si komplikacione aktuale që pasojnë një infarkt akut të miokardit (I31.-, I51.-)

**I23.0 Hemoperikardi si komplikacion akut pas infarktit akut të miokardit**

**I23.1 Defekti septal atrial si komplikacion akut pas infarktit akut të miokardit**

**I23.2 Defekti septal ventrikular si komplikacion akut pas infarktit akut të miokardit**

**I23.3 Ruptura e murit kardiak pa hemoperikard si komplikacion akut pas infarktit akut të miokardit**

*Përjashton:* me hemoperikardium (I23.0)

**I23.4 Ruptura e kordave tendinoze si komplikacion akut pas infarktit akut të miokardit**

**I23.5 Ruptura e muskulit papilar si komplikacion akut pas infarktit akut të miokardit**

**I23.6 Tromboza e atriumit, apendazhit (shtojcës) aurikular dhe ventrikulit si komplikacion akut pas infarktit akut të miokardit**

**I23.8 Komplikacione të tjera akute pas infarktit akut të miokardit**

## I24 Sëmundje të tjera iskemike akute të zemrës

*Përjashton:* anginën pectoris (I20.-)

isheminë tranziente të miokardit tek i porsalinduri (P29.4)

**I24.0 Tromboza koronare që nuk shkakton infarkt akut të miokardit**

Koronare (arterie)(venë)

- embolizëm
- okluzion
- tromboembolizëm

jo si rezultat i infarktit të miokardit

*Përjashton:* specifikuar si kronik ose me kohëzgjatje mbi 4 javë (28 ditë) nga fillimi (I25.8)

**I24.1 Sindromi Dressler**

Sindromi pas infarktit miokardial

**I24.8 Forma të tjera të sëmundjes iskemike akute të zemrës**

Koronar/e:

- dështim
- insufiçiencë

**I24.9 Sëmundja iskemike akute e zemrës, e paspecifikuar**

*Përjashton:* sëmundjen ishemike të zemrës (kronike) NOS (I25.9)

## I25 Sëmundja iskemike kronike e zemrës

*Përjashton:* sëmundjen kardiovaskulare NOS (I51.6)

**I25.0 Sëmundja atherosklerotike kardiovaskulare, kështu e përshkruar**

**I25.1 Sëmundja atherosklerotike e zemrës**

Koronare (arteria):

- ateroma
- ateroskleroza

- sëmundja
- skleroza

**I25.2 Infarkti i vjetër i miokardit**

Infarkt i shëruar i miokardit

Infarkt i vjetër i miokardit i diagnostikuar me EKG ose mjete të tjera, por pa simptoma aktuale

**I25.3 Aneurizma e zemrës**

Aneurizma:

- murale
- ventrikulare

**I25.4 Aneurizma e arteries koronare**

Fistula arteriovenoze koronare, e fituar

***Përjashton:*** aneurizmin (arterial) koronar kongjenital (Q24.5)

**I25.4 Kardiomiopatia iskemike**

**I25.6 Iskemia e heshtur e miokardit**

**I25.8 Forma të tjera të sëmundjes iskemike kronike të zemrës**

Çdo gjendje në I21-I22 dhe I24.- specifikuar si kronike dhe me një kohëzgjatje më shumë se 4 javë (28 ditë) nga fillimi

**I25.9 Sëmundja iskemike kronike e zemrës, e paspecifikuar**

Sëmundja ishemike e zemrës (kronike) NOS

# Sëmundja pulmonare e zemrës dhe sëmundjet e qarkullimit pulmonar

# (I26–I28)

## I26 Embolia pulmonare

***Përfshin:*** pulmonar (arterien)(venën):

- infarktin
- tromboembolinë
- trombozën

***Përjashton:*** që komplikojnë:

- abortin ose shtatzënine ektopike ose molare (O00-O07, O08.2)
- shtatzëninë, lindjen dhe pas lindjen (O88.-)

**I26.0** **Embolia pulmonare me zemër mushkërore (cor pulmonale) acute**

Cor pulmonale acute NOS

**I26.9** **Embolia pulmonare pa zemër mushkërore (cor pulmonale) akute**

Emboli pulmonare NOS

## I27 Sëmundje të tjera të zemrës mushkërore

**I27.0** **Hipertensioni pulmonar primar**

**I27.1** **Sëmundja kifoskoliotike e zemrës**

**I27.2** **Hipertension pulmonar sekondar tjetër**

Përdorni kode shtesë, nëse dëshirohet, për të identifikuar shkakun.

**I27.8** **Sëmundje të tjera të specifikuara të zemrës mushkërore**

***Përjashton:*** defektin Eisenmenger (Q21.8)

**I27.9** **Sëmundja e zemrës mushkërore, e paspecifikuar**

Sëmundja kardiopulmonare kronike

Cor pulmonale (kronike) NOS

## I28 Sëmundje të tjera të vazave pulmonare

**I28.0** **Fistula arteriovenoze e vazave pulmonare**

**I28.1** **Aneurizma e arteries pulmonare**

**I28.8** **Sëmundje të tjera të specifikuara të vazave pulmonare**

Rupturë
Stenozë
Strikturë
| të vazës pulmonare

**I28.9** **Sëmundja e vazave pulmonare, e paspecifikuar**

# Forma të tjera të sëmundjeve të zemrës (I30–I52)

## I30 Perikarditi akut

***Përfshin:*** efuzionin perikardial akut

***Përjashton:*** perikarditin reumatizmal (akut) (I01.0)

**I30.0** **Perikarditi akut idiopatik i paspecifikuar**

**I30.1** **Perikarditi infektiv**

Perikarditi:

- pneumokoksik
- purulent
- stafilokoksik
- streptokoksik
- viral

Pioperikarditi

Përdorni kodet shtesë (B95-B98), nëse dëshironi, për të identifikuar agjentin infeksioz.

**I30.8** **Forma të tjera të perikarditit akut**

**I30.9** **Perikardit akut i paspecifikuar**

## I31 Sëmundje të tjera të perikardit

***Përjashton:*** komplikacionet aktuale që pasojnë infarktin akut të miokardit (I23.-)

sindromën post-kardiotomi (I97.0)

traumën (S26.-)

kur specifikohet si reumatizmale (I09.2)

**I31.1** **Perikarditi kronik adeziv**

Accretio cordis

Perikardiumi adherens

Mediastinoperikarditi adeziv

**I31.1** **Perikarditi kronik konstriktiv**

Concretio cordis

Kalcifikime perikardiale

**I31.2** **Hemoperikardi, i paklasifikuar tjetërkund**

**I31.3** **Efuzioni perikardial (jo inflamator)**

Kiloperikardium

**I31.8** **Sëmundje të tjera të specifikuara të perikardit**

Pllaka epikardiale

Adezione perikardiale fokale

**I31.9** **Sëmundja e perikardit, e paspecifikuar**

Tamponada e zemrës

Perikarditi (kronik) NOS

## I32* Perikarditi në sëmundjet e klasifikuara tjetërkund

### I32.0* Perikarditi në sëmundjet bakteriale e klasifikuara tjetërkund

Perikarditi:

- gonokoksik (A54.8†)
- meningokoksik (A39.5†)
- sifilitik (A52.0†)
- tuberkular (A18.8†)

### I32.1* Perikarditi në sëmundje të tjera infektive dhe parazitare të klasifikuara tjetërkund

### I32.8* Perikarditi në sëmundje të tjera të klasifikuara tjetërkund

Perikarditi në:

- reumatoid (M05.3†)
- lupus sistemik eritematoz (M32.1†)
- uremik (N18.5†)

## I33 Endokarditi akut dhe subakut

***Përjashton:*** endokarditin reumatizmal akut (I01.1)
endokarditin NOS (I38)

### I33.0 Endokarditi infektiv akut dhe subakut

Endokarditi (akut)(subakut):

- bakterial
- infektiv NOS
- lenta
- malinj
- septik
- ulcerativ

Përdorni kodet shtesë (B95-B98), nëse dëshirohet, për të identifikuar agjentët infeksioze.

### I33.9 Endokarditi akut, i paspecifikuar

| | |
|---|---|
| Endokarditi | akut ose subakut |
| Mioendokarditi | |
| Periendokarditi | |

## I34 Çrregullimet joreumatizmale të valvulës mitrale

***Përjashton:*** mitrale (valvulës):

- sëmundje (I05.9)
- dështim (I05.8)
- stenozë (I05.0)

kur ka shkak të papërcaktuar pa përmendje të:

- sëmundjeve të valvulës aortike (I08.0)
- stenozës ose bllokimit të valvulës mitrale (I05.0)

kur përcaktohet si kongjenitale (Q23.2, Q23.9)

kur specifikohet si reumatizmale (I05.-)

**I34.0 Insufiçienca e valvulës mitrale**

Mitrale (valvula)

- inkompetencë
- regurgitim

NOS ose shkak i përcaktuar, përveç reumatizmal

**I34.1 Prolapsi i valvulës mitrale**

Sindroma e valvulës mitrale të ngathët

***Përjashton:*** sindromën Marfan (Q87.4)

**I34.2 Stenoza mitrale jo-reumatizmale**

**I34.8 Çrregullime të tjera jo-reumatizmale të valvulës mitrale**

**I34.9 Çrregullim jo-reumatizmal i valvulës mitrale, i paspecifikuar**

## I35 Çrregullimet jo-reumatizmale të valvulës aortale

***Përjashton:*** stenozën subaortike hipertrofike (I42.1)

kur ka shkak të papërcaktuar, por me përmendje të sëmundjes së valvulës mitrale (I08.0)

kur specifikohet si kongjenitale (Q23.0, Q23.1, Q23.4-Q23.9)

kur specifikohet si reumatizmale (I06.-)

**I35.0 Stenoza aortale**

**I35.1 Insufiçienca aortal**

Aortike (valvula)

- inkompetencë
- regurgitim

NOS ose shkak i përcaktuar, përveç reumatizmal

**I35.2 Stenoza aortale me insufiçiencë**

**I35.8 Çrregullime të tjera të valvulës aortale**

**I35.9 Çrregullim i valvulës aortale, i paspecifikuar**

## I36 Çrregullimet jo-reumatizmale të valvulës trikuspidale

***Përjashton:*** kur shkaku është i papërcaktuar (I07.0)
kur specifikohet si kongjenitale (Q22.4, Q22.8, Q22.9)
kur specifikohet si reumatizmale (I07.-)

**I36.0 Stenoza trikuspidale jo-reumatizmale**

**I36.1 Insufiçienca trikuspidale jo-reumatizmale**

| | |
|---|---|
| Trikuspidale (valvula)<br>• inkompetencë<br>• regurgitim | NOS ose shkak i përcaktuar, përveç reumatizmal |

**I36.2 Stenoza trikuspidale jo-reumatizmale me insufiçiencë**

**I36.8 Çrregullime të tjera jo-reumatizmale të valvulës trikuspidale**

**I36.9 Çrregullim jo-reumatizmal i valvulës trikuspidale, i paspecifikuar**

## I37 Çrregullimet e valvulës pulmonare

***Përjashton:*** kur specifikohet si kongjenitale (Q22.4, Q22.8, Q22.9)
kur specifikohet si reumatizmale (I09.8)

**I37.0 Stenoza e valvulës pulmonare**

**I37.1 Insufiçienca e valvulës pulmonare**

| | |
|---|---|
| Pulmonare (valvula)<br>• inkompetencë<br>• regurgitim | NOS ose shkak i përcaktuar, përveç reumatizmal |

**I37.2 Stenoza e valvulës pulmonare me insufiçiencë**

**I37.8 Çrregullime të tjera të valvulës pulmonare**

**I37.9 Çregullimi i valvulës pulmonare, i paspecifikuar**

## I38 Endokarditi, valvula e paspecifikuar

***Përfshin:*** endokarditin (kronik) NOS
valvular:

| | | |
|---|---|---|
| • inkompetencë<br>• insufiçiencë<br>• regurgitim<br>• stenozë | valvula e papërcaktuar | NOS ose shkak i përcaktuar, përveç reumatizmal ose kongjenital |

valvulit (kronik)

***Përjashton:*** insufiçiencën kongjenitale të valvulës kardiake NOS (Q24.8)

stenozën kongjenitale të valvulës kardiake NOS (Q24.8)
fibroelastozën endokardiale (I42.4)
kur specifikohet si reumatizmale (I09.1)

## I39* Endokarditi dhe çrregullimet e valvulave të zemrës në sëmundje të klasifikuara tjetërkund

***Përfshin:*** përfshirjen e endokarditit në:

- infeksionin nga kandida (B37.6†)
- infeksionin gonokoksik (A54.8†)
- sëmundjen Libman-Sacks (M32.1†)
- infeksionin meningokoksik (A39.5†)
- artritin reumatoid (M05.3†)
- sifiliz (A52.0†)
- tuberkuloz (A18.8†)
- ethen e tifos (A01.0†)

### I39.0* Çrregullimet e valvulës mitrale në sëmundje të klasifikuara tjetërkund

### I39.1* Çrregullimet e valvulës aortale në sëmundje të klasifikuara tjetërkund

### I39.2* Çrregullimet e valvulës trikuspidale në sëmundje të klasifikuara tjetërkund

### I39.3* Çrregullimet e valvulës pulmonare në sëmundje të klasifikuara tjetërkund

### I39.4* Çrregullimet multiple të valvulave në sëmundje të klasifikuara tjetërkund

### I39.8* Endokarditi, valvula e paspecifikuar në sëmundje të klasifikuara tjetërkund

## I40 Miokarditi akut

### I40.0 Miokarditi infektiv

Miokarditi septik

Përdorni kodet shtesë (B95-B98), nëse doni, për të identifikuar agjentin infeksioz.

### I40.1 Miokarditi i izoluar (veçuar)

### I40.8 Miokardit akut tjetër

### I40.9 Miokardit akut i paspecifikuar

## I41* Miokarditi në sëmundje të klasifikuara tjetërkund

### I41.0* Miokarditi në sëmundjet bakteriale të klasifikuara tjetërkund

Miokarditi:

- difteritik (A36.8†)
- gonokoksik (A54.8†)
- meningokoksik (A39.5†)
- sifilitik (A52.0†)
- tuberkular (A18.8†)

### I41.1* Miokarditi në sëmundjet virale të klasifikuara tjetërkund

Miokarditi (akut) nga gripi:

- virusi sezonal i identifikuar i gripit (J10.8†)
- virusi jo i identifikuar i gripit (J11.8†)
- virusi i gripit zoonitik ose epidemik i identifikuar (J09†)

Miokarditi nga shytat (=parotiti epidemik) (B26.8†)

### I41.2* Miokarditi në sëmundje të tjera infektive dhe parazitare të klasifikuara tjetërkund

Miokarditi (në):

- sëmundjen e Chagas (kronike) (B57.2†)
- akut (B57.0†)
- toksoplasmozë (B58.8†)

### I41.8* Miokarditi në sëmundje të tjera të klasifikuara tjetërkund

Miokarditi reumatoid (M05.3†)

Miokarditi sarkoidik (D86.8†)

## I42 Kardiomiopatia

***Përjashton:*** kardiomiopatinë që komplikon:

- shtatzëninë (O99.4)
- pas lindjen (O90.3)

kardiomiopatinë ishemike (I25.5)

### I42.0 Kardiomiopatia e dilatuar

Kardiomiopatia kongjestive

### I42.1 Kardiomiopatia obstruktive hipertrofike

Stenoza subaortike hipertrofike

### I42.2 Kardiomiopatia hipertrofike tjetër

Kardiomiopatia hipertrofike jo-obstruktive

### I42.3 Sëmundja endomiokardiale (eozinofilike)

Fibroza endomiokardiale (tropikale)

Endokarditi Löffler

**I42.4 Fibroelastoza endokardiale**

Kardiomiopatia kongjenitale

**I42.5 Kardiomiopatia restriktive tjetër**

Kardiomiopatia konstriktive NOS

**I42.6 Kardiomiopatia alkoolike**

**I42.7 Kardiomiopatia nga barnat dhe agjentët e tjerë të jashtëm**

Përdorni kodet shtesë (kapitulli XX), nëse dëshironi, për të identifikuar shkakun.

**I42.8 Kardiomiopati të tjera**

**I42.9 Kardiomiopati e paspecifikuar**

Kardiomiopatia (primare)(sekondare) NOS

## I43* Kardiomiopatia në sëmundje të klasifikuara tjetërkund

**I43.0* Kardiomiopatia në sëmundjet infektive dhe parazitare të klasifikuara tjetërkund**

Kardiomiopatia në difteri (A36.8†)

**I43.1* Kardiomiopatia në sëmundjet metabolike**

Amiloidoza kardiake (E85.-†)

**I43.2* Kardiomiopatia në sëmundjet nutricionale**

Kardiomiopatia nutricionale NOS (E63.9†)

**I43.8* Kardiomiopatia në sëmundje të tjera të klasifikuara tjetërkund**

Tofet Gouty të zemrës (M10.0†)

Sëmundja tirotoksike e zemrës (E05.9†)

## I44 Blloku atrioventrikular dhe i gjysëmdegës së majtë

**I44.0 Blloku atrioventrikular, grada e parë**

**I44.1 Blloku atrioventrikular, grada e dytë**

Blloku atriventrikular, lloji II dhe II

Blloku Möbitz, lloji II dhe II

Bllok i gradës së dytë, lloji I dhe II

Blloku Wenckebach

**I44.2 Blloku atrioventrikular, i plotë**

Blloku i plotë i zemrës

Blloku i gradës së tretë

**I44.3 Bllok atrioventrikular tjetër dhe i paspecifikuar**

Blloku atriventrikular NOS

**I44.4 Blloku fashikular anterior i majtë**

**I44.5 Bloku fashikular posterior i majtë**

**I44.6 Blloku fashikular tjetër dhe i paspecifikuar**

Gjysëm-blloku i gjysëmdegës së majtë NOS

**I44.7 Blloku i gjysëmdegës së majtë, i paspecifikuar**

## I45 Çrregullime të tjera të përçueshmërisë

**I45.0 Blloku fashikular i djathtë**

**I45.1 Gjysëmblloku i degës së djathtë tjetër dhe i paspecifikuar**

Bllok i gjysëmdegës së djathtë NOS

**I45.2 Blloku bifashikular**

**I45.3 Blloku trifashikular**

**I45.4 Blloku intraventrikular i paspecifikuar**

Bllok i degës NOS

**I45.5 Blloqe të tjera të specifikuara**

Blloku sinoatrial

Blloku sinoaurikular

***Përjashton:*** bllokun e zemrës NOS (I45.9)

**I45.6 Sindromi i preeksitimit**

Eksitim atrioventrikular anomal

Përçim atrioventrikular:

- i përshpejtuar
- aksesor
- pre-eksitacional

Sindroma Lown–Ganong–Levine

Sindroma Wolff–Parkinson–White

**I45.8 Çrregullime të tjera të specifikuara të përçueshmërisë**

Disocacioni atrioventrikular [AV]

Disocacioni i interferencës

***Përjashton:*** zgjatja e intervalit QT (R94.3)

**I45.9 Çrregullimi i përçueshmërisë, i paspecifikuar**

Bllok i zemrës NOS

Sindroma Stoke-Adams

## I46 Arresti kardiak

***Përjashton:*** shokun kardiogjenik (R57.0)

që komplikon:

- abortin ose shtatzëninë ektopike ose molare (O00-O07, O08.0)
- procedurat dhe kirurgjinë obstetrike (O75.4)

### I46.0 Arresti kardiak me reanimim të suksesshëm

### I46.1 Vdekje e menjëhershme nga zemra, e përshkruar kështu

***Përjashton:*** vdekjen e menjëhershme:

- NOS
- me:
  - çrregullim përçimi (I44-I45)
  - infarkt i miokardit (I21-I22)

### I46.9 Arrest kardiak i paspecifikuar

## I47 Takikardia paroksizmale

***Përjashton:*** që komplikon:

- abortin ose shtatzëninë ektopike ose molare (O00-O07, O08.8)
- procedurat ose kirurgjinë obstetrike (O75.4)

takikardinë :

- NOS (R00.0)
- sinoatriale NOS (R00.0)
- sinusale NOS (R00.0)

### I47.0 Aritmia ventrikulare rihyrëse

### I47.1 Takikardia supraventrikulare

Takiakardia (paroksizmale)

- atriale
- atrioventrikulare [AV]:
  - NOS
  - ri-hyrëse (nodale)
- junksionale
- nodale

### I47.2 Takikardia ventrikulare

**I47.9** **Takardia paroksizmale e papërcakuar**

Sindroma Bouveret(-Hoffmann)

## I48 Fibrilacioni dhe flateri atrial

**I48.0** **Fibrilacioni atrial paroksizmal**

**I48.1** **Fibrilacioni atrial persistent**

**I48.2** **Fibrilacioni atrial kronik**

**I48.3** **Flateri atrial tipik**

Flater atrial I llojit I

**I48.4** **Flateri atrial atipik**

Flater atrial I llojit II

**I48.9** **Fibrilacioni atrial dhe flateri atrial, I papercaktuar**

## I49 Aritmi kardiake të tjera

***Përjashton:*** bradikardinë:

- NOS (R0.01)
- sinoatriale (R0.01)
- sinusale (R0.01)
- vagale (R0.01)

që komplikon:

- abortin ose shtatzëninë ektopike ose molare (O00-O07, O08.8)
- procedurat ose kirurgjinë obstetrike (O75.4)

disritminë kardiake neonatale (P29.1)

**I49.0** **Fibrilacioni dhe flateri ventrikular**

**I49.1** **Depolarizimi i parakohshëm atrial**

Rrahje atriale të parakohshme

**I49.2** **Depolarizimi i parakohshëm junksional**

**I49.3** **Depolarizimi i parakohshëm ventrikular**

**I49.4** **Depolarizimi i parakohshëm tjetër dhe i paspecifikuar**

Rrahje ektopike

Ekstrasistola

Aritmi ekstrasistolike

Premature:

- rrahje NOS

- kontraktime

**I49.5 Sindromi i sinusit të sëmurë**

Sindroma takikardi-bradikardi

**I49.8 Aritmi kardiake të tjera të specifikuara**

Sindroma Brugada

Sindroma e QT-së së gjatë

Çrregullim i ritmit:

- sinusit koronar
- ektopik
- nodal

**I49.9 Aritmi kardiake të paspecifikuara**

Aritmia (kardiake) NOS

## I50 Insufiçienca kardiake

***Përjashton:*** që komplikon:

- abortin ose shtatzëninë ektopike ose molare (O00-O07, O08.8)
- procedurat ose kirurgjinë obstetrike (O75.4)

për shkak të hipertensionit (I11.0):

- me sëmundje renale (I13.-)

që pason kirurgjinë kardiake për shkak të pranisë së protezës kardiake (I97.1)

insufiçiencën kardiake të neonatit (P29.0)

**I50.0 Insufiçienca kardiake kongjestive**

Sëmundje kardiake kongjestive

Insufiçiencë e ventrikulit të djathtë (për shkak të insufiçiencës së majtë)

**I50.1 Insufiçienca e ventrikulit të majtë**

Astma kardiake

Insufiçienca e majtë e zemrës

Edema e mushkërive | me përmendje të sëmundjes së zemrës
Edema pulmonare | së majtë NOS ose insufiçiencë të zemrës

**I50.9 Insufiçiencë kardiake e paspecifikuar**

Insufiçiencë kardiake, e zemrës ose miokardit NOS

## I51 Komplikacionet dhe përshkrimet e keqspecifikuara të sëmundjes së zemrës

***Përjashton:*** çdo gjendje në I51.4-I51.9 nga hipertensioni (I11.-)
çdo gjendje në I51.4-I51.9 nga hipertensioni (I11.-):
- me sëmundje renale (I13.-)

komplikacione që pasojnë infarktin miokardial (I23.-)
kur specifikohen si reumatizmale (I00-I09)

**I51.0 Defekti septal kardiak, i fituar**

Defekt septal i fituar (i vjetër):
- atrial
- aurikular
- ventrikular

**I51.1 Ruptura e kordave tendinoze të paklasifikuara tjetërkund**

**I51.2 Ruptura e muskulit papilar i paklasifikuar tjetërkund**

**I51.3 Tromboza intrakardiake e paklasifikuar tjetërkund**

Trombozë e vjetër:
- apikale
- atriale
- aurikulare
- ventrikulare

**I51.4 Miokarditi, i paspecifikuar**

Fibrozë miokardiale
Miokardit:
- NOS
- kronik (intersticial)

**I51.5 Degjenerimi miokardial**

Degjenerim i zemrës ose miokardit:
- dhjamosje
- senil

Sëmundje miokardiale

**I51.6 Sëmundja kardiovaskulare, e paspecifikuar**

Aksident kardiovaskular NOS

***Përjashton:*** sëmundjen kardiovaskulare aterosklerotike, të përshkruar të tillë (I25.0)

**I51.7 Kardiomegalia**

Kardiake:
- dilatacioni
- hipertrofia

Dilatacioni ventrikular

**I51.8 Sëmundje të tjera të keqspecifikuara të zemrës**

Karditi (akut)(kronik)

Pankarditi (akut)(kronik)

**I51.9 Sëmundje e zemrës, e paspecifikuar**

## I52* Çrregullime të tjera të zemrës në sëmundje të klasifikuara tjetërkund

***Përjashton:*** sëmundjen kardiovaskulare NOS në sëmundje të klasifikuara tjetërkund (I98.0*)

**I52.0* Çrregullime të tjera të zemrës në sëmundje bakteriale të klasifikuara tjetërkund**

Karditi meningokoksik NEC (A39.5†)

**I52.1* Çrregullime të tjera të zemrës në sëmundje të tjera infektive dhe parazitare të klasifikuara tjetërkund**

Sëmundja pulmonare e zemrës në shistosomiazë (B65.-†)

**I52.8* Çrregullime të tjera të zemrës në sëmundje të tjera të klasifikuara tjetërkund**

Karditi reumatoid (M05.3†)

# Sëmundjet cerebrovaskulare (I60–I69)

***Përfshin:*** me përmendje të hipertensionit (gjendjet në I10 dhe I15.-)

Përdorni kodet shtesë, nëse dëshironi, për të identifikuar praninë e hipertensionit.

***Përjashton:*** sulme ishemike kardiake tranziente dhe sindromat e lidhura me to (G45.-)

hemorragji intrakraniale traumatike (S06.-)

demencien vaskulare (F01.-)

## I60 Hemorragjia subaraknoidale

**I60.0 Hemorragjia subaraknoidale nga sifoni dhe bifurkacioni karotid**

**I60.1 Hemorragjia subaraknoidale nga arteria media cerebri**

**I60.2 Hemorragjia subaraknoidale nga arteria comunicans anterior**

**I60.3 Hemorragjia subaraknoidale nga arteria comunicans posterior**

**I60.4 Hemorragjia subaraknoidale nga arteria bazilare**

**I60.5** **Hemorragjia subaraknoidale nga arteria vertebrale**

**I60.6** **Hemorragjia subaraknoidale nga arterie të tjera intrakraniale**

Prekje të disa arterieve intrakraniale

**I60.7** **Hemorragjia subaraknoidale nga arterie intrakraniale, e paspecifikuar**

Rupturë e aneurizmës Berry (kongjenitale) NOS

Hemorragji subaraknoidale nga:

- cerebrale
- komunikuese

arteria NOS

**I60.8** **Hemorragji subaraknoidale tjetër**

Hemorragji meningeale

Rupturë e keqformimit arterio-venoz cerebral

**I60.9** **Hemorragji subaraknoidale e paspecifikuar**

## I61 Hemorragji intracerebrale

***Përjashton:*** pasojat e hemorragjisë intracerebrale (I69.1)

**I61.0** **Hemorragji intracerebrale në hemisferë, subkortikale**

Hemorragji intracerebrale e thellë

**I61.1** **Hemorragji intracerebrale në hemisferë, kortikale**

Hemorragji e lobit cerebral

Hemorragji intracerebrale superficiale

**I61.2** **Hemorragji intracerebrale në hemisferë, e paspecifikuar**

**I61.3** **Hemorragji intracerebrale në truncus cerebri**

**I61.4** **Hemorragji intracerebrale në cerebelum**

**I61.5** **Hemorragji intracerebrale intraventrikulare**

**I61.6** **Hemorragji intracerebrale me lokalizim të shumfishtë**

**I61.8** **Hemorragji intracerebrale të tjera**

**I61.9** **Hemorragji intracerebrale, e paspecifikuar**

## I62 Hemorragji intrakraniale të tjera jotraumatike

***Përjashton:*** pasojat e hemorragjisë intracerebrale (I69.2)

**I62.0** **Hemorragji subdurale akute jotraumatike**

**I62.1** **Hemorragji ekstradurale jotraumatike**

Hemorragji epidurale jotraumatike

**I62.9** **Hemorragji intrakraniale e paspecifikuar**

## I63 Infarkti cerebral

***Përfshin:*** bllokim dhe stenozë cerebrale të arterieve precerebrale (përfshirë dhe trungun brakiocefalik), që çon në infarkt cerebral

***Përjashton:*** pasojat e infarktit cerebral (I69.3)

**I63.0 Infarkti cerebral nga tromboza e arterieve precerebrale**

**I63.1 Infarkti cerebral nga embolia e arterieve precerebrale**

**I63.2 Infarkti cerebral nga bllokimi ose stenoza e paspecifikuar e arterieve precerebrale**

**I63.3 Infarkti cerebral nga tromboza e arterieve cerebrale**

**I63.4 Infarkti cerebral nga embolia e arterieve cerebrale**

**I63.5 Infarkti cerebral nga bllokimi ose stenoza e paspecifikuar e arterieve cerebrale**

**I63.6 Infarkti cerebral nga tromboza venoze jopiogjene**

**I63.8 Infarkt cerebral tjetër**

**I63.9 Infarkt cerebral, i paspecifikuar**

## I64 Insulti, i paspecifikuar si hemorragji apo infarkt

***Përfshin:*** aksidentin cerebrovaskular NOS

***Përjashton:*** pasojat e insultit (I69.4)

## I65 Bllokimi dhe stenoza e arterive precerebrale që nuk jep infarkt cerebral

***Përfshin:*** embolizmin, ngushtimin, bllokimin (plotë)(pjesshëm), trombozën i/e arterieve bazilare, karotide ose vertebrale, por që nuk çon në infarkt cerebral

***Përjashton:*** kur shkakton infarkt cerebral (I63.-)

**I65.0 Bllokimi dhe stenoza e arteries vertebrale**

**I65.1 Bllokimi dhe stenoza e arteries baziliare**

**I65.2 Bllokimi dhe stenoza e arteries karotide**

**I65.3 Bllokimi dhe stenoza e arterieve multiple dhe bilaterale precerebrale**

**I65.8 Bllokimi dhe stenoza e arterieve të tjera precerebrale**

**I65.9 Bllokimi dhe stenoza e arteries precerebrale, e paspecifikuar**

Arteria precerebrale NOS

## I66 Bllokimi dhe stenoza e arterieve cerebrale që nuk japin infarkt cerebral

***Përfshin:*** embolizmin
ngushtimin
bllokimin (plotë)(pjesshëm)
trombozen
i/e arterieve cerebreale mesme, anteriore dhe posteriore, atyre cerebelare, që nuk çojnë në infarkt cerebral

***Përjashton:*** kur shkakton infarkt cerebral (I63.-)

**I66.0 Bllokimi dhe stenoza e arteries media cerebri**

**I66.1 Bllokimi dhe stenoza e arteries anteriore cerebri**

**I66.2 Bllokimi dhe stenoza e arteries posteriore cerebri**

**I66.3 Bllokimi dhe stenoza e arterieve cerebelare**

**I66.4 Bllokimi dhe stenoza e arterieve cerebrale multiple dhe bilaterale**

**I66.8 Bllokimi dhe stenoza e arteries cerebrale tjetër**

Bllokimi dhe stenoza e arterieve perforante

**I66.9 Bllokimi dhe stenoza e arteries cerebrale, e paspecifikuar**

## I67 Sëmundje të tjera cerebrovaskulare

***Përjashton:*** pasojat (sekelat) e listuara në gjendjet (I69.8)

**I67.0 Diseksioni i arterieve cerebrale, të parupturuara**

***Përjashton:*** arteriet cerebrale të çara (I60.7)

**I67.1 Aneurizmi cerebral, i parupturuar**

Cerebrale:

- aneurizmi NOS
- fistula arteriovenoze, e fituar

***Përjashton:*** aneurizmin cerebral kongjenital, të paçarë (Q28.-)
aneurizmin cerebral të çarë (I60.-)

**I67.2 Ateroskleroza cerebrale**

Ateroma e arterieve cerebrale

**I67.3 Leukoencefalopatia progresive vaskulare**

Sëmundja Binswander

***Përjashton:*** demencien vaskulare subkortikale (F01.2)

**I67.4 Encefalopatia hipertensive**

**I67.5 Sëmundja Moyamoya**

**I67.6** **Tromboza jopiogjene e sistemit venoz intrakranial**

Tromboza jo-piogjenike e:

- venave cerebrale
- sinusit venos intrakranial

***Përjashton:*** kur shkakton infarkt (I63.6)

**I67.7** **Arteriti cerebral i paklasifikuar tjetërkund**

**I67.8** **Sëmundje cerebrovaskulare tjetër e specifikuar**

Insufiçienca kardiovaskulare akute NOS

Ishemia cerebrale (kronike)

**I67.9** **Sëmundje cerebrovaskulare, e paspecifikuar**

## I68* Çrregulime cerebrovaskulare në sëmundje të klasifikuara tjetërkund

**I68.0*** **Angiopatia amiloide cerebrale (E85.-†)**

**I68.1*** **Arteriti cerebral në sëmundjet infektive dhe parazitare të klasifikuara tjetërkund**

Arteriti cerebral:

- listerial (A32.8†)
- siflitik (A52.0†)
- tuberkular (A18.8†)

**I68.2*** **Arteriti cerebral në sëmundje të tjera të klasifikuara tjetërkund**

Arteriti cerebral në lupusin eritematoz sistemik (M32.1†)

**I68.8*** **Çrregullime të tjera cerebrovaskulare në sëmundje të klasifikuara tjetërkund**

Apopleksia uremike në sëmundjen kronike të veshkës (N18.5†)

## I69 Pasojat e sëmundjes cerebrovaskulare

***Shënim:*** Kategoria I69 duhet përdorur për të treguar gjendjet në I60-I67.1 dhe I67.4-I67.9 si dhe pasojat (sekelat) e tyre, të klasifikuara tjetërkund. ‘Pasojat’ (‘sekelat’) përfshijnë gjendje të specifikuara si të tilla ose si efekte të vona, ose ato që shfaqen një vit apo më shumë pas shfaqjes së gjendjes shkaktare.

Nuk duhet përdorur për sëmundjet kardiovaskulare kronike. I kodoni këto në I60-I67.

**I69.0** **Pasojat e hemorragjisë subaraknoidale**

**I69.1** **Pasojat e hemorragjisë intracerebrale**

**I69.2** **Pasojat e hemorragjisë intrakraniale tjetër jotraumatike**

**I69.3** **Pasojat e infarktit cerebral**

**I69.4** **Pasojat e insultit të paspecifikuar si hemorragji apo infarkt**

**I69.8** **Pasojat e sëmundjeve të tjera dhe të paspecifikuara cerebrovaskulare**

# Sëmundjet e arterieve, arteriolave dhe kapilarëve (I70–I79)

## I70 Ateroskleroza

***Përfshin:*** arteriolosklerozën
arteriosklerozën
sëmundjen vaskulare arteriosklerotike
ateromën
degjenerimin:
- arterial
- arteriovaskular
- vaskular

endarteritin deformans ose obliterans
senil:
- arteritin
- endarteritin

***Përjashton:*** cerebrale (I67.2)
koronare (I25.1)
mezenterike (K55.1)
pulmonare (I27.0)

Klasifikimi shtesë i mëposhtëm, që tregon praninë ose jo të gangrenës, është për përdorim me nënkategoritë në I70.

**0** **pa gangrenë**

**1** **me gangrenë**

**I70.0** **Ateroskleroza e aortës**

**I70.1** **Ateroskleroza e arteries renale**

Veshka Goldblatt

***Përjashton:*** aterosklerozën e arteriolave renale (I12.-)

**I70.2 Ateroskleroza e arterieve të ekstremiteteve**

Gangrena aterosklerotike

Skleroza (mediale) e Mönckeberg

**I70.8 Ateroskleroza e arterieve të tjera**

**I70.9 Ateroskleroza e gjeneralizuar dhe e paspecifikuar**

## I71 Aneurizma dhe diseksioni i aortës

**I71.0 Diseksioni i aortës (i çdo pjese)**

Aneurizma e disekuar e aortës (e çarë) [çdo pjesë]

**I71.1 Aneurizma e aortës toracike, e rupturuar**

**I71.2 Aneurizma e aortës toracike, pa përmendur rupturë**

**I71.3 Aneurizma e aortës abdominale, e rupturuar**

**I71.4 Aneurizma e aortës abdominale, pa përmendur rupturë**

**I71.5 Aneurizma e aortës torakoabdominale, e rupturuar**

**I71.6 Aneurizma e aortës torakoabdominale, pa përmendur rupturë**

**I71.8 Aneurizma e aortës me lokalizim të paspecifikuar, e rupturuar**

Rupturë e aortës NOS

**I71.9 Aneurizma e aortës me lokalizim të paspecifikuar, pa përmendur rupturë**

Aneurizëm
Dilatacion
Nekroze hialine
} i/e aortës

## I72 Aneurizma dhe diseksione të tjera

***Përfshin:*** aneurizmën (cirsoide)(false)(e çarë)

***Përjashton:*** aneurizmën (e):

- aortës (I71.-)
- arteriovenoze NOS (Q27.3)
- arteriovenoze të fituar (I77.0)
- cerebrale (të paçarë) (I67.1)
- cerebrale të çarë (I60.-)
- koronare (I25.4)
- të zemrës (I25.3)
- arteries pulmonare (I28.1)
- retinale (H35.0)

- varikoze (I77.0)

diseksionin e:

- arteries koronare (I25.4)
- arteries precerebrale, kongjenitale (të paçarë) (Q28.1)

**I72.0 Aneurizëm dhe diseksion i arteries karotide**

**I72.1 Aneurizëm dhe diseksion i arterieve të anësive superiore.**

**I72.2 Aneurizëm dhe diseksion i arteries renale**

**I72.3 Aneurizëm dhe diseksion i arteries iliake**

**I72.4 Aneurizëm dhe diseksion i arterieve të anësive inferiore**

**I72.5 Aneurizëm dhe diseksion arterieve të tjera cerebrale**

Aneurizëm dhe diseksion i (trungut) të arteries bazilare

***Përjashton:*** aneurizmën dhe diseksionin e:

- arteries karotide (I72.0)
- arteries vertebrale (I72.6)

**I72.6 Aneurizëm dhe diseksion i arteries vertebrale**

**I72.8 Aneurizëm dhe diseksion i arterieve të tjera të specifikuara**

**I72.9 Aneurizëm dhe diseksion me lokalizim të paspecifikuar**

## I73 Sëmundje të tjera vaskulare periferike

***Përjashton:*** enjtjet nga të ftohtit e gjymtyrëve (T69.1)
dëmtimet nga ngrirja (T33–T35)
imersionin e dorës ose këmbës (T69.0)
spazma të arteries cerebrale (G45.9)

**I73.0 Sindromi Raynaud**

Raynaud:

- sëmundja
- gangrena
- fenomeni (sekondar)

**I73.1 Tromboangiti obliterant (Buerger)**

**I73.8 Sëmundje të tjera të specifikuara vaskulare periferike**

Akrocianoza

Akroparestezia:

- e thjeshtë [e llojit Schultze]
- vazomotore [e llojit Nothnagel]

Eritrocianoza

Eritromelalgia

**I73.9 Sëmundje vaskulare periferike të paspecifikuara**

Klaudikimi intermitent

Spazma e arteries

## I74 Embolia dhe tromboza arteriale

***Përfshin:*** infarktin:

- embolik
- trombotik

bllokimin:

- embolik
- Trombotik

***Përjashton:*** embolizmin dhe trombozën:

- bazilare (I63.0–I63.2, I65.1)
- karotide (I63.0–I63.2, I65.2)
- cerebrale (I63.3–I63.5, I66.9)
- që komplikon:
  - abortin ose shtatzëninë ektopike ose molare (O00-O07, O08.8)
  - shtatzëninë, lindjen ose pas lindjen (O88.-)
- koronare (I21–I25)
- mezenterike (K55.0)
- precerebrale (I63.0–I63.2, I65.9)
- pulmonare (I26.-)
- renale (N28.0)
- retinale (H34.-)
- vertebrale (I63.0–I63.2, I65.0)

**I74.0 Embolia dhe tromboza e aortës abdominale**

Sindroma e bifurkacionit aortik

Sindroma Leriche

**I74.1 Embolia dhe tromboza në pjesë të tjera të paspecifikuara të aortës**

**I74.2 Embolia dhe tromboza e arterieve të ekstremiteteve superiore**

**I74.3 Embolia dhe tromboza e arterieve të ekstremiteteve inferiore**

**I74.4 Embolia dhe tromboza e arterieve të ekstremiteteve, e paspecifikuar**

Embolizmi arterial periferik

**I74.5** **Embolia dhe tromboza e arteries iliake**

**I74.8** **Embolia dhe tromboza e arterieve të tjera**

**I74.9** **Embolia dhe tromboza e arterieve, të paspecifikuara**

## I77 Çrregullime të tjera të arterieve dhe arteriolave

***Përjashton:*** sëmundjet (vaskulare) të kolagjenit (M30-M36)
angiitin hipersensitiv (M31.0)
arterien pulmonare (I28.-)

**I77.0** **Fistula arteriovenoze, e fituar**

Variksi aneurizmal

Aneurizmi arteriovenoz, i fituar

***Përjashton:*** aneurizmin arteriovenoz NOS (Q27.3)
cerebral (I67.1)
koronar (I25.4)
traumatik – shih dëmtimet e enëve të gjakut sipas rajoneve

**I77.1** **Striktura arteriale**

**I77.2** **Ruptura arteriale**

Fistula e arteries

***Përjashton:*** çarjen traumatike të arteries -- shih dëmtimet e enëve të gjakut sipas rajoneve

**I77.3** **Displazia arteriale fibromuskulare**

**I77.4** **Sindromi i kompresionit të arteries celiake**

**I77.5** **Nekroza e arteries**

**I77.6** **Arteriti, i paspecifikuar**

Aortiti NOS

Endarteriti NOS

***Përjashton:*** arteritin ose endarteritin:

- e harkut aortik [Takayasu] (M31.4]
- cerebral NEC (I67.7)
- koronar (I25.8)
- deformans (I70.-)
- me qeliza gjigante (M31.5–M31.6)
- obliterans (I70.-)
- senil (I70.-)

**I77.8** **Çrregullime të tjera të specifikuara të arterieve dhe arteriolave**

Erozion | i/e arteries

Ulçer

**I77.9 Çrregullime të arterieve dhe arteriolave, të paspecifikuara**

## I78 Sëmundjet e kapilarëve

**I78.0 Teleangiektazia hemorragjike hereditare**

Sëmundja Rendu-Osler-Weber

